# RAPORT I MONITORIMIT TË

# ZBATIMIT TË BUXHETIT 12 M VITI 2022

# BASHKIA SHKODER

***Shkurt   2023***

**REALIZIMI I BUXHETIT TË 12 M TE VITIT 2022** .......... 4

**REALIZIMI I TE ARDHURAVE TE BASHKISË NGA BURIMET E VETA VENDORE PËR 12 M E VITIT 2022** .......... 6
Kategorizimi i të ardhurave 8
Realizimi i të ardhurave nga burimet e veta vendore 9
Analiza e peshës specifike sipas kategorive 17
Analiza e peshës specifike sipas zërave 17
Fluksi monetar mujor i të ardhurave të veta, viti 2022 18
Realizimi i të ardhurave 2022, krahasuar me vitete kaluara 19
Analiza e zërave kryesore që kanë ndikuar tek të ardhurat e veta të bashkisë ndër vite 19

**REALIZIMI I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË 12 M TE VITIT 2022** .......... 27
Shpenzimet nga transferta e pakushtezuar dhe te ardhurat e veta vendore 47
Transferta e pakushtezuar sektoriale 54
Transferta e kushtëzuar 58
Shpenzimet nga fondet e trasheguara 61

**VETËVLERËSIMI FINANCIAR PER PERIUDHEN 12 M 2022 PER SITUATEN E GJENDJES FINANCIARE TE BASHKISË SHKODER** .......... 63

**FUNKSIONI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE** .......... 65
Programi 01110: Planifikim, menaxhim dhe administrim 65
Programi 01170: Gjendja Civile 88

**FUNKSIONI 03: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE** .......... 93
Programi 03140: Shërbimet Policore Vendore 93
Programi. 03280: Emergjencat Civile 99

**FUNKSIONI 4: ÇËSHTJET EKONOMIKE** .......... 107
Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik 107
Programi 04160: Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi 98
Programi 04220: Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve 103
Programi 04240: Menaxhimi i insfrastruktures së ujitjes dhe kullimit 108
Programi 04260: Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave 113
Përshkrimi i objektivave 113
Programi 04520: Rrjeti rrugor rural 120
Programi 04570: Transporti publik dhe lëvizshmëria 134
Programi 04760: Zhvillimi i Turizmit 140

**FUNKSIONI 05: MBROJTJA E MJEDISIT** .......... 151
Programi 05100: Menaxhimi i mbetjeve 151
Programi 05200: Menaxhimi i ujërave të zeza 158

Programi 05320: Programet e Mbrojtjes së Mjedisit 164
Programi 05630: Ndërgjegjësimi Mjedisor 170

**FUNKSIONI 06: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT ............................ 175**
Programi 06140: Urbanistika 175
Programi 06330: Furnizimi me ujë 187
Programi 06440: Ndriçimi i rrugëve 193

**FUNKSIONI 07: SHËNDETËSIA ........................................................................................ 200**
Programi 07220: Shërbimet e kujdesit parësor 202

**FUNKSIONI 8: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA ................................................................ 208**
Programi 08130: Sport dhe argëtim 208
Programi 08220:Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore 224

**FUNKSIONI 09: ARSIMI ............................................................................................... 253**
Programi 09120: Arsimi baze parashkollor 253
Programi 09230: Arsimi i mesem i pergjithshem 266
Programi 09240: Arsimi mesem Profesional 274

**FUNKSIONI 10: MBROJTJA SOCIALE.......................................................................... 283**
Programi 10430: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët 283
Programi 10661: Strehimi social 322

## Realizimi i buxhetit të 12 M te vitit 2022

Realizimi i buxhetit te 12 M te vitit 2022, është bërë, duke respektuar nenin 64 te ligjit 139/2015 " *Per veteqeverisjen vendore* ", i ndryshuar, ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " *Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise*", të ndryshuar , ligjin nr 68/2017 date 27.4.2017 " *Per financat e veteqeverisjes vendore* ", ligjin nr. 10296 date 8.7.2010 "*Per menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, ligjin 115/2021 datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022" i ndryshuar , udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22 date 30.07.2018 "*Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit te njesive te qeverisjes vendore*", udhezimi nr. 9 date 20.03.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit* " , Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*" i ndryshuar, Udhëzimin Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1 datë 10.01.2022 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022*" , VKB nr. 3 datë 5.1.2022 "*Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër* " i ndryshuar.

Bashkia Shkoder, administron dhe menaxhon fondet, sipas programeve të miratuara, si më poshtë:

Funksioni 1 SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE
- Programi - 01110: Planifikim menaxhim administrim
- Programi - 01170: Gjendja civile

Funksioni 3 RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE
- Programi - 03140: Sherbimet policise vendore
- Programi - 03280: Mbrojtje nga zjarri dhe mbrojtja civile"

Funksioni 4 ÇESHTJE EKONOMIKE
- Programi - 04130: Mbeshtetje per zhvillim ekonomik
- Programi - 04160:Sherbimet e tregjeve,akreditimi dhe inspektimi
- Programi-04220:Sherbimetbujqesore,inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorit
- Programi - 04240: Menaxhimi i infrastruktures se ujitjes dhe kullimit
- Programi - 04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave
- Programi - 04520: Rrjeti rrugor rural
- Programi - 04570: Transporti publik
- Programi - 04760: Zhvillimi i turizmit

Funksioni 5 MBROJTJA E MJEDISIT
- Programi - 05100: Menaxhimi i mbetjeve
- Programi - 05200: Menaxhimi i Ujravetezeza dhe kanalizimeve
- Programi - 05320: Programet e mbrojtjes se mjedisit
- Programi - 05630: Ndergjegjesimi mjedisor

Funksioni 6 STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT
- Programi - 06140: Planifikim urban vendor

Programi - 06260: Sherbimet Publike vendore
Programi - 06330: Furnizimi me uje
Programi - 06440: Ndricim rrugesh

Funksioni 7 SHENDETESIA
Programi - 07220: Sherbimet e kujdesit paresor

Funksioni 8 ARGETIMI KULTURA DHE FEJA
Programi - 08130: Sport dhe argetim
Programi - 08220: Trashegimia kulturore, eventetartistike dhe kulturore

Funksioni 9 ARSIMI
Programi - 09120: Arsimi baze perfshire arsimi parashkollor
Programi - 09230: Arsimi i mesem i pergjithshem
Programi - 09240: Arsimi profesional

Funksioni 10 MBROJTJA SOCIALE
Programi - 10430: Kujdesi social per familjet dhe femijet
Programi - 10661: Strehimi social

Burimet e financimit te buxhetit të Bashkisë, vijnë nga dy burime:

**Nga burimet e veta vendore,** ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, te ardhurat nga tarifat vendore, te ardhura te tjera, donacione, grante nderkombetare dhe te ardhura qe trashegohen.

**Nga burimet qendrore,** ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e transferuara dhe transferta e kushtëzuar.

**Buxheti i 12 M te vitit 2022 , ne total ne 000/leke me te gjitha burimet e financimit te realizuara, paraqitet si me poshte:**

*000/leke*

| Nr | TE HYRAT DHE FINANCIMET NE LLOGARITE E THESARIT | Plani Fillestar 2022 | Plani Korrigjuar 2022 | Finacim i realizuar |
|---|---|---|---|---|
| **I** | **TE ARDHURAT E VETA** | **896,109** | **896,109** | **880,748** |
| | Të ardhura nga taksat vendore | 346,037 | 346,037 | 344,708 |
| | Të ardhura nga taksat e ndara | 127,155 | 127,155 | 118,568 |
| | Te ardhura nga tarifat vendore | 355,259 | 355,259 | 353,966 |
| | Të ardhura të tjera | 67,658 | 67,658 | 63,506 |
| **II** | **GRANTE NDERKOMBETARE** | 1,832 | 3,206 | 1,478 |
| **III** | **TRANSFERTAT** | **2,184,106** | **2,183,755** | **2,183,755** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **1** | Transferte e Pakushtezuar | 665,861 | 665,861 | 665,861 |
| **2** | Transferte e Pakushtezuar Sektoriale | 404,020 | 417,285 | 417,285 |
| **3** | Transferte specifike per mbrojtjen e mjedisit | 15,000 | 15,000 | 15,000 |
| **3** | Transferte e kushtezuar | 1,099,225 | 1,085,609 | 1,085,609 |
| **IV** | **TE TRASHEGUARA** | **89,081** | **190,605** | **190,605** |
| **1** | Transferte e pakushtezuar | 46,065 | 94,289 | 94,289 |
| **2** | Transferte e Pakushtezuar Sektoriale | 16,727 | 27,777 | 27,777 |
| **3** | Te ardhura | 24,804 | 67,054 | 67,054 |
| **4** | Donacione | 1,485 | 1,485 | 1,485 |
| | **TOTALI** | **3,171,128** | **3,273,675** | **3,256,586** |
| | Shpenzime me llogari jashte thesari | 32,445 | 54,185 | 54,185 |
| | **TOTALI VITI 2022** | **3,203,573** | **3,327,860** | **3,310,771** |
| **1** | Transferte e pakushtezuar | 209,307 | 161,083 | 161,083 |
| **2** | Transferte e Pakushtezuar Sektoriale | 62,696 | 51,646 | 51,646 |
| **4** | Te ardhura | 540,997 | 414,648 | 414,648 |
| **5** | Donacione | 8,692 | 8,692 | 8,692 |
| | **TE TRASHEGUARA** | **821,692** | **636,069** | **636,069** |
| | Shpenzime me llogari jashte thesari te trasheguara | **33,954** | **33,954** | **33,954** |
| | **TOTALI TE TRASHEGUARA** | **855,646** | **670,023** | **670,023** |
| | **TOTALI** | **4,059,221** | **3,997,882** | **3,980,794** |

## Realizimi i te ardhurave te Bashkisë nga burimet e veta vendore për 12 M e vitit 2022.

Bashkia Shkodër, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ka të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe kryerjes së shpenzimeve. Financimin e buxhetit të saj, bashkia e realizon nga:

**a**. burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera dhe të ardhura që trashëgohen;

**b**. grantet e projekteve të huaja dhe donacionet;

**c**. burimet qendrore**,** ku përfshihen transferta e pakushtëzuar,transferta e kushtëzuardhe transferta specifike.

Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efiçencë të aseteve të veta, implementimit të proçedurave online e të thjeshta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të proçedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë. Objektivat kryesisht të fokusuara në lehtësimin maksimal fiskal dhe shpëndarjen e drejtë të ngarkesës tatimore, kanë ndikuar në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësimi i shlyerjes së pagesave pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpermjet zyrave me Një Ndalese dhe agjentit tatimor Ujesjelles Kanalizime të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, si dhe shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshem të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin. Objektivat e përcaktuar e të realizuar, dhe që kanë ndikuar në përmirësimin e klimës së biznesit, duke ruajtur e madje duke rezultuar si politika efikase në rritjen e të ardhurave, jane ulja e taksave të pronës deri në mimimumin ligjor të lejuar, mbeshtetja e disa aktiviteteve të veçanta si bizneset e prodhimit, lehtësimi kryesisht i bizneseve të vogla, mbështetja me tarifa zero për fermerët, tarifa minimale për tregjet dhe ambulantët etj, me rezultat dhenie frymëmarrje financiare biznesit si dhe Vendimit nr.25, datë 26.06.2020 “Për disa ndryshime në VKB NR.1, datë 22.1.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar përjashtimin nga taksat dhe tarifat vendore për një periudhë tre mujore të vitit 2020, për të gjitha kategoritë e taksapaguesveindividë, familje,persona fizik dhe juridik, ambulant, OJF, institucione publike në të gjithëterritorin e Bashkisë Shkodër.
Politikat e ngjashme për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqësore, mundësia e arkëtimit në këste dhe pranë njësive administrative ku banojne etj, janë zbatuar dhe kanë rezultuar të suksesshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për vetë rritjen e arkëtimeve nga viti në vit. Keto politika të lehtësimit fiskal dhe inçentivues, shoqëruar paralelisht me përmiresimin e vazhdueshëm të shërbimit, kanë ndikuar pozitivisht edhe në objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga taksapaguesi familjar, kundrejt fokusimit për uljen e barrës fiskale nga ana tjetër, vërteton efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që bashkia ka arritur në rritjen e bazës së taksapaguesve, si familjar, ashtu edhe atij biznes. Vëmendje e veçantë gjate vitit 2022 i është kushtuar monitorimit të detajuar dhe implementimi i regjistrave të sakte elektronikë të kapaciteteve fiskale, duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye ju kushtua vëmendje e veçantë dhe mbështetje logjistike më tej strukturave e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve, u ushtruan verifikime te vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave dhe dixhitalzimin e tyre, me efekt arritjen e rezultate shumë të mira në pothuajse të gjithë zërat kryesore të të ardhurave. Kujdes

të veçantë gjatë vitit 2022 ju kushtua përmirësimit të mëtejshëm të sistemeve të kompjuterizuara, detajimit të raporteve, emetimit të statistikave, saktësimit dhe detajimit të të dhënave për bizneset, etj. Sot është e mundur hedhja on-line në sistemin e taksave të gjobave të IMT dhe Policisë Bashkiake, llogaritja automoatike e kamatvonesave, llogaritja e menjëhershme dhe emetimi i akt-marrëveshjeve pranë Z1N për subjektet shfytëzuese të hapsirave publike, parkingjeve, ambulantëve etj. Vazhdon perdorimi i aplikacionit për smartphone "Taksat e Mia Shkodër", ku mundësohet llogaritja e taksës së ndërtesës, truallit dhe tokës bujqësore sipas adresave, vitit fiskal, dhe kategorisë familjare. Objektivi kryesor për realizimin e të ardhurave buxhetore të planifikuara është realizuar në masën 98% (taksa dhe tarifa vendore) , referuar planifikimit buxhetor. Mosrealizimi i planit buxhetor me 100% të vitit 2022 ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i taksës së tokës bujqësore e cila është realizuar në masën 29 %, si rrjedhim i mosregjistrimit te pronave të tokës bujqësore, problemeve me Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi. Referuar arkëtimeve mujore gjatë vitit 2022, është siguruar njëtrajtshmëri në nivelet e të hyrave mujore, duke garantuar kështu të ardhurat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë për gjithë periudhën e vitit buxhetor. Të ardhurat e veta u realizuan nga administrata e bashkisë, Njësitë Administrative, Institucionet dhe agjentët tatimorë, institucionet shtetërore etj. Vijimi i performancës së punës dhe i procesit bashkëpunues, garanton më tej sigurimin e të ardhurave të veta buxhetore vjetore për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë.
Bashkia Shkodër me burimet e veta arriti të menaxhojë situatën dhe të ofrojë shërbimet e duhura ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj.

## Kategorizimi i të ardhurave

- Taksat vendore:
    - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
    - Taksa e ndikimit në infrastrukturë
    - Taksa e fjetjes në hotel
    - Tatimi thjeshtuar mbi fitimin, biznesi vogël nga 5-8 milion, agjent DRT Shkodër
    - Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi

- Taksat e ndara:
    - Taksa vjetore e e qarkullimit te mjeteve
    - Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë, agjent tatimor ASHK
    - Taksa e rentës minerare
    - Tatimi mbi të ardhurat personale

- Tarifat vendore
    - Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
    - Tarifa për ndriçimin publik
    - Tarifa për gjelbrimin
    - Tarifa të shërbimit administrativ
    - Tarifa për parkimin e mjeteve e liçensuara dhe vendparkime publike
    - Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri

- Tarifa për zënien e hapësirave publike
- Tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj

- Të ardhura të tjera:
  - Të ardhura nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.
  - Të ardhura nga kundravajtjet administrative
  - Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve
  - Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime
  - Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e sherbimeve
  - Grante nga ndihma nderkombetare
  - Te ardhura nga donacione/sponsorizime
  - Të ardhura te tjera (komision si agjent tatimor).

## Realizimi i të ardhurave nga burimet e veta vendore

| Të ardhurat nga Burimet e Veta Vendore /mijë lekë | **970,365** |
|---|---|
| Të ardhura nga taksat | 344,708 |
| Të ardhura nga taksat e ndara | 118,568 |
| Të ardhura nga tarifat | 353,966 |
| Të ardhura nga burime të tjera vendore | 153,123 |

Të ardhurat nga burimet e veta vendore për vitin 2022 arritën vlerën 970,365 mijë Lekë. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga taksat e ndara, të ardhura nga tarifat dhe të ardhura të tjera ku përfshihen edhe të ardhruat nga Grante ndhima ndërkombëtare.

**Realizimi i të ardhurave në lidhje me planin**

Realizimi i planit të të ardhurave në total është në masën 104%

mijë/lek

| Bashkia Shkodër,Realizimi i të ardhurave Viti 2022 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Bashkia Shkoder | | |
| | LLOJET E TË ARDHURAVE | Plan viti 2022 | Realizimi viti 2022 | Krahasimi në % me planin 2022 |
| A | TË ARDHURAT E VETA | 931,758 | 970,365 | 104% |
| A.I | TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE | 346,037 | 344,708 | 100% |
| I.1 | Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për BV | 5,000 | 2,175 | 44% |
| I.1.0 | Të ardhura nga taksa mbi BV | 1,000 | 63 | 6% |
| I.2 | Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 182,348 | 187,954 | 103% |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| I.2.1 | Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat | 147,190 | 167,173 | **114%** |
| *I.2.1.1* | *Ndërtesa banimi* | *67,564* | 78,598 | **116%** |
| *I.2.1.2* | *Ndërtesa të tjera* | *79,626* | 88,574 | **111%** |
| 1.2.2 | Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore | 21,736 | 6,226 | **29%** |
| 1.2.3 | Të ardhura nga taksa mbi truallin | 13,422 | 14,555 | **108%** |
| **I.3** | **Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel** | **20,500** | **18,408** | **90%** |
| **I.4** | **Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë** | **121,044** | **121,182** | **100%** |
| *I.4.1* | *Nga ndërtimet e reja* | *96,835* | 105,505 | **109%** |
| *I.4.2* | *Ndertimet ne proçes legalizimi* | *24,209* | 15,677 | **65%** |
| **I.5** | **Të ardhura nga taksa e tabelës** | **16,145** | **14,926** | **92%** |
| *I.5.1* | *Takse Tabele* | *8,880* | 14,926 | **168%** |
| *I.5.2* | *Takse Reklame* | *7,265* | 0 | |
| **A.II** | **TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA** | **127,155** | **118,568** | **93%** |
| **II.1** | **Të ardhura nga taksa vjetore e qarkullimit te mjeteve** | **90,000** | **70,780** | **79%** |
| **II.2** | **Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë** | **15,120** | **18,935** | **125%** |
| **II.3** | **Të ardhura nga taksa e rentës minerare** | **35** | **6** | **19%** |
| **II.4** | **Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale** | **22,000** | **28,847** | **131%** |
| **A.III** | **TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE** | **355,259** | **353,966** | **100%** |
| **III.1** | **Te ardhura nga tarifa e pastrimit, largimit të mbeturinave** | **171,363** | **183,336** | **107%** |
| III.1.1 | Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Familje | 75,328 | 72,621 | **96%** |
| III.1.2 | Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Institucione | 464 | 504 | **109%** |
| III.1.3 | Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Biznesi | 95,571 | 110,212 | **115%** |
| **III.2** | **Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik** | **52,935** | **42,339** | **80%** |
| III.1.1 | Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga Familje | 32,080 | 25,422 | **79%** |
| III.1.2 | Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Institucione | 163 | 96 | **59%** |
| III.1.3 | Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Biznesi | 20,692 | 16,821 | **81%** |
| **III.3** | **Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin** | **23,541** | **23,486** | **100%** |
| III.1.1 | Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga Familje | 9,907 | 10,601 | **107%** |
| III.1.2 | Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Institucione | 160 | 79 | **49%** |
| III.1.3 | Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Biznesi | 13,474 | 12,806 | **95%** |
| **III.5** | **Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ** | **107,420** | **104,804** | **98%** |
| III.5.1 | Nga tarifa administrative, kontroll territorit, AMTP, etj. | 4,500 | 13,701 | **304%** |
| III.5.2 | Nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura | 0 | 0 | |
| III.5.3 | Nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit | 1,400 | 1,513 | **108%** |
| III.5.4 | Nga tarifa parkimi për mjetet | 9,600 | 4,920 | **51%** |
| III.5.5 | Nga tarifë për dhënie liçensa për tregtimin e naftës | 22,000 | 17,649 | **80%** |
| III.5.6 | Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave. | 1,900 | 459 | **24%** |
| III.5.7 | Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ | 660 | 1,487 | **225%** |
| III.5.8 | Nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 40,050 | 47,652 | **119%** |
| III.5.9 | Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille | 1,400 | 0 | **0 %** |
| III.5.10 | Nga linjat ajrore dhe nëntokësore | 500 | 195 | **39%** |
| III.5.11 | Nga dokumentat për tender, ankand etj. | 15 | 6 | **40%** |
| III.5.12 | Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit | 4,000 | 9 | **0%** |
| **III.1.11** | **Nga tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj** | **21,395** | **17,215** | **80%** |
| III.1.11.1 | *Biblioteka "Marin Barleti"* | *15* | 9 | **60%** |
| III.1.11.2 | *Muzeumet* | *2,600* | 2,246 | **86%** |
| III.1.11.3 | *Teatri "Migjeni"* | *1,750* | 306 | **17%** |
| III.1.11.4 | *Qendra Kulturore e fëmijëve* | *0* | 0 | |
| III.1.11.5 | *Pallati sportit " Qazim Dervishi"* | *0* | 0 | |
| III.1.11.6 | *Stadiumi Loro Borici* | *0* | 0 | |
| III.1.11.7 | *Qendra Komunitare* | *0* | 21 | |
| III.1.11.8 | *Nga mensat (konviktet)* | *30* | 17 | **58%** |
| III.1.11.9 | *Nga kopshtet* | *11,500* | 9,846 | **86%** |
| III.1.11.10 | *Nga çerdhet* | *5,500* | 4,769 | **87%** |
| **A.IV** | **TË ARDHURA TË TJERA** | **103,307** | **153,123** | **241%** |
| **IV.1** | **Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)** | **20,000** | **17,996** | **90%** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *IV.1.1* | *Gjobe Kësti* | *9,500* | 13,804 | **145%** |
| *IV.1.2* | *Gjoba Policia Ndërtimore* | *9,000* | 3,417 | **38%** |
| *IV.1.3* | *Gjobe Gjendja Civile* | *0* | 0 | |
| *IV.1.4* | *Gjobe Policia Bashkiake* | *1,500* | 776 | **52%** |
| **IV.2** | **Të ardhura nga dhënia me qira** | **3,190** | **3,668** | **115%** |
| **IV.3** | **Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime** | **3,091** | **1,668** | **54%** |
| **IV.4** | **Grante nga ndihma nderkombetare** | **35,650** | **88,139** | **247%** |
| **IV.5** | **Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e sherbimeve** | **1,250** | **215** | **17%** |
| **IV.6** | **Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara** | **0** | **0** | |
| **IV.7** | **Shitja e aseteve financiare** | **39,762** | **39,763** | **100 %** |
| **IV.8** | **Të ardhura nga privatizimi** | **0** | **0** | |
| **IV.9** | **Të ardhura te tjera** | **364** | **197** | **54%** |
| **IV.10** | **Të ardhura nga garanci financiare** | **0** | **0** | |
| **IV.11** | **TË ARDHURA NGA DONACIONET** | **0** | **1,478** | **100 %** |

Grafiku i mëposhtëm paraqet nivelin e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave sipas kategorive kryesore.



Grafiku i  mëposhtëm pasqyron përqindjen e realizimin të ardhurave për zërat kryesorë, në raport me planin.



Zërat kryesorë, që janë me tejkalim në krahasim me planin e vitit 2022 janë të ardhurat nga taksa mbi ndërtesën, taksa mbi truallin , mbi kalimin e të drejtës së pronësisë, tarifat e pastrimit, zënia e hapësirës publike që vijnë si rezultat i mbledhjes së detyrimeve aktuale po ashtu edhe atyre të prapambetura nëpërmjet bllokimit të llogarive të biznesit apo akt-marrëveshjeve për pagesë me këste.

Të ardhurat për këto zëra janë realizuar me tejkalim si rezultat i zgjerimit së bazës taksapaguesesi efekt i rritjes së kontrollit në terren dhe realizimit të 2581 akt-kontrolleve, ushtrimit të masave shtrënguese ligjore rreth 350 bllokime llogari bankare, sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit të takapagueve nëpërmjet njoftimeve në media dhe në ëeb, nëpërmjet dërgimit të rreth 5.080 njoftim-detyrimeve, përmirësimit të sistemit informatik SiTTV dhe lidhjes me Zyrën me 1Ndalesë, rivlersimit të kategorive dhe aktivitetit të subjekteve, mbështetjes nga agjentët tatmorë etj.

Në realizimin e planit kanë ndikuar gjithashtu edhe donacionit, Grantet , si dhe shitja e titujve të pjesëmarrjes në ndërmarrjet shtetërore "Klubi Futbollit Vllaznia.

Zërat ndikues me mosrealizim janë taksa e tokës bujqësore, si rezultat i mungesës së informacionit të plotë nga ASHK me pasojë vështirësinë e krijimit të regjistrave të saktë që lidhin pronën dhe taksapaguesin e taksës së tokës bujqësore. Këto diferenca në të ardhurat buxhetore totale plotësohen nga zëra të tjerë me tejkalim dhe kanë ndikuar në realizimin e mbledhjes së të ardhurave në masën 104 % për taksa dhe tarifa dhe Grante nda ndihma ndërkombëtare.

Agjenti tatimor Ujësjellës Kanalizime sh.a vazhdon të jetë i bllokuar nga subjekte të treta, shoqëri përmbarimore në bankat e nivelit të dytë, dhe si pasojë detyrimi që Ujësjellës Kanalizime sh.a ka ndaj Bashkisë Shkodër nuk është transferuar në llogari të saj Nga ana e Bashkisë Shkodër janë marrë masa për gjetjen dhe ndjekjen e rrugëve ligjore për transferimin e shumave përkatëse të palikujduara duke u bazuar në akt marrëveshjen e lidhur Ujësjellës Kanalizime sha dhe korrespondencën me bankat e nivelit të dytë .

**Realizimi i të ardhurave sipas Njësive Administrative**

Tabela e mëposhtme pasqyron realizimin e të ardhurave në çdo njësi administrative gjatë vitit 2022, të kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik në 000/lekë.

**Plani - Realizimi i të Ardhurave, viti 2022**

| | | Bashkia Shkoder | Njësia Qendër | Postribë | Guri i Zi | Bërdicë | Velipojë | Dajç | Ana e Malit | Rrethina | Pult | Shosh | Shalë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **LLOJET E TË ARDHURAVE** | **Realizimi viti2022** | **Realizimi viti 2022** | **Realizimi viti 2022** | **Realizimi viti 2022** | **Realizimi viti 2022** | **Realizimi viti 2022** | **Realizimi viti 2022** | **Realizimi viti 2022** | **Realizimi viti 2022** | **Realizimi viti 2022** | **Realizimi viti 2022** | **Realizimi viti 2022** |
| **A** | **TË ARDHURAT E VETA** | **970,365** | **811,908** | **4,408** | **9,027** | **12,456** | **98,872** | **5,030** | **4,008** | **22,996** | **187** | **67** | **1,407** |
| **A. I** | **TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE** | **344,708** | **261,973** | **1,911** | **5,715** | **5,368** | **53,829** | **2,056** | **1,630** | **11,030** | **128** | **34** | **1,032** |
| **I.1** | **Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël** | **2,175** | **2,175** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| **I.1 .0** | **Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)** | **63** | **63** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| **I.2** | **Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme** | **187,954** | **138,063** | **1,823** | **1,972** | **2,513** | **34,159** | **2,022** | **806** | **5,889** | **95** | **34** | **577** |
| **I.3** | **Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel** | **18,408** | **6,135** | **0** | **0** | **0** | **11,569** | **0** | **0** | **253** | **0** | **0** | **451** |
| **I.4** | **Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja** | **121,182** | **102,443** | **80** | **3,706** | **2,528** | **7,661** | **34** | **540** | **4,157** | **32** | **0** | **0** |
| **I.5** | **Të ardhura nga taksa e tabelës** | **14,926** | **13,094** | **8** | **37** | **327** | **441** | **0** | **284** | **731** | **0** | **0** | **4** |
| **A. II** | **TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA** | **118,568** | **118,568** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| **II. 1** | **Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura** | **70,780** | **70,780** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| **II. 2** | **Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme** | **18,935** | **18,935** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| **II.** | **Të ardhura nga taksa e rentës** | **6** | **6** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | minerare | | | | | | | | | | | | |
| II. 4 | **Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale** | **28,847** | **28,847** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| **A. III** | **TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE** | **353,966** | **280,775** | **2,393** | **3,214** | **6,952** | **44,241** | **2,873** | **2,318** | **10,780** | **59** | **29** | **330** |
| III .1 | **Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave** | **183,336** | **161,784** | **1,448** | **2,419** | **2,647** | **5,458** | **1,538** | **1,023** | **6,721** | **41** | **29** | **226** |
| III .2 | **Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik** | **42,339** | **39,477** | **206** | **346** | **268** | **1,010** | **227** | **123** | **675** | **8** | **0** | **1** |
| III .3 | **Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin** | **23,486** | **22,724** | **15** | **53** | **45** | **562** | **0** | **0** | **88** | **0** | **0** | **0** |
| III .5 | **Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë** | **104,804** | **56,790** | **724** | **396** | **3,992** | **37,212** | **1,108** | **1,172** | **3,297** | **10** | **0** | **104** |
| **A. IV** | **TË ARDHURA TË TJERA** | **153,123** | **150,591** | **103** | **98** | **136** | **801** | **101** | **60** | **1,185** | **0** | **3** | **44** |
| IV .1 | **Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)** | **17,996** | **15,923** | **103** | **98** | **136** | **583** | **101** | **60** | **944** | **0** | **3** | **44** |
| IV .2 | **Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë** | **3,668** | **3,643** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **25** | **0** | **0** | **0** |
| IV .3 | **Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime** | **1,668** | **1,440** | **0** | **0** | **0** | **218** | **0** | **0** | **10** | **0** | **0** | **0** |
| IV .4 | **Grante nga ndihma nderkombetare** | | **88,139** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| IV .5 | **Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e sherbimeve** | **215** | **9** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **206** | **0** | **0** | **0** |
| IV .6 | **Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| IV .7 | **Shitja e aseteve financiare** | | **39,763** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| IV .8 | **Të ardhura nga privatizimi** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| IV .9 | **Të ardhura te tjera** | **197** | **197** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| IV .10 | **Të ardhura nga garanci financiare** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| IV .11 | **TË ARDHURA NGA DONACIONET** | **1,478** | **1,478** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |

Grafiku paraqet planin dhe realizimin e të ardhurave për secilën Njësi Administrative më vehte.






**Analiza e peshës specifike sipas kategorive**

Pjesën më të madhe të të ardhurave e përbëjnë të ardhurat nga tarifat me 36% dhe të ardhurat nga taksat me 36% të totalit.

Grafiku i mëposhtëm peshën e të ardhurave sipas kategorive:




**Analiza e peshës specifike sipas zërave**

Të ardhurat që mbulojnë pjesën më të madhe të realizimit nga burimet e veta për vitin 2022 janë zërat e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga bizneset dhe familjet me 19% të të ardhurave të veta, taksa mbi ndërtesat për biznese dhe banesa me 17%, taksa e ndikimit në infrastrukturë 12%, taksa vjetore e mjeteve te përdorura 7 %, tarifa për zënien e hapësirës publike 5%, tarifa e ndriçimit publik 4%, tarifa e gjelbërimit 2%, taksa e tabelës 2 %, tarifa nga institucionet e varësisë me 2 %, taksa e fjetjes në hotel 2%, gjobat 2%, taksa mbi truallin 1 %, etj.

Grafiku vijues paraqet peshën specifike sipas zërave kryesorë të ardhurave të veta të realizuara pë vitin 2022.




**Fluksi monetar mujor i të ardhurave të veta, viti 2022**

Falë fokusimit për zgjerim të vazhdueshëm të bazës taksapaguese, evidentimit të kapaciteteve, ndjekjes së hapave ligjorë ndaj subjekteve debitore, etj., të ardhurat kanë ruajtur një nivelet konstant të arkëtimeve, duke siguruar kështu plotësimin buxhetor dhe fluiditetin e nevojshëm financiar në ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë.

**Fluksi monetar i të ardhurave viti 2022**




| | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Series1 | 53,424 | 58,140 | 87,141 | 63,766 | 86,667 | 186,289 | 53,436 | 49,314 | 45,671 | 59,804 | 77,220 | 61,352 |

Referuar arkëtimeve të të gjithë vitit, niveli më i lartë i arkëtimit është në muajin Mars, Qershor dhe Nentor-Dhjetor, periudha të përcaktuara për afatin e fundit të shlyerjes së detyrimit nga

biznesi sipas VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”të ndryshuar dhe falë efektit të njoftimit, sensibilisimit dhe ndjekjes së masave administrative shtrënguese të ushtruara ndaj subjekteve debitore.

**Realizimi i të ardhurave 2022, krahasuar me vitete kaluara**

| Emertimi /000 Lekë | Viti 2015 | Viti 2016 | Viti 2017 | Viti 2018 | Viti 2019 | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Totali** | **482.687** | **506.154** | **612.033** | **702.144** | **682,069** | **659,778** | **738,309** | **882,226** |
| Taksat vendore | 244,549 | 195,811 | 278,096 | 280,071 | 268,810 | 233,917 | 259,082 | 344,708 |
| Taksat e ndara | 57,5 | 54,448 | 57,207 | 81,214 | 94,614 | 126,722 | 164,666 | 118,568 |
| Tarifat vendore | 171,122 | 239,277 | 241,838 | 305,624 | 287,610 | 274,154 | 287,445 | 353,966 |
| Burime të tjera vendore | 9,515 | 16,618 | 34,892 | 35,235 | 31,034 | 24,985 | 27,116 | 64,984 |

Krahasuar me vitin 2021, realizimi i të ardhurave ka një rritje me rreth +143,917 mijë Lekë, ose **19% më shumë se viti i kaluar**. Kjo rritje vjen si rezultat i përformancës pozitive në arkëtimin e detyrimeve aktuale dhe të prapambetura. Në programimin e të ardhurave për vitin 2022 Bashkia Shkodër u tregua e kujdesshme me qëllim parashikimin afatgjatë të pasojave të pandemisë dhe efektin negativ që mund të shkaktonte në mbledhjen e të ardhurave, por hapja shkallë-shkallë dhe sezoni i verës, i cili rigjallëroi turizmin dhe të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë ndikoi pozitivisht në rritjen të ardhurave dhe përmbushjen e objektivave të vendosur.

**Analiza e zërave kryesore që kanë ndikuar tek të ardhurat e veta të bashkisë ndër vite**



Detyrimi i taksës së pasurisë për biznesin shlyhet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe shlyhet së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë te Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Sh.A. Shkodër, në cilësinë e agjentit tatimor.

Taksa e *ndërtesës*, krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rritje në nivelin e arketimit me +21% më shumë ose 28,470 mijë lekë .
Rritja në arkëtimin e të ardhurave nga ndërtesat për qëllimi biznesi, ka ardhur si rezultat i përmirësimit të situtatës së krijuar nga pandemia, rritjes së numrit të njësive të biznesve të reja dhe zgjerimit të aktiviteteve të bizneseve në plazhin e Velipojës si dhe ndjekjes dhe arkëtimit të detyrimeve të prapambetura ne mënyrë rigoroze.
Gjatë vitit 2022, jane rregjistruar rreth 827 bisnese te reja krahasuar me 681 biznese te reja në vitin 2021, pra rreth 146 biznese më shumë.
Taksa e *truallit*, krahasuar me vitin e kaluar, është pothuejse në të njëjtat nivele arkëtimi me + 1% më shumë ose me +1.134 mijë Leke më shumë se vitin e kaluar.
Taksa e *tokës bujqësore*, krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar një rënie me -2,057 mijë më pak. Për efekt të lehtësimit fiskal për fermerët, në gjithë bashkinë Shkodër niveli i taksës së tokës bujqesorë është ulur me 30%, pra deri në nivelin e lejuar të refencës ligjore, me ndikim nxitjen e fermerëve, por dhe në zgjerimin e bazës së taksapaguesve.

Janë përfshirë falë monitorimit të sistemit të Z1N në skemën e pagesave të taksave dhe tarifave familjare rreth 695 familje, nga të cilat 324 familje në qytet dhe 371 familje në Nj.A., të cilat janë faturuar në Sistemin e Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Shkodër.

Zgjerimi i bazës taksapaguese dhe rritja e arkëtimit ka ardhur si rezultat i verifikimeve të kapaciteteve dhe krijimit dhe formalizimit të bazës së të dhënave, i kontakteve konstante në terren me subjektet dhe familjarët, nxitjes së vazhdueshme të debitorëve, si dhe i politikave lehtësuese, nxitëse e sensibilizuese të bashkisë.



Tatim fitimi i biznesit të vogël administrohet, pas miratimit të ndryshimeve ligjore sipas ligjit 142/2015 dt 17.12.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, datë 30/08/2006 "Për sistemin e taksave vendore", dhe Ligjit Nr. 122/2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar arkëtohet nga bizneset e vogla,dhe më pas i transferohet bashkisë nga drejtoria tatimore, në rolin e agjentit tatimor.




Kjo taksë zë një nga zërat më të rëndësishëm tek të ardhurat e veta të bashkisë. Në raport me vitin e kaluar kjo taksë ka një rritje të konsiderueshme në arkëtim me +55,495 mijë Lekë ose + 84 më shumë, si rezultat i ndjekjes së të gjitha procedurave për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura.




Të ardhurat nga taksa e hotelit burojnë kryesisht nga zonat turistike, konkretisht plazhi Velipojë, dhe faturohen bazuar në monitorimet dhe verifikimet e herëpashershëm të shfrytëzimit të kapaciteteve në terren. Krahasuar me vitin e kaluar të ardhurat kanë një rritje prej 42% ose e shprehur në lek 5,441 mijë. Kjo ka ardhë si rrjedhojë e rritjes së kapaciteteve të bizneseve në plazhin e Velipojës, rihapjes graduale pas pandemisë globale COVID-19 dhe rinisjes së lëvizjeve të transportit të udhëtarëve brenda vendit gjatë periudhës së verës.




Taksa e tabelës për qëllime reklamimi,krahasuar me vitin e kaluar, ka një rritje prej +2,017mijë Lek, si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjitNr. 106/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar", me efekt uljen e bazës së taksës referuar aneksit Nr. 7 të këtij Ligji.

**Taksat e ndara**

Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë administrohet nga ASHK (Agjensia Shteterore e Kadastrës), në rolin e agjentit tatimor. Taksa mblidhet nga agjenti tatimor i cili ia transferon të ardhurat e grumbulluara bashkisë. Krahasuar me vitin e kaluar kjo taksë është realizuar me +1,380mijë Lekë.

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura grumbullohet bazuar në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare" të ndryshuar, ku përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, pas arkëtimit nga institucioni i Drejtorisë Shërbimit Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimorë. Krahasuar me vitin e kaluar, rezulton një rënie e të ardhurave nga kjo taksë me një vlerë -.38,544 mijë lekë, ose -35%, që është krijuar si realizultat i rritjes së numrit të personave që emigrojnë jashtë vendit.

Taksa e rentës minerare që grumbullohet bazuar në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare" " të ndryshuar, dhe shpërndahet si taksë e ndarë nga Ministria e Financave dhe

Ekonomisë. Rezulton me një rënie të të ardhurave nga viti i kaluar me një vlerë 5 mijë lekë, ose -15 % .

Tatimi mbi të ardhurat personale, sipas ligjit Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", si taksë e ndarë, duhet t' transferohet 2% bashkisë. Per 2 vite rresht 2018-2019, bashkisë nuk iu transferua asnjë lekë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
Gjatë vitit 2022 Ministria e Financave dhe Ekonomisëka transferuar vlerë prej 28,847 mijë lek në favor të bashkisë.
Në total të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar -46,098 mijë lekë më pak se vitin e kaluar.

## Tarifat




Tarifat vjetore të pastrimit në total arrijnë vlerën e arketuar prej 183,336 mijë lek me +25,748 mijë lek më shumë konkretisht : nga biznesi për vitin 2022 arrijnë në total vlerën e 110,212 mijë Lekë krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rritje me vlerë +15,356 mijë e cial vjen si rezultat i ndjekjes për marrjen e masave shtrënguese.



Tarifat vjetore të ndriçimit, që janë arkëtuar për vitin 2022 arrijnë në total vlerën e 42,339 mijë Lekë. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rritje me vlerë +9,620 mijë Lekë ose +29% .




Tarifat vjetore të gjelbërimit, që janë arkëtuar nga biznesi dhe familjarët për vitin 2022 arrijnë në total vlerën e 23,486 mijë Lekë. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rritje me vlerë 3,375 mijë Lekë ose +17% .

**Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë**




Pavarësisht se institucionet nuk kanë qëllim në vetvete krijimin e të ardhurave, nëpërmjet grumbullimit të tyre dhe gjetjen e burimeve të reja, ato lehtësojnë dhe mundësojnë shërbimin më cilësor dhe më të standartizuar të vetë atyre ndaj qytetarëve.

Edhe pse tarifat për shërbimet që ofrojnë këto insitucione kulturore, arsimore, sportive etj. kanë pasur tendencë uljeje si rrjedhojë e mbylljes së Klubit Sportiv"Vllaznia ose zerimi kryesisht për disa kategori të veçanta përfituese si nxënës, studenë, grupe rinore etj.," gjithsesi falë

përmirësimit të shërbimit me efekt rritjen e fluksit të përfituesve të shërbimeve, shfrytëzimit me efikasitet i ambienteve, si dhe rritjes së numrit të aktiviteteve në përgjithësi, ka rezultuar që në total gjatë vitit 2022 janë krijuar rreth 104,804 mijë Lekë të ardhura.
Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar, kemi një rritje me vlerë +27,776mijë Lekë .

**Të ardhura  të tjera**




Të ardhurat e tjera burojnë nga gjobat, kamatvonesat, qira etj,për vitin 2022 janë grumbulluar 64,984 mijë lekë ku rol kryesor kanë luajtur shitja e titujve të Klubit të Vllaznisë.

**Të ardhurat nga Gjobat**



Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat) për vitin 2022 arrijnë në total vlerën e 17,996 mijë Lekë. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rënie me vlerë -3,772 mijë Lekë ose -17%.




Të ardhurat nga donacionet për vitin 2021 janë në masën 1,478 mijë lekë. Këto donacione kanë ardhur nga projekti fitues projekti People" histori personale të diskriminimit dhe persekutimit nën regjimet totalitare të shekullit XX" ndërmjet shoqatës ATRIUM dhe Bashkisë Shkodër si dhe projektit "Faro- trashegimi te ndryshme ne qytezat europiane , krijimi i nje rrefimi te identiteteve europaiane te kontestuara permes pjesemarrjes se qytetareve", marreveshje mes Bashkise Shkoder dhe Bashkise Dimitrovgrad.

## Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të 12 M te vitit 2022

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, të 12 M vitit 2022 , nga te gjitha burimet e financimit, arritën në 3 464 046 mije lekë me një nivel realizimi prej 87 për qind.

*000/leke*

| Emertimi | Plani Korrigjuar | Likuidimi ne thesar | Realizimi ne % | Obligime me fature/kontrate | Totali realizimit | Realizimi ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Paga dhe Sigurime | 921,701 | 685,999 | 74% | - | 685,999 | 74% |
| Shpenz.Operative | 1,019,735 | 661,440 | 65% | 193,801 | 855,241 | 84% |
| Subvencione | 1,000 | - | 0% | - | - | 0% |
| Transferime | 1,231,302 | 1,165,929 | 95% | 12,834 | 1,178,763 | 96% |
| Investime | 736,005 | 408,201 | 55% | 307,228 | 715,429 | 97% |
| **Totali shpenzimeve me Thesar** | **3,909,743** | **2,921,569** | **75%** | **513,863** | **3,435,432** | **88%** |
| **Shpenzime me llogari jashte thesari** | **88,139** | **28,614** | **32%** | | **28,614** | 32% |
| **TOTALI** | **3,997,882** | **2,950,183** | **73.8%** | **513,863** | **3,464,046** | **87%** |




Peshen me te madhe te realizimit ne perqindje e zene transferimet ne masen 34 % ku perfshihen ndihmat ekonomike dhe pagesa e personave me aftesi ndryshe ne shumen 1 077 531 mije leke si transferte e kushtezuar .




Shpenzimet per paga rreth 57.45 % jane realizuar me burim financimi Burimet e Veta , rreth 39 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale dhe 3.55 % me Transferte te Kushtezuar.

Shpenzimet operative rreth 83.3 % jane realizuar me Burimet e veta, 15.96 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale, 0,38 % me donacion dhe 0.37 % me Transferte te Kushtezuar.

Shpenzimet per transferime jane realizuar me transferte te kushtezuar me rreth 89 % ,me Burimet e veta 7.08 % dhe 3.93 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale.

Shpenzimet per investime rreth 97.6 % jane realizuar me Burimet e veta, 2.31 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale, 0,09 % me donacion.

Realizimi i shpenzimeve sipas burimeve te financimit paraqitet si me poshte:












Realizimi i shpenzimeve sipas matricës së programeve, 12 M per vitin 2022 paraqitet si me poshte: 000/leke

| | | Paga dhe Sigurime | | | Shpenzime operative | | | Subvencione | | | Transferime | | | Investime | | | Totali | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Plani fillestar 2022 | Plani korrigj. 2022 | Realizimi 12 M 2022 | Plani fillestar 2022 | Plani korrigj. 2022 | Realizimi 12 M 2022 | Plani fillestar 2022 | Plani korrigj. 2022 | Realiz 12 M | Plani fillestar 2022 | Plani korrigj. 2022 | Realizimi 12 M 2022 | Plani fillestar 2022 | Plani korrigj. 2022 | Realizimi 12 M 2022 | Plani fillestar 2022 | Plani korrigj. 2022 | Realizimi 12 M 2022 |
| Programi | EMERTIMI | Totali | Totali | Totali | Totali | Totali | Totali | Totali | Totali | Totali | Totali | Totali | Totali | Totali | Totali | Totali | Totali | Totali | Totali |
| 01110 | Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi | 275,969 | 271,469 | 188,585 | 101,253 | 91,266 | 47,930 | - | - | - | 8,537 | 12,954 | 6,537 | 6,918 | 5,603 | 3,345 | 392,677 | 381,291 | 246,398 |
| 01170 | Gjendja civile | 16,545 | 15,386 | 15,029 | - | - | - | - | - | - | 59 | 310 | 310 | - | - | - | 16,604 | 15,696 | 15,339 |
| 1620 | | - | 7,927 | 7,867 | - | 973 | 781 | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | 8,900 | 8,648 |
| 03140 | Shërbimet e Policisë Vendore | 24,383 | 23,904 | 16,667 | 4,195 | 3,916 | 3,667 | - | - | - | 18 | 498 | 480 | 5,013 | 5,000 | - | 33,609 | 33,317 | 20,814 |
| 03280 | Mbrotja nga zjarri dhe mbrojtja civile | 50,417 | 50,297 | 37,043 | 24,472 | 27,141 | 8,578 | - | - | - | 82,864 | 34,344 | 20,309 | 13,742 | 16,041 | - | 171,495 | 127,823 | 65,930 |
| 04130 | Mbështetje për zhvillimin ekonomik | 1,549 | 1,510 | 1,466 | 4,645 | 5,183 | 471 | - | - | - | 4,883 | 2,540 | 2,253 | 1,665 | - | - | 12,742 | 9,233 | 4,190 |
| 04160 | Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi | - | - | - | 1,389 | 1,313 | 124 | - | - | - | - | - | - | 962 | - | - | 2,351 | 1,313 | 124 |
| 04220 | Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtjae konsumatoreve | - | - | - | 2,237 | 2,230 | 1,321 | - | - | - | - | - | - | 5,000 | 5,000 | 3,830 | 7,237 | 7,230 | 5,151 |
| 04240 | Menaxhimi i Infrastruktuës së | 18,599 | 18,259 | 12,054 | 26,391 | 25,228 | 14,244 | - | - | - | 1 | 340 | 340 | 174 | 1,031 | - | 45,165 | 44,858 | 26,638 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ujitjes dhe kullimit | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 04260 | Administrimi i pyjeve dhe kullotave | 18,160 | 17,829 | 11,255 | 5,946 | 4,513 | 4,228 | - | - | - | - | 330 | 330 | 9,500 | 9,415 | 4,516 | 33,606 | 32,087 | 20,329 |
| 04520 | Rrjeti rrugor rural | - | - | - | 44,746 | 44,084 | 35,053 | - | - | - | - | - | - | 385,530 | 449,303 | 280,419 | 430,276 | 493,388 | 315,472 |
| 04570 | Transporti publik | - | - | - | 4,364 | 3,777 | 2,927 | 4,000 | 1,000 | - | - | - | - | 10,000 | 9,150 | 3,150 | 18,364 | 13,927 | 6,077 |
| 04760 | Zhvillimi i turizmit | - | - | - | 4,247 | 3,650 | 1,641 | - | - | - | 2,954 | 2,150 | 2,137 | 849 | 250 | 168 | 8,050 | 6,050 | 3,946 |
| 05100 | Menaxhimi i mbetjeve | - | - | - | 386,633 | 370,991 | 173,081 | - | - | - | - | - | - | 10,355 | 13,553 | 10,092 | 396,988 | 384,544 | 183,173 |
Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 165 datë 02.03.2016 ”Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar me VKM nr. 625 dt.28.09.2022 , VKM nr.158 datë 12.03.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar me VKM nr. 604 dt.14.09.2022, VKM nr. 234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të spcecialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike; i ndryshuar me VKM nr. 627 dt. 28.09.2022, VKM nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” i ndryshuar me VKM nr. 621 dt. 28.09.2022.
Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore u bazua në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

**P01110.O2.A2 Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve**
Ky aktivitet synon rekrutimin e burimeve profesionale për të qënë pjesë e administratës vendore përmes procedurave të përcaktuara me ligj, në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve. Këto rekrutime realizohen me procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Kjo procedurë realizohet përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18/03/2015, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” Bashkia është në fazën e rivlerësimit të strukturës së administratës së Bashkisë për vitin 2022. Është realizuar rekrutimi për vendet vakante të shpallura.

**P01110.O2.A3 Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës**.
Ky aktivitet synon që nëpunësit civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të mund të kryejnë trajnime në institucione të tjera trajnuese me iniciativën e tyre, për detyrën që ata kryejnë, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit të institucionit. Për vitin 2022 janë realizuar disa trajnime për punonjësit me status nëpunësi civil nga ASPA si edhe trajnime te tjera si “Studimet e Fizibilitetit”; Buxhetimi gjinor për NGJV nga Ministria e Shëndetësise dhe Mbrojtjes Sociale; Metodologjia e përcaktimit të Vulnerabilitetin ndaj Klimës dhe Vlerësimin e Kapaciteteve, Menaxhimi i projekteve të Huaja; Qeverisja elektronike dhe siguria kompjuterike ; Përpunimi tekniko shkencor i dokumenteve zyrtare; Impakti i ndryshimeve klimatike dhe pershtatja në zonat Basene Ujore Delta në Hollandë; Të rinjtë dhe pushteti vendor për

vullnetarizmit; Procesi i formulimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave antikorrupsion; Roli i sekretari-arkivit në mbarëvajtjen e punës në institucionet publike.
Gjithashtu edhe specialistet e IT-së janë trajnuar konform marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Universitetit "Luarasi", i cili ofron kursin me tematikë "Hacker Etik i Çertifikuar". Është nënshkruar edhe marrëveshja me operatorin Tech 01 ShPK me objekt aktiviteti Akademi Mësimdhënie, Programe dhe trajnime te ndryshme, mentorim dhe konsultim në fushën e sipërmarrjes dhe reklamave dixhitale, programe te formimit profesional e lidhur me dt.29.12.2022. Është realizuar edhe trajnimi në vazhdimësi për nëpunësit e administratës sipas konfirmimeve të eprorëve direkt.

**P01110.O2.A4 Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë.**
Tek ky aktivitet realizohet shërbimi sipas nevojave për udhëtime për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë, i cili është i domosdoshëm në rritjen e standartit të plotësimit të kushteve të punës ndaj administratës si dhe anasjelltas, në rritjen e eficiencës së administratës për dhënien e kontributit dhe përfaqësimin e duhur të institucionit në takime pune etj. Për realizimin e këtyre lëvizjeve është bërë gjatë vitit rimbursimi i shpenzimeve dhe dietave për administratën vendore në masën financiare që ligji e parashikon. Për arsye pune jashtë vendit janë rimbursuar punonjesit për takime pune që kishin në fokus nxitjen e dialogut mes kryetarëve të bashkive të zonës së Mesdheut për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mbështetjes reciproke, në Firence Itali, gjithashtu dhe një takim në qytetin e Pragës (Çeki) në Forumin ekonomik të Qyteteve Inteligjente BE-Ballkani Perëndimor.

**P01110.O3.A1 Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës.**
Është përmirësuar dhe realizuar funksionimi normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shkodrës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, shërbim telefonie dhe shërbime të tjera..

**P01110.O3.A2 Shërbimi me kancelari dhe shtypshkrime për administratën e Bashkisë së Shkodrës.**
Është mundësuar sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, bojë, shtypshkrime etj. sipas kërkesave të drejtorive. Sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, dhe bojëra për printera e fotokopje dhe shtypshkrime i mundëson punonjësve përmbushjen e detyrave dhe objektivave. Është realizuar blerja e shpenzimeve për shtypshkime, libërlidhje etj Nuk ështe realizuar procedura për shpenzime kancelari për shkak të pezullimeve të prokurimit të mallrave, punëve dhe shërbimeve të parashikuara në regjistrin e parashikimeve pas datës 15 tetor.

**P01110.O3.A3 Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale elektrike, hidraulike etj)**
Janë siguruar dhe realizuar në vazhdimësi shërbimet mbështetëse bazë për mirëmbajtjen dhe furnizimin me materiale elektrike, hidraulike.

**P01110.O3.A4 Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës.**
Është bërë identifikimi dhe klasifikimi i kërkesave për pajisje të reja zyre të nevojshme dhe është realizuar blerja për kondicionerë, tavolina, rafte, karrige etj.

**P01110.O3.A5 Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Shkodrës dhe inventarit të tyre ekonomik.**
Bashkia Shkodër ka detyrim ligjor për sigurimin nga zjarri dhe rreziqet e tjera të pronave dhe inventarit të saj ekonomik. Ky shërbim u krye për 10 objekte bashkë me inventarin ekonomik të tyre si ndërtesa e Bashkisë Qendër, magazinave dhe Njësive Administrative. Sigurimet e ndërtesave reduktojnë barrën

financiare dhe lehtësojnë vazhdimësinë e institucionit duke ulur kostot publike në rast të ndodhjes së fatkeqësive.

**P1.F1.O2.A11 Rikonstruksion i rrjetit elektrik të godinës në qendër të Bashkisë së Shkodrës(Kolaudim) trashëguar nga viti 2017.**

Nuk është realizuar për shkak se ka një kontratë të lidhur mes Bashkisë Shkodër dhe subjektit Arena MK Shpk më dt.30.08.2017 me vlerë kolaudimi 1,800 lekë, por kolaudatori nuk ka sjellë faturë për likuidim prandaj kjo vlerë mund të pakësohet vetem me një marrëveshje dypalëshe.

**Rikonstruksion godina komuna (kolaudim) trashëguar nga viti 2014.**

Nuk është realizuar për shkak se ka një kontratë të lidhur mes ish Komuna Rrethina dhe subjektit Faik Shegaj më dt.16.05.2014, me vlerë kolaudimi 8,400 lekë, dhe kolaudatori nuk ka sjellë një dokumentacion të rregullt ligjor, pra kjo vlerë mund të pakësohet vetëm me një marrëveshje dypalëshe.

**P01110.O3.A6 Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës.**

Ndërtesa e Bashkisë Qendër dhe e Njësive Administrative duhet të jetë në kushte fizike normale të pranueshme për administratën, me qëllim kryerjen e detyrave të përditshme si edhe për qytetarët të cilët paraqiten në ato ambiente për të marrë shërbimin e nevojshëm. Është realizuar mirëmbajtja e këtyre ambienteve, e cila është një nevojë e domosdoshme për të mbajtur në kushte normale të pranueshme në vazhdimësi këto ndërtesa.

**P01110.O3.A7 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës.**

Janë siguruar në vazhdimësi furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë Shkodër sipas nevojave në Bashkinë qendër, Njësi Administrative etj. si edhe shlyerja e të gjitha taksave të qarkullimit dhe kolaudimit vjetor të mjeteve të transportit në shërbim të administratës.

**P01110.O3.A8 Organizimi i pritjeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja.**

Është realizuar shërbimi për organizimin e pritje- përcjelljeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja. Në kuadër të bashkëpunimit me shtete të tjera, në nivel lokal, rajonal dhe më gjërë, në vendosjen dhe nxitjen e mëtejshme të bashkëpunimit midis qyteteve dhe partnerëve lokal, rajonal dhe ndërkombëtar në të gjitha fushat, për zhvillimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe në kuadër të eksperiencave për arritjen dhe zhvillimin e kontakteve të krijuara nga përfaqësuesit tanë, kemi synuar arritjen e standarteve në nivele të përafërta me qytetet e tjera evropiane. Janë zhvilluar takime të ndryshme me qëllim forcimin e partneritetit. Bashkinë Shkodër e kanë vizituar delegacione të shumta, përfaqësues të institucioneve homologe të nivelit lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, pjesëmarrës nga institucionet kulturore të ftuar për organizimin e aktiviteteve kulturore të ndryshme etj. Për vitin 2022 janë realizuar shpenzime për pritje percjellje për dreka, darka pune, dhurata dhënë këtyre përfaqësuesve si : dreke shtruar Ansamblit popullor të qytetit të Shkodrës për marrjen pjesë në Festivalin në Gjakovë, darkë në kuadër të takimit Anëtarëve te Komitetit drejtues si edhe Asamblesë së Përgjithshme AARC dhe të Universitetit të Shkodrës, drekë shtruar në Konferencen e partnerëve “Shkodra në fokus drejt nje qyteti të qendrueshëm”, dreke delegacioni nga Gjakova për hartimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Bashkisë Gjakovë dhe Bashkisë Shkodër, drekë me rastin e Ditës Europiane e Projekteve, drekë pune shtruar në nder të delegacionit europian dhe perfaqesueve të National IPA coordinator etj.,darkë pune për nder të Kryetares së Delegacionit Europian në Shqipëri, drekë për bandën e qytetit me rastin e festave të fundvitit. Gjithashtu është shtruar Iftar për komunitetin mysliman dhe qytetarëve të Shkodrës me rastin e Muajit të Madhnueshëm të Ramazanit .

**P01110.O3.A9 Shërbim interneti për institucionin e Bashkisë së Shkodrës**

Është realizuar prokurimi dhe ofrimi i shërbimit të internetit në të gjithë Bashkinë Shkodër (Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative dhe Lagje). Bashkia Shkodër ka implementuar një sistem të qendërzuar të marrjes së shërbimit të internetit në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative, Lagje dhe Qendra Komunitare. Zgjidhja e implentuar ofron 99.99% shërbimin në çdo kohë në çdo pikë të tij. Sistemi siguron konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit që trasmetohet në linjat e komunikimit. Të gjithë pikat e furnizuara të Bashkisë Shkodër kanë akses në internet 24/7 pa kufizim në komunikim. Ky shërbim ka rritur shpejtësinë në komunikim të të dhënave, ka ulur kostot operative për komunikimin e informacionit, ka garantuar mirëfunksionimin e sistemeve të bazuara në platforma web që Bashkia ka implementuar dhe ka shtrirë në të gjithë njësitë e saj administrative, si: Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N), Sistemi i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV), Sistemi i qendërzuar kombëtar i shërbimeve të Ndihmës Ekonomike, e- Lejet, Sistemi AFMIS, portali i Transparencës së Buxhetit, sistemi i integruar i menaxhimit të Shërbimeve Sociale dhe Strehimit, faqja zyrtare e internetit www.bashkiashkoder.gov.al, menaxhimi i dokumentacionit dhe punës së përditshme të administratës vendore në rrugë elektronike, transparente dhe në kohë, etj.

**P01110.O3.A10 Mirëmbajtje pajisje informatike.**
Nevoja e administratës për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) ka qenë dhe është e domosdoshme. Është bërë vazhdimisht një rivlerësim i pajisjeve ekzistuese TIK në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative të saj, Lagjeve dhe Qendrave Komunitare, ku janë kryer procedura kalimi në inventar nga njëra drejtori në tjetrën, janë nxjerrë jashtë përdorimi pajisjet që nuk plotësojnë specifikimet teknike minimale të miratuara nga AKSHI. Ky shërbim i siguruar sistematikisht çdo vit nga buxheti i Bashkisë Shkodër, ka mbështetur administratën vendore me një infrastrukturë optimale pajisjesh të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Është lidhur kontrata në dhjetor 2022 me afat 45 ditë.

**P01110.O3.A11 Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).**

Nevoja e administratës për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) ka qenë dhe është e domosdoshme. Është bërë sistematikisht një rivlerësim i pajisjeve ekzistuese TIK në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative të saj, Lagjet dhe Qendrat Komunitare, ku janë kryer procedura kalimi në inventar nga njëra drejtori në tjetrën, janë nxjerrë jashtë përdorimi pajisjet që nuk plotësojnë specifikimet teknike minimale të miratuara nga AKSHI. Pajisje të reja TIK janë prokuruar nga buxheti i Bashkisë gjatë vitit 2022, pasi nevoja për ripërtëritje të pajisjeve ekzistuese TIK ka qenë vazhdimisht dhe është e nevojshme për t'u bërë gradualisht nga viti në vit. Kjo nevojë vjen si rezultat i programeve të licensuara që duhet të përdorim në zbatim të Rregulloreve të AKSHI- t për Komunikimet Elektronike, asaj të Blerjeve të Pajisjeve TIK dhe plotësimit të standarteve minimale teknike, si dhe asaj të ofrimit të Shërbimeve të Përqendruara në Administratën Publike.
Bashkia ka mundësuar pajisje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në gjendje optimale funksionimi në mbështetje të punës së administratës vendore dhe në mbështetje të sistemeve të informacionit të implementuara dhe që do të implementohen në të ardhmen në Bashkinë Shkodër.

**P01110.O3.A12 Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Informacionit të Bashkisë Shkodër**.
Një tjetër iniciativë inovative e Bashkisë Shkodër është ajo e përfshirjes së qytetarëve në buxhetim përmes përdorimit të platformës online Transparenca e Buxhetit, një instrument Open Data i realizuar për herë të parë dhe të vetme në Shqipëri. Ky instrument online informon publikun për të ardhurat vjetore të saj, shpenzimet dhe investimet, si dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vjetore të qytetarëve dhe bizneseve, si dhe i fton ato të shprehen online për kërkesa apo pakënaqësi të mundshme t'i drejtohen zyrave përkatëse përgjegjëse në Bashki për zgjidhjen.

Bashkia Shkodër ka implementuar një sistem informacioni për Shërbimet Sociale. Qëllimi kryesor i implementimit të këtij sistemi është ofrimi i mundësisë për të populluar një bazë të dhënash të saktë me informacione mbi institucionet që ofrojnë shërbime sociale, si dhe mbi përfituesit që janë të regjistruar pranë këtyre institucioneve, në nivel vendor.
Ky aktivitet është realizuar dhe Bashkia Shkodër ka arritur ofrimin e shërbimeve administrative elektronike aty ku qytetari dhe biznesi ndodhet, duke mundësuar që qeverisja vendore të shkojë drejt qytetarit në kohë të shkurtër, në mënyrë cilësore dhe transparente. Kjo ka rritur llogaridhënien financiare dhe ka mundësuar pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

## P01110.O3.A13 Mirëmbajtje e faqes zyrtare web www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj.

Ky aktivitet është realizuar.Bashkia Shkodër zotëron faqe zyrtare interneti nën domain-in www.bashkiashkoder.gov.al. Kjo faqe është 24/7 online dhe aktualisht është një faqe e nivelit të 3 në përputhje me rregulloren e AKSHI- t për faqet zyrtare në administratën publike. Në faqe janë të integruar disa module që mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe demokracinë vendore në kuadër të mirëqeverisjes elektronike vendore. Moduli i Librarisë Ligjore i implementuar dhe i integruar në faqe, bën të mundur që Bashkia të ndajë me qytetarët të gjithë projekt- vendimet dhe vendimet e Këshillit të Bashkisë përmes një moduli të menaxhueshëm në web nga Sekretaria e Këshillit të Bashkisë. Moduli e- Pjesëmarrje i implementuar dhe i integruar në faqe, mundëson krijimin e vazhdueshëm të sondazheve me tematika të ndryshme dhe marrjen e mendimeve nga qytetari, lehtësisht i menaxhueshëm nga punonjësit e Bashkisë. Moduli i SiZ1N, i integruar në faqen web, bën të mundur gjurmimin e kërkesave për shërbim të qytetarëve (tregon se në cilin status të aplikimit ndodhen shërbimet) që aplikohen në Zyrën e Integruar me Një Ndalesë në Bashkinë Qendër apo Njësitë Administrative, direkt nga portali zyrtar online. Shkarkimi i formularëve online, informacioni i detajuar i rregjistrit të kërkesave, raportet e auditimit, raportet financiare, buxheti dhe realizimi i tij, paketa fiskale, transparenca e buxhetit, raportimi online, forumi online, etj. në kuadër të programit të transparencës janë një tjetër mjet i përfshirjes së qytetarit përmes këtij portal web. Aktualisht faqja zyrtare e internetit e Bashkisë Shkodër është e një niveli të lartë informimi dhe përfshirëse e qytetarëve.

### P01110.O3.A14. Informimi i qytetarëve përmes mediave vizive për përfitimin e shërbimeve nga Bashkia Shkodër.

Ky aktivitet është realizuar.Bashkia Shkodër është institucioni i parë i qeverisjes vendore në Shqipëri që në respektim të parimit "qytetari në qendër" ka implementuar një model për ofrimin e Shërbimeve Administrative të Integruara të shtrirë tashmë në të gjithë territorin përmes hapjes Zyrave të Integruara me Një Ndalesë (Zi1N) në Bashkinë Qendër, në të gjitha njësitë administrative dhe së fundmi është në proces shtrirja e sistemit në 5 Lagjet e qytetit.
Informimi mbi këto shërbime dhe mbi procedurat e përfitimit të tyre vazhdimisht i prezantohet qytetarëve në takime të tematikave të ndryshme, në dëgjesa publike, përmes afishimeve të bëra dhe fushatave informuese me fletëpalosje në të gjitha Zyrat me Një Ndalesë. Njëkohësisht kemi vlerësuar si të domosdoshëm informimin e qytetarëve për këto shërbime dhe mënyrën e përfitimeve të tyre përmes mediave vizive lokale si një mjet tjetër i domosdoshëm komunikimi qytetar- qeverisje vendore.

### P1.F1.O2.A25 Implementimi i dokumentacionit të integruar i qendërzuar për të gjithë Bashkinë Shkodër në platformën Microsoft 365, Azure Active Directory dhe Mail Server bazuar në Cloud.

Trashëguar nga viti 2017. Realizuar kontrata në vitin 2017 dhe mbetur gjendje plani si donacion.

**P01110.O3.A15 Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve të Varësive.**
Është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik "*Infosoft Software Developer*" dhe janë kryer disa nga pikat kryesore të saj, si instalimi i sistemit në postet e punës, konfigurimi i planit kontabël apo i artikujve të ndryshëm të magazinës, trajnimet bazë mbi disa nga modulet kryesore të saj. Duke qenë se nuk janë plotësuar specifikimet teknike sipas kërkesës nga Drejtoria e Financës, operatori ekonomik ka kërkuar shtyrjen e afateve për përmbushjen e të gjitha kërkesave të autoritetit kontraktor ku thekson dhe arsyet e mospëmbushjes në kohë të kontratës.

**P01110.O4.A1 Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Shkodër**
Ky aktivitet përfshin rregjistrimin e pronave të transferuara me VKM për transferimin në pronësi ose përdorim të pronave të paluajtshme publike, shtetërore dhe rregjistrimi i pronave që fitohen nga shpronësimet, aktivitet që realizohet nga Drejtoria Juridike
Për 12- mujorin e vitit 2022 numri i pronave të Bashkisë Shkodër të rregjistruara në ASHK është 155 prona, 1 pronë e përfituar nga shpronësime me VKM , 179 prona të dërguara në ASHK për konfirmim statusi juridik dhe 3 aplikime të realizuara për rregjistrim të pronave referuar VKM .

## P01110.O4.A2 Detyrime dhe kompensime legale & të trashëguara

Gjatë 12 mujorit te vitit 2022, Drejtoria Juridike ka realizuar këto veprimtari :

1. Janë likujduar 3 vendime gjyqesore të formës së prerë me efekte financiare.
2. Janë depozituar 3 kërkesë padi në lidhje me vlerën e debitorëve në zbatim të rekomandimeve të KLSH.
3. Janë ndjekur 195 proçese gjyqësore në të gjitha Gjykatat dhe të gjithë shkallët e gjykimit.
4. Janë realizuar shpenzime gjyqesore për tërheqje të taksës së pullës për depozitim ankimi/ njoftimi/ kërkesë padi 30 urdhëra shpenzimi .
5. Janë realizuar 3 (tre) proçedura likujdimi të vendimeve gjyqesore të formës së prerë
6. Vendime gjyqësore të formës së prerë me efekte financiare (vendimmarrje të Gjykatës së Apelit), për vitin 2022 janë 3 vendime gjyqësore.

**P01110.O4.A3.Shlyerja e detyrimeve te prapambetura Kompensim per shtepite e djegura & te trasheguara.**

Nuk është realizuar për shkak të mungesës së dokumentacionit të rregullt financiar dhe ligjor, si mungesës së IBAN dhe kërkesa nga përfituesi.

**P01110.O4.A4.** Pagesa e komisionit si agjent tatimor (Transferim komisioni 1%) realizohet në zbatim të ligjit për transferimin e komisionit për agjentin tatimor, që llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe transferuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për llogari të Administratës Tatimore Qendrore. (Drejtorisë Rajonale Tatimore)

**Shuma për pagesën e agjentëve tatimore**. Akt marrëveshja me nr.1725 prot, datë 01.02.2022, e lidhur mes Bashkisë Shkodër dhe "Ujësjellës Kanalizime" sh.a, Shkodër, nuk është duke u respektuar nga kjo e fundit, pasi vlerat e arkëtuara për taksat dhe tarifat vendore, nuk janë duke u transferuar çdo muaj për llogari të Bashkisë Shkodër. "Ujësjellës Kanalizime" sh.a, Shkodër, e ka të pamundur transferimin çdo muaj të këtyre vlerave, pasi është në proçes përmbarimor me shoqërinë tregtare Ludwig Pfeiffer Houg Und Tiefbau GMBH&CO.KG, si dhe e bllokuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër. Drejtoria e të

Ardhurave, i është drejtuar Zyrës së Përmbarimit Privat "EPSA" sh.p.k, me shkresë "Për transferimin e vlerave monetare të bllokuara për taksat dhe tarifat familjare të Bashkisë Shkodër", me arsyetimin që vlerat e patransferuara ndaj Bashkisë Shkodër, janë paguar nga qytetarët për taksën e ndërtesës dhe truallit; tarifës së pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, dhe nuk kanë lidhje me aktivitetin kryesor të Ujësjellës Kanalizime sh.a Shkodër. Si rrjedhojë, nuk mund të jenë objekt i bllokimit për arsye të detyrimeve që kjo shoqëri ka ndaj palëve të treta, për deri sa kjo vlerë nuk është e ardhur e tyre. Në shkresë, është kërkuar që përmbaruesi, ti drejtohet bankave të nivelit të dytë, në të cilat "Ujësjellës Kanalizime" sh.a, Shkodër ka llogari bankare, të bëjnë transferimin e vlerave të bllokuara për taksat dhe tarifat familjare për llogari të Bashkisë Shkodër. Drejtoria e të Ardhurave, i është drejtuar gjithashtu edhe bankave të nivelit të dytë, që të bëjnë transferimin e vlerave të bllokuara për taksat dhe tarifat familjare për llogari të Bashkisë Shkodër. Njëkohësisht, Drejtoria e të Ardhurave është duke lëshuar Urdhër Ekzekutime për vjeljen e detyrimeve të prapambetura që "Ujësjellës Kanalizime" sh.a, Shkodër, ka ndaj nesh. Èshtë realizuar vetëm pagesa e Tatimit te thjeshtuar mbi fitimin ( 1%)  TFTH. Meqenëse, akt marrëveshja e mësipërme nuk është respektuar nga ana e "Ujësjellës Kanalizime" sh.a, Shkodër, likujdimi i pagesës së komisionit për agjentin tatimor nuk mund të kryhet.

**Njësia e Auditit**

Për 12-mujorin e vitit 2022 Njësia e Auditit ka realizuar aktivitetet si më poshtë:

| Nr | Subjektet | Niveli vlerësimit te riskut | Llojet e auditimeve | Objektet të pa audituara mbi 2-vjet | Realizimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Përfunduar 7 subjekte auditimi | I mesëm/lartë | Përputhshmëri Kombinuar | | ✓ |
| 2. | Në proces realizimi 2 subjekte auditimi | Mesëm | Përputhshmëri | ✓ | Në proces realizimi |

**Njësia e Prokurimit**

Gjatë vitit 2022 në Njësinë e Prokurimit Publik është punuar për zhvillimin dhe realizimin e të gjitha procedurave të prokurimit publik të ardhura pranë Njësisë së Prokurimit në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha drejtoritë përkatëse dhe dërgimin e tyre për likuidim pranë Drejtorisë së Financës dhe Degës së Thesarit brenda afateve ligjore.
Gjatë periudhës 01.01.2022 – 31.12.2022 Bashkia Shkodër ka realizuar në total 165 procedura prokurimi.

| **Lloji i procedurës** | **Numri** |
|---|---|
| E hapur, e thjeshtuar | 37 |
| Procedure të hapur | 5 |
| Shërbim konsulence | 0 |
| Negocim pa botim paraprak | 1 |
| Blerje dinamike | 12 |
| Blerje me vlerë të vogël | 96 |
| Blerje me vlerë nën 100,000 | 6 |

| | |
|---|---|
| **Totali** | **165** |
| **Në rolin e organit qëndror blerës** | **1** |
| **Për llogari të institucioneve të varësisë si organ i deleguar** | **15** |

| **Fondi i total i parashikuar për prokurim (pa tvsh)** | **Fondi limit i prokuruar (pa tvsh)** | **Vlera e kontratës së lidhur (pa tvsh)** |
|---|---|---|
| 437,392,396 lekë | 400,487,396 lekë | 398,903,114 lekë |

Të gjitha kontratat janë depozituar brenda afatit pranë Degës së Thesarit Shkodër.

Problematika kryesore që vazhdon prej një kohe të gjatë ka lidhje me procedurat e prokurimit të parashikuara për tu realizuar gjatë këtij viti buxhetor, por që janë me financim disavjeçar, të cilat refuzohen nga Dega e Thesarit Shkodër si dhe prokurimi i mallrave, punëve dhe shërbimeve të parashikuara në Regjistrin e Parashikimeve pas datës 15 tetor.

# Programi 01170: Gjendja Civile

Qëllimi i programit 01170: Gjendja Civile është sigurimi i një shërbimi sa më cilësor ndaj komunitetit për funksionet e deleguara.

Objektivi i programit është :
O1. Shërbime të deleguara të mbështetura për funksionimin e tyre.

**Përshkrimi i programit:** Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Zbatimi i buxhetit për shërbimet e deleguara (Gjendjes civile) bazohet tek ligji nr. 10129, datë 11.05.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar; dhe VKM nr. 1299, datë 16.12.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të punonjësve të shërbimit të gjendjes civile në Bashki/njësi Bashkiake/ komuna dhe në degët e qarqeve" i ndryshuar .
Pagat i referohen VKM nr. 187, datë 8.3.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, Gjykatën e lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", i ndryshuar me VKM nr.621 dt. 28.09.2022.

Realizimi i buxhetit të planifikuar:

*000/leke*

| **Programi 01170** | **Paga & sigurime** | **Transferta** | **Totali** |
|---|---|---|---|
| PBA 2022 | 16,545 | 59 | 16,604 |
| Plani fillestar 2022 | 16,545 | 59 | 16,604 |
| Plani i rishikuar 2022 | 15,386 | 310 | 15,696 |
| Realizimi viti 202 | 15,029 | 310 | 15,339 |
| % e realizimit | 97.7% | 100.0% | 97.7% |




Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin në total është %, sipas zërave kryesorë më poshtë:

| | |
|---|---|
| Shpenzime korente | 97.7% |
| Shpenzime kapitale | 0 % |




Për 12-mujorin e vitit 2022 janë përditësuar të dhënat e shtetasve me vërtetësi dhe në kohë reale, është realizuar rregjistrimi i akteve të mbajtura nga shërbimi i gjendjes civile (lindje, martese, vdekje) si dhe të shërbimeve të tjera të ofruara nga Gjendja Civile.

**Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit**

**Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022**

| Kodi i Programit | 1170 | Emertimi i programit: | Gjendja Civile | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | Sigurimi i një shërbimi sa më cilësor ndaj komunitetit për funksionet e deleguara | | | | | | | | |
| | | | Treguesit e performancës | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances | Emertimi i Treguesit te Performances | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances | |
| Objektivi 1 | Shërbime të deleguara të mbështetura për funksionimin e tyre. | 1 | Numri i dokumenteve të prodhuara / lëshuara | 59,500 | 56,000 | 30,000 | 29,300 | 98% | |
| | | 2 | Të ardhurat nga dokumentat e prodhuar. (mijë lekë) | 301 | 364 | 200 | 197 | 99% | |
| | | 3 | Numër shërbimesh (lindje, martese, vdekje) si dhe të shërbimeve tjera të ofruara nga Gjendja Civile | 10 | 10 | 10 | 10 | 100% | |

## ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Gjendja Civile | Kodi i Programit | 1170 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2021) | Shpenzimet (sipas vitit 2021) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2021) | Sasia (sipas planit te vitit 2022 | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022 | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Sasia Faktike (viti 2022) | Shpenzimet Faktike (viti 2022) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2022) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | Komente |
| 1 | Shërbime të ofruara nga Gjendja Civile | Numri i dokumenteve të prodhuara / lëshuara | 59,500 | 15,407 | 0.26 | 56,000 | 16,604 | 0.30 | 30,000 | 15,696 | 0.52 | 29,300 | 15,339 | 0.52 | 0.26 | 0.23 | 0.00 | |

Për 12- mujorin e vitit 2022 në programin 01170 “Gjendja Civile” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara, për vitin 2022, ka vijuar puna për përmirësimin e shërbimit të Gjendjes Civile.

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | | | 000/leke |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Totali | | |
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| **P01170.O1.A1 Shërbimet e deleguara Gjendja Civile** | Bashkia Shkodër | realizuar | 16,604 | 15,696 | 15,339 |
| **01170 Gjendje Civile** | | | **16,604** | **15,696** | **15,339** |
| **Te trasheguara** | | | **-** | **-** | **-** |
| **Totali** | | | **16,604** | **15,696** | **15,339** |

**P01170.O1.A1** Shërbimet e deleguara Gjendja Civile.

Është realizuar në vazhdimësi dhe përmirësuar prodhimi i dokumentave në shërbim të qytetarëve
Kemi realizuar sigurimin e mbështetjes së funksionimit të Gjendjes Civile përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

# FUNKSIONI 03: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

## Programi 03140: Shërbimet Policore Vendore

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

Policia Bashkiake

### Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

-Qëllimi i programit të Policise Bashkiake është:

Shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore; Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të bashkisë dhe Keshillit Bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12 -mujorin e vitit 2022 kanë qënë:

O1. Polici vendore e trajnuar dhe e kualifikuar për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësive.

O2. Rritja e qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

*000/leke*

| Programi 03140 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| PBA 2022 | 18,107 | 3,088 | 18 | 5,000 | 26,213 |
| Plani fillestar 2022 | 24,383 | 4,195 | 18 | 5,013 | 33,609 |
| Plani i rishikuar 2022 | 23,904 | 3,916 | 498 | 5,000 | 33,318 |
| Realizimi viti 2022 | 16,667 | 3,667 | 480 | - | 20,814 |
| % e realizimit | 69.7% | 93.6% | 96.4% | 0.0% | 62.5% |




Realizimi i shpenzimeve per paga,shpenzime operative, transferime dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 62.5 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzimet korrente 73.5 %

Shpenzimet kapitale 0 %




**Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:**

Fondet të cilat ishin planifikuar për tu realizuar në 12-mujorin e vitit 2022 , janë realizuar. Pjesa mbetur e fondeve janë planifikuar të realizohen gjatë vitit në vazhdim.

## Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

**Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022**

| Kodi i Programit | 3140 | Emertimi i programit: | Shërbimet e Policisë Vendore | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | Shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore. Parandalimin e kundërvajtjeve admini-strative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të bashkise dhe keshillit bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances | Emertimi i Treguesit te Performances | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances | |
| *Objektivi 1* | Polici vendore e trajnuar dhe e kualifikuar për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësive. | | | | | | | | |
| | | 1 | Punonjësit e policisë bashkiake gëzojnë statusin sipas ligjit · Raporti midis punonjësve me status të oficerit të policisë bashkiake kundrejt numrit total të punonjësve të policisë Bashkiake | 10% | 13% | 13% | 9% | 72% | |
| | | 2 | Punonjësit e policisë bashkiake janë të kualifikuar. - Numër punonjësish të trajnuar, kundrejt numrit total të punonjësve të policisë Bashkiake | 86% | 100% | 100% | 78% | 78% | |
| *Objektivi 2* | Rritja e qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi | | | | | | | | |
| | | 3 | Shpenzimet buxhetore për shërbimet e policisë bashkiake kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara (mije/Lekë të shpenzuara për 1 rast të menaxhuar) | 119 | 749 | 952 | 56 | 6% | |
| | | 4 | Numri i rasteve problematikave të menaxhuara kundrejt rasteve të raportuara/konstatuara ) | 160 | 35 | 35 | 374 | 1069% | |
| | | 5 | Numri i akteve të ekzekutuara kundrejt akteve të nxjerra | 602 | 100 | 100 | 279 | 279% | |
| | | 6 | Numri i kamerave të vendosura në pika strategjike të qytetit | 41 | 71 | 71 | 41 | 58% | |

**ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"**

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Policia Bashkiake | Kodi i Programit | 3140 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2021) | Shpenzimet (sipas vitit 2021) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2021) | Sasia (sipas planit të vitit 2022 | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022 | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Sasia Faktike (viti 2022) | Shpenzimet Faktike (viti 2022) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2022) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | Komente |
| 1 | Polici vendore e trajnuar dhe e kualifikuar | numri i punonjësve | 21 | 14,530 | 692 | 24 | 18,125 | 755 | 24 | 24,402 | 1,017 | 18 | 17,147 | 953 | 261 | 197 | -64 | |
| 2 | Performancë dinjitoze e Policisë Bashkisë në shërbim të qytetareve nëpërmjet mjeteve të nevojshme në dispozicion për zbatimin e ligjit. | numër raste të menaxhuara dhe të raportuara | 160 | 4,437 | 28 | 35 | 8,088 | 231 | 35 | 8,916 | 255 | 374 | 3,667 | 10 | -18 | -221 | -245 | |

### Realizimi i buxhetit për periudhën 12-mujori 2022:

Gjatë këtij 12-mujori janë vendosur gjithsej 1016 masa administrative me vlerë 1,325,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 279 masa.

| Lloji i masës administrative | Numër |
|---|---|
| Zënie e hapësires publike | 52 |
| Masa administrative për shkelje qarkullimit rrugor | 957 |
| Depozitim mbetje urbane, Ndertim pa leje | 7 |

Policia Bashkiake menjëherë, përveç punes së saj në monitorimin dhe kontrollin e shërbimeve publike në terren, është angazhuar në sigurimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve sportive, artistike, kulturore dhe fetare në territorin e Bashkisë së Shkodrës.

| Lloji i aktivitetit | Numër aktivitetesh |
|---|---|
| Aktivitete sociale (masive) | 115 |
| Aktivitete sportive | 141 |
| Aktivitete fetare | 3 |
| Aktivitete artistike | 46 |

Për vitin 2022 në Programin "*Shërbimet e Policisë Vendore*" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 4 aktivitete.

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | | | 000/leke |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Totali | | |
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| **P03140.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv te Policise Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 18,125 | 24,402 | 17,147 |
| **P03140.O2.A1 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 800 | 800 | 701 |
| **P03140.O2.A2 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policise Bashkiake & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,540 | 1,660 | 1,576 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **P03140.O2.A3 Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policise bashkiake** | Bashkia Shkodër | Jorealizuar | 40 | 40 | - |
| **P03140.O2.A4.Kamera sigurie(CCTV) per ambjente publike dhe mirembajtja e tyre & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Proçes | 5,708 | 6,416 | 1,391 |
| **03140 Sherbimet e policisë vendore** | | | **26,213** | **33,318** | **20,814** |
| **Te trasheguara** | | | **7,396** | **-** | **-** |
| **Totali** | | | **33,609** | **33,318** | **20,814** |

## Aktivitetet janë realizuar si më poshtë:

**P03140.O1.A1** Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të Policisë Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Për 12 mujorin e vitit 2022 janë realizuar pagesa për pagat dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore për 24 punonjës të policisë bashkiake me vlerë 16,667 mijë lekë.

**P03140.O2.A1** Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake.

Për vitin 2022 është planifikuar fondi 800 mijë lekë , për blerjen e uniformave për punonjësit e policisë bashkiake. Ky aktivitet është realizuar në vlerën 701 mijë lekë.

**P03140.O2.A2** Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policisë Bashkiake.

Në funksion të policisë bashkiake janë 3 automjete, për të cilët për 12-mujorin e vitit 2022 janë shpenzuar 1,576 mijë lekë per siguracion makine.

**P03140.O2.A3** Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policisë bashkiake.

Për këtë aktivitet nuk është realizuar shpenzim për periudhën e 12- mujorit të vitit 2022. Blerja e shtypshkrimeve (akt konstatime, shkelje, akt kontrolle, raport sherbime etj) kryhet përmes blerjes shtypshkronjës së letrave me vlerë. Blerja e shtypshkrimeve është në proces të hartimit të dokumentacionit teknik për realizimin më pas të prokurimit të fondit të planifikuar sipas nevojës për shtypshkrime.

**P03140.O2.A4.** Kamera sigurie(CCTV) për ambjente publike dhe mirembajtja e tyre & te trasheguara .

Blerja dhe vendosje e kamerave te sigurisë nuk është realizuar, është trashëguar për vitin 2023. Mirëmbajtja e kamerave ekzistuese është realizuar për vleren 1,391 mijë lekë.

## Programi. 03280: Emergjencat Civile

Në këtë program përfshihen institucionet:

1. Aparatin e Bashkisë
2. MZSH

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:
-Qëllimi i programit të *Mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtjes civile* është:
Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12-mujorin e vitit 2022 kanë qënë:
**a. Strukturat për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile.**
Është realizuar Objekti “Shërbim për mirëmbajtjen emergjente të objekteve infrastrukturore nga situatat e rënduara atmosferike Bashkia Shkodër”
Është realizuar Loti I-rë Shërbime për mirëmbajtjen emergjente të rrugëve të qytetit dhe njësive administrative Bashkia Shkodër.
Është realizuar Loti II-të Shërbime për mirëmbajtjen emergjente të segmentit Ura Mesit – Prekal – Kir - Mali Shoshit – Breglumi – Nderlysaj – Theth.
Janë trajtuar 90 familje me ndihmë për blegtorinë në zonat e prekura nga përmbytjet.
Është dhënë ndihma për raste fatkeqësie, shtëpi të djegura.

**b. Shërbim i përmirësuar i MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.**
Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në vijim shërbimi i MNZSH-së, është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme. Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut (LIGJ Nr. 152/2015 Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, neni 2)
Po sipas këtij ligji, në Nenin 7, Organizimi i strukturës së shërbimit, pikat 3. Përcakton se “Drejtoria ose sektori i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor është në varësi të kryetarit të bashkisë. Ajo përfaqëson strukturën bazë operuese dhe inspektuese në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në territorin që ka në juridiksion”.
Çdo bashki duhet të mbulojë territorin e saj me shërbim zjarrfikës, me stacione të kompletuara me personel, automjete dhe pajisje zjarrfikëse
Stacioni i shërbimit të MZSH-së është njësi operuese dhe inspektuese në varësi të drejtorit te MZSH-së dhe ngrihet në çdo bashki, duke zbatuar standardin 1 zjarrfikës profesionist për 1500-2000 banorë.
Në propocion me numër të popullsisë (mbi 200 mijë banorë, dhe vetëm 42 punonjes aktual të stacionit, raporti është 1 punonjës për 6 000 qytetarë.
Prandaj na lind detyrimi të shtojmë gradualisht, vit pas viti punonjës të stafit, deri në plotësim të kriterit të këtij ligji.
Gjatë vitit 2022 është shtuar me 6 punonjës, luftues pranë MZSH, duke arritur në numrin 42 punonjës në total pranë MZSH:

Në llogarinë “Transferime” janë trajtuar disa punonjës, të cilët në zbatim të VKM 499 datë 13.08.1998i ndryshuar me VKM 633 datë 28.10.1998,përfitojnë shpërblim për përballimin e ngarkesës familjare mbi 3 femijë. Në këtë llogari trajtohet edhe një punonjës sipas Neni 12 “Shpërblimi i menjëhershëm dhe pagesa kalimtare”
- Strukturat e MZSH Shkodër financohen nga Transferta Specifike qeveritare për këtë qëllim. Bashkia Shkodër financon nga të ardhurat e veta buxhet shtesë (dhe është ndër të vetmet Bashki në Shqipëri që e bën këtë ) për financimin për paga të pambuluara, shpenzime operative të pambuluara, Investime në mjete dhe godina, Blerje pajisje operacionale. Situata krahasuar me atë kur ky shërbim është marrë në dorëzim ka ndryshuar shumë, qoftë në sajë të mbështetjes, por edhe organizimit më të mirë.

## Realizimi i Buxhetit të planifikuara:

*000/leke*

| Programi 03280 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| PBA 2022 | 42,557 | 8,097 | 78,980 | 1,000 | 130,634 |
| Plani fillestar 2022 | 50,417 | 24,472 | 82,864 | 13,742 | 171,495 |
| Plani i rishikuar 2022 | 50,297 | 27,141 | 34,344 | 16,041 | 127,823 |
| Realizimi viti 2022 | 37,043 | 8,578 | 20,309 | | 65,930 |
| % e realizimit | 73.6% | 31.6% | 59.1% | 0.0% | 51.6% |




Realizimi i shpenzimeve për paga, shpenzime operative, transferime dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 51.6%, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Shpenzime korente | 59.0% |
| Shpenzime kapitale | 0.0% |




## Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

- Është realizuar plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe certifikimi për MZSH i të gjitha objekteve të varësi të Bashkisë. Janë realizuar 68 projekte teknike.
- Është realizuar "Blerja dhe rimbushje e fikeseve te zjarrit" i të gjitha objekteve të varësi të Bashkisë Shkodër .
- Është në proces hartimi të projektit dhe dokumentacionit për prokurim të objektit "Rikonstruksion godina ekzistuese e MZSH". Fondi është Trashëguar për vitin buxhetor 2023.

## Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

**Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022**

| Kodi i Programit | 3280 | Emertimi i programit: | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile. Perafrimi me standartet europiane te organizimit te mbrojtjes civile. Sigurimi I mbrojtjes civile ne te gjithe territorin. Parandalimi. Informim public per reziqet dhe aktivitetet e organeve vendore përgjegjëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve në nivel lokal dhe administrimi i strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| Objektivi 1 | Strukturat per planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile | | | | | | | | |
| | | 1 | Numri i famljeve perfituese qe mbareshtojne blegtorine ne zonat e prekura nga permbytjet | 718 | 400 | 400 | 90 | 23% | |
| | | 2 | Numri i familjeve të trajtuara me shpërblim për fatkeqësi natyrore | 8 | 37 | 37 | 13 | 35% | |
| | | 3 | Numri i kontrolleve sistematike vjetore për certifikimin për MZSH i objekteve të Bashkisë. | 0 | 130 | 130 | 120 | 92% | |
| | | 4 | Numrit të ofruar të pajisjeve dhe kolaudimi i fikësve të zjarrit në institucione | 1362 | 1517 | 1517 | 0 | 0% | |
| | | 5 | Numri i projekteve teknike për masat e MZSH në institucione | 84 | 54 | 126 | 97 | 77% | |
| Objektivi 2 | Shërbim i përmirësuar i | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve. | 6 | Numri i stacioneve të shërbimit të MZSH-së | 1 | 1 | 1 | 1 | 100% | |
| | | 7 | Zona e mbuluar nga shërbimi i MZSH në % | 29% | 29% | 29% | 29% | 100% | |
| | | 8 | Të ardhurat nga tarifat për shërbimin ndaj të tretëve (pajisja me çertifikata, etj) në mijë lekë | 516 | 660 | 660 | 1257 | 190% | |
| | | 9 | Reagim më i shpejtë ndaj njoftimeve për zjarre/Koha e daljes nga stacioni në sekonda | 60 | 60 | 60 | 60 | 100% | |
| | | 10 | Efiçienca buxhetore në ofrimin e shërbimit MZSH/ lekë/rast të menaxhuar | 78.4 | 80.5 | 94.4 | 81.5 | 86% | |
| | | 11 | Numri i thirrjeve nga popullata drejt Shërbimit Zjarrfikës | 830 | 534 | 820 | 620 | 76% | |

## ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri i Grupit** | **Bashkia Shkodër** | **Kodi i Grupit** | **141** |
| | | | |
| **Programi** | **Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile** | **Kodi i Programit** | **3280** |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **në 000/lekë** | | | | **I** | | | **II** | | | **III** | | | **IV** | **Luhatjet në** | **Ko** |

| | | | | | | | | | | | | | | Koston për Njësi | | | me nte |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kodi** | **Emërtimi i Produktit** | **Njësia matëse** | **Sasia Faktike (sipas vitit 2021)** | **Shpenzimet (sipas vitit 2021)** | **Kosto për Njësi (sipas vitit 2021)** | **Sasia (sipas planit të vitit 2022** | **Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022)** | **Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022)** | **Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022)** | **Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022** | **Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022)** | **Sasia Faktik (viti 2022)** | **Shpenzimet Faktike (viti 2022)** | **Kosto për Njësi Faktike (viti 2022)** | **V = IV - I** | **V = IV - II** | **V = IV - III** | |
| **1** | Familje të trajtuara me ndihmë për blegtorinë në zonat e prekura nga përmbytjet | numër | 718 | 15,742 | 22 | 400 | 75,730 | 189 | 400 | 57,328 | 143 | 90 | 19,819 | 220 | 198 | 31 | 77 | |
| **2** | Familje të trajtuara me shpërblim për fatkeqësi natyrore | numër | 8 | 8,279 | 1,035 | 37 | 3,000 | 81 | 37 | 4,670 | 126 | 13 | 1,440 | 111 | -924 | 30 | -15 | |
| **3** | Pajisje për fikje zjarri funksionale | numër | 1,362 | 0 | 0 | 1,517 | 1,000 | 1 | 1,517 | 1,000 | 1 | 0 | 166 | 0 | 0 | -1 | -1 | |
| **4** | Projekte teknike për masat e MZSH | numër | 84 | 0 | 0 | 54 | 1,000 | 19 | 126 | 4,000 | 32 | 97 | 0 | 0 | 0 | -19 | -32 | |
| **5** | Menaxhimi dhe mirëadministrimi strukturave të institucionit MZSH | Numri i ndertesave të rikonstruktuara | | | | | | | 1 | 2,299 | 2,299 | | | | 0 | 0 | -2,299 | |
| **6** | Raste të menaxhuara për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi | numri i rasteve të menaxhuara | 517 | 40,517 | 78 | 620 | 49,904 | 80 | 620 | 58,526 | 94 | 546 | 44,505 | 82 | 3 | 1 | -13 | |

Për vitin 2022 në Programin "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, ishin parashikuar 5 aktivitete.

-Aktivitetet janë analizuar si më poshtë:

P.03280.O1.A1. Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër & të trashëguara.

P.03280.O1.A2. Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie & të trashëguara.

P.03280.O1.A3. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe çertifikimi për MZSH i të gjitha objekteve në varësi të Bashkisë.

P03280.O1.A4. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH i të gjitha objekteve të varësi të Bashkisë & të trashëguara.

P.03280.O2.A1. Shërbimi i Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi & të trashëguara.

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | | | 000/leke |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Totali | | |
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| **P10910 Kodi i Ministrise P03280.O1.A1. Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër.& te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Ne proces gjate vitit | 75,730 | 57,328 | 19,819 |
| **P03280.O1.A2. Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie& te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Ne proces gjate vitit | 3,000 | 4,670 | 1,440 |
| **P03280.O1.A3. Plotësimi dhe certifikimi për MZSH i pajisjeve për fikje zjarri i të gjithë institucioneve të Bashkisë** | Bashkia Shkodër | Plotësimi dhe certifikimi për MZSH i pajisjeve për fikje zjarri i të gjithë institucioneve të Bashkisë, procedure e anulluar, eshte ne proces te hartimit te dokumentacionit te rishikuar | 1,000 | 1,000 | 166 |
| **P03280.O1.A4. Plotësimi I dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH i të gjitha objekteve të varësi të Bashkisë & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Plotësimi dhe certifikimi për MZSH i pajisjeve për fikje zjarri i të gjithë institucioneve të Bashkisë e anulluar, eshte ne proces te hartimit te dokumentacionit te rishikuar | 1,000 | 4,000 | - |
| **P03280.O1.A5. Rikonstruksion godina ekzistuese e MZSH** | Bashkia Shkodër | | - | 2,299 | - |
| **P03280.O2.A1. Shërbimi I Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit & te** | Drejtoria e mbrojtjes nga zjarri | A1 paga realizu si 12-m 87%.A2 sigurime 87%.A3-kancelari nuk eshte prokuruar(Bashkia). A4- | 49,904 | 58,526 | 44,505 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **trasheguara** | dhe shpëtimit | materiale pastrim+ngrohje 59740lekë.A 5 Blerje dokumenta 8400 leke.A,6 blerje karburant 1,601,969 Lekë.A7 realizuar ,l.A8 Taksa makine,realizuar.A9 ,siguracione ,realizuar.A11,Energji elektrike realizuar .A 12,Ujë,realizuar .A13,Telefon +intrnet,realizuar si 12.m.A14,Udhetim dieta(nuk eshte realizuar.A15 realizuar.A16 ,materiale dhe shërbime operative për MZSH,realizuar.A17,Kompensime realizuar .A18 blerje Uniforma për punonjësit e MZSH ,Realizuar.A19,sigurim jete,realizuar. | | | |
| **03280 Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile** | | | **130,634** | **127,823** | **65,930** |
| **Te trasheguara 3280** | | | **40,861** | **-** | **-** |
| **Totali** | | | **171,495** | **127,823** | **65,930** |

## FUNKSIONI 4: ÇËSHTJET EKONOMIKE

# Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit ka për qëllim rritjen ekonomike nëpërmjet tërheqjes së investitorëve të huaj dhe zhvillimi i NVM-ve. Kjo arrihet nga forcimi i bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkuesve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. në mbështetje të biznesit, si institucion realizojmë panairin e Punës dhe të Biznesit çdo vit brenda ambjenteve të Bashkisë si një mënyrë shumë efikase për të venë përballë njeri tjetrit të gjithë aktorët e interesuar në proces. Qëllimi është krijimi i një network-u që lidh aktorët e interesuar, shkëmben informacionet me synim zbutjen e papunësisë.

**Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:**

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2022 në programin 04130 "*Mbështetja për zhvillim ekonomik*" ka qëllim të programit të saj këto funksione zhvillimi:

- Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal
- Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë
- Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike
- Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik.
- Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Objektivat për përmbushjen e këtyre funksioneve për 12-mujorin e vitit 2022 janë:

**O1**. Mbështetja për përmirësimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planëve ekonomike zhvillimore lokale.

**O2**. Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

**O3**. Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja.

**O4**. Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet incentivave financiar, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre.

**Realizimi i buxhetit të planifikuar:** **(mijë/lekë)**

| Programi 04130 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| PBA 2022 | 1,549 | 2,729 | 3,940 | | 8,218 |
| Plani fillestar 2022 | 1,549 | 4,645 | 4,883 | 1,665 | 12,742 |
| Plani i rishikuar 2022 | 1,510 | 5,183 | 2,540 | | 9,233 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Realizimi viti 2022 | 1,466 | 471 | 2,253 | - | 4,190 |
| % e realizimit | 97.1% | 9.1% | 88.7% | 0 % | 45.4% |




Realizimi i shpenzimeve korente dhe kapitale për kete program krahasuar me planifikimin është në total 45.4 % sipas zerave me poshte:

| | |
|---|---|
| Shpenzime korente | 45.4 % |
| Shpenzime kapitale | 0.0% |




## Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Për sa i përket programit 4130 aktivitetet janë realizuar sipas afateve të parashikuara me përjashtim të atyre proceduarve që nuk kanë arritur të finalizohen.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022

| Kodi i Programit | 4130 | Emertimi i programit: | Mbeshtetja per zhvillim ekonomik | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | Synojmë që zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti të mobilizojë dhe të përfshijë komunitetet dhe organizatat lokale për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të Strategjisë Europë 2020 për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke nxitur kohezionin territorial dhe duke arritur objektiva të caktuara politikash. | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktitt | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Produktit | |
| *Objektivi O1* | Mbështetja për përmiresimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve zhvillimore lokale. | 1 | Dokumenti i monitorimit të strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër | 1 | 1 | 1 | 1 | 100% | Realizuar |
| | | 2 | Kapacitete të forcuara të OSHC-ve | 24 | 12 | 12 | 16 | 133% | Realizuar |
| | | 3 | Projekte të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare | 7 | 22 | 16 | 16 | 100% | Realizuar |
| | | 4 | Aktivitete informuese | 42 | 45 | 45 | 40 | 89% | Realizuar |
| | | 5 | Persona të informuar | 220 | 240 | 240 | 100 | 42% | Realizuar |
| | | | | | | | | | |
| *Objektivi O2* | Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. | 6 | Panaire të produkteve dhe shërbimeve të territorit | 10 | 10 | 10 | 2 | 20% | Realizuar pjeserisht |
| | | 7 | Shërbimi pranë zyrës QKB | 4 | 4 | 4 | 4 | 100% | Realizuar |
| | | | | | | | | | |
| *Objektivi O3* | Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale per nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja. | 8 | Publikime dhe Botime për zhvillim ekonomik | 0 | 1 | 1 | 0 | | I parealizuar |
| | | | | | | | | | |
| *Objektivi O4* | Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit | 9 | Iniciativa të biznesit të mbështetura financiarisht | 201 | 200 | 200 | 200 | 100% | Realizuar |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | vendor,nëpërmjet incentivave financiare, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre. | **10** | Biznese të asistuara për aplikime në programe dhe skema financiare | 30 | 25 | 25 | 25 | 100% | Realizuar |

**ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"**

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Mbështetja për zhvillim ekonomik | Kodi i Programit | 4130 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2021) | Shpenzimet (sipas vitit 2021) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2021) | Sasia (sipas planit të vitit 2022 | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022 | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Sasia Faktike (viti 2022) | Shpenzimet Faktike (viti 2022) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2022) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | Komente |
| 1 | Dokumenti i monitorimit të strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër | dokumenti | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | I realizuar |
| 2 | OSHC me kapacitete të forcuara | numër OSHC | 24 | 0 | 0 | 12 | 0 | 0 | 12 | 0 | 0 | 16 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | I realizuar |
| 3 | Projekte të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare | numër projektesh | 7 | 501 | 72 | 22 | 1,000 | 45 | 16 | 600 | 38 | 16 | 371 | 23 | -48 | -22 | -14 | I realizuar |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Aktivitete informuese | numër aktivitetesh | 42 | 0 | 0 | 45 | 43 | 1 | 45 | 43 | 1 | 40 | 0 | 0 | 0 | -1 | -1 | I realizuar |
| 6 | Persona të informuar | numër personash | 220 | 0 | 0 | 240 | 0 | 0 | 240 | 0 | 0 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | I realizuar |
| 7 | Panaire të produkteve dhe shërbimeve të territorit | numër panairesh | 10 | 2,138 | 214 | 10 | 2,440 | 244 | 10 | 2,840 | 284 | 2 | 689 | 0 | -214 | -244 | -284 | I realizuar |
| 8 | Shërbimi pranë zyrës QKB | numër shërbimesh | 4 | 1,521 | 380 | 4 | 1,635 | 409 | 4 | 1,650 | 413 | 4 | 1,606 | 402 | 21 | -7 | -11 | I realizuar |
| 9 | Publikime dhe botime | numër botimesh | 0 | 0 | 0 | 1 | 200 | 200 | 1 | 200 | 200 | 0 | 0 | 0 | 0 | -200 | -200 | I parealizuar |
| 10 | Iniciativa të biznesit të mbështetura financiarisht | numër biznesesh | 201 | 1,531 | 8 | 200 | 2,900 | 15 | 200 | 3,900 | 20 | 200 | 1,524 | 8 | 0 | -7 | -12 | I realizuar pjeserisht |
| 11 | Biznese të asistuara për aplikime në programe dhe skema financiare | numri i bizneseve të asistuara | 30 | 0 | 0 | 25 | 0 | 0 | 25 | 0 | 0 | 25 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | I realizuar |

Gjatë 12 mujorit të vitit 2022 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër për Programin 04130 "*Mbështetja për zhvillim ekonomik*".

## Tabela e aktiviteteve dhe realizimi i tyre nga pikëpamja financiare:

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | **000/leke** | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Totali** | | |
| | | | **Plani fillestar 2022** | **Plani i rishikuar 2022** | **Realizimi 2022** |
| **P04130.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| **P04130.O1.A2. Vazhdimi i zbatimit të metodologjise ReLOad) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve.** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| **P04130.O1.A3. Pjesmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian, Organizata të tjera ndërkombëtare si dhe anëtaresimi në shoqata nderkombëtare.** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,000 | 600 | 371 |
| **P04130.O1.A4. Organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit Europian nëpërmjet Këndit të BE Shkodër,** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 43 | 43 | - |
| **P04130.O1.A5. Informimi ne menyre periodike per publikun dhe grupet e tjera te interesit për procesin e Integrimit Evropian, Këndi BE Shkodër,** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| **P04130.O2.A1. Organizimi i një panairi pune dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër** | Bashkia Shkodër | I parealizuar | 300 | 300 | - |
| **P04130.O2.A2. Panairi i produkteve agroperpunuese sipas njësive administrative** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 700 | 700 | 689 |
| **P04130.O2.A3. Panairi i promovimit të vlerave artistiko- kulturore dhe i produkteve të territorit (për Njësitë Administrative)** | Bashkia Shkodër | I parealizuar | 1,440 | 1,840 | - |
| **P04130.O2.A4 Shërbimet e deleguara të QKB** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,635 | 1,650 | 1,606 |
| **P04130.O3.A1. Botimi i profilit te bizneseve të Bashkisë Shkodër në anglisht** | Bashkia Shkodër | Nuk eshte aktivitet I vitit 2022 | - | - | - |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **P04130.O3.A2. Publikimi i materialeve promocionale për zonat zhvillimore (për investime vendase dhe te huaja).** | Bashkia Shkodër | I parealizuar | 200 | 200 | - |
| **P04130.O4.A1. Bashkëpunimi me Zonën e permirësimit të bisnesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,600 | 1,600 | 1,524 |
| **P04130.O4.A2. Mbështetja e iniciativave të reja të zonave tregtare & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | I parealizuar | 1,300 | 2,300 | - |
| **P04130.O4.A3. Mbështetja dhe lehtesimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare.** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| 04130 Mbeshtetja per zhvillim ekonomik | | | **8,218** | **9,233** | **4,190** |
| Te trasheguara | | | 4,524 | - | - |
| Totali | | | 12,742 | 9,233 | 4,190 |

## Përshkrimi i aktiviteteve:

### P04130.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për zhvillim, i cili përfshin identifikimin dhe shfrytëzimin kryesisht të burimeve vendore, ideve dhe aftësive për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ky proces shoqërohet me monitorimin dhe vlerësimin e tij, si mekanizëm tepër i vlefshëm për të treguar nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efektivitet dhe nëse po bëhet ajo që është planifikuar.

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor bëhet nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit. Monitorimi realizohet në fund të vitit fiskal në zbatim të Planit të Përgjthshëm Vendor. Monitorimi i zbatimit të strategjisë territoriale Shkodër përbëhet nga dy pjesë. Njëra është monitorimit të ecurisë së zbatimit. Tjetra është monitorimi i rezultateve të zbatimit.Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër përbëhet nga Vizioni, 5 objektiva strategjike, 28 programe strategjike dhe 198 projekte. Aktualisht programi buxhetor afatmesëm i Bashkisë Shkodër është instrumenti kryesor i financimit të planit të investimeve. Ndërsa disa nga projektet strategjike kanë gjetur mbështetjen financiare të partnerëve ndërkombëtarë të zhvillimit si Bashkimi Europian, Banka Botërore, UNDP, etj.

### P04130.O1.A2. Vazhdimi i zbatimit te metodologjise ReLOad) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve.

Bashkia Shkodër ka shpallur Thirrjen e hapur për projekt propozime, për Organizatat e Shoqërisë Civile përmes metodologjisë LOD të Programit ReLOaD. Gjatë zhvillimit të proçedurës i jemi referuar VKB nr. 69, datë 30.10.2017 për "*Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër*" si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile", Miratimin e shpalljes së Thirrjes së hapur publike për organizatat e shoqërisë civile nr. 1290/2, datë 07.02.2022. Prioritetet u propozuan nga bashkia në përputhje me dokumentat strategjike që disponon. Nëpërmjet kësaj thirrjeje publike është synuar forcimi i partneritetit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe njësive të pushtetit vendor. Në këtë kuadër janë ftuar të gjitha OSHC-të e interesuara të cilat kanë dorëzuar projekt-propozime, të cilat duhet të adresojnë prioritetet strategjike të Bashkisë Shkodër. Gjatë 2022 thirrja është bërë 3 herë, në total numri i aplikimeve është 16 nga të cilat 7 prej të cilave u shpallen fituese për fazën e parë.

**P04130.O1.A3. Pjesmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian dhe Organizata të tjera ndërkombëtare**.

Procesi i integrimit evropian është sfida dhe prioriteti kryesor për Shqipërinë, ku pa dyshim një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe qeverisja vendore. Mjetet me të cilin BE mbështet Shqipërinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit janë programet e BE-së. Në këtë kuadër njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të përfitojnë nga financimi i fondeve të BE-së. Shkalla e përfitimit të fondeve të BE-së në nivel vendor varet nga angazhimi i njësive vendore në këtë proces. Prandaj është me shumë rëndësi që qeverisja vendore të fokusojë prioritetet e saj edhe në drejtim të forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndër-rajonal duke aplikuar në programe të ndryshme të BE-së.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe rajonal, Bashkia Shkodër shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE-së me qëllim rritjen e shërbimeve publike për qytetarët me standarde të përafruara europianë. Konkretisht Bashkia Shkodër është aplikuese në disa nga programet e financuara nga BE-së dhe një ndër specifikat e thirrjeve për projekte është edhe bashkëfinancimi. Kështu për projektet e shpallura fituese nga Bashkimi Europian, Bashkia Shkodër merr përsipër bashkëfinancimin e projekteve fituese sipas specifikave të programeve të BE-së. Në këtë kuadër lind e nëvojshme parashikimi i një fondi për bashkëfinancim në zërat e buxhetit vjetor dhe afatmesëm. Gjithashtu bashkia Shkodër është anëtare e shoqatës FAIC- Forumi i vendeve që lagen nga deti Adriatik dhe Jon.

**P04130.O1.A4. Organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit Europian nëpërmjet Këndit të BE Shkodër**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 450, datë 26.7.2018 "*Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integrimit evropian, ndërmjet qeverisjes*

*qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore*”, janë krijuar strukturat e Integrimit Evropian në 61 Bashkitë e Shqipërisë. Në këtë kuadër është krijuar struktura edhe në Bashkinë Shkodër, misioni i sëcilës është të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga proçesi i Integrimit Evropian. Të sigurojë programimin dhe zbatimin me efiçencë të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia.

Një ndër objektivat e Bashkisë Shkodër është shndërrimi i saj në një aktor të rëndësishëm të bashkëpunimit ndërkufitar, me të gjithë partnerët vendore, të Ballkanit Perëndimor, evropianë dhe nga vende të tjera. Kjo lidhet jo vetëm me bashkërëndimin e aksioneve dhe kontributeve në përputhje me synimet dhe interesat e partnerëve rajonalë dhe të komunitetit, por edhe me promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore të territorit.

Parë në këtë kontekst, Bashkia Shkodër vlerëson çdo bashkëpunim të mundshëm me partnerët tanë, me qellim zhvillimin e qëndrueshëm të bashkëpunimit institucional. Prandaj këtë herë me qëllim mbështetjen e produkteve tona lokale, promovimin e tyre si dhe përpunimin e produktit lokal nga ferma deri tek tavolinat e restoranteve të zonës në bashkëpunim me partnerët tonë mbështetëm organizimin e eventit më të rëndësishëm veror që solli në qytet turistë të huaj dhe shqiptar, aktivitetin SHIFE.

**P04130.O1.A5. Informimi në menyre periodike për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e Integrimit Evropian, Kendi BE Shkoder**

Projekti “*Bashkitë për në Evropë*”, i mbështetur nga Bashkimi Europian, synon fuqizimin e pushtetit vendor në Shqipëri gjatë procesi të integrimit. Në kuadër të këtij projekti është ngritur zyra e çështjeve të BE-së pranë 61 bashkive. Kjo zyrë luan një rol të rëndësishëm në promovimin e parimeve të BE-së në nivel vendor si dhe sherben si një urë për absorbimin e fondeve/programeve të BE. Këtu bëhet informimi në mënyrë periodike i publikut dhe i grupeve të tjera të interesit për procesin e integrimit evropian, për politikat e BE-së dhe mundësitë për përfitim nga asistenca e Bashkimit Evropian, nëpërmjet këndit të Bashkimit Evropian, i cili është krijuar dhe funksion brenda bashkisë.

Në këtë kuadër zyra e çështjeve të BE-së Shkodër ka siguruar dhënien e informacionit të nëvojshëm për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e integrimit evropian, për politikat e BE-së dhe mundësitë për përfitim nga asistenca e Bashkimit Evropian. Janë realizuar 40 aktivitete informuese të organizuara, nëpërmjet të cilave janë informuar rreth 100 persona. Njëkohësisht është bërë shpërndarja e materialeve promovuese mbi fondet, programet dhe projektet e BE-së. Përgjithesisht kërkesat e qytetareve në ketë periudhe kanë qenë të lidhura me mundësitë e financimit të projekteve.

**P04130.O2.A1. Organizimi i një panairi punë dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër**

Rajoni i Shkodrës, është i prekur nga një numër i lartë i të papunëve. Në Universitetin e Shkodrës si dhe në shkollat profesionale çdo vit diplomohen një numër i konsiderueshëm studentësh, të cilët kanë vështirësi të integrohen në tregun e punës. Nga ana tjetër në

Bashkinë e Shkodrës operojnë një numër relativisht i mirë i aktviteteve ekonomike të sektorëve të ndryshëm të cilët gjithashtu herë pas here kanë vështirësi në gjetjen e punonjësve e sidomos të atyre të kualifikuar. Kjo gjë ndodh nga mungesa e informacionit si për vendet e punës së disponueshme por gjithashtu edhe për mundësitë që kanë bizneset për të punësuar punonjës të kualifikuar. Për këtë arsye, Bashkia Shkodër realizon panairin e punës me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm në këtë proces ku mund të përmendim Zyren Rajonale të Punësimit Shkoder, Qendren e Formimit Profesional,Universitetin e Shkodrës, shkollat e mesme profesionale dhe bizneset që kanë aktivitet në Shkodër e më gjërë.  Ky panair synon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të tregut të punës, nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit midis autoriteteve vendore, institucionëve, partnerëve socialë dhe të sektorit privat, në një partneritet lokal të qëndrueshëm për punësim.
Ky aktivitet nuk ështe realizuar.

**P04130.O2.A2. Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative**
Bashkia Shkodër për shkak të pozicionimit gjeografik dhe resurseve natyrore që disponon ka potenciale të madhe për zhvillimin ekonomik. Baza ekonomike është blegtoria, sidomos në zonën malore të saj, ndërsa në zonën fushore përparësi ka bujqësia, kryesisht drithërat e bukës. Përveç tyre, produkte të tjera tipike të zonës janë të lidhura me vreshtarinë, ullishtat dhe frutat/perimet. Po ashtu, afërsia me liqenin ka nxitur edhe peshkimin. Sektori i agropërpunimit është një ndër sektorët e ekonomisë e cila gërsheton potencialet e burimeve natyrore, pozitën gjeografike, traditën e rajonit por gjithashtu edhe interesin në rritje të aktorëve dhe partnërëve të rëndësishëm për rajonin. Si e tillë vërehet praninë e biznëseve agro përpunuese të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë. Por përtej mundësive që vendi ofron ky sektor ndeshet me disa problematika që kanë të bëjnë kryesisht me investimet për modernizimin e teknologjisë, standardizimin, konkurrueshmërinë, nxitjen e promovimit të markave rajonale, kapacitetet menaxhuese etj. Në këtë kuadër me qellim zhvillimin e biznësit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse bashkia ka parashikuar organizimin e panaireve të produkteve agropërpunuese. Në këtë panair do të prezantohen të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër me produktet vendase, me pasuritë e tyre kulturore dhe ushqimin tradicional. Ky aktivitet është realizuar në datën  21.10.2022 duke prezantuar produktet vendore, pasuritë natyrore dhe kulturore duke i promovuar në funksion të zhvillimit ekonomik dhe turistik të të gjitha njësive  administrative të Bashkisë Shkodër. Për herë të parë, këtij aktiviteti ju bashkuan trojet shqipfolëse, Gjakova, Ulqini, Tetova, si dhe qytetet shqiptare nga veriu në jug, duke i dhënë një tjetër dimension kësaj feste ku shpalosen vlerat tona më të mira.

**P04130.O2.A3. Panair i promovimit të vlerave dhe produkteve të territorit (për Njësitë Administrative)**
Territori i ri i Bashkisë Shkodër, si nga morfologjia e territorit dhe burimet natyrore ashtu dhe nga mënyra e zhvillimit është një territor shumë i larmishëm dhe dinamik. Si i tillë

përveç potencialeve të shumta natyrore, paraqet edhe potenciale të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të zonës. Qyteti, rrethinat dhe malësitë e Bashkisë Shkodër janë dalluar për prodhimet artizanale si punimet prej thupre, bakri, argjendi e druri, qëndismat, qilimat, etj. Gjithashtu e gjithë zona është karakterizuar nga veshje tradicionale funksionale për çdo ceremoni dhe për jetën e përditshme. Një larmi tejet të madhe edhe në shkallë vendi paraqet bashkia për sa i përket pasqyrimit të shpirtit njerëzorë përmes këngës. Po ashtu Bashkia e re është dalluar për një numër të madh prodhimesh tradicionale me bazë burimet dhe kushtet natyrore të saj. Thirrja publike është shpallur tre here për zhvillimin e këtij aktiviteti por nuk ka patur asnjë aplikim nga shoqatat, e cila ka ardhur si rezultat i ndryshimit drastik të çmimeve në masën 30 %.

**P04130.O2.A4 Shërbimet e deleguara të QKB**

Pagesa e punonjësve të QKB pranë institucionit tonë bëhet në mbështetje të nënit 8, pika 1 dhe 2; dhe nënit 9, pika 2, të ligjit nr 131/2015 "*Për Qendrën Kombëtare të Biznesit*" .

Në zbatim ligjit, Bashkia Shkodër ka lidhur me QKB-në, marrëveshjen e bashkëpunimit nr 6074 date 25.05.2016 ku në nenin 5 pika 1 përcaktohet:

"Niveli i pagave dhe shpërblimeve të nëpunësve në sportelet e shërbimit, pranë njësisë së qeverisjes vendore, përcaktohen me vendim të këshillit bashkiak duke marrë në konsideratë fondin e deleguar nga QKB –ja për këtë qëllim.

Këto funksione të deleguara tashmë kryhen nga Bashkia dhe gjithashtu me Vendimin e Këshillit Bashkiak " Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe të institucioneve të varësisë". Janë përcaktuar disa nivele page në kategorinë e pozicionit ku paguhen nëpunësit e sporteleve të shërbimit të QKB-së.

Është kryer rregullisht procesi i likujdimit të pagave dhe sigurimeve shoqerore për muajt Janar –Dhjetor për vitin 2022.

**P04130.O3.A2 Publikimi i materialeve promocionale për zonat zhvillimore (për investime vendase dhe te huaja)**

Bashkia Shkodër ka tashmë një shtrirje territoriale të madhe dhe gjithashtu ka edhe detyrën e shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin. Për të arritur këtë qëllim duhet bërë një klasifikim i zonave zhvillimore sipas pozicioneve përkatëse gjeografike dhe sipas sektorëve të zhvillimit. Një pikë e rëndësishme është seleksionimi i industrive dhe funksioneve ekonomike të zonave zhvillimore, duke zgjedhur industri të lehtë, zhvillim turizmi apo bujqësie që është jo dëmtuese për mjedisin apo duke i bashkuar me industri të tjera plotësuese ose që ndajnë karakteristika të përbashkëta dhe mund të funksionojnë së bashku. Promovimi i zhvillimit në zonat ekonomike dhe në fashat e zhvillimit ekonomik të përcaktuara në strategjinë e territoriale të Bashkisë Shkodër të cilat janë:

- Zona e ish-fushës së aviacionit- zonë e lirë ekonomike
- Ish-zonës industriale Shkodër (rikualifikim i Brownfield)

- Bypassi në një itinerarë natyror
- Aksit Ura e Bahçallëkut -Bërdicë si aks ekonomik
- Fashat ekonomike: Bashkinë Shkodër Aksi Shkodër -Koplik
- Aksit rrugor Shkoder - Ana e Malit - Muriqan
- Fashat ekonomike - Aksi Shkodër - Vau i Dejës
- Rruga Shirokë- Zogaj
- Zona e Qëndrës Shkodër
- Zona pranë By-Pass Perëndimor
- Terminali ujor
- Zona Velipojë-Rrjoll
- Etj.

Një nga masat e bashkisë për të krijuar mundësinë e zhvillimit të këtyre zonave do të jetë edhe promovimi dhe tërheqja e investitorëve vendas dhe të huaj.

Përmes bashkëpunimit me drejtorinë e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe drejtorinë Juridike do të detajohen rregulloret dhe procedurat për zhvillimin e këtyre zonave. Publikimi i materialeve promocionale për zonat zhvillimore, nuk është realizuar pasi nuk janë përfunduar disa nga PDV (Planet e Detajuara Vendore).

**P04130.O4.A1. Bashkëpunimi me Zonën e permirësimit të biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori**

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është mbështetja e biznesit të vogël për t'u konsoliduar, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të zonës së përmirësimit të biznesit, për ta kthyer atë në një vend tërheqës për vizitorin.

**P04130.O4.A2. Mbeshtetja e iniciativave te reja te Zonave Tregtare**

Një ndër prioritetet e Bashkisë Shkodër është zhvillimi i qendrueshëm ekonomik dhe përmirësimi i klimës së biznesit në territorin e saj. Për këtë qëllim Bashkia do të vazhdojë të mbështesë iniciativa të reja për zhvillimin e biznesit, në fusha që lidhen me vizionin e zhvillimit të saj. Iniciativa të tilla kanë të bëjnë me krijimin e lehtësirave infrastrukturore të nevojshme për zhvillimin e zonave të reja tregtare si dhe nxitjen e kulturës së sipërmarrjes duke ju përgjigjur zhvillimeve të reja në kohë dhe në mënyrë krijuese. Konkretizimi i ndërhyrjeve në zonat karakteristike të Shkodrës të cilat kanë një potencial të lartë për kthimin e tyre në atraksione turistike dhe integrimi i tyre me ofertën turistike, përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të saj. Trashëgimia dhe kultura identifikohen si elemente të forta territorial dhe Shkodra është një ndër destinacionet më të rëndësishme në Shqipëri. Prandaj është me shumë interes krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për terheqjen e investimeve në zonat e përmirësimit të biznesit dhe organizimin e veprimtarive kulturore - artistike në mënyrë që të rrisim numrin e vizitorëve dhe kohën e qëndrimit jo vetëm përgjatë sezonit veror, por gjatë gjithë vitit. Nisma të tilla nuk kanë munguar edhe më përpara, mjafton të përmendim projektin "BID Shkodra" përgjatë rrugëve "13 Dhjetori", "28 Nëntori" dhe "Kolë Idromeno" por është e nevojshme shtrirja e tyre edhe në zona të tjera historike të Shkodrës, ku pa dyshim

Shkodrës nuk i mungojnë. Të tilla mbështetje do të ndikojnë në përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve bazë, gjenerimin e të ardhurave dhe krijimin e vendeve të lira të pune.

**P04130.O4.A3. Mbështetja dhe lehtesimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare**.

Bizneset ekzistuese në Shkodër kanë hasur vështirësi për të aplikuar në programet dhe në skemat e ndryshme financiare qeveritare. Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së informacionit dhe gjithashtu vështirësive që hasin në plotësimin e dokumantacionit ligjor, sipas udhëzimeve të përcaktuara nga ministria e linjës apo edhe nga rregulloret e programeve të ndryshme. Programet mbështetëse dhe instrumentat financiare qeveritare janë një mënyrë e mirë për rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë dhe industrisë ushqimore, në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të zonave malore të disavantazhuara, rritjen e ekonomisë lokale nga njëra anë dhe nga ana tjetër përforcimi i marrëdhënieve ekonomike me Bashkimin Europian, mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e transportit të qëndrueshëm dhe të infrastrukturës publike etj. Në këtë kuadër Bashkia Shkodër jep asistencen e saj për plotësimin e dokumentacionit për aplikim për ato subjekte që kanë nëvojë si dhe i mban të informuar ato për thirrje të ndryshme që hapen gjatë vitit.

# Programi 04160: Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

## Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2022 në programin 04160 "*Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi"* ka fokusuar përpjekjet e saj në 1 funksion zhvillimi:

- Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

Objektivat për përmbushjen e këtyre funksioneve për 12-mujorin vitit 2022 janë:
**O1**. Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës

**Realizimi i buxhetit të planifikuar per programin :Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi**

*000/leke*

| Programi 04160 | Shpenzime operative | Investime | Totali |
|---|---|---|---|
| PBA 2022 | 1,000 | | 1,000 |
| Plani fillestar 2022 | 1,389 | 962 | 2,351 |
| Plani i rishikuar 2022 | 1,313 | | 1,313 |
| Realizimi viti 2022 | 124 | - | 124 |
| % e realizimit | 9.4% | - | 9.4% |




Realizimi i shpenzimeve korente dhe kapitale per ketë program krahasuar me planifikimin eshtë në total 9.4 % sipas zerave me poshtë:
Shpenzime operative 9.4 %




**Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:**
Për sa i përket programit 4160 aktivitetet janë të shtrira në kohë përgjatë vitit kalendarik/ buxhetor .

**Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit**

**Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022**

| Kodi i Programit | 4160 | Emertimi i programit: | Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | Synojmë që zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti të mobilizojë dhe të përfshijë komunitetet dhe organizatat lokale për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të Strategjisë Europë 2020 për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke nxitur kohezionin territorial dhe duke arritur objektiva të caktuara politikash. | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktitt | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Produktit | |
| *Objektivi O1* | Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës. | 1 | Numri i vendeve të shitjes në tregje publike të mirëmbajtura (pagese e sherbimeve utilitare dhe riparim vende shitjeje) | 120 | 120 | 120 | 120 | 100% | Jane likujduar në kohë shpenzimet e parashikuara |

**ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"**

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi | Kodi i Programit | 4160 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2021) | Shpenzimet (sipas vitit 2021) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2021) | Sasia (sipas planit të vitit 2022 | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022 | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Sasia Faktike (viti 2022) | Shpenzimet Faktike (viti 2022) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2022) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | Komente |
| 1 | Mirëmbajtja e tregjeve ekzistuese | numri i tregjeve të mirëmbajtura | 120 | 126 | 1.1 | 120 | 1,000 | 8.3 | 120 | 1,313 | 10.9 | 120 | 124 | 1.0 | 0.0 | -7.3 | -9.9 | Realizuar |

Gjatë vitit 2022 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër per Programin 04160 Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

### Tabela e aktiviteteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare:

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | | | 000/leke |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Totali | | |
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| **P04160.O1.A1. Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,000 | 1,313 | 124 |
| **P04160.O1.A2. Tregu rajonal i peshkut** | Bashkia Shkodër | Nuk eshte aktivitet I vitit 2022 | - | - | - |
| **P04160.O1.A3. Tregu I produkteve bujqësore Velipojë** | Bashkia Shkodër | Nuk eshte aktivitet I vitit 2022 | - | - | - |
| **P04160.O1.A4. Ndërtimi i tregut të shitjes me pakicë të produkteve agro-ushqimore lokale** | Bashkia Shkodër | Nuk eshte aktivitet I vitit 2022 | - | - | - |
| **04160 Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi** | | | **1,000** | **1,313** | **124** |
| **Te trasheguara** | | | **1,351** | **-** | **-** |
| **Totali** | | | **2,351** | **1,313** | **124** |

### P04160.O1.A1. Mirëmbajtje e tregjeve egzistuese

Tregjet ekzistuese dhe ato të rejat që do ndërtohen e kanë të domosdoshme mirëmbajtjen e tyre sepse ato amortizohen. Më shumë duhet të bëhet në drejtim të përmirësimit të ambientëve fizike të tregjeve duke parashikuar riparime në infrastrukturen e tezgave, banakeve, lyerje. Mirëmbajtje të hapësirave për automjetet dhe këmbësoret gjithashtu duhen parashikuar mirëmbajtje të vazhdueshme në banjo publike, elektricitet, ujë etj. Riparime në ambjentet e magazinimit të mallit etj. I njëjti model mirëmbajtje duhet të funksionojë pastaj edhe për tregjet e reja që do ndërtohen, në mënyrë që të qëndrojnë përherë brenda standarteve të mira të tregtimit. Për këtë arsye eshtë planifikuar edhe aktiviteti në fjalë, i cili është i shtrirë edhe në vitet në vazhdim. Konkretisht këtë vit me buxhetin e programit 04160 janë likujduar çdo muaj detyrimet e energjisë elektrike si dhe deri tani nuk është kryer asnjë riparim, pasi nuk është paraqitur asnjë kërkesë për mirëmbajtjen e vend tregtimeve të tregut të ri.

## Programi 04220: Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve

Ky program përfshin institucionet:

1. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve

**Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikes së programit:**

Qëllimi i programit të shërbimeve bujqesore është:

Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive bujqësore dhe ekonomike në zonat rurale në nivelin e fermës dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj nëpërmjet projekteve, që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokave bujqesore si dhe të kategorive të resurseve të tjera.

Mbështetja për përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore me masa të ndryshme investuese nëpërmjet projekteve. Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve. Nxitja, përmes financimit dhe këshillimit bujqësor të organizatave, shoqatave dhe kooperativave të prodhuesve bujqësore dhe ato të përpunimit e tregtimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore, të ngritura në baza vullnetare.

Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor dhe rural. Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për zhvillimin rural të financuara nga buxheti lokal dhe /ose me bashkëfinancim nga të tretë.

Objektivat e programeve buxhetore për përmbushjen e këtyre qëllimeve për vitin 2022 kanë qënë:

- O1. Krijimi i sistemit të informacionit për administrimin, përdorimin e tokës mbështetur në teknologji bashkëkohore.
- O2. Krijimi i databazës së informacionit bujqësor. Krijimi i strukturës këshillimit bujqësor.
- O3. Përthithja e granteve nga programet për zhvillimin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.
- O4.Trajtimi veterinar i kafshëve të rrugës.

| | | | *000/leke* |
|---|---|---|---|
| **Programi 04220** | **Shpenzime operative** | **Investime** | **Totali** |
| **PBA 2022** | 2,230 | 5,000 | 7,230 |
| **Plani fillestar 2022** | 2,237 | 5,000 | 7,237 |
| **Plani i rishikuar 2022** | 2,230 | 5,000 | 7,230 |
| **Realizimi viti 2022** | 1,321 | 3,830 | 5,151 |
| **% e realizimit** | 59.2% | 76.6% | 71.2% |




Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 71.2 %, sipas zërave kryesorë më poshtë:

| | |
|---|---|
| Shpenzime korente | 59.2% |
| Shpenzime kapitale | 76.6% |

### Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Nuk kemi pasur faktorë pengues për mosrealizimin e shpenzimeve të parashikuara. Janë parashikuar 1,326 mijë lekë për shërbimin e trajtimit të qenve të rruges, për të cilen është lidhur kontrata në vlerën 1,321 mijë lekë dhe është realizuar. Për sa i perket investimit për ndërtimin e strehezës ka përfunduar, sipas parashikimit, faza e parë e ndërtimit.

**Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit**

**Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022**

| Kodi i Programit | 4220 | Emertimi i programit: | Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive bujqësore dhe ekonomike në zonat rurale në nivelin e fermës dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj nëpërmjet projekteve, që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokave bujqësore si dhe të kategorive të resurseve të tjera. Mbështetja për përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore me masa të ndryshme investuese nëpërmjet projekteve. Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqesore e të kategorive të tjera të resurseve. Nxitja, përmes financimit dhe këshillimit bujqësor të organizatave, shoqatave dhe kooperativave të prodhuesve bujqësore dhe ato të përpunimit e tregtimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore, të ngritura në baza vullnetare. Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor dhe rural. Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për zhvillimin rural të financuara nga buxheti lokal dhe /ose me bashkëfinancim nga të tretë. | | | | | | | | |
| | | | Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Produktit | Emertimi i Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Produktit | |
| *Objektivi 1* | Krijimi i sistemit të informacionit për administrimin, përdorimin e tokës mbështetur në teknologji bashkëkohore. Plotësimi i dokumentacioneve përkatëse të pronësive private | 1 | Regjistri kadastral për të gjithë territorin e bashkisë, manual dhe elektronik | 20 | 18 | 18 | 18 | 100% | |
| | | 2 | Numri i njësive bujqësore aktive të përditësuara në database bujqësore | 320 | 350 | 350 | 360 | 103% | |
| | | | | | | | | | |
| *Objektivi 2* | Përthithja e granteve nga programet për zhvillimin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural | 3 | Numri i përfituesve (nr. përfitues individual, nr. Sh.B.B), nr. agropërpunes) në programet e mbështetjes nga donatorët për promovimin dhe bashkëpunimin në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural | 96 | 64 | 64 | 150 | 234% | |
| | | | | | | | | | |
| *Objektivi 3* | Trajtimi veterinar i kafshëve të rrugës. Ngritja dhe funksionimi i strehëzes për kafshët e rrugës. | 4 | Numri i qenve në rrugë qe perfitojne sherbime dhe trajtohen. Numri i Qenve me pronar që do pajisen me chip gjurmues. | 260 | 350 | 350 | 172 | 49% | |
| | | 5 | Kapaciteti i strehezës për të strehuar qentë e rrugës | | 110 | 110 | 110 | 100% | |

**ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri i Grupit** | **Bashkia Shkodër** | **Kodi i Grupit** | **141** |
| | | | |
| **Programi** | **Shërbimet Bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve** | **Kodi i Programit** | **4220** |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
|---|---|---|---|---|---|
| **P 04520.O3.A87.17 Kontrate shtese Bardhaj koder II 20% (TRASHEGUARA)** | Bashkia Shkoder | Realizuar investimi | - | 1,109 | - |
| **P 04520.O3.A88 Sistemim asfaltim rruga Varrezat e Deshmorev e - Bardhaj(TRASHEGUARA)** | Bashkia Shkoder | Realizuar | - | 9,543 | 9,538 |
| **P 04520.O3.A89 Sistemim asfaltim dhe punime mbrojtese ne segmentin Ura Bardhaj - Shkolla Bardhaj" faza II(TRASHEGUARA)** | Bashkia Shkoder | Realizuar | - | 6,491 | 6,491 |
| **P 04520.O3.A90 Rikonstruksion rruga "Bajri"(TRASHEGUARA)** | Bashkia Shkoder | Realizuar | - | 7,539 | 7,538 |
| **P04520.O3.A91 Sistemim - Asfaltim i rrugës Oblike – Pallate, Faza II** | Bashkia Shkoder | Trasheguar ne vitin 2023 | - | 7,563 | - |
| **P04520.O3.A92 Sistemim - Asfaltim rruga "Lulaj" Hot i Ri** | Bashkia Shkoder | Trasheguar ne vitin 2023 | - | 5,300 | - |
| 04520 Rrjeti rrugor | | | 260,547 | 488,993 | 315,366 |
| **P04520.O4.A1.Projektim Rikonstruksion rruge Shkoder Qender** | Bashkia Shkodër | | 1,000 | - | - |
| **P04520.O4.A2.Projektim Rikualifikim Urban blloqe Shkoder Qender** | Bashkia Shkodër | | - | - | - |
| **P04520.O4.A4. Projektim Rehabilitim, shtrim dhe asfaltim i rrugeve ne Njesi Administrative** | Bashkia Shkodër | | - | - | - |
| **P04520.O4.A3. Projekti PARK4SUMP& te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Trasheguar | 758 | 3,285 | - |
| **P 04520.O4.A4.1 Studim Projektim Rikonstruksion rruga memorandumi i Greces (TRASHEGUARA)** | Bashkia Shkoder | Trasheguar | - | 70 | - |
| **P 04520.O4.A4.2 Studime dhe projektime ne bashkefinancim (TRASHEGUARA)** | Bashkia Shkoder | Trasheguar | - | 1,040 | 106 |
| 04520 Studime për rrugët | | | 1,758 | 4,394 | 106 |
| 04520 Rrjeti rrugor rural | | | **262,305** | **493,388** | **315,472** |
| Te trasheguara | | | **167,971** | **-** | **-** |
| Totali | | | **430,276** | **493,388** | **315,472** |

# Programi 04570: Transporti publik dhe lëvizshmëria

Ky program përfshin institucionin e Bashkisë.

**Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:**

-Qëllimi i programit të Transportit publik është:

Për të favorizuar përdorimin e rrugës nga këmbësorët dhe biçikletat, si dhe për të promovuar një kulturë të re për përdorimin e mjeteve të transportit publik.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12-mujorin 2022 kanë qënë:

**a.Lëvizshmëria**

Shërbimi për mirëmbajtjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale realizohet me punonjës të shërbimeve publike.

Është kryer vijëzimi i rrugëve kryesore të qytetit, vijëzimi i parkingjeve, parkingjet për persona me aftësi ndryshe, korsitë e biçikletave dhe vijëzime të këmbësorëve në degëzimet kryesore.

Është bërë përmrësimi me sinjalistikë në afërsi të shkollave për rritjen e sigurisë së lëvizjes së nxënësve

Janë ndërtuar 7 rrampa për lehtësimin e lëvizjes së personave me aftësi ndryshe. Ndërtimi i tyre është bërë në kryqëzimet dhe rrugët kryesore të qytetit.

Është realizuar plotësimi me sinjalistikë sipas nevojave në zbatim të vendimeve të marra duke bashkëpunuar dhe me Drejtorine e Policisë së Qarkut sektorin e qarkullimit rrugor.

Është realizuar shërbimi i sinjalistikës edhe në njësitë e tjera administrative kryesisht në Nj.A Velipojë përpara fillimit të sezonit të plazhit por edhe në zonat e banuara dhe në afërsi të shkollave në njësitë administrative Rrethina, Guri Zi, Bërdicë, Postribë dhe Ana e Malit,

Si pjesë e zbatimit të projekteve në infrastrukturë, është bërë plotësimi me sinjalistikë horizontale e vertikale, në të gjitha rrugët e rikonstruktuara me financimet e Bashkisë Shkodër

**b.Shërbimi urban qytetas realizohet në linjat:**

***Linja 1*** (Bahçallëk- Fermentim- Bahçallëk) e cila realizohet me 50 cikle në ditë me frekuencë 15 minuta paradite dhe 25 minuta pasdite.

***Linja 2*** (Qendër- Shirokë- Zogaj)e cila shërbehet 2 herë në ditë sipas orareve të miratuara.

Krahas shërbimit qytetas në Bashkinë Shkodër realizohet shërbimi rrethqytetës me linja të rregullta që lidhin Njësitë Administrative me Bashkinë Qendër. Shërbimi kryhet me operatorë ekonomik të liçencuar nga Bashkia Shkodër sipas frekuencave të miratuara me vendim të këshillit të bashkisë nr.5 datë 05.01.2022: "*Për miratimin e rrjetit të linjave dhe të tarifës së biletave të transportit qytetëse dhe rrethqytetëse të udhëtarëve, për periudhën afatmesme 2022-2024 në Bashkinë Shkodër*".

Sipas vendimit të mësipërm transporti i udhëtarëve realizohet në linjat si më poshtë:

- Shkodër – Velipojë
- Shkodër – Dajç
- Shkodër–Trush
- Shkodër – Gur i Zi
- Shkodër – Ana e Malit
- Shkodër – Postribë

- Shkodër – Rrethina me 3 linja (Shkodër - Bleran – Bardhaj, Shkodër – Grudë e Re – Gucijë e Re, Shkodër – Shtoj i Ri – Shtoj i vjetër )
- Shkodër – Shalë me dy drejtime: a. Shkodër – Breglumi – Shalë – Theth – Shkodër; b. Shkodër- Koplik – Theth – Breglumi – Shalë – Shkodër

## Realizimi i Buxhetit të planifikuar:

**mijë lekë**

| Programi 04570 | Shpenzime operative | Subvencione | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|
| PBA 2022 | 3,637 | 1,000 | 6,000 | 10,637 |
| Plani fillestar 2022 | 4,364 | 4,000 | 10,000 | 18,364 |
| Plani i rishikuar 2022 | 3,777 | 1,000 | 9,150 | 13,927 |
| Realizimi viti 2022 | 2,927 | | 3,150 | 6,077 |
| % e realizimit | 77.5% | 0.0% | 34.4% | 43.6% |




Realizimi i shpenzimeve për shpenzime operative, subvencion dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 43.6 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Shpenzime korente | 61.3% |
| Shpenzime kapitale | 34.4% |



**Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:**

Investim në përmirësimin rrugore horizontale dhe vertikale është në proçes të hartimit të dokumentacionit. Fondet janë trashëguar për vitin 2023.

Shërbim mirëmbajtje për makinat është realizuar gjatë vitit.

Subvencione për abonetë e transportit urban nuk është sepse nuk ka pasur aplikim për abone nga kategoritë përfituese (nxënës dhe studentë).

## Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

## Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022

| Kodi i Programit | 4570 | Emertimi i programit: | Transporti publik | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | Lëvizshmeri e sigurt, e mire orientuar për banorët dhe vizitoret. Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor në shërbim të qytetarëve te Bashkisë Shkodër. Përmirësim të impaktit mjedisor nëpërmjet stimulimit të transportit publik dhe traditës së përdorimit të biçikletës. | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| ***Objektivi 1*** | Përmiresimi i levizshmerise urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë | 1 | Rritja e sigurisë në rrugë për këmbësoret dhe pedaluesit nëpërmjet: Numri i tabelave për sinjalistikën vertikale. | 1362 | 1500 | 1500 | 1500 | 100% | |
| | | 2 | Rritja e sigurisë në rrugë për këmbësoret dhe pedaluesit nëpërmjet: Numri i bumpeve për sinjalistikën horizontale . | 56 | 88 | 88 | 88 | 100% | |
| ***Objektivi 2*** | Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor në shërbim të qytetarëve të Bashkisë Shkodër | 3 | Përmirësimi i transportit publik. Zona e mbuluar me transport publik (Popullsia që jeton brenda një rrezeje 500 m deri në një stacion autobusi); Numri i linjave të transportit publik urban dhe interurban | 15 | 15 | 17 | 17 | 100% | |
| | | 4 | Rritja e komunikimit nëpërmjet transportit publik - Numri i mjeteve të transportit publik urban dhe interurban | 65 | 67 | 70 | 70 | 100% | |
| | | 5 | Numri i biletave te shitura. | 420,000 | 600,000 | 600,000 | 600,000 | 100% | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 6 | Përkrahja e kategorive si nxënës, studentë dhe kategorive të veçanta që përfitojnë sipas dispozitave ligjore.Numri i njerëzve të mbështetur / subvencionuar për transportin publik | 0 | 500 | 500 | 0 | 0% | |

## ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Transporti publik | Kodi i Programit | 4570 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kodi** | **Emërtimi i Produktit** | **Njësia matëse** | **Sasia Faktike (sipas vitit 2021)** | **Shpenzimet (sipas vitit 2021)** | **Kosto për Njësi (sipas vitit 2021)** | **Sasia (sipas planit të vitit 2022** | **Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022)** | **Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022)** | **Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022)** | **Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022** | **Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022)** | **Sasia Faktike (viti 2022)** | **Shpenzimet Faktike (viti 2022)** | **Kosto për Njësi Faktike (viti 2022)** | **V = IV - I** | **V = IV - II** | **V = IV - III** | **Komente** |
| **1** | Rruge lokale urbane me sinjalistikë rrugore. | km | 150 | 3,047 | 20 | 155 | 9,637 | 62 | 160 | 12,927 | 81 | 155 | 6,077 | 39.21 | 19 | -23 | -42 | |
| **2** | Udhëtarë që përdorin linjat e transportit publik | Numri i njerëzve të mbështetur / subvencionuar për transportin publik | 0 | 0 | 0 | 500 | 1,000 | 2 | 500 | 1,000 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | -2 | -2 | |

Për vitin 2022 në Programin " Transporti publik dhe lëvizshmëria" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë realizuar aktivitetet si më poshtë:
P04570.O1.A1:Lëvizshmëria dhe sinjalistika & të trashëguara.
P04570.O2.A1: Shërbimi i transportit.

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | | | 000/leke |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Totali | | |
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| **P04570.O1.A1:Levizshmëria dhe sinjalistika & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Investim permiresimin rrugore horizontale dhe vertikale eshte ne proces e pa realizuar(e mbartur per vitn 2023), Blerje materile sinjalistike horizontale dhe vertikale e perfunduar. Sherbim mirembajtje per makinat e vijezimit e realizuar. Shpenzime per karburant eshte e realizuar | 9,637 | 12,927 | 6,077 |
| **P04570.O2.A1: Shërbimi i transportit** | Bashkia Shkodër | E trasheguar per vitin 2023 | 1,000 | 1,000 | - |
| **04570 Transporti Publik** | | | **10,637** | **13,927** | **6,077** |
| **Te trasheguara** | | | **7,727** | **-** | **-** |
| **Totali** | | | **18,364** | **13,927** | **6,077** |

# Programi 04760: Zhvillimi i Turizmit

Turizmi, si aktivitet ndërsektoral, është i lidhur me shumë aktivitete ekonomike me ndikim të jashtëzakonshëm në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime të lidhura me kohën e lirë dhe me udhëtimet e biznesit. Ai luan një rol të madh në zhvillim, pasi kontribuon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e zonave në rënie industriale apo rurale, si dhe në rigjenerimin urban.

## I. Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

F1. Zhvillimi i Turizmit
Objektivat për secilin funksion janë:
F1.O1. Promovim i territorit të Bashkisë nërpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promocionale dhe informative.
F2.O2. Organizim dhe pjesëmarrje në panaire lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.
F3. O3 Organizimi i aktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë Shkodër.
F4. O4 Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara për zhvillimin e turizmit.
F5. O5 Hartim i planeve dhe studimeve të zhvillimit të turizmit nga bashkëpunimi me struktura të interesuara dhe universitetin.
F6. O6 Ngritje e kapaciteteve të bizneseve që operojnë në fushën e turizmit me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit nga ana e tyre.
F6. O7. Përmirësim i infrastrukturës turistike dhe i aksesit.

## II. Rezultatet e programit 04760: Zhvillimi i turizmit

*000/leke*

| Programi 04760 | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|
| PBA 2022 | 2,750 | 2,950 | 250 | 5,950 |
| Plani fillestar 2022 | 4,247 | 2,954 | 849 | 8,050 |
| Plani i rishikuar 2022 | 3,650 | 2,150 | 250 | 6,050 |
| Realizimi viti 2022 | 1,641 | 2,137 | 168 | 3,946 |
| % e realizimit | 45.0% | 99.4% | 67.2% | 65.2% |




Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 65.2 %.

| | |
|---|---|
| Shpenzime korente | 65.1% |
| Shpenzime kapitale | 67.2% |




**Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara**:

Aktivitet janë parashikuar të zhvillohen gjatë vitit. Pershkrimet e stutusit të aktiviteteve janë dhënë në hollësi në përshkrimin e aktiviteteve. Për disa aktivitete si prodhimi i materialeve promocionale ( ri printimi i hartave të Bashkisë Shkodër, kalendarit të aktiviteteve dhe riprintim të itinerareve turistike) është konsideruar e panevojshme përdorimi i fondeve të parashikuara për arsye të gjendjes stok të këtyre materialeve.

**Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit**

**Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022**

| Kodi i Programit | 4760 | Emertimi i programit: | Zhvillimi i turizmit | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | Zhvillimi i Turizmit | | | | | | | | ..... |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | ..... |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/ Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| *Objektivi 1* | Promovim i territorit të Bashkisë nërpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promocionale dhe informative. | 1 | Numri i vizitorëve në faqen e turizmit të Bashkisë. | 6,900 | 67,000 | 67,000 | 10,200 | 15% | |
| | | 2 | Numri i shkarkimeve të aplikacionit | 2,750 | 35,000 | 35,000 | 7,000 | 20% | |
| | | 3 | Numri i materialeve promocionale të prodhuara. (harta, guida etj) | 5,000 | 6,800 | 6,800 | 1,800 | 26% | |
| | | | | | | | | | |
| *Objektivi 2* | Organizim dhe pjesëmarrje në panaire lokale, kombëtare dhe ndërkombetare. | 4 | Artizan pjesëmarrës në panarin e artizanatit | 40 | 24 | 40 | 35 | 88% | |
| | | 5 | Pjesëmarrje në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare | 0 | 3 | 3 | 1 | 33% | |
| | | | | | | | | | |
| *Objektivi 3* | Organizimi i aktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë Shkodër. | 6 | Numri i aktiviteteve të organizuara | 6 | 7 | 7 | 7 | 100% | |
| | | | | | | | | | |
| *Objektivi 4* | Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave te dedikuara për zhvillimin e turizmit. | 7 | Numri i turistëve (i personave) të akomoduar në hotele. | 185,243 | 285,714 | 292,857 | 262,971 | 89.8% | |
| | | 8 | Rritja e të ardhurave të bashkisë nga turizmi. (mijë lekë) | 12,967 | 20,000 | 20,500 | 18,408 | 89.8% | |
| | | 9 | Numri i turistëve që marrin informacion / shërbehen në zyrën e informacionit | 7,200 | 6,400 | 10,500 | 9,800 | 93.3% | |
| | | | | | | | | | |
| *Objektivi 5* | Ngritje e kapaciteteve të bizneseve që operojnë në fushën e turizmit me qëllim | 10 | Numri i personave të trajnuar | 0 | 20 | 0 | 0 | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | rritjen e cilësisë së shërbimit nga ana e tyre. | 11 | Numri i tabelave informative dhe orientuese progresive | 11 | 11 | 0 | 0 | | |

**ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"**

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| **Programi** | **Zhvillimi i turizmit** | **Kodi i Programit** | **4760** |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kodi** | **Emërtimi i Produktit** | **Njësia matëse** | **Sasia Faktike (sipas vitit 2021)** | **Shpenzimet (sipas vitit 2021)** | **Kosto për Njësi (sipas vitit 2021)** | **Sasia (sipas planit të vitit 2022** | **Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022)** | **Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022)** | **Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022)** | **Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022** | **Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022)** | **Sasia Faktike (viti 2022)** | **Shpenzimet Faktike (viti 2022)** | **Kosto për Njësi Faktike (viti 2022)** | **V = IV - I** | **V = IV - II** | **V = IV - III** | **Komente** |
| 1 | Platforma të ndryshme elektronike të mirëmbajtura | numër | 0 | 0 | 0.00 | 2 | 900 | 450.00 | 2 | 900 | 450.00 | 0 | 0 | 0 | 0 | -450 | -450 | |
| 2 | Materiale promocionale te publikuara dhe te prodhuara. | copë | 5,000 | 497 | 0.10 | 6,800 | 1,350 | 0.20 | 6,800 | 1,350 | 0.20 | 1,800 | 572 | 0 | 0.22 | 0.12 | 0.12 | |
| 3 | Organizim panairi | numër | 1 | 396 | 396 | 1 | 500 | 500.00 | 1 | 500 | 500 | 1 | 498 | 498 | 102 | -2 | -2 | |
| 4 | Pjesemarrje në panaire | numër | 0 | 0 | | 3 | 200 | 66.67 | 3 | 300 | 100 | 1 | 150 | 150 | 150 | 83 | 50 | |
| 5 | Organizim i aktiviteteve | numër | 6 | 2,317 | 386.17 | 7 | 2,750 | 392.86 | 7 | 2,750 | 392.86 | 7 | 2,558 | 365 | -21 | -27 | -27 | |
| 6 | Vazhdimi i shërbimit të Zyrave të informacionit turistik | numri i zyrave te informacion it turistik | 2 | 393 | 0.00 | 2 | 250 | 125 | 2 | 250 | 125 | 2 | 168 | 84 | 84 | -41 | -41 | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | Punonjës të sektorit të biznesit të turizmit të trajnuar | numër | 0 | 0 | | 20 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | Totali (000/leke) | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| **P04760.O1.A1. Hostim, mirembajtje, perditesim dhe sherbime shtesë për web sitin e turizmit.** | Bashkia Shkodër | e parealizuar | 100 | 100 | - |
| **P04760.O1.A2.Hostim , mirëmbajtje , pëditesim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit** | Bashkia Shkodër | e parealizuar | 800 | 800 | - |
| **P04760.O1.A3. Përditesim dhe ribotim i guidës turistike të Bashkisë Shkodër.** | Bashkia Shkodër | perfunduar | 300 | 300 | 241 |
| **P04760.O1.A4. Ribotim i hartave turisitike të Bashkisë Shkodër** | Bashkia Shkodër | e parealizuar | 250 | 250 | - |
| **P04760.O1.A5. Publikimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë** | Bashkia Shkodër | e parealizuar | 150 | 150 | - |
| **P04760.O1.A6.Prodhimi i materialeve promocionale të tilla si dosje, stilolapsa, canta, cakmakë etj.** | Bashkia Shkodër | Perfunduar | 350 | 350 | 331 |
| **P04760.O1.A7. Përgatitja dhe publikimi I itinerareve turistike** | Bashkia Shkodër | e parealizuar | 300 | 300 | - |
| **P04760.O2.A1.Panairi i artizanatit në ditën ndërkombetare të artizanatit.** | Bashkia Shkodër | Perfunduar | 500 | 500 | 498 |
| **P04760.O2.A2.Stenda levizëse "Vizito Shkodren"** | Bashkia Shkodër | e parealizuar | - | - | - |
| **P04760.O2.A3. Pjesëmarrje në panaire kombetare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Perfunduar | 200 | 300 | 150 |
| **P04760.O3.A1. Festa e Liqenit** | Bashkia Shkodër | Perfunduar | 450 | 450 | 450 |
| **P04760.O3.A2. Dita e turizmit** | Bashkia Shkodër | Perfunduar | 300 | 300 | 214 |
| **P04760.O3.A3. Hapja e sezonit turistik Velipoje** | Bashkia Shkodër | Perfunduar | 400 | 400 | 347 |
| **P04760.O3.A4. Feste e Thethit** | Bashkia Shkodër | Perfunduar | 500 | 500 | 489 |
| **P04760.O3.A5. Dita e biçikletave** | Bashkia Shkodër | Perfunduar | 350 | 350 | 350 |
| **P04760.O3.A6. Triathlon** | Bashkia Shkodër | Perfunduar | 400 | 400 | 358 |
| **P04760.O3.A7.Mbështetje për Panairin e Ornitologjisë** | Bashkia Shkodër | | - | - | - |
| **P04760.O3.A8. Lojra Popullore Fest** | Bashkia Shkodër | Perfunduar | 350 | 350 | 350 |
| **P04760.O4.A1. Rrjeti i Zyrave të informacionit turistik Qyteti Shkodër, Velipoje, Theth** | Bashkia Shkodër | perfunduar | 250 | 250 | 168 |
| **P04760.O5.A1. Trajnime të punonjësve që ofrojnë shërbime në bizneset turistike.** | Bashkia Shkodër | | - | - | - |
| **04760 Zhvillimi I Turizmit** | | | **5,950** | **6,050** | **3,946** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Te trasheguara** | | | **2,100** | **-** | **-** |
| **Totali** | | | **8,050** | **6,050** | **3,946** |

Përshkrimi i aktiviteteve:

Gjatë 12 mujorit të vitit 2022 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër për Programin 04760.

P04760.O1.A1. Hostim, mirembajtje, perditësim dhe shërbime shtesë për web sitin e turizmit.

Një ndër instrumentët më të fuqishëm të marketingut territorial, është promovimi online. Promocioni online ofron avantazhe të shumta dhe është lehtësisht i arritshëm nga çdo pikë e globit, mund të përditësohet shpejt dhe nuk ka kosto të madhe. Mundësia unike që ka web-i për të bashkuar shumë element në një dokument multimedia, kanë rritur përdorimin në një shkallë të lartë kundrejt mediave të tjera tradicionale, duke e kthyer atë në një media globale. Bashkia Shkodër ka një website zyrtar që i dedikohet turizmit. Ky portal përmban materiale promocionale dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për vizitorët që dëshirojnë të vijnë në Shkodër. Gjatë 2022, me përfundimin e kontratës së hostimit të websitit, është parë e nevojshme rishikimi dhe rindërtimi i një website të ri kushtuar turizmit. Bashkia Shkodër në kuadër të projektit "*Tourism for Albania*" ka parashikuar të kryejë realizimin dhe vënien në funksion të websitit të ri dhe për këtë arsye fondi i parashikuar për këtë zë buxheti nuk është përdorur.

P04760.O1.A2. Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit

Për të promovuar territorin e Bashkisë Shkodër si destinacion turistik dhe përmirësuar cilësinë e shërbimit për turistët, krijimi i një aplikacioni për smartphone, me informacionet dhe orientimet e nevojshme drejt nevojave të vizitorëve, është i domosdoshëm. Ofrimi i informacionit online përmes rrjeteve socialeve, web-it, aksesi për shkarkimin falas të gjithë materialeve promocionale të territorit përmes aplikacionit do të ketë një impakt pozitiv në rritjen e numrit të vizitorëve dhe do ndikojë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Bashkia Shkodër ka realizuar krijimin e një aplikacioni dedikuar turizmit. Duke qënë se fondi në dispozicion për këtë zë buxheti nuk ishte i mjaftueshëm për rimodelimin dhe pasurimin me module shtesë, është menduar që ky fond të trashëgohet për vitin 2023 dhe të realizohet me shtesë buxheti në vlerën e parashikuar nga ofertat e marra në treg.

P04760.O1.A3. Përditesim dhe ribotim i guidës turistike të Bashkisë Shkodër.

Bashkia Shkodër ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit. I gjithë territori karakterizohet nga një shumëllojshmëri atraksionesh turistike, që nga bukuritë natyrore te ndërtesat historike dhe identitetet kulturore. Pozita e favorshme gjeografike është pa dyshim një pasuri e rëndësishme për zhvillimin turistik të saj. Traditat njerëzore, kulturore dhe historike ia shtojnë më shumë vlerën këtij potenciali. Gjatë viteve të fundit, numri i turistëve që vizitojnë Shkodrën është rritur në mënyrë të qëndrueshme. Si rezultat i zgjerimit të territorit të Bashkisë Shkodër, një vëmendje e veçantë i është kushtuar pritjes së turistëve dhe marketingut të ofertës turistike. Në këtë kuadër Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe botuar guidën turistike të territorit, material i cili kërkon përditësim të të dhënave dhe shtim informacioni të herëpashershëm. Me hapjen e zyrave të informacionit, interesimi i vizitorëve pranë këtyre zyrave është gjithnjë e në rritje dhe përgatitja e materialeve promocionale dhe shpërndarja e tyre, është shumë i rëndësishëm. Për këtë arsye, është e nevojshme që ky produkt të

ribotohet herë pas here. Në vitin 2017 janë botuar 3 800 guida në gjuhën angleze dhe në vitin 2018 janë botuar 1 200 copë guida të destinuara për turistin shqipfolës, ndërsa për vitin 2019 është përditësuar informacioni dhe është përmirësuar paraqitja e guides dhe gjithashtu është printuar në 1 000 kopje. Ky aktivitet në 2022 është realizuar me printimin e 1000 kopjeve.

P04760.O1.A4. Ribotim i hartave turistike të Bashkisë Shkodër

Zona e Shkodrës gjithnjë e më tepër po tërheq vizitorë nga shtete të ndryshme të botës. Këto vizitorë shpesh kanë nevojë për të marrë informacion për vendet me interes dhe mënyrën se si mund të arrihet atje. Gjatë vitit 2017 është realizuar botimi i disa materialeve promocionale të tilla si broshura e Thethit (1000 copë) dhe broshura e Velipojës (500 copë) të cilat përmbajnë hartën përkatëse dhe informacionet e nevojshme për një vizitor në këto zona. Nevoja për të pasur një hartë turistike të gjithë territorit të Bashkisë Shkodër, për të plotësuar nevojat e vizitorëve potencial të Bashkisë, ka qënë i domosdoshëm. Në këtë kuadër, Drejtoria e Turizmit ka bërë përzgjedhjen e modelit dhe përmbajtjes së informacionit që do të ketë harta turistike e Bashkisë Shkodër dhe ka përcaktuar termat e referencës për shërbimin e konsulencës. Janë publikuar 1550 kopje të hartës në 2018 të të gjithë territorit të Bashkisë Shkodër. Në 2021 janë printuar harta të destinacioneve të veçanta për qytetin e Shkodrës dhe për zonën e Thethit. Duke qënë se për këtë vit sasia e hartave ishte e mjaftueshme për përdorim/ shpërndarje, është menduar që ky fond të trashëgohet për 2023.

P04760.O1.A5. Publikimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë

Në territorin aktual të Bashkisë Shkodër zhvillohen një seri ngjarjesh dhe aktivitetesh social-kulturore, sportive etj. Pjesa më e madhe e tyre organizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose e mbështetur në mënyra të ndryshme nga Bashkia. Një pjesë e tyre janë aktivitete me pjesëmarrje të gjërë dhe me potencial të konsiderueshëm për të tërhequr vizitorë edhe nga trevat e tjera të Shqipërisë e më gjërë. Stafi i Drejtorisë së Turizmit, ka konceptuar modelin, përmbajtjen, hartuar termat e referencës dhe mbledhur informacionin e nevojshëm si dhe ka bërë përkthimin në anglisht të tekstit të kalendarit. Është realizuar publikimi i këtij kalendari në gjuhën shqipe dhe angleze për vitin 2019 dhe 2021. Ky aktivitet nuk është realizuar për vitin 2022 për arsye të ndryshimit të datave të realizimit të festave. Ky zë buxheti nuk është realizuar.

P04760.O1.A6. Prodhimi i materialeve promocionale te tilla si dosje, stilolapsa, canta, çakmake etj.

Materiale të ndryshme promocionale si dosje, stilolapsa, çanta, çakmakë etj, janë materiale që kanë kosto të lirë por ndikim të madh në promovimin e një destinacioni të caktuar. Për të promovuar turizmin në destinacion, janë mjaft me vlerë edhe materialet promocionale, të cilat në shpërndarjen e tyre lënë një imazh të destinacionit. Është e rëndësishme që prezantimet apo takimet që do bëhen nga stafi i drejtorisë së turizmit, të kenë mjetet e nevojshme identifikuese. Janë realizuar prodhimi i materilaeve të branduara stilolapsa, mbajtëse çelësash, çanta kartoni, blloqe axhendë, shënjues libri dhe spila me foto. Është zhvilluar procesi i prokurimit me të gjithë dokumentacionin tekniko ligjor dhe operatori i shpallur fitues do sjellë materialet sipas specifikimeve teknike të prokurimit. Aktiviteti është realizuar. Sasia e materialeve promocionale: 800 është likujduar.

P04760.O1.A7. Përgatitja dhe publikimi i itinerareve turistike

Një ndër mangësitë më të mëdha të identifikuara për sa i përket zhvillimit të turizmit në Shqipëri është mungesa e zhvillimit të produktit turistik gjë e cila bëhet faktor pengues për rritjen e numrit të turistëve në territorin e Bashkisë Shkodër. Për këtë arsye, gjatë viteve të kaluara është realizuar

konceptimi, dizenjimi dhe publikimi i itinerareve të ndryshme turistike të cilat janë vënë në dispozicion të operatorëve turistikë me qëllim që të integrohen në paketat e tyre turistike. Duke qënë se për këtë vit sasia e materialeve ishte e mjaftueshme për përdorim/ shpërndarje, është menduar që ky fond të trashëgohet për 2023.

P04760.O2.A1. Panairi i artizanatit në ditën ndërkombëtare të artizanatit.

Një pikë e fortë e ofertës turistike të Bashkisë Shkodër me të cilën mund të konkurojmë denjësisht edhe në nivele ndërkombëtare, është artizanati. Në një situatë në të cilën zhvillimi ekonomik dhe rritja e mirëqënies po çojnë dalëngadalë drejt humbjes së interesit për punimet artizanale dhe zbehjen e rëndësisë së tyre si aktivitet ekonomik, për shkak të rritjes së interesit të vizitorëve dhe të turistëve të shumtë që vizitojnë qytetin për punimet artizanale dhe suveniret, lind nevoja që këto zeje dhe zanate të promovohen dhe të mbështeten si një element tërheqës dhe burim turistik. Punimet e qytetit të Shkodrës dhe të zonave përreth mbeten një suvenir i mrekullueshëm sapo viziton këtë qytet. Panairi është një instrument i fuqishëm që ndikon drejtpërdrejtë në promovimin e këtyre vlerave që ka territori. Panairi i Artizanatit zhvillohet çdo vit me datë 10 Qershor, Ditën Ndërkombëtare të Artizanatit. Është shpallur fituesi përmes procedures së përzgjedhjes së operatorit me metodologjinë LOAD dhe aktiviteti është realizuar dhe likujduar.

P04760.O2.A3. Pjesëmarrje në panaire kombetare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës

Për të promovuar ofertën turistike të territorit, Bashkia Shkodër ka marrë pjesë në  "Panairin e Turizmit dhe Mjedisit"- Tiranë, panair i cili u zhvillua në datat 02-04 qershor. Aktiviteti është realizuar dhe likujduar.

P04760.O3.A1. 7. Festa e Liqenit

Ky është një aktivitet promovues social kulturor dhe sportiv që organizohet me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së pasur natyrore të qytetit si dhe promovimin e produkteve rajonale dhe bizneseve lokale të Shkodrës. Në vite janë organizuar gara të ndryshme noti (të rritur, të rinj & fëmijë), gara me kanoe, ski board, ndeshje vaterpoli me pjesmarrjen e ekipeve të notit dhe fshatrave Zogaj dhe Shirokë dhe shkollave 9 vjeçare dhe të mesme të qytetit. Me anë të organizimit të këtij aktiviteti Bashkia synon të ruajë dhe të forcojë këtë traditë me qëllim tërheqjen e vizitorëve dhe ndërgjegjësimin qytetar për vlerat ekoturistike, ekonomike dhe mjedisore të Liqenit të Shkodrës. Është shpallur fituesi përmes procedurës së përzgjedhjes së operatorit me metodologjinë LOAD dhe aktiviteti është realizuar dhe likujduar.

P04760.O3.A2. Dita e turizmit

Zhvillimi i turizmit ka ecur me hapa të shpejtë në vitet e fundit. Numri i vizitorëve ka ardhur vazhdimisht në rritje nga viti në vit dhe po ashtu edhe shtrirja gjeografike e prejardhjes së tyre. Gradualisht sektori i turizmit po shndërrohet në një ndër sektorët lider të zhvillimit ekonomik të Shkodrës. Bashkia Shkodër, duke  kuptuar rëndësinë e zhvillimit të turizmit, i ka dhënë përparësi të veçantë zhvillimit të tij, duke forcuar kuadrin institucional që punon në këtë drejtim. Gjithashtu për të ndërgjegjësuar edhe më shumë komunitetin dhe biznesin, për të rritur përpjekjet dhe bashkëpunimin në këtë drejtim, Bashkia Shkodër organizon çdo vit një festë kushtuar turizmit në ditën botërore të turizmit me datë 27 Shtator, duke zhvilluar aktivitete të ndryshme me qëllim evidentimin dhe

promovimin më tej të vlerave dhe potencialeve turistike që ka territori i Bashkisë Shkodër. Aktiviteti është realizuar dhe likujduar.

P04760.O3.A3. Hapja e sezonit turistik Velipojë

Velipoja është një ndër destinacionet e më të njohura të bregdetit shqiptar me vlera dhe potenciale të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit të diellit e rërës. Aktualisht frekuentohet nga një numër i madh pushuesish gjatë sezonit të verës të përqëndruar kryesisht vetëm në muajt korrik e gusht, por Velipoja zotëron potenciale të tilla, që ky sezon të jetë më masiv dhe më i shtrirë ne kohë. Dita e hapjes së sezonit turistik është zhvilluar çdo vit këto vitet e fundit me pjesëmarrjen e banorëve të zonës dhe qytetarë nga Shkodra. Në 2022, ky aktivitet u realizua me datë 1 maj dhe konsistoi në organizimin e një koncerti të madh festiv të mbajtur në qendër të plazhit të Velipojës në të cilin performuan live një rockband i përbërë nga atistë të qytetit të shkodrës si edhe një grup valltarësh, lojra sportive ( volejboll, futboll dhe hemboll ) dhe gara me varka me vela dhe kanoe. Përmes procedurës së përzgjedhjes së operatorit me metodologjinë LOAD nuk është perzgjedhur asnjë fitues dhe ky aktivitet ka kaluar në proces tenderimi. Është zhvilluar tenderi, shpallur fituesi i operatorit. Aktiviteti është realizuar dhe likujduar.

P04760.O3.A4. Festë e Thethit

Festa e Thethit është zhvilluar rregullisht vitet e fundit. Në vitin 2022 u organizua kjo festë me datat 9-10 Qershor, me një koncert me muzikë, këngë e valle tradicionale nga zona e Thethit, ngjitje në mal, vizitë në ujëvarën e Grunasit dhe Syrin e Kalter, vizita në Kullën e Ngujimit si dhe në shtëpitë pritëse të zonës. Në koncertin me këngë nga grupi “*Treva*” dhe me valle tradicionale të zonës nga trupa e valltarëve, u përfshinë të rinj, fëmijë, familje nga zona e Dukagjinit, të cilët imituan pjesë nga ritet tradicionale dhe zakonet e dasmave të zonës, të veshur me kostume popullore. Vitin e kaluar, për shkak edhe të kushteve të papërshtatshme atmosferike aktiviteti u shty dhe për shkak të fillimit të punimeve në rrugën e Thethit ishte e pamundur të realizohej. Për këtë vit, është shpallur fituesi përmes procedurës së përzgjedhjes së operatorit me metodologjinë LOAD dhe aktiviteti është realizuar dhe likujduar.

P04760.O3.A5. Dita e biçikletave.

Shkodra është qyteti numër një në Shqipëri për përdorimin e biçikletës me një traditë të hershme të përdorimit të saj që zë fill që në shekullin e 19. Gjithashtu Shkodra renditet në 10 qytetet që përdorin më shumë biçikletën në shkallë europiane. Gjatë periudhës së dikataturës biçikleta ishte mjeti kryesor i transportit në Shkodër pasi numri i makinave ishte shumë i kufizuar. Me ardhjen e demokracisë dhe zhvillimin ekonomik numri i makinave ka ardhur vazhdimisht në rritje duke kërcënuar kështu zbehjen e kësaj tradite. Gjithashtu rritja e numrit të makinave rrezikon edhe ndotjen e ajrit nga gazrat dhe elementëve të tjerë të mjedisit nga mbetjet e tyre. Me organizimin e ditës së biçikletave dhe shndërrimin e saj në një festë të përvitshme synohet ripërtëritja e traditës si edhe promovimi i mënyrës së shëndetshme të jetesës por synohet edhe gjallërimi i jetës kulturore të qytetit duke rritur atraktivitetin e tij. Është zgjedhur fituesi me proceduren e përzgjedhjes së operatorit me metodologjinë LOAD dhe aktiviteti është realizuar dhe likujduar.

P04760.O3:A6. Triathlon

Triathlon është një aktivitet tre-garësh në tre disiplina sportive të ndryshme, si gara e notit, ciklizmi dhe vrapimi, për të cilat ne jemi shumë krenarë për traditën dhe rezultatet e shkëlqyera që sportistët tanë profesionistë dhe amatorë kanë dhënë ndër vite. Aktiviteti zhvillohet në një nga zonat më të bukura të Bashkisë Shkodër, që shtrihet në të gjithë gjatësinë e bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës: Shirokë - Zogaj. Ky aktivitet, që zhvillohet gjatë muajit shtator, ngjall interes të shumtë për pjesmarrje jo vetëm nga Shkodra, por dhe nga qytete të tjera të Shqipërisë. Interes të madh kishte vitin e kaluar dhe nga Kosova dhe nga shtete të tjera të Europës. Duke qenë se është një garë në 3 disiplina, u mendua që këtë vit të pranohen në garë jo më shumë se 55 persona, për arsye mirë organizimi dhe sigurie. Në 2022, ky aktivitet u zhvillua me datën 8 shtator dhe në të morën pjesë rreth 70 pjesëmarës nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia. Me proceduren e përzgjedhjes së operatorit me metodologjinë LOAD nuk është shpallur asnjë fitues gjatë dy fazave të aplikimit dhe është menduar që ky aktivitet ka kaluar si shpenzim operativ. Aktiviteti u realizua me tenderim dhe është likujduar.

P04760.O3:A8. Lojra Popullore Fest.

Lojra Popullore Fest është një aktivitet me karakter social kulturor për të rinjtë i cili synon jo vetëm të pasurojë jetën e të rinjve por edhe ti njohë ato me traditat tona kombëtare me anë të këngëve, valleve dhe lojrave popullore. Qëllimi i aktivitetit të promovojë paqen, tolerancën, miqësinë në mes të trupave pjesëmarrësve. “*Lojra Popullore Fest*” gjithashtu synon të pasurojë jetën e të rinjve duke i angazhuar ato në identifikimin e vlerave njerëzor, folklorike kombëtare dhe ndërkombëtare. Vetë të rinjtë konkurrojnë me performaca dhe lojra popullore, këngë e valle tradicionale kombëtare dhe etnografike. Aktiviteti shërben edhe për promovimin e vlerave dhe potencialeve turistike. Këtë vit u zhvillua në muajin Tetor dhe në të morën pjesë rreth 150 pjesëmarrës nga të gjitha trevat shqipfolëse dhe u mbajt në sheshin Shirokë. Është zgjedhur fituesi me proceduren e përzgjedhjes së operatorit me metodologjinë LOAD dhe aktiviteti është realizuar dhe likujduar.

P04760.O4:A1. Rrjeti i Zyrave të informacionit turistik Qyteti Shkodër, Velipojë.

Vitet e fundit, gjithnjë e më tepër, territori i Bashkisë Shkodër ka një numër në rritje të vizitorëve me origjinë nga vende të ndryshme por edhe nga kontinente të ndryshme. Të ndryshme janë jo vetëm vendet e origjinës por edhe tipologjia e udhëtimit të tyre. Një pjesë vijnë në mënyrë të organizuar nga agjensi të ndryshme shqiptare por edhe të huaja, por një pjesë e mire e tyre vijnë në mënyrë të paorganizuar. Kjo tipologji vizitorësh ka nevojë më shumë se të tjerët për informacion. Ka 3 vjet tashmë që në territorin e Bashkisë Shkodër janë hapur një rrjet zyrash të informacionit turistik me dy zyra, në Shkodër dhe Velipojë. Në këto zyra ofrohet informacion sipas nevojës së vizitorëve që vizitojnë destinacione të veçanta të territorit të bashkisë. Aktiviteti është realizuar dhe likujduar.

# FUNKSIONI 05: MBROJTJA E MJEDISIT

## Programi 05100: Menaxhimi i mbetjeve

Ky program përfshin institucionin e Bashkisë.

**Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:**

-Qëllimi i programit të Menaxhimit të mbetjeve është:

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit, menaxhimi i mbetjeve të ngurta duke filluar ndarjen në burim të atyre të ricikluеshme nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor që bën të mundur përmirësimin e situatës mjedisore dhe reduktimin e sasisë së mbetjeve që depozitohet në landfill.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12-mujorin e vitit 2022 kanë qënë:

O1. Rritja e mbulimit me shërbim.

Zona e mbulimit është rritur duke përmbushur objektivin e ofrimit të shërbimit sipas planit të miratuar dhe mbulimi i territorit administrativ të Bashkisë Shkodër. Me kontratat e reja që mbulojnë shërbimin e pastrimti për zonën lindore dhe perëndimore janë shtuar edhe territorie ku sot është sistemuar infrastruktura janë shtuar pika grumbullimi dhe i ofrohet shërbimi në Sheldi, Rragam, Prekal, Theth.

O2. Përmirësimi i administrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane:

Me miratimin e Procedurës standarte të veprimit për administrimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër dhe njësitë administrative realizohet më së miri përmirësimi i cilësisë të shërbimit duke rritur standartin e kontrollit dhe monitorimit të ofrimit të shërbimit të pastrimit për zonat funksionale bazuar në kontratat e ofrimit të shërbimit të pastrimit.

O3. Efiçienca buxhetore për ofrimin e shërbimit.

O4. Rritja e frekuencës së mbledhjes së mbetjeve bashkiake.

Nën vëmendje përdorimi me efiçiencë të burimeve financiare dhe rritja e tranparencës dhe përfshirja e hallkave administrative, që sigurojnë administrimin e plotë të shërbimit, planifikimin, zbatimin, kontrollin dhe verifikueshmërinë e shërbimit të ofruar.

Është shtuar shërbimi dhe strukturuar me frekuenca të përcaktuara, sipas standartit të dakordësuar, me pika grumbullimi të përcaktuara dhe me kontenierë shtesë edhe në të gjitha Njësitë Administrative.

Gjatë vitit 2022, ka vazhduar realizimi i shërbimit  me kontratat e reja për të gjitha njësitë administrative në dy zona funksionale respektivisht për zonën Perëndimore njësitë Velipojë, Dajç, Bërdicë Ana e Malit dhe për zonën lindore Njësitë administrative Rrethina Postribë Shalë dhe Gur i Zi. Procedurat këto të realizuara në zbatim të detyrimit ligjor sipas zbatimit të detyrimit ligjor për një menaxhim të drejtë, transparent dhe me efiçiencë financiare në përmirësimin e administrimit dhe menaxhimit të sektorit të mbetjeve me zbatimin e VKM 319/2018 "*Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve*''.  Kjo ka ndikuar në përmbushjen e synimit të rritjes së përformancës dhe standartit të shërbimit përmes përmirësimit teknologjik, të rritjes së frekuencave të shërbimit dhe sistemit të monitorimit dhe penaliteteve.

**A. Shërbimi i pastrimit zona Qendrore**:

Në këtë zonë përfshihet qyteti i Shkodrës. Shërbimi përfshin:

Grumbullim dhe transportin e mbetjeve bashkiake në të gjithë territorin e qytetit;

Fshirje manual me fshesë tërrugëve kryesore dhe dytësore cdoditë ne 94 rrugë dhe sheshe të qytetit;

Fshirje me makinë fshesë të rrugëve kryesore dhe dytësore katër here nëjavë në 48 rrugë dhe sheshe të qytetit;

Larje me presion të rrugëve kryesore në 27 rrugë në 79 ditë të vitit kryesisht në sezonin veror.

Larje e pedonaleve të qytetit dy here ne muaj përgjatë periudhës gjashtë mujore (maj-Qershor2023).

Frekuenca e parë shërbimit realizohet 1 herë në ditë/7 ditë të javës në të gjithë Qytetin gjatë orëve të natës;

Frekuenca e dytë e shërbimit realizohet 2 herë në ditë/7 ditë të javës ne 50% të pikave të grumbullimit të Qytetit në orët e ditës.

Mjetet e përdorura për realizimin e shërbimit janë:

Pesë me kapacitet 10 ton.

**B. Shërbimi i pastrimit Zona lindore:**

Në këtë zonë përfshihen njësitë administrative Rrethinat, Postribë, Shalë, Guri i Zi.

Shërbimi përfshin:

Grumbullim dhe transportin e mbetjeve bashkiake në të gjithë territorin

Mirëmbajtjen e kontenierëve

Dezinfektimin e mbi 150 pikave të grumbullimit në sezonin e dimrit dy here në javë dhe në sezonin turistik çdo javë

Mjetet e përdorura për realizimin e shërbimit janë:

2 mjete 10 ton

1 mjet 5 ton për rrugë të ngushta .

Frekuenca e lëvizjes së mjeteve:

Mjeti 10 ton kryen shërbimin në NJ.A. Rrethinat 2 herë/javë,

Mjeti 10 ton kryen shërbimin në NJ.A. Postribë 2 herë/ javë

Mjeti 5 ton kryen shërbimin 1 herë në javë në NJ.A. Shalë

Mjet rezervë 5-10 ton

**C.Shërbimi i pastrimit Zona Perëndimore:**

Në këtë zonë përfshihen njësitë Ana Malit, Bërdicë, Velipojë, Dajç.

Shërbimi përfshin:

Grumbullim dhe transportin e mbetjeve të përziera urbane

Fshirje manuale / me fshesë të rrugëve kryesore dhe dytësore të nj.a Velipojë në100 ditë të sezonit turistik.

Mirëmbajtjen e tualeteve publike përgjatë vijës bregdetare (katër tualete) 8 punonjës në total.

Mirëmbajtje të rërës të plazhit përgjatë vijës bregdetare me12 punëtore

Dezinfektimin dy herë në muaj dhe çdo javë gjatë sezonit turistik të rreth 200 pika të grumbullimit të mbetjeve.

Mjetet e përdorura për realizimin e shërbimit janë:
Për NJ.A. Velipojë pa zonën e Plazhit dhe Dajç 2 mjete 10 ton.
Për NJ.A. Velipojë zona e plazhit 1 mjet 5 ton
Për NJ.A Velipojë për zonën e plazhit 1 mjet 3 ton i hapur

Frekuenca e lëvizjes së mjeteve:

Mjeti 10ton në NJ.A. Velipojë (pa zonën e plazhit) 2 herë/javë
Mjeti 10 ton në NJ.A. Dajç 2 herë/ javë
Mjeti 5 ton NJ.A. Velipojë (zona e plazhit) 2 herë në ditë/7 ditëve të javës në stinën e verës
Është realizuar blerja e 102 kazanëve të cilët janë shpërndarë kryesisht në qytet.

**Realizimi i Buxhetit të planifikuar:** **mijë lekë**

| Programi 05100 | Shpenzime operative | Investime | Totali |
|---|---|---|---|
| PBA 2022 | 251,448 | 5,900 | 257,348 |
| Plani fillestar 2022 | 386,633 | 10,355 | 396,988 |
| Plani i rishikuar 2022 | 370,991 | 13,553 | 384,544 |
| Realizimi viti 2022 | 173,081 | 10,092 | 183,173 |
| % e realizimit | 46.7% | 74.5% | 47.6% |




Realizimi i shpenzimeve operative dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 47.6 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Shpenzime korente | 46.7% |
| Shpenzime kapitale | 74.5% |




**Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:**

- Mosrealizimi i procedures se prokurimit per zonen qenrdore
- Shpenzime për karburant nuk është realizuar pasi mjetet nuk janë përdorur përderisa shërbimi është realiuzuar me sipërmarrje.
- Shërbim mirëmbajtje për makinat nuk është realizuar pasi mjetet nuk janë përdorur përderisa shërbimi është realizuar me sipërmarrje.
- Blerje kosha dekorative betoni është në proçes të hartimit të dokumentacionit. Fondi është trashëguar për vitin 2023.
- Ndërtim xhepa kazanash është në proçes të hartimit të dokumentacionit. Fondi është trashëguar për vitin 2023.

## Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

## Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022

| Kodi i Programit | 5100 | Emertimi i programit: | Menaxhimi i mbetjeve | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve; Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake. Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve; Pastrimi i rrugëve ,parqeveve etj. | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| Objektivi 1 | Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane | 1 | - Popullata e mbuluar me shërbim kundrejt totalit të popullatës në qytet në % | 70% | 70% | 70% | 70% | 100% | |
| | | 2 | - Popullata e mbuluar me shërbim kundrejt totalit të popullatës në njësinë administrative në % | 82% | 82% | 82% | 82% | 100% | |
| | | 3 | Të ardhura nga tarifat e shërbimit për 1 ton mbetje të menaxhuar (mbulimi kostos së shërbimit nga tarifa) | 130% | 68% | 46% | 106% | 229% | |
| | | 4 | Efiçienca buxhetore për ofrimin e shërb. Të ardhura nga tarifat e shërbimit për 1 ton mbetje të menaxhuara | 3.627 | 6.286 | 9.275 | 5.256 | 57% | |
| | | 5 | Efiçienca buxhetore për ofrimin e shërb. Të ardhura nga tarifat e shërbimit për 1 ton mbetje të menaxhuara | 4.711 | 4.284 | 4.284 | 5.567 | 130% | |
| | | 6 | Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane në qytet | 10.5 | 10.5 | 10.5 | 10.5 | 100% | |
| | | 7 | Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane në Nj.Administrative | 2.5 | 2.5 | 2.5 | 2.5 | 100% | |
| | | 8 | Sasia e mbetjeve urbane të grumbulluara dhe të transportuara ne vendet e miratuar kundrejt numrit total të banorëve (tonë për frymë në ditë) | 0.4139 | 0.4949 | 0.4949 | 0.4074 | 82% | |

## ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Menaxhimi i mbetjeve | Kodi i Programit | 5100 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2021) | Shpenzimet (sipas vitit 2021) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2021) | Sasia (sipas planit të vitit 2022 | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022 | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Sasia Faktike (viti 2022) | Shpenzimet Faktike (viti 2022) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2022) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | Komente |
| 1 | Shërbimi i pastrimit në qytet + Njësi Administrative | ton/mbetje | 33,451 | 121,313 | 4 | 40,000 | 257,348 | 6 | 40,000 | 384,544 | 10 | 32,931 | 183,173 | 6 | 2 | -1 | -4 | |



BASHKIA SHKODËR

Për vitin 2022 në Programin "Menaxhimi i mbetjeve" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, është parashikuar 1 aktivitet.

**Aktiviteti është analizuar si më poshtë:**

P.05100.O1.A1-A2. Shërbimi i pastrimit & të trashëguara.

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | | | 000/leke |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Totali | | |
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| **P05100.O1.A1-A8. Shërbimi i pastrimit & te trasheguara** | Bashkia Shkoder | Shërbimi i pastrimit qytet po realizohet në zonën qendrore. Ne proces per proceduren e prokurimit me afat një vjeçar.<br>Shërbimi i pastrimit po realizohet në zonën lindore. Kontrate ne vazhdim.<br>Shërbimi i pastrimit realizohet në zonën perendimore. Kontrate ne vazhdim.<br>Shpenzime per mjete transporti gjate vitit, Furnizim vendosje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje e makinerive. Nuk eshte realizuar.<br>Blerje kazana eshte realizuar . | 257,348 | 384,544 | 183,173 |
| **05100 MENAXHIMI I MBETJEVE** | | | **257,348** | **384,544** | **183,173** |
| **Te trasheguara** | | | **139,640** | **-** | **-** |
| **Totali** | | | **396,988** | **384,544** | **183,173** |

# Programi 05200: Menaxhimi i ujërave të zeza

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:
1. Aparatin e Bashkisë
2. Ujësjellësin

### Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

- Qëllimet e programit të Menaxhimit të ujërave të zeza janë:
1. Rritja e numrit të lidhjeve të shkarkimeve të ujërave të zeza të popullsisë urbane dhe rurale si dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues.
2. Sigurimi i funksionimit normal të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha (shiut) në qytet dhe grykëderdhjet kryesore për të evituar problematikat e ndryshme.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre qëllimeve për 12-mujorin e vitit 2022 kanë qënë:

**O1. Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza në të gjithë zonat urbane të Njësive Administrative të Bashkisë.**

Ky shërbim realizohet nga Ujësjellës Kanalizime Shkodër, sh.a:

- Rreth 23,320 familje janë të lidhur me rrjetin KUZ në Shkodër qytet + Nj.A;
- 3,274 biznese në të gjithë Bashkinë janë të lidhura në sistemin e KUZ;
- Rrjeti i kanalizimeve të ujerave të zeza në qytet është rreth 150 km;
- Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve të ujërave të ndotura për zonën urbane dhe rurale, është përkatësisht 78% për qytetin Shkodër dhe 4% për popullsinë e njësive administrative. Kryesisht janë të pa lidhur me rrjetin KUZ zonat periferike të qytetit, të cilat funksionojnë me gropa septike.

Territori i juridiksionit i Bashkisë Shkodër mbulohet me shërbimin e kanalizimeve në nivelin 46%. Shërbimi i kanalizimeve ofrohet për pjesën më të madhe të qytetit dhe për zonën e plazhit në Velipojë, ndërsa fshatrave të tjerë të Bashkisë Shkodër, nuk u ofrohet shërbimi i largimit të ujërave të ndotura dhe funksionojnë me anë të gropave septike të ndërtuara nga vetë familjarët. Gjendja e aseteve në operim nga UK Shkodër për sektorin e kanalizimeve, paraqitet si më poshtë:

*I – Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza për qytetin Shkodër*

Ky sistem përbëhet nga:

- Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza të qytetit, i cili përbëhet prej rreth 150 km tubacione të dimensioneve të ndryshme, me material betoni dhe plastik, dhe rreth 10 000 puseta.

- Stacioni i pompave, i cili ndodhet në hyrje të qytetit (Pazar) i cili është rikonstruktuar. Ky stacion bën të mundur pompimin e ujërave të zeza dhe ngritjen e tyre në kuotën e kolektorit shkarkues. Nëpërmjet këtij kolektori shkarkues, me tubacion betoni Ø 1000 mm ujërat e zeza derdhen në lumin Drin.

- Pika e shkarkimit të ujërave të zeza, ndodhet në krah të djathtë të hyrjes së urës së Bahçallekut, në lumin Drin. Krahas saj shkarkim tjetër (emergjence) i ujërave të zeza bëhet në lumin Buna, nëpërmjet një kanali me tubacion plastik Ø 800 mm, i cili është rikonstruktuar plotësisht. Ky kanal fillon nga stacioni i pompave për në lumin Buna pranë urës së vjetër.

Në kuadër të investimeve të realizuar nga Bashkia në programin e investimeve të vitit 2022, si pjesë e investimit në infrastrukturë është kryer rikonstruksioni i rrjetit të KUZ, nëpërmjet rehabilitimit të linjave të largimit të ujërave të ndotura, nëpër të gjitha rrugicat ku Bashkia Shkodër ka ndërhyrë me shtrim të rrugëve me shtresa asfaltike.

*II - Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza në Shirokë, i* cili përfshin:

- Stacioni i Shirokës bën të mundur trajtimin e ujërave të përdorura që grumbullohen nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza të zonës turistike Shirokë dhe i shkarkon në liqen, duke eliminuar kështu ndotjen e liqenit.

*III - Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza në Velipojë.*

- UKSH mirëmban sistemin e kanalizimeve të zonës së plazhit në Velipojë dhe operon ITUN e Velipojës, i cili gjatë sezonit veror punon me kapacitet të plotë, si rrjedhojë e rritjes së fluksit të pushueve. Pavarësisht mangësive dhe vështirësive të konstatuara, gjatë vitit 2022 është punuar intensivisht për operimin dhe funksionimin normal të tij.
- Është punuar në pastrimin e kolektoreve kryesore K1, K2 dhe K3 komplet, kanalizime ujërave të përdorura të rrugëve të ndryshme të qytetit.
- Në Bashkinë Shkodër ka 2 impiante të pastrimit të ujërat të zeza në Velipojë, dhe në Shirokë;
- Stacioni i Shirokës bën të mundur trajtimin e ujërave të përdorura që grumbullohen nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza të zonës turistike Shirokë dhe i shkarkon në liqen, duke eliminuar kështu ndotjen e liqenit.

**O2. Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut në të gjithë zonat urbane të Njësive Administrative të Bashkisë.**
**Menaxhimi i sistemit te ujërave të bardha (KUB):**

Sistemi i kanalizimit të ujërave të bardha (shiut), u ndërtua fillimisht si një sistem i veçantë nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të përdorura. Shkodra ka një sistem largimi të ujërave të shiut sipas një sistemi kanalesh të hapura, tombino dhe tubacione ku pjesa më e madhe e ujit të shiut shkarkohet me gravitet në Liqenin e Shkodrës. Disa zona, duke përfshirë edhe zonën industriale, shkarkohen në lumin Kir. Gjatësia e përgjithshme e sistemit të kanalizimeve për qytetin e Shkodrës është rreth 54 km, nga të cilat, rreth 37 km përbëhet nga tubacione të mbyllura betoni e plastike dhe pjesa tjetër janë kanale të hapura. Kanalet e hapura kanë nevojë për pastrime të herëpashershme, për të siguruar një gjendje të mirë të tyre nga ana hidraulike. Për të ardhmen duhet të mendohet investimi në mbulimin e tyre, pasi gjendja aktuale e tyre

është burim hedhjeje e mbeturina inerte dhe të llojeve të tjera nga persona të papërgjegjshëm, duke u shndërruar në rrezik shëndetësor për komunitetet përreth tyre. Pjesa tjetër e kanalizimeve përbëhet nga kanale në gjendje të amortizuar, me karakteristika përcjellje prurje jo të mira. Përveç kësaj, ka dhe shumë kilometra me kanale të vogla kullimi, të cilat kanë nevojë për ridimensionim.

Problematikë tjetër e mprehtë, janë lidhjet e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të përdorura me kanalizimet e ujërave të shiut, që janë bërë ndër vite si rrjedhojë e mungesës së rrjeteve të kanalizimit, apo në mënyrë të njëanshme nga banorët. Këto lidhje, përbëjnë rrezik të dukshëm, sidomos nga përmbytjet gjatë kohës së reshjeve. Vjedhja e kapakëve të pusetave dhe gradelave prej material gize, krijojnë probleme në qarkullim dhe shoqërohet me hedhje të mbeturinave të cilat çojnë në bllokim dhe mosfunksionim të tyre.

Puna e deritanishme tregon për probleme të shumta dhe për nevoja emergjente ndërhyrjeje edhe në sektorin e KUB për zonat rurale.

**Aktiviteti punues i sektorit KUB për vitin 2022**

Për vitin 2022 janë hartuar plane pune për mirëmbajtjen rutinë të pastrimit të kanaleve të ujërave të shiut, gjithashtu janë realizuar edhe ndërhyrje të paplanifikuara sipas situatave kritike që janë krijuar dhe që rrezikonin përmbytje të zonave të caktuara. Kanalet kryesore të kullimit kanë nevojë për ndërhyrje në pastrimin e tyre me makineri të mëdha, për heqjen e dherave, largimin e mbeturinave dhe prerjen e shkurreve dhe bimësisë përgjatë tyre.

**Realizimi i Buxhetit të planifikuar:** **mijë lekë**

| Programi 05200 | Transferta | Totali |
|---|---|---|
| PBA 2022 | 15,000 | 15,000 |
| Plani fillestar 2022 | 16,002 | 16,002 |
| Plani i rishikuar 2022 | 16,002 | 16,002 |
| Realizimi viti 2022 | 15,000 | 15,000 |
| % e realizimit | 93.7% | 93.7% |

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin në total është 93.7 %, sipas zërave kryesorë më poshtë:

| | |
|---|---|
| Shpenzime korente | 93.7% |
| Shpenzime kapitale | 0 % |

**Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:**
Ky shërbim është realizuar

## Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

## Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022

| Kodi i Programit | 5200 | Emertimi i programit: | Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | Administrim, mbikëqyrje, inspektim, vënie në funksionim ose mbështetje e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza; Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza. | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| *Objektivi 1* | Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza në të gjithë zonat urbane të Nj.A të bashkisë | 1 | Sasia e ujit te shkarkuar nje sistemin e përunimit të ujrave të ndotur | 322,127 | 450,000 | 450,000 | 234,907 | 52% | |
| | | 2 | % e popullsisë qëmbulohet nga shërbimi i trajtimit të ujërave të zeza / ndotura | 5% | 24% | 24% | 25% | 104% | |
| | | 3 | Rritja e mbulimit të popullsisë me shërbime sanitare / kanalizimeve të ujërave të përdorura (zeza dhe bardha) | 45% | 49% | 49% | 46% | 94% | |
| | | 4 | Mbulimi I kostos nga tarifa e shërbimit Raporti i të ardhurave nga tarifa kundrejt kostove (vetem O & M jo investime, pra jo kostototale(në %) | 106% | 133% | 131% | 67% | 51% | |
| *Objektivi 2* | Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujrave të shiut në të gjithe zonat urbane të Nj.A të bashkisë. | 5 | Buxheti për shërbimin e menaxhimit të kanalizimeve të ujërave të shiut | 13,998 | 15,000 | 16,002 | 15,000 | 94% | |

## ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve | Kodi i Programit | 5200 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2021) | Shpenzimet (sipas vitit 2021) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2021) | Sasia (sipas planit të vitit 2022 | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022 | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Sasia Faktike (viti 2022) | Shpenzimet Faktike (viti 2022) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2022) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | Komente |
| 1 | Menaxhimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut (KUB) | numër popullsie mbuluar me shërbim | 93,310 | 13,998 | 0.15 | 102,131 | 15,000 | 0.15 | 102,131 | 16,002 | 0.16 | 95,058 | 15,000 | 0.16 | 0.01 | 0.01 | 0.00 | |

Për vitin 2022 në Programin "Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizime" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 2 aktivitete.

**Aktivitetet janë analizuar si me poshtë:**

P.05200.O1.A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të zeza

P.05200.O2.A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të bardha (KUB) & të trashëguara.

000/leke

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | Totali | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Plani fillestar 2022** | **Plani i rishikuar 2022** | **Realizimi 2022** |
| P05200.O1.A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të zeza & te trasheguara | Bashkia Shkodër & UK Shkodër sh.a | | - | - | - |
| P05200.O2.A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të bardha (KUB) | Bashkia Shkodër | Realizuar. Sherbimi i vazhdueshem gjate gjithe vitit | 15,000 | 16,002 | 15,000 |
| **05200 MENAXHIMI I UJRAVE TE ZEZA** | | | **15,000** | **16,002** | **15,000** |
| **Te trasheguara** | | | **1,002** | **-** | **-** |
| **Totali** | | | **16,002** | **16,002** | **15,000** |

## Programi 05320: Programet e Mbrojtjes së Mjedisit

**Qëllimi i këtij programi është**:

Mbrojtja e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetarëve. Zbatimin e dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit dhe të përbërësve të tij. Ndërgjegjësimi i banorëve nëpërmjet promovimit të politikave edukuese për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

**Përshkrimi i objektivave**

O1: Zvogëlimi dhe administrimi i ndotjes së mjedisit

Në kuadër të Programit 05320 "Programet e mbrojtjes së mjedisit" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar dhe realizuar produktet/Aktivitetet si më poshtë: Auditim Energjetik dhe simulim i sistemeve eficente të energjisë në objektet publike, pronë e Bashkisë Shkodër.

**Zbatimi i Planit të veprimit mbi zhurmat në Bashkinë Shkodër**

Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Shkodër nr. 22 datë 18.04.2019 është miratuar "Plani *Lokal i Veprimit për Zhurmën në mjedis*", pjesë integrale e të cilit ishte edhe Plani i Veprimit. Produkt i realizuar me sukses. Dhe në vazhdimësi të vitit 2022, u vazhdua me zbatimin e këtij Plani duke filluar me Planin e administrimit të Zhurmave për sezonin turistik. Plan veprimi që gjendet në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër.

**Projekti i Bashkive të zgjuara të Energjisë (PBZHE)**

Ky projekt konsiston në vlerësimin e humbjeve energjitike dhe dhënien e zgjidhjeve eficente të simulimit të energjisë duke përdorur teknologjinë ekologjike (energjinë e rinovueshme), për plotësimin e nevojave për ngrohje, ndriçim, në reduktim maksimal të energjisë elektrike. Aktualisht jemi në pritje të Firmosjes së protokollit të Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet MIE-SECO dhe Bashkia Shkodër.

Në kuadër të mbrojtjes së mjedisit dhe kryesisht mbrojtjes nga ndotja është parashikuar një ndërhyrje/ investim në ish fushën e mbetjeve të qytetit duke realizuar një mbulim të saj me inerte kryesisht dhera të dala nga punimet e prishjeve apo gërmimit gjatë zbatimit të lejeve të ndërtimit **Investim për sistemimin dhe izolimin sipërfaqësor ("capping")** të ish fushës së vend-depozitimit të mbetjeve urbane tek Varrezat e Dëshmoreve.

**Realizimi i Buxhetit të planifikuara:** **mijë lekë**

| Programi 05320 | Shpenzime operative | Investime | Totali |
|---|---|---|---|
| PBA 2022 | 100 | 12,278 | 12,378 |
| Plani fillestar 2022 | 100 | 52,724 | 52,824 |
| Plani i rishikuar 2022 | 100 | 41,795 | 41,895 |
| Realizimi viti 2022 | - | 3,008 | 3,008 |
| % e realizimit | 0.0% | 7.2% | 7.2% |




Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin në total është 7.2 %, sipas zërave kryesorë më poshtë:

| | |
|---|---|
| Shpenzime korente | 0.0% |
| Shpenzime kapitale | 7.2% |

**Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara**:

Në kuadër të projektit Bashki të Zgjuara Energjie, projekt në bashkëpunim me SECO, MIE dhe Bashkisë Shkodër. Marrëveshja e këtij projekti ndërmjet Këshillit të Ministrave përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Konfederatës Zvicerane si edhe Bashkive përfituese (pjesë e të cilit është edhe Bashkia Shkodër), është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 38 dt 19.01.2022. Gjatë këtij viti filloi procesi për tenderim të objekteve dhe realizim të fondeve aktualisht jemi në procedurë.
Realizimi i investimit të parashikuar për Mbulimin e ish-fushës së mbetjeve nuk realizohet, kjo për arsye se Bashkia Shkodër ka parashikuar në PPV një vend tjetër për depozitimin e inerteve.

## Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

**Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022**

| Kodi i Programit | 5320 | Emertimi i programit: | Programet e mbrojtjes së mjedisit | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi | Mbrojtja e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetareve. Bashkëpunim me të gjitha institucionet rajonale për ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimi i statusit të ruajtjes për llojet dhe habitatet që janë pjesë e mbrojtur me ligje dhe konventa të veçanta. Shfrytëzimi racional i burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre sipas qëllimeve të përdorimit, si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja. | | | | | | | | ..... |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | ..... |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| | | | | | | | | | ..... |
| *Objektivi 1* | Zvogelimi dhe administrimi i ndotjes se mjedisit | 1 | Numri i projekteve /aktiviteteve në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mjedisit. | 1 | 3 | 3 | 1 | 33% | |
| | | 2 | Planit i veprimit mbi zhurmat në Bashkinë Shkodër | 1 | 1 | 1 | 1 | 100% | |
| | | 3 | Siperfaqe m2 (sistemuar) tek ish fusha e mbetjeve | 0 | 5000 | 0 | 0 | | |

## ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Programet e mbrojtjes së mjedisit | Kodi i Programit | 5320 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2021) | Shpenzimet (sipas vitit 2021) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2021) | Sasia (sipas planit të vitit 2022) | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022 | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Sasia Faktike (viti 2022) | Shpenzimet Faktike (viti 2022) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2022) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | Komente |
| 1 | Studime aktivitete për eficiencën e energjisë | Numri i projekteve /aktiviteteve në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mjedisit. | 3 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 3 | 41,795 | 13,932 | 1 | 3,008 | 3,008 | 3,008 | 3,008 | 10,924 | |
| 2 | Zbatim i Planit te veprimit mbi zhurmat në Bashkinë Shkodër | Planit i veprimit mbi zhurmat | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 3 | Sipërfaqe e fushës e mbuluar/ rehabilituar | $m^2$ | 0 | 0 | | 5000 | 12,378 | 2 | 0 | 100 | | 0 | 0 | 0 | 0 | -2 | 0 | |

## Tabela e aktiviteteve dhe realizimi i tyre

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi I Aktiviteteve | Totali | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| | | | Totali | Totali | Totali |
| **P05320.O1.A1.Auditim Energjitik dhe simulim i sistemeve eficiente të energjisë në objektet publike, pronë e Bashkisë Shkoder.** | Bashkia Shkodër | realizuar | - | - | - |
| **P05320.O1.A2.Projekti i Bashkive të Zgjuara të Energjisë (PBZHE) & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | ne proces | - | 41,795 | 3,008 |
| **P05320.O2.A1. Zbatim i Planit te veprimit mbi zhurmat në Bashkinë Shkodër** | Bashkia Shkodër | Proces/ realizuar | - | - | - |
| **P05320.O2.A2 Investim per sistemimin dhe izolimin sipërfaqësor (“capping”) te ish fushës së vend-depozitimit të mbetjeve urbane tek Varrezat e Deshmoreve.** | Bashkia Shkodër | pa realizuar | 12,378 | 100 | - |
| **05320 REDUKTIMI I NDOTJES** | | | 12,378 | 41,895 | 3,008 |
| **Te trasheguara** | | | 40,446 | - | - |
| **Totali** | | | 52,824 | 41,895 | 3,008 |

### Realizimi i Aktiviteteve të Programit:

Për vitin 2022 në “*Programet e mbrojtjes së mjedisit*” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar aktivitetet si më poshtë:

**P05320.O1.A1. Auditim Energjetik dhe simulim i sistemeve eficente të energjisë në objektet publike, pronë e Bashkisë Shkodër**.

Në kuadër të Ligjit nr 124/2015 “ *Për eficensën e energjisë*” si edhe akteve nënligjore në zbatim të tij parashikojmë hartimin e projektit për një objekt pronë e Bashkisë Shkodër. Aktualisht është realizuar.

**P05320.O1.A2.Projekti i Bashkive të Zgjuara të Energjisë (PBZHE)**

Në kuadër të projektit Bashki të Zgjuara Energjie, projekt në bashkëpunim me SECO, MIE dhe Bashkisë Shkodër. Marrëveshja e këtij projekti ndërmjet Këshillit të Ministrave përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Konfederatës Zvicerane si edhe Bashkive përfituese (pjesë e të cilit është edhe Bashkia Shkodër), është miratuar me Vendim të Këshillit të

Ministrave nr. 38 dt 19.01.2022. Gjatë këtij viti  filloi procesi për tenderim të objekteve dhe realizim të fondeve aktualisht jemi në procedure.

**P05320.O2.A1 Zbatimi i Planit të veprimit mbi zhurmat në  Bashkinë Shkodër**

Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Shkodër nr 22 datë 18.04.2019 është miratuar   Plani Lokal i Veprimit për  Zhurmën në mjedis, pjesë integrale e të cilit ishte edhe Plani i Veprimit. Produkt i realizuar me sukses.

**P05320.O2.A2  Investim për sistemimin dhe izolimin sipërfaqësor (“capping”)  te ish fushës së vend-depozitimit të mbetjeve urbane tek Varrezat e Dëshmorëve.**

Në kuadër të mbrojtjes së mjedisit dhe kryesisht mbrojtjes nga ndotja është parashikuar një ndërhyrje/ investim në ish fushën e mbetjeve të qytetit duke realizuar një mbulim të saj me inerte kryesisht dhera të dala nga punimet e prishjeve apo gërmimit gjatë zbatimit të lejeve të ndërtimit. Realizimi i investimit të parashikuar për Mbulimin e ish fushës së mbetjeve nuk realizohet, kjo për arsye se Bashkia Shkodër ka parashikuar në PPV një vend tjetër për depozitimin e inerteve.

## Programi 05630: Ndërgjegjësimi Mjedisor

**Qëllimi i këtij programi është**:

Mbrojtja e mjedisit, ruajtja dhe përmirësimi i tij, parandalimi dhe pakësimi i rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetarëve. Zbatimi i dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit dhe të përbërësve të tij. Ndërgjegjësimi i banorëve nëpërmjet promovimit të politikave edukuese për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

**Përshkrimi i objektivave:**

O1: Rritja e ndjeshmërisë së popullatës ndaj problemeve të mjedisit

Për vitin 2022 në programin "*Ndërgjegjësimi Mjedisor*" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar dhe realizuar produktet/Aktivitetet: që kanë të bëjnë me zbatimin e objektivave mjedisore të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër.
Takim sensibilizues për 22 prill "Ditën e Tokës", 05 Qershor- Dita botërore e mjedisit, 22 Shtator- Dita e lëvizjes pa makina/ Qytet i pastër, 11 Dhjetor– Dita ndërkombëtare e maleve– Pyllëzimi.
Në kuadër të dëgjesave publike mbi ndërgjegjësimin e publikut për efektet e projekteve që zbatohen dhe ndikimet mjedisore që ata kanë, parashikohen 4 takime.

Realizimi i këtij Programi nuk parashikon financime dhe nuk realizon të ardhura.

## Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

**Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022**

| Kodi i Programit | 5630 | Emertimi i programit: | Ndërgjegjësimi mjedisor | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi | Mbrojtja e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetareve. Zbatimin e dispozitave ligjore nepermjet strategjive, programeve dhe projekteve te cilat synojne permiresimin e vazhdueshme te mjedisit dhe te perbersve te tij. Ndergjegjesimi i banoreve nepermjet promovimit te politikave edukuese per ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktikne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| *Objektivi 1* | Rritja e ndjeshmërisë së popullatës ndaj problemeve të mjedisit | | | | | | | | |
| | | 1 | Përmiresimi i aktiviteteve të bashkisë për promovimin e mbrojtjes mjedisore sipas Planit Strategjik: Nr. Masash | 5 | 5 | 5 | 5 | 100% | |
| | | 2 | Numri i aktiviteteve/programe në kuadër të edukimit dhe informimit për mbrojtjen e mjedisit | 9 | 9 | 9 | 9 | 100% | |
| | | 3 | Numri i identifikimeve/projekteve për menaxhimin e burimeve ujore në territorin e Bashkisë. | 50 | 0 | 0 | 0 | | |
| | | 4 | Numri i Masave per permiresimin e eficiences se energjise sipas sektoreve qe administrohen nga Bashkia. | 0 | 0 | 0 | 0 | | |

## ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Ndërgjegjësimi mjedisor | Kodi i Programit | 5630 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2021) | Shpenzimet (sipas vitit 2021) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2021) | Sasia (sipas planit të vitit 2022 | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022 | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Sasia Faktike (viti 2022) | Shpenzimet Faktike (viti 2022) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2022) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | Komente |
| 1 | Masa të zbatuara në kuadër të deklaratës mjedisore | numër | 5 | 0 | 0 | 5 | 0 | 0 | 5 | 0 | 0 | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 2 | Aktivitete në kuadër të mbrojtjes së mjedisit | numër | 9 | 0 | 0 | 9 | 0 | 0 | 9 | 0 | 0 | 9 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 3 | Plani Vendor i veprimit për efiçiencë të Energjisë si edhe masat për përmirësimin e efiçiencës së energjisë | numër | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |

**Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre:**

| Aktivitete/Projekte | Plani | Realizimi 12mujorit |
|---|---|---|
| P05630.O1.A1. Zbatimi i objektivave mjedisore të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër | 5 | 5 |
| P05630.O1.A2.Takim secibilizues për 22 prill "Ditën e Tokës", 05 Qershor - Dita botërore e mjedisit, 22 Shtator - Dita e lëvizjes pa makina/ Qytet i paster, 11 Dhjetor – Dita ndërkombëtare e maleve – Pyllëzimi. | 5 | 5 |
| P05630.O1.A3. Realizimi i 4 takimeve | 4 | 4 |
| P05630.O1.A4.Mbledhje Informacioni / Përgatitje e Draftit të Planit Vendor të Veprimit për Eficiencë Energjie Bashkia Shkodër. | azhornim | proces |

**Realizimi i aktiviteteve të Programit**:

Për vitin 2022 në programin *"Ndërgjegjësimi Mjedisor"* në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë realizuar produktet/Aktivitetet si më poshtë:

**P05630.O1.A1. Zbatimi i objektivave mjedisore të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër.**

Deklarata Mjedisore e PPV parashikon zbatimin e 18 masave të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e Mjedisit në kuadër të projekteve për VNM. Për vitin 2022 ishte parashikuar zbatimi i 5 masave. Ky produkt është detyrë funksionale dhe është zbatuar në 12 mujorin e vitit 2022.

**P05630.O1.A2. Takim sensibilizues për 22 prill "Ditën e Tokës" 05 Qershor- Dita botërore e mjedisit, 22 Shtator- Dita e lëvizjes pa makina/ Qytet i pastër, 11 Dhjetor– Dita ndërkombëtare e maleve– Pyllëzimi.**

Jane realizuar 5 takime në Shkollën Pyjore kjo për ditën e tokës datë 22 prill, Shkolla në Gur të Zi , Shkolla në Rrethina dhe Shkolla në Postrribë.

**P05630.O1.A3. Realizimi i 4 takimeve**

Në kuadër të dëgjesave publike mbi ndërgjegjësimin e publikut për efektet e projekteve që zbatohen dhe ndikimet mjedisore që ata kanë. Si detyrim ligjor për pjesëmarrje në dëgjesa publike, referuar kërkesave të subjekteve dhe në bashkëpunim me Agjensinë Rajonale të Mjedisit.

**P05630.O1.A4.Mbledhje Informacioni / Përgatitje e Draftit te Planit Vendor të Veprimit për Eficiencë Energjie Bashkia Shkodër.**

Aktualisht jemi në procedurë të mbledhjes së të gjithë informacionit për këtë plan.

## FUNKSIONI 06: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

# Programi 06140: Urbanistika

Strategji të unifikuara për zhvillimin e integruar të territorit në funksion të krijimit të një rajoni shumë qendërsh përmes krijimit e zhvillimit të infrastrukturës publike, administrative, sociale dhe kulturore.

**I. Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave**
Bashkia Shkodër gjatë vitit 2022 ka fokusuar përpjekjet e saj në një funksion zhvillimi

Objektivat për secilin funksion janë:
O1. Hartimi, mbështetja dhe monitorimi i proceseve planifikuese në Bashkinë Shkodër, me qëllim sigurimin e kornizës së përgjithshme të zhvillimit të territorit dhe promovimit të tij.
O2. Realizimi dhe Monitorimi i Sistemit të Adresave si mjet për përmirësimin e shërbimeve dhe identitetit të qytetarit.

### II. Rezultatet e programit 06140: Planifikimi Urban Vendor në 000/ lekë

| Programi 06140 | Investime | Totali |
|---|---|---|
| PBA 2022 | 500 | 500 |
| Plani fillestar 2022 | 1,500 | 1,500 |
| Plani i rishikuar 2022 | 500 | 500 |
| Realizimi viti 2022 | - | - |
| % e realizimit | 0.0% | 0.0% |




**Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:**
Rivlerësimi, realizimi dhe monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër, realizohet nga punonjësit e bashkisë Shkodër. Është parashikuar që të bëhet vendosja e tabelave të numrave të ndërtesave dhe të hyrjeve të objekteve. Duke qënë se sipas përllogaritjeve ka një kosto të konsiderueshme, vitin e ardhshëm do implementohet në një zonë pilot.

**Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit**

**Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022**

| **Kodi i Programit** | **6140** | **Emertimi i programit:** | **Planifikimi Urban Vendor** | | | | | | **Komente** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qellimi 1** | **Strategji të unifikuara për zhvillimin e integruar të territorit në funksion të krijimit të një rajoni shumëqendërsh përmes krijimit e zhvillimit të infrastrukturës publike, administrative, sociale dhe kulturore.** | | | | | | | | |
| | | | ****Treguesit e performancës/Produktet:** | | | | | | |
| ***Objektivat e politikës*:** | | **Kodi i Treguesit te Performances/ Produktit** | **Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit** | **Niveli faktik i vitit paraardhes** | **Niveli i planifikuar ne vitin korent** | **Niveli i rishikuar ne vitin korent** | **Niveli faktik ne fund te vitit korent** | **% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit** | |
| ***Objektivi 1.1*** | Hartimi, mbështetja dhe monitorimi i proceseve planifikuese në Bashkinë Shkodër, me qëllim sigurimin e kornizës së përgjithshme të zhvillimit të territorit dhe promovimit te tij. | **1** | Instrumentat të përdorur nga bashkia: - PPV periudha 2015 - 2030 | 1 | 1 | 1 | 1 | 100% | |
| | | **2** | Plani detajuar për njësi të ndryshme | 7 | 8 | 8 | 2 | 25% | |
| ***Objektivi 1.2*** | Realizimi dhe Monitorimi i Sistemit të Adresave si mjet për përmirsimin e shërbimeve dhe identitetit të qytetarit | **3** | Përmirësimi i adresarit të bashkisë Shkodër: Rritja e rrugëve të azhornuar në sistemin e adresave në vite (ndryshimi vjetor në %) | 17% | 14% | 14% | 6% | 43% | |

**ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"**

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Planifikimi Urban Vendor | Kodi i Programit | 6140 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2021) | Shpenzimet (sipas vitit 2021) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2021) | Sasia (sipas planit të vitit 2022 | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022 | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Sasia Faktike (viti 2022) | Shpenzimet Faktike (viti 2022) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2022) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | Komente |
| 1 | Përgatitja e PDV | numër | 7 | 0 | 0 | 8 | 500 | 63 | 8 | 500 | 63 | 2 | 0 | 0 | 0 | -63 | -63 | |

## III. Realizimi i produkteve për vitin 2022

Gjatë vitit 2022 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër
Sipas kërkesave të bëra dhe prioriteteve të Bashkisë Shkodër, janë marrë nismat për hartimin e 4 Planeve të Detajuara Vendore, për hartimin e të cilave është marrë stafi i Bashkisë Shkodër. Pjesa më e madhe e tyre janë në pritje të konfirmimit nga AKPT.

Për vitin 2022 në Programin "*Planifikimi Urban Vendor*" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara janë parashikuar aktivitetet në mijë lekë si më poshtë:

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | | | 000/leke |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Totali | | |
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| **P06140.O1.A1 Përgatitja e PDV për zonat e parashikuara në PPV.** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| **P06140.O1.A2 Publikimi i Planeve te Detajuara Vendore nepermjet publikimit elektronik dhe mjeteve tradicionale të informimit** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| **P06140.O2.A1. Rivlerësimi, realizimi dhe monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër** | Bashkia Shkodër | Trasheguar | 500 | 500 | - |
| **06140 Planifikimi Urban Vendor** | | | **500** | **500** | **-** |
| **Te trasheguara** | | | **1,000** | **-** | **-** |
| **Totali** | | | **1,500** | **500** | **-** |

## Programi 06260: Zhvillimi i komunitetit

Ky program përfshin institucionin e Bashkisë.

**Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:**

-Qëllimet e programit të Zhvillimit të komunitetit janë:

I. Garantimi për të gjithë qytetarët e saj shërbime publike cilësore në të gjithë territorin e saj pavarësisht vendndodhjes së tyre.

II. Përmirësimi i efiçencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, modernizimi i tyre nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë.

III. Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike dhe të sigurojë pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe ta orientojë atë sipas nevojave të qytetarëve.

IV. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit të varrimit.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre qëllimeve për 12-mujorin e vitit 2022 kanë qënë:

**O1. Përmbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera për objektet dhe hapësirat publike.**

Shpenzime për pagat, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative për punonjësit e Shërbimeve Publike

*-Paga dhe shtesat për punonjës mbështetes shërbimi, mirëmbajtje, pastrim, heqje mbeturina urbane, roje*

Shërbimet për shpenzime personeli janë bazuar tek numri i punonjesve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve, bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 165 datë 02.03.2016 "*Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore*", duke u bazuar në sistemin me klasat e përshtatur sipas VKM nr 717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave "*Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore*", të ndryshuar.

Numri i plotë punonjësve me kohë të plotë është 26, ndërsa me kohë të pjesshme është 30 punonjës.

*-Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore*

Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993, "*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar.

- Është realizuar shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të administratës vendore në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.

- Është realizuar mirëmbajtja e të gjithë objekteve në qytet dhe në Nj.A.
- Është realizuar mirëmbajtje e ambjenteve publike në Nj.A.

**O2. Shërbim cilësor me standarte dhe sipas normativave të rregullores së Mirëmbajtjes së Varrezave. Zgjerim i territorit të Varrezave për vazhdimësinë e këtij shërbimi.**

Shërbimi i mirëmbajtjes së Varrezave Publike realizohet me sipërmarrje në varrezat publike dhe varrezave të dëshmorëve. Shërbimet kryesore që janë realizuar në mirëmbajtjen e territorit gjatë vitit 2022 janë:

- Pastrim parcelash dhe rrugësh të brendshme ndërmjet parcelave me 78 800 $m^2$.
- Mbjellje bordurë të gjelbërt në parcelat e reja 243 ml.
- Mbjellje drurë dekorativ në parcelat e reja 75 copë.
- Mbjellje shkurre dekorative në parcelat e reja 37 copë.
- Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve.
- Shërbimi i ruajtjes dhe mirëmbajtjes për varrezat publike dhe ato të dëshmorëve.

Gjatë këtij viti kemi ofruar dhe shërbim për varrimin e njerëzve pa perkrahje me fonde të parashikuara në buxhet.

Për vitin 2022 ishte parashikuar ishte parashikuar fillimi i investimit në sipërfaqen e mbetur të territorit të rrethuar për varreza publike me financim dy vjeçar për ti paraprirë nevojave për varreza. Është realizuar projekti dhe pritet të realizohen procedurat e prokurimit në vitin 2023.

**O3. Shtimi i aktiviteteve festive që kanë nevojë për dekorim, duke ruajtur traditën dhe kulturën tonë.**

Shërbimin e dekorit Bashkia Shkodër është realizuar me mjetet logjistike e fuqinë punëtore prej 3 punonjës të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës. Me financimet në buxhet është realizuar blerja e aksesorëve të rinj me të cilët janë dekoruar sheshet dhe akset kryesore të qytetit. Pjesa tjetër e dekorit është realizuar me elementë të investuar në vite, të cilët janë gjendje dhe mirëmbahen nga punonjësit e sektorit të dekorit. Me këto elementë zbukurues dekorohen sheshet Parrucë, Nënë Tereza, Demokracia, Rus i madh, rrugët 13 Dhjetori, 28 Nëntori, Kolë Idromeno, Zogu i Parë, Studenti, Bulevardi Skënderbeg, Gjuhadol, Mehmet Pashë Plaku si dhe godina e Bashkisë e sheshi i saj.

Realizimi i dekorit është bërë me punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Publike ku perveç specialistëve të dekorit që punojnë me kohë të plotë gjatë kësaj periudhe, për realizimin e shërbimit angazhohen dhe specialistët e ndriçimit që punojnë me kohë të pjesshme për dekorin në rastet e festave.

Gjithashtu për dekorimin e mjediseve janë vënë në dispozicion edhe 2 autovinçat e ndriçimit në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investime dhe Infrastrukturës.

Krahas punës për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit, është realizuar shërbimi edhe në rastet e festave të tjera zyrtare si dhe aktivitete të ndryshme të Bashkisë gjatë vitit, ku ndër më kryesoret janë aktivitetet tradicionale si 2 Prilli, Dita e Luleve, Dita e Karnevaleve, Festa e Pavarësisë, si dhe aktivitete të tjera që organizohen nga Bashkia.

**O4. Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor, në të gjithë Bashkinë.**

Gjatë këtij viti krahas shërbimeve të parashikuara një vëmendje e veçante i është kushtuar zgjerimit të sipërfaqeve të gjelbra, përmirësimit të sipërfaqeve ekzistuese. Shërbimi realizohet për mirëmbajtjen e 111 631 $m^2$ sipërfaqe të gjelbër, ku përfshihen 72 lulishte ndër të cilat 94 140 $m^2$ në qytet dhe 17 491 $m^2$ lulishte në Velipojë. Këto lulishte sipas rendësisë dhe sipërfaqeve përkatëse janë specifikuar sipas kategorive të sipërfaqeve të gjelbërta, tipi “A”, “B”, “C”.

Sipërfaqe të gjelbra Tipi A (Intensive) me sipërfaqe 48 742 $m^2$ -përfshihen lulishte dhe parqe Urbane me sipërfaqe më të madhe se 5 000 $m^2$, e kushtëzuar nga frekuentimi i lartë social.

Sipërfaqe të gjelbra Tipi B (të rëndëshishme) me sipërfaqe 39 051 $m^2$ – përfshihen zona të gjelbra të lagjeve, rrethrrotullime, dhe parqe lojrash.

Sipërfaqe të gjelbra Tipi C (mirëmbajtje me frekuencë të reduktuar) me sipërfaqe 23 838 $m^2$ të cilat përfshijnë zona të gjelbra me shërbim, me frekuenca të reduktuara sipas grafikut e mirëmbajtjes.

Janë kryer sipas grafikëve të përcaktuar në funksion të tipologjive dhe elementet atraktiv të këtyre sipërfaqeve në zërat e: mirëmbajtjes së siperfaqes së barit, drurëve dekorativë, bordurave të gjelbra, shkurreve, sipërfaqeve ujore, mirëmbajtjen dhe riparimin e stolave, pastrim i rrugëve të brendshme etj.

Është realizuar vendosja e 11 vazove të reja me drurë dekorativ në Pedonalen e qytetit. Janë realizuar punime për gjelbërimin e rrethrrotullimit tek Bexhisteni dhe trafikndarësve përreth.

Është realizuar gjatë gjithë vitit mirëmbajtja e rrugës së Shirokës duke bërë pastrimin e rrugës dhe trotuarëve nga bimësitë e këqija, pastrimi i bregut të liqenit si dhe pjesës ujore në afërsi të bregut.

Është realizuar gjatë gjithë vitit mirëmbajtja e rrugës së Kalasë duke bërë pastrimin e rrugës dhe trotuarëve nga bimësitë e këqija.

Gjatë këtij viti janë realizuar shërbime të mirëmbajtjes në sipërfaqet e rikonstruktuara gjatë vitit të fundit .

Janë vendosur gjithashtu 70 copë stola të rinj dekorativ në lulishte dhe shëtitore.

Shërbimi i gjelbërimit gjatë vitit 2022 është realizuar sipas zërave të preventivit më poshtë:

Mirëmbajtje e sip.të gjelbra Tipi A – me sipërfaqe 48 742 $m^2$

Mirëmbajtje e sip. të gjelbra Tipi B – me sipërfaqe 39 051 $m^2$

Mirëmbajtje e sip. të gjelbra Tipi C – me sipërfaqe 23 838 $m^2$

Mirëmbajtje e sip. të gjelbra Velipojë Tipi A – me sipërfaqe 17 491 $m^2$

Mirëmbajtje gjelbërim Rrugor Tipi 1 – 2 986 copë

Mirëmbajtje gjelbërim Rrugor Tipi 2 – 1 824 copë

Mirëmbajtje gjelbërim Rrugor Tipi 3 – 1 980 copë

Mirëmbajtje bimësi në vazo dekoraqtive (Xhabije, Pedonale) – 250 copë

Mirëmbajtje stola dekorative – 464 copë

Mirëmbajtje shkurre dekorative (Rr. Mehmet P. Plaku) – 800 copë

Mbjellje drurë dekorativë (lulishte dhe gjelbrim rrugor) – 200 copë

Mbjellje shkurre dekorative – 120 copë

Prodhim fidanë lule sezonale në fidanishte – 1070 m2

Mbjellje bordurë e gjelbër – 150 ml

Shërbimi i mirëmbajtjes së Rrugës së Kalasë (shkulje e rrënjëve te bimëve të vogla) – 9 440 $m^2$
Shërbimi i mirëmbajtjes së rrugës së Shirokës dhe bregut të liqenit (prerje bimë të vogla) – 68 600 $m^2$
Mirëmbajtje sipërfaqe ujore qytet – 650 $m^2$
Mirëmbajtje sipërfaqe ujore Velipojë – 491 $m^2$

Një vëmendje e shtuar ka patur këtë vit në Plazhin Velipojë duke krijuar një ambjent më tërheqës dhe duke kijuar një mjedis më tërheqës për pushuesit e shumtë vendas dhe të huaj.
Është realizuar shërbimi mirëmbajtje në sipërfaqen e gjelbër (lulishte) në qendrën e plazhit Velipojë. Shërbimi është realizuar në një sipërfaqe prej 17 000 $m^2$ lulishte dhe 491 $m^2$ sipërfaqe ujore (shatërvanet). Brenda kësaj sipërfaqeje ka dhe elementë të tjerë si, stola dekorativ 90 copë dhe drurë dekorativ 300 copë, gjelbërim rrugor 76 rrënjë.
Krahas përmirësimit të dukshëm të kësaj sipërfaqeje është realizuar krijimi i 5 000 $m^2$ sipërfaqe të re në afërsi të shetitores së plazhit, mbjellja e 220 copë drurëve dekorativ të llojit, palmë, pishë etj.

**Realizimi i Buxhetit të planifikuar:** **mijë lekë**

| Programi 06260 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| PBA 2022 | 29,577 | 56,740 | 161 | 1,000 | 87,478 |
| Plani fillestar 2022 | 41,943 | 75,995 | 255 | 1,066 | 119,259 |
| Plani i rishikuar 2022 | 40,783 | 64,634 | 1,321 | 1,000 | 107,738 |
| Realizimi viti 2022 | 25,968 | 61,037 | 1,240 | - | 88,245 |
| % e realizimit | 63.7% | 94.4% | 93.9% | 0.0% | 81.9% |




Realizimi i shpenzimeve për paga, shpenzime operative, transferime dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 81.9 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Shpenzime korente | 82.7% |
| Shpenzime kapitale | 0.00% |




### Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

- Ndërtim parcela te reja është hartuar dokumentacioni për prokurim me fondet e trashëguara nga viti 2022 dhe plani për vitin 2023 .
- Blerje aksesorë dekori fondi është trashëguar për vitin 2023.
- Blerje materiale të ndryshme është realizuar.

## Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

## Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022

| Kodi i Programit | 6260 | Emertimi i programit: | Shërbimet publike vendore | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si:rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin; Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapësirën e gjelbërt të njësisë së vetëqeverisjes vendore; Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësor që përmirëson hapësirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve. Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike. Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore; | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/ Produktit | |
| ***Objektivi 1*** | Përmbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera për objektet dhe hapësirat publike. | 1 | Buxheti i shpenzuar për shërbime publike vendore në mijë lekë | 62,160 | 87,478 | 107,738 | 88,245 | 82% | |
| ***Objektivi 2*** | Shërbim cilësor me standarteve dhe sipas normativave të rregullores së Mirëmbajtjes së Varrezave. Zgjerim i territorit të Varrezave për vazhdimësinë e këtij shërbimi . | 2 | Rregullore për mirëmbajtjen dhe funksionimin e Varrezave Publike | 1 | 1 | 1 | 1 | 100% | |
| | | 3 | Kapaciteti i varrezave publike për 1000 banorë | 683 | 683 | 683 | 683 | 100% | |
| | | 4 | Sipërfaqe varreza publike e mirëmbajtur në $m^2$ | 78,800 | 78,800 | 78,800 | 78,800 | 100% | |
| ***Objektivi 3*** | Shtimi i aktiviteteve festive që kanë nevojë për dekorim, duke ruajtur traditën dhe kulturën tonë | 5 | Aksesor zbukurimi blerje në vit | 45 | 57 | 61 | 4 | 7% | |
| ***Objektivi 4*** | Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor, në të gjithë Bashkinë. | 6 | Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (në %) | 77% | 77% | 76% | 76% | 100% | |
| | | 7 | Lekë të ardhura nga tarifa e gjelbërimit kundrejt siperfaqes se mirembajtuar (në mijë lekë/sip mirëmbajtur në $m^2$) | 0.197 | 0.228 | 0.228 | 0.228 | 100% | |
| | | 8 | Rrënjë pemë të mbjella në vit | 310 | 1,000 | 1,000 | 470 | 47% | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 9 | Rrënjë pemë të mirembajtura gjithsej | 10,910 | 12,101 | 12,571 | 12,571 | 100% | |

## ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Shërbimet publike vendore | Kodi i Programit | 6260 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2021) | Shpenzimet (sipas vitit 2021) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2021) | Sasia (sipas planit të vitit 2022 | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022 | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Sasia Faktike (viti 2022) | Shpenzimet Faktike (viti 2022) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2022) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | Komente |
| 1 | Punonjës në funksion të shërbimeve publike | numër | 57 | 22,436 | 394 | 57 | 28,156 | 494 | 57 | 40,522 | 711 | 57 | 25,991 | 456 | 62 | -38 | -255 | |
| 2 | Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve | Sipërfaqe varreza publike e mirëmbajtur në m2 | 78,800 | 14,168 | 0.18 | 78,800 | 14,653 | 0.19 | 90,180 | 15,642 | 0.17 | 90,180 | 14,116 | 0.16 | (0.02) | (0.03) | (0.02) | |
| 3 | Dekorimi i mjediseve publike | copë | 45 | 4,043 | 90 | 57 | 3,606 | 63 | 61 | 5,047 | 83 | 4 | 3,123 | 781 | 691 | 717 | 698 | |
| 4 | Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta | m2 | 102,331 | 21,515 | 0.21 | 103,231 | 41,063 | 0.40 | 111,631 | 45,356 | 0.41 | 111,631 | 45,015 | 0.40 | 0.19 | 0.01 | (0.00) | |

Për vitin 2022 në Programin "*Zhvillimi i komunitetit*" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 5 aktivitete.

**Aktivitetet janë analizuar si më poshtë:**

P.06260.O1.A1. Shpenzime për pagat, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative për punonjësit e Shërbimeve Publike & të trashëguara.
P.06260.O1.A2. Hartimi i planeve të veprimit për shërbimet publike.
P.06260.O2.A1. Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve.
P.06260.O3.A1. Dekorimi i mjediseve publike & të trashëguara.
P.06260.O4.A1. Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta & të trashëguara.

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | | | 000/leke |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Totali | | |
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| **P06260.O1.A1. Shpenzime për pagat, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative për punonjësit e Shërbimeve Publike & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Sherbimi i vazhdueshem gjate gjithe vitit | 28,156 | 40,522 | 25,991 |
| **P06260.O1.A2. Hartimi i planeve të veprimit per sherbimet publike** | Bashkia Shkodër | | - | - | - |
| **P06260.O2.A1.: Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve.& te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Shërbimi i mirembajtjeve te varrezave është realizuar. Sherbime varrimi per raste te vecanta eshte realizuar. Ndertim parcela te reja eshte mbartur per vitin 2023 | 14,653 | 15,642 | 14,116 |
| **P06260.O3.A1. Dekorimi i mjediseve publike & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Blerje aksesorë dekori për festat eshte trasheguar per vitin 2023, Blerje materiale të ndryshme për dekorin eshte realizuar | 3,606 | 5,047 | 3,123 |
| **P06260.O4.A1. Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Shërbimi i mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberta është realizuar | 41,063 | 45,356 | 45,015 |
| **06260 Sherbimet Publike** | | | **87,478** | **106,566** | **88,245** |
| **Te trasheguara** | | | **31,781** | **1,172** | **-** |
| **Totali** | | | **119,259** | **107,738** | **88,245** |

## Programi 06330: Furnizimi me ujë

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:
1. Aparatin e Bashkisë
2. Ujësjellësin

### Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i programit të Prodhimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm dhe mbledhjes së ujërave të përdorura, është:
Garantimi i furnizimit me ujë të pijshëm të popullatës pa ndërprerje.

Objektivi i programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12- mujorin e vitit 2022 ka qënë:
O1. Rritja e numrit të popullsisë së Bashkisë Shkodër që ka akses në furnizimin me ujë të pijshëm.

**Furnizimi me ujë i Qytetit dhe Njësive Administrative**

Territori i juridiksionit i Bashkisë Shkodër mbulohet me shërbimin e furnizimit me ujë në nivelin 56%. Shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet për zonën urbane dhe rurale. Situata e furnizimit me ujë në qytet paraqitet e qëndrueshme, ndersa në zonat rurale mbulimi me këtë shërbim është më i ulët, kjo si rrjedhojë e mungesës së mbulimit me shërbim për shume fshatra te Bashkise Shkoder. Që nga viti 2016, kur u morën në dorëzim sistemet e furnizimit me ujë të zonës rurale, janë bërë përpjekje për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm të popullatës së ketyre njësive administrative. Në pamundësi të realizimit të investimeve kapitale, aktivitetet përmirësuese janë bazuar kryesisht në mirëmbajtje rutinë, si dhe në hartimin e grafikeve të operimit të pompave, për të optimizuar furnizimin me ujë të banoreve të këtyre njësive administrative.
Gjithë aktiviteti shoqërohet me kosto shumë të larta financiare, ku gjatë vitit 2022 dy zërat kryesorë të kostove të UKSH kanë pasur rritje të konsiderueshme. Fondi i pagave është rritur me 8% si rrjedhojë e rritjes së nivelit të pagës minimale në nivel kombëtar. Rritjen më të lartë e ka pësuar kostoja e energjisë elektrike, duke rezultuar në një rritje prej mesatarisht 62%, si rrjedhojë e rritjes së tarifës së energjisë elektrike për shkak të krizës energjitike të shkaktuar edhe nga lufta mes Ukrainës dhe Rusisë. Rritje kanë pësuar edhe çmimet e materialeve të mirëmbajtjes dhe kimikatet, të cilat janë të domosdoshme për veprimtarinë punuese të UKSH-së. Rritja e kostove e vë në vështirësi ekstreme stafin menaxhues të shoqërisë UKSH për realizimin e furnizimit me ujë të popullatës dhe largimit të ujërave të përdorura, me të ardhurat e e veta, pa u mbështetur me financim nga qeveria, ose Bashkia Shkodër. Gjatë vitit 2023, kostot e energjisë elektrike parashikohet të rriten me rreth 84,000,000 lekë. Si rrjedhojë e kësaj situate stafi drejtues do të marrë të gjitha masat e nevojshme për kursimin e energjisë elektrike, pa cënuar cilësinë e furnizimit për banorët e Bashkisë Shkodër.

Ndërsa situata e furnizimit me ujë të qytetit paraqitet si më poshtë:
Furnizimi me ujë i qytetit të Shkodrës kryhet me ngritje mekanike nga 10 pus-shpimet që janë në funksion dhe nga 2 stacione pompimi që ndodhen në Dobraç. Zonat që mbulohen nga ky shërbim janë:

-Qyteti Shkodër.
-Një pjesë e Komunës Rrethina që merr furnizim me ujë nga linjat kryesore të transmetimit të ujit që shtrihen nga Stacioni Pompave në Dobraç direkt për në sistemin shpërndarës.
-Lagjen Bahçallëk me një pjesë të Komunës Bërdicë (zona e Harkut të Bërdicës)
Norma standarte e furnizimit me ujë është 150 litër/për një frymë/në dit. Prodhimi në stinën e dimrit është rreth 650 l/s, ndërsa në stinën e verës shkon rreth 850 l/s.
Niveli i humbjeve të ujit është i lartë dhe është rrjedhojë e amortizimit te rrjetit, dëmtimet nga ndërtimet, ndërhyrjet e shumta të paligjshme nga banorët e ish Komunës Rrethina në linjat kryesore, zgjatja e tyre nëpër zona të banuara që arrijnë deri ne Vrakë, etj. Zgjatja pa kriter e linjave të hapura private në zonat periferike shkakton prishjen e rregjimit të furnizimit me ujë të qytetit me presionin normal. Nga presioni i ulët, klientët detyrohen të instalojnë elektropompa individuale për ngritjen e ujit në katet e sipërme të objekteve duke rritur koston për m³ të ujit të prodhuar.
Nevojat për ndërhyrje me investime për përmirësimin e sistemit ujësjellës janë shumë të mëdha si në rrjetin shpërndarës të qytetit, ashtu edhe në ndërtimin e rrjetit për zonat informale, zonat rurale dhe në linjat kryesore.
Aftësia financiare e UKSH nuk është e mjaftueshme për realizimin e investimeve kapitale në sektorin e ujësjellësit, por me mbështetjen e Bashkisë Shkodër është synuar përmirësimi i shërbimit, nëpërmjet rehabilitimit të linjave të furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit të ujërave të ndotura, nëpër të gjitha rrugicat ku Bashkia Shkodër ka ndërhyrë me shtrim të rrugëve me shtresa asfaltike. Gjatë vitit 2022 ka vazhduar edhe projekti i investimit në ndërtimin e ujësjellësit të Kullajve, i cili pritet të finalizohet gjatë vitit 2023.

**Realizimi i Buxhetit të planifikuar:** **mijë lekë**

| Programi 06330 | Shpenzime operative | Investime | Totali |
|---|---|---|---|
| PBA 2022 | - | 22,027 | 22,027 |
| Plani fillestar 2022 | 61 | 40,415 | 40,476 |
| Plani i rishikuar 2022 | | 40,415 | 40,415 |
| Realizimi viti 2022 | - | 16,924 | 16,924 |
| % e realizimit | 0 % | 41.9% | 41.9% |




Realizimi i shpenzimeve kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 41.9 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Shpenzime korente | 0.0% |
| Shpenzime kapitale | 41.88% |




**Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:**

Shpenzimi për tarifën së lidhjes së kontratës dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë nuk është realizuar plotësisht për arsye teknike Ujësjellës Kanalizime sh.a nuk ka realizuar të gjitha lidhjet e parashikuara.

## Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

## Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022

| Kodi i Programit | 6330 | Emertimi i programit: | Furnizimi me ujë | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | Administrim i problemeve të furnizimit me ujë; Mbikëqyrje dhe disiplinim i të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, duke përfshirë pastërtinë e ujit, çmimin dhe kontrollet e sasisë; Ngritja ose vënia në funksionim e kapaciteteve të zgjeruara shërbimin lokal të furnimizmit me ujë; Prodhim dhe shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e furnizimit me ujë; Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë. | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| *Objektivi 1* | Furnizimi me ujë të pijshëm i qytetit dhe njësive administrative të Bashkisë Shkodër | | | | | | | | |
| | | 1 | Sasia e ujit te faturuar (/000m3) | 3,922 | 4,079 | 4,079 | 3,739 | 92% | |
| | | 2 | Humbjet (/000m³) | 8,793 | 6,390 | 6,390 | 8,306 | 130% | |
| | | 3 | Sasia e prodhimit të ujit Qytet (Litër/sek) | 358 | 330 | 330 | 380 | 115% | |
| | | 4 | Rritja e mbulimit me shërbim e ujit të pijshëm: Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm kundrejt popullsisë totale të bashkisë (në %) | 57% | 60% | 60% | 57% | 95% | |
| | | 5 | Kohëzgjatja e ofrimit me ujë pijshëm në ditë: Orë ujë në ditë | 22.7 | 22 | 22 | 22.7 | 103% | |
| *Objektivi 2* | Mirë administrimi i shërbimit të furnizimit me ujë | | | | | | | | |
| | | 6 | Rritja e efiçiencës financiare të menaxhimit të shërbimit. Mbulimi i kostove nga tarifa e shërbimi. Total të ardhura nga tarifa kundrejt shpenzimeve Operative dhe mirëmbajtjes (në %) | 81% | 119% | 119% | 61% | 51% | |
| | | 7 | Të ardhura kundrejt shpenzimeve totale (plus investime dhe amortizimi) (në %) | 55% | 81% | 81% | 46% | 57% | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 8 | Rikonstruksion i stacionit të vjetër të ujësjellësit në Dobrac. Ndërtim rrjeti te KUZ në Dobrac. ( banorë përfitues) | 7,000 | 7,000 | 7,000 | 7,000 | 100% | |
| | | 9 | Numri i banoreve që furnizohen me ujë të pijshem në fshatin Muriqan ( banorë përfitues) | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 100% | |

## ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Furnizimi me ujë | Kodi i Programit | 6330 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kodi** | **Emërtimi i Produktit** | **Njësia matëse** | **Sasia Faktike (sipas vitit 2021)** | **Shpenzimet (sipas vitit 2021)** | **Kosto për Njësi (sipas vitit 2021)** | **Sasia (sipas planit të vitit 2022** | **Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022)** | **Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022)** | **Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022)** | **Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022** | **Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022)** | **Sasia Faktike (viti 2022)** | **Shpenzimet Faktike (viti 2022)** | **Kosto për Njësi Faktike (viti 2022)** | **V = IV - I** | **V = IV - II** | **V = IV - III** | **Komente** |
| **1** | Furnizimi me ujë i qytetit dhe Njësive Administrative | numri i banorëve që marrin shërbim | 208,618 | 9,016 | 0.04 | 210,182 | 22,027 | 0.10 | 210,182 | 40,415 | 0.19 | 208,618 | 16,924 | 0.08 | 0.04 | -0.02 | -0.11 | |

Për vitin 2022 në Programin "*Furnizimi me ujë*" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë realizuar 3 aktivitete.

P.06330.O1.A1. Furnizimi me ujë i qytetit dhe Njësive Administrative
P.06330.O1.A2. Programi i performancës në sektorin Ujësjellës
- Kanalizime me bashkëpunim financiar të qeverisë Gjermane, Bashkimit Europian dhe SECO
P06330.O1.A3. Rikonstruksion e rrjetit kryesor te ujësjellësit dhe ndërtim i rrjetit te brendshëm të ujësjellësit ne fshatrat Kullaj, Guci, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër, Vinoteka dhe Fshat i Ri (Pularia), Hot i Ri, Grudë e Re (faza e dytë dhe e tretë) - të trashëguara

| **Aktivitete/Projekte** | **Institucioni** | **Statusi i Aktiviteteve** | | | **000/leke** |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Totali** | | |
| | | | **Plani fillestar 2022** | **Plani i rishikuar 2022** | **Realizimi 2022** |
| **P06330.O1.A1. Furnizimi me ujë i qytetit dhe Njësive Administrative** | Bashkia Shkodër & UK Shkodër sh.a | | - | - | - |
| **P06330.O1.A2 Programi I performancës dhe investimeve në sektorin Ujësjellës – Kanalizime , me bashkëpunim financiar të qeverisë Gjermane, Bashkimit Europian dhe SECO.** | UK Shkodër sh.a | | - | - | - |
| **P06330.O1.A3 Rikonstruksion e rrjetit kryesor te ujësjellësit dhe ndërtim i rrjetit te brendshëm të ujësjellësit ne fshatrat Kullaj, Guci, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër, Vinoteka dhe Fshat i Ri (Pularia), Hot i Ri, Grudë e Re (faza e dytë dhe e tretë)** | UK Shkodër sh.a | Objekt vazhdim | 22,027 | 40,415 | 16,924 |
| **06330 Sherbimet lokale te ujesjellesit** | | | **22,027** | **40,415** | **16,924** |
| **Te trasheguara** | | | **18,449** | **-** | **-** |
| **Totali** | | | **40,476** | **40,415** | **16,924** |

## Programi 06440: Ndriçimi i rrugëve

Ky program përfshin institucionin e Bashkisë.

**Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:**

-Qëllimet e programit të ndriçimit të rrugëve janë:

I. Garantimi i shërbimeve publike cilësore për përmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe përmirësimi i ndriçimit të mjediseve publike.

II. Rritja e efiçencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të zonës së shërbimit.

-Objektivi i programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12- mujorin e vitit 2022 ka qënë:

O1. Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit

Shërbimi i ndriçimit publik të qytetit në Qytet, përfshin mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe ndërtimin e rrjetit të ndriçimit në qytet dhe në njësi administrative, të klasifikuar si më poshtë:

- ndriçimi i rrugëve kryesore dhe dytësore
- ndriçimi i shesheve
- ndriçimi i parqeve dhe lulishteve

Sipërfaqja totale e rrugëve dhe e shesheve, arrin afërsisht 1,600,000 $m^2$, nga të cilat 1,329,400 $m^2$ janë të ndriçuara, ose 83.1% e sipërfaqes totale, të rrugëve dhe shesheve.

Sipërfaqet e lulishteve dhe brezit të gjelbërt në qytet zënë një hapësirë mbi 66,000 $m^2$, nga të cilat 42,000 $m^2$ janë të ndriçuara, ose 63.6% e sipërfaqes së gjelbër është e ndriçuar.

Ndriçimi realizohet në një mesatare vjetore 10.5 orë në ditë gjatë gjithë vitit.

Asetet në dispozicion të shërbimit të ndriçimit publik për qytetin janë:

- Numri i pikave të furnizimit të energjisë (kabinave elektrike) që kanë kontratë 302 kontrata.
- Numri i ndriçuesve të instaluar 5,290 copë.

Në territorin urban të qytetit ka 3 lloje shtyllash:

- dekorative: të cilat gjenden në zonat pedonale dhe disa nga parqet e qytetit;
- çeliku: pothuajse të gjitha të zinkuara, përbëjnë pjesën dominuese të shtyllave që shërbejnë për ndriçimin e qytetit;
- betoni: shtyllat i përkasin OSHEE, por ndriçuesit janë të Bashkisë Shkodër.

Nëpërmjet shërbimit të mirëmbajtjes, rehabilitimit realizohet puna për rehabilitimin rrjetit elektrik ekzistues në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë:

- Mirëmbajtje e 5,290 ndriçuesve të zakonshëm;
- Mirëmbajtje e 148 ndriçueve dekorativ;
- Realizimi i pagesës për konsumin e energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative. Shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit administrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës. Numri i punonjësve të sektorit është 9 (nëntë).

Mirëmbajtja realizohet me të ardhurat e Bashkisë, që mbulojnë: shpenzimet për blerje materiale të ndryshme për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik, të cilat planifikohen çdo vit, në bazë të preventivave dhe miratohen në buxhetin e Bashkisë.
Në njësitë e tjera administrative situata e ndriçimit është si më poshtë:

*Nj.A. Rrethina:*

Janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat: Rruga Shtoj i Ri me 19 ndriçues, Rruga Guci e Re me 16 ndriçues, fshatit Grudë me 9 ndriçues, fshati Bardhaj degëzim me 7 ndriçues, Dobraç me 34 ndriçues, Grudë të Re me 12 ndriçues, Lagjja Vinotekë me 8 ndriçues,në fshatin Bardhaj me 15 ndriçues, Hot i Ri me 10 ndriçues, Grudë me 5 ndriçues, Bardhaj me 4 ndriçues.

*Nj.A. Bërdicë:*

Janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat: Rruga Mllojë me 12 ndriçues, Rruga e Beltojës me 7 ndriçues, Trush me 25 ndriçues, në Bërdicë e Sipërme me 23 ndriçues dhe në GjoMarkaj me 15 ndriçues, Masmalaj me 17 ndriçues.

*Nj.A. Gur i Zi:*

Janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat: Rruga Shkodër– Mjedë me 12 ndriçues, rruga Gajtan me 8 ndriçues, Fshatit Ganjollë me 10 ndriçues, Vukatanë me 35 ndriçues, Juban me 12 ndriçues, Kuç me 12 ndriçues, Qendra e Rrencit me 22 ndriçues dhe Rragam me 10 ndriçues.

*Nj.A. Postribë:*

Janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat: Rruga e Madhe me 25 ndriçues, rruga Rosek me 10 ndriçues, fshati Drisht me 6 ndriçues, fshati Myselim me 5 ndriçues, fshati Boks me 19 ndriçues, fshati Dragoç me 14 ndriçues, fshati Kullaj me 6 ndriçues, dhe fshati Mes me 6 ndriçues.

*Nj.A. Dajç:*

Në vitin 2022 janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat: Rruga e Emigrantëve me 18 ndriçues, kryqëzimi i Dajçit me 13 ndriçues, fshati Pentar me 7 ndriçues, Qendra e Dajçit me 25 ndriçues, Samrish të Ri me 5 ndriçues, Samrish i Vjetër me 18 ndriçues, Mushan me 20 ndriçues dhe Darragjat me 17 ndriçues.

*Nj.A. Velipojë:*

Është realizuar investimi në ndriçimin lulishtes në qendër të Velipojësme ndricues LED në një sipërfaqe prej 17 000 m2. Është mbajtur në eficencë të plotë ndriçimi i shëtitores së Velipojës. Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat: rruga nr.7 me 9 ndriçues, rruga nr.12 me 12 ndriçues, rruga nr.13 me 6.

Është realizuar investimi për Rehabilitim i ndriçimit të lulishtes Plazh- Velipojë. Ndriçimi është realizuar me shtylla ndriçimi LED të teknologjisë së fundit që do të kenë kursim në raport me ndriçuesit e vjetër SMART SON. Janë vendosur 98 shtylla nga 67 të mëparshmet.
Gjatë vitit 2022 Bashkia Shkodër nëpërmjet projektit SEMP (Bashki te Zgjuara Energjie) ka hartuar projektet teknike për instalimin e ndriçuesve me efiçencë energjie të teknologjisë LED.
Janë projektuar 11 rrugët kryesore të qytetit të Shkodrës, të cilët do të krijojnë mundësinë e ndriçimit me të mirë të rrugëve me një kosto me të ulet. Projekti parashikon zëvendësimin e

rreth 500 ndriçuesve të teknologjisë se vjetër SAP SON me fuqi 250 W me ndriçues LED me fuqi 80 W.
Nëpërmjet shërbimit të mirëmbajtjes, rehabilitimit është realizuar puna për rehabilitimin rrjetit elektrik ekzistues.
Mirëmbajtja e gjithë rrjeti i ndriçimit publik në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë:
Mirëmbajtje e 5,240 ndriçuesve të zakonshëm;
Mirëmbajtje e 148 ndriçuesve dekorativ;
Realizimi i pagesës për konsumin e pritshëm të energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative;.
Blerje materiale elektrike është realizuar.

**Realizimi i Buxhetit të planifikuar:** **mijë lekë**

| **Programi 06440** | **Paga & sigurime** | **Shpenzime operative** | **Transferta** | **Investime** | **Totali** |
|---|---|---|---|---|---|
| PBA 2022 | 4,673 | 105,864 | 10 | 19,900 | 130,447 |
| Plani fillestar 2022 | 5,448 | 108,495 | 50 | 19,980 | 133,973 |
| Plani i rishikuar 2022 | 5,268 | 106,440 | 190 | 18,958 | 130,856 |
| Realizimi viti 2022 | 4,528 | 99,996 | 180 | 10,417 | 115,121 |
| % e realizimit | 86.0% | 93.9% | 94.7% | 54.9% | 88.0% |




Realizimi i shpenzimeve për paga, shpenzime operative, transferta dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 88 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:




**Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:**

- Blerje mjete të ndryshme për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve është realizuar; Blerje vegla pune per elektricista në proçes është realizuar.
- Shpenzime per karburant në proçes prokurimi.
- Pajisje me dokumentin e sigurimit teknik për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve është realizuar.
- Furnizim vendosje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje e makinerive është në proçes është realizuar.
- Investim ndricim rruge është në proçes të hartimit të dokumentacionit. Është transhëguar për vitin 2023.
- Zëvendësim shtyllash zinkat, ndriçuesve të dëmtuar zinkat dhe i kapakëve të shtyllave është realizuar.
- Blerje uniforma e parashikuar është realizuar.

## Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

## Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022

| Kodi i Programit | 6440 | Emertimi i programit: | Ndriçim rrugësh | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | **Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve,mjediseve publike; Zhvillimi dhe rregullimi i standarteve të ndriçimit rrugor.** | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/ Produktit | |
| *Objektivi 1* | Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit | | | | | | | | |
| | | 1 | Rritja e mbulimit të territorit me ndriçim publik: - Sipërfaqja e shtuar e rrugëve dhe e shesheve të ndriçuara; - Sipërfaqe e hapësirave publike e mbuluar me ndriçim – raporti sipërfaqe e mbuluar me ndriçim kundrejt totalit të sipërfaqes publike të bashkisë (në%) | 83% | 85% | 85% | 85% | 100% | |
| | | 2 | Përmirësimi i efiçiencës së buxhetit të bashkisë për shërbimin e ndriçimit publik -Shpenzime operative totale kundrejt sipërfaqes totale të ndriçuar | 8.2% | 9.6% | 9.7% | 8.5% | 87% | |
| | | 3 | Mbulimi sherbimit te ndricimit publik nga tarifa e sherbimit- Lekë ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike kundrejt totalit të shpenzimeve të bashkisë për mbulimin me ndriçim (në %) | 42% | 63% | 63% | 42% | 67% | |
| | | 4 | Përmirësimi i mbulimit të kostove nga tarifa e shërbimit. Lekë të ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike kundrejt totalit të shpenzimeve të bashkisë për mbulimin me ndriçim | 42% | 63% | 63% | 42% | 67% | |
| | | 5 | Zgjerimi i rrjetit te shërbimit të ndricimit publik në Njësitë Administrative të Bashkisë | 0 | 2500 | 2500 | 0 | 0% | |

## ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Ndriçim rrugësh | Kodi i Programit | 6440 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2021) | Shpenzimet (sipas vitit 2021) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2021) | Sasia (sipas planit të vitit 2022 | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022 | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Sasia Faktike (viti 2022) | Shpenzimet Faktike (viti 2022) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2022) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | Komente |
| 1 | Sherbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Qytetit dhe Njësive Administrative | $m^2$ | 1,329,400 | 108,869 | 0.08 | 1,354,400 | 130,447 | 0.10 | 1,354,400 | 130,856 | 0.10 | 1,354,400 | 115,121 | 0.08 | 0.003 | (0.011) | (0.012) | |

Për vitin 2022 në Programin "Ndriçimi i rrugëve" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, është parashikuar 1 aktivitet.

**Aktivitetet janë analizuar si më poshtë:**

P06440.O1.A1. Shërbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Qytetit dhe Njësive Administrative & të trashëguara

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | | | 000/leke |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Totali | | |
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| **P06440.O1.A1: Sherbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Qytetit dhe Njësive Administrative & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Blerje mjete të ndryshme për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve e perfunduar.Rehabilitim i ndriçimit te lulishtes Plazh-Velipoje e perfunduar materiale elektrike e perfunduar.Blerje vegla pune per elekticistanë proçes likujdimi. Shpenzime per karburant eshte ne proces prokurimi .Paisje me dokumentin e sigurimit teknik për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve e perfunduar. Furnizim vendosje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje e makinerive eshte perfunduar .Investim ndricim rruge ne proces pjesa e tenderimit. Zevendesim shtyllash zinkat , ndricuesve te demtuar zinkat dhe i kapakeve te shtyllave perfunduar. Blerje uniforma perfunduar. | 130,447 | 130,856 | 115,121 |
| **06440 Ndricimi rrugor** | | | **130,447** | **130,856** | **115,121** |
| **Te trasheguara** | | | **3,526** | **-** | **-** |
| **Totali** | | | **133,973** | **130,856** | **115,121** |

# FUNKSIONI 07: SHËNDETËSIA

## SHËRBIMET SOCIALE, STREHIMI DHE SHËNDETI PUBLIK

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik është drejtori e krijuar për herë të parë në Bashkinë e Shkodrës në fillim të vitit 2016.

***Vizioni i kësaj drejtorie është "Shërbime Sociale multisektoriale, të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë".***

Struktura e kësaj drejtorie përbëhet nga 2 sektorë si më poshtë:

1. Sektori i Përfshirjes Sociale, Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Strehimit.
2. Sektori i Planifikimit Strategjik, Standarteve e Monitorimit për Shërbimet sociale dhe Shëndetin Publik.

Shërbimet me bazë komunitare të cilat filluan të krijohen gjatë vitit 2016 janë të parat struktura operative në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Qendrat Komunitare "Për Familjen" janë njësitë bazë të ngritura dhe që mbulojnë me shërbime sociale çdo lagje të qytetit dhe njësitë administrative.

Aktualisht janë të ngritura dhe në funksion 13 qendra komunitare; 6 në zonën urbane dhe nga një në Njësitë Administrative të Gurit të Zi, të Dajçit, Velipojës, Postribës, Rrethinave dhe Shalës. Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizim ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komuniteti, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, etj.

Gjatë punës sonë përveç qendrave komunitare "Për Familjen" që ofrojnë shërbime sociale bazë në një territor të përcaktuar kemi arritur të ndërtojmë qendra që ofrojnë shërbime të specializuara për grupe dhe individë në nevojë të tilla si: qendra komunitare Multifunksionale në shërbim të fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge; qendra Rinore Atelie, në shërbim të të rinjve; qendra komunitare "Për Familjen" nr.6 me apartamente sociale për jetimët dhe familjet me një kryefamiljar dhe fëmijë.

Gjithashtu, është rikonstruktuar  ish godina e kopshtit "Guerrile", në zbatim të projektit ESERE "Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale" ku ofrohen disa shërbime si: kopsht dhe çerdhe, zyra administrative dhe qendër shëndetësore për komunitetin e lagjes Nr.1.

Gjithashtu ka përfunduar rikonstruksioni i godinës së ish shkollës Veterinare me synim krijimin e hapësirave për krijimin e qendër komunitare "Për Familjen", qendër shëndetësore për lagjen,

kopshte&çerdhe dhe zyrë administrative të Bashkisë Shkodër. Ky projekt po bëhet në zbatim të projektit “Shërbime multi-funksionale të Shkodrës – Model i përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit”, të financuar nga Programi i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim (IADSA), i qeverisë Italiane dhe Bashkisë Shkodër.

Në fushën e strehimit social, në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”,gjatë vitit 2022, Bashkia Shkodër ka zbatuar disa nga programet e strehimit social, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet në nevojë për strehim. Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe miratuar në Këshill Bashkiak një paketë vendimesh, të cilat rregullojnë veprimtarinë e strukturës përgjegjëse dhe Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë gjatë zbatimit të programeve të strehimit social. Gjatë këtij viti janë zbatuar 3 programe të strehimit social (banesa sociale me qira pranë ish konviktit të pyjores, subvencionimi i interesave te kredisë dhe subvencionimi i qirasë në tregun e lirë) për të cilat janë miratuar me vendim të këshillit bashkiak përfituesit. Gjithashtu janë zbatuar disa projekte që kanë si synim përmirësimin e kushteve të banimit për individë dhe familje në nevojë siç janë: Godinat sociale për komunitetin rom, Rikonstruksioni i godinës së ish konviktit të shkollës veterinare.

Bashkia Shkodër ka krijuar dhe vënë në funksion të plotë Qendrën Harmonia, e cila ofron shërbime të specializuara për spektrin e autizmit. Përgjatë kësaj periudhe kanë marrë shërbim rreth 16 fëmijë të diagnostikuar me spektrin e autizmit.

Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin.

**Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave**

Në ushtrim të detyrave funksionale në zbatim të ligjit 139 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”, ligjit 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse, Ligjit nr. 22/2018 “ Për strehimin Social”.

## Programi 07220: Shërbimet e kujdesit parësor

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

**Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.**

Qëllimi i programit të "Shërbimet e kujdesit parësor" .

- Projektimi, përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirëadministrimi i infrastrukturës së ndërtuar.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2022 kanë qenë:

- O1. Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes aktiviteteve të edukimit e promocionit shëndetësor, parandalimit të sëmundjeve dhe shërbimeve të tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor.

Me qëllim përmirësimin e shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përgjatë të gjithë vitit organizohen aktiviteteve të edukimit e promocionit shëndetësor, si dhe merren masa për projektimin, përmirësimin e kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirëadministrimin e infrastrukturës së ndërtuar. Si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe në respektim të udhëzimeve të institucioneve përkatëse aktivitetet e parashikuara gjatë kësaj periudhe janë realizuar nën masa të kujdesit të shtuar dhe protokolleve përkatëse për parandalimin e përhapjes së COVID-19.

### Realizimi i Buxhetit të planifikuar për programin "Shërbimet e kujdesit parësor":

*000/leke*

| Programi 07220 | Shpenzime operative | Totali |
|---|---|---|
| PBA 2022 | 3,000 | 3,000 |
| Plani fillestar 2022 | 6,000 | 6,000 |
| Plani i rishikuar 2022 | 5,850 | 5,850 |
| Realizimi viti 2022 | 2,850 | 2,850 |
| % e realizimit | 48.7% | 48.7% |




Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 48.7 %, sipas zërave kryesorë më poshtë:

| | |
|---|---|
| Shpenzime korente | 48.7% |
| Shpenzime kapitale | 0 % |




### Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Aktiviteti i parashikuar është mbartur për tu realizuar për në vitin 2023.

**Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit**

**Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022**

| **Kodi i Programit** | **7220** | **Emërtimi i programit:** | **Shërbimet e kujdesit parësor** | | | | | | **Komente** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi** | **Projektimi, përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirëadministrimi i infrastrukturës së ndërtuar.** | | | | | | | | ..... |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet:** | | | | | | ..... |
| ***Objektivat e politikës*:** | | **Kodi i Treguesit te Performances/Produktit** | **Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit** | **Niveli faktik i vitit paraardhes** | **Niveli i planifikuar ne vitin korent** | **Niveli i rishikuar ne vitin korent** | **Niveli faktik ne fund te vitit korent** | **% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit** | |
| ***Objektivi 1*** | **Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes aktiviteteve të edukimit e promocionit shëndetësor, parandalimit të sëmundjeve dhe shërbimeve të tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor** | | | | | | | | |
| | | 1 | Numri i temave të zhvilluara. | 32 | 20 | 20 | 17 | 85% | |
| | | 2 | Nrumri i aktiviteteve informuese dhe promovuese për shëndetin. | 74 | 60 | 60 | 62 | 103% | |
| | | 3 | Numri i pjesëmarrësve në takime e aktivitete. | 988 | 1200 | 1200 | 1087 | 91% | |
| | | 4 | Numri i pjesëmarrësve në takime e aktivitete vajza/gra. | 730 | 800 | 800 | 703 | 88% | |
| | | 5 | Numri i qendrave shëndetësore funksionale. | 14 | 14 | 14 | 14 | 100% | |
| | | 6 | Numri i qendrave shëndetësore të ndërtuara ( të reja) dhe të rikonstrukturuara; | 1 | 1 | 1 | 0 | 0% | |
| | | 7 | Numri i personave që marrin shërbim në këto qendra shëndetësore | 181,628 | 181,628 | 181,628 | 181,628 | 100% | |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Shërbimet e kujdesit parësor | Kodi i Programit | 7220 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2021) | Shpenzimet (sipas vitit 2021) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2021) | Sasia (sipas planit te vitit 2022 | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022) | Sasia (sipas planit të rishikuar e vitit 2022) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar e vitit 2022 | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar e vitit 2022) | Sasia Faktike (viti 2022) | Shpenzimet Faktike (viti 2022) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2022) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | Komente |
| 1 | Aktivitete informuese dhe promovuese për shëndetin | Numri i aktiviteteve | 74 | 0 | 0 | 60 | 0 | 0 | 60 | 0 | 0 | 62 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 2 | Numri i qendrave shëndetësore të mirëmbajtura | Numri i qendrave | 0 | 0 | 0 | 1 | 3,000 | 0 | 2 | 5,850 | 2,925 | 1 | 2,850 | 2,850 | 2,850 | 2,850 | -75 | |

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | | | 000/leke |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Totali | | |
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| **P07220.O1.A1 Informimi dhe promovimi për një komunitet më të shëndetshëm** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| **P07220.O1.A2 Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor & trashëguar** | Bashkia Shkodër | Mbartur për tu realizuar në vitin 2023 | 3,000 | 5,850 | 2,850 |
| **07220 Shërbimet e kujdesit parësor** | | | **3,000** | **5,850** | **2,850** |
| **Te trasheguara** | | | **3,000** | **-** | **-** |
| **Totali** | | | **6,000** | **5,850** | **2,850** |

Për vitin 2022 në Programin "Shërbimet e kujdesit parësor", në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 2 aktivitete.

- **P07220.O1.A1** Informimi dhe Promovimi për një komunitet më të shëndetshëm.

Shërbimi i shëndetit publik pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik ka organizuar një sërë takimesh informuese me synim përmirësimin e shëndetit dhe cilësisë së jetës së komunitetit. Këto takime janë organizuar pranë qendrave komunitare "Për Familjen" dhe gjithashtu në shkollat 9 vjeçare dhe të mesme të bashkisë së Shkodrës. Temat e referuara janë në përputhje me kalendarin kombëtar të promocionit shëndetësor të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Organizimi dhe zhvillimi i këtyre aktiviteteve është realizuar në bashkëpunim me institucionet përgjegjese të shërbimit shëndetesor dhe atij arsimor me moton "Së bashku për shëndetin tuaj". Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 17 tema të shëndetit. Këto tema janë prezantuar në 62 takime të organizuara në qendrat komunitare "Për Familjen", në qendrën rinore "Atelie", në shkolla, në zonën urbane dhe në njësitë administrative Dajç, Gur i Zi, Postribë, Ana e Malit, Rrethina dhe Bërdicë. Numri i përfituesve është rreth 1,087 individë.

- **P07220.O1.A2** Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik pranë Bashkisë së Shkodrës, ndër detyrat funksionale ka përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat në nevojë, pjesë e së cilës është vlerësimi i kushteve infrastrukturore të qendrave shëndetësore, ristrukturimi i tyre, planifikimi dhe projektimi i ndërhyrjeve, me synim që të krijohen kushtet e përshtatshme për komunitetin për marrjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Bashkia e Shkodrës tashmë ka krijuar një database të qendrave shëndetësore parësore të gatshme, me të dhënat aktuale dhe nevojat për ndërhyrje. Pjesë e këtij database i cili është në përditësim të

vazhdueshëm, është projektimi dhe përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore në territor. Është arritur sigurimi i financimit të projektit të qendrës komunitare Multifunksionale, në objektin ish shkolla Veterinare, në të cilin është projektuar një qendër shëndetësore shumë e domosdoshme për lagjen nr. 1 dhe kanë përfunduar punimet për ndërtimin e saj. Aktualisht në Bashkinë e Shkodrës janë 14 qendra shëndetësore funksionale, në të cilat marrin shërbim shëndetësor rreth 181,628 individë.

## FUNKSIONI 8: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA

# Programi 08130: Sport dhe argëtim

Ky program përfshin institucionin:

1- Aparati i Bashkisë

**Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit**:

### Qëllimi i programit Sport dhe argëtim është:

Ofrimi i shërbimeve specifike në lidhje me:

I. Informimin dhe këshillimin për rininë për shërbimet lokale, edukim, për formim profesional, etj;
II. Vlerësimin e nevojës për mbështetje të të rinjve;
III. Bashkëfinancim të aktiviteteve rinore;
IV. Bashkërendim me sektorin e shërbimeve sociale, shëndetësore e të sportit për nxitjen e aktiviteteve me të rinj.

Pjesë e programit për rininë dhe sportet janë organizimi i përvitshëm i aktiviteteve sportive dhe zhvillimi i sportit në komunitet. Këto aktivitete zhvillojnë traditën ku të rinjtë dhe të rejat e Shkodrës, shoqatat e klubet sportive nga vendi ose nga rajoni të garojnë në mes tyre.

Bashkia Shkodër, në zbatim të Ligjit 79/2017 "Për sportin", mbështet zhvillimin e tij nëpërmjet projekteve sportive që shoqatat sportive kanë paraqitur e janë përzgjedhur nga Bashkia për të përfaqësuar Vllazninë në kompeticionet sportive kombëtare dhe ndërkombëtare.
Janë 14 disiplina sportive që mbështeten nëpërmjet 24 ekipeve sportive dhe 500 sportistë të përfshirë në këto ekipe që kontribuojnë në zhvillimin e sportit në Bashkinë tonë.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për 12 mujorin e vitit 2022 kanë qenë:

**O1.** Pjesëmarrje aktive e të rinjve në aktivitete sportive dhe sociale, si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit.

**O2.** Menaxhim dhe mirëadministrim i strukturave sportive dhe krijimi i infrastrukturës së përshtatshme dhe cilësore për të gjithë sportet.

**O3.** Sigurimi i pjesëmarrjes së ekipeve sportive "Vllaznia" në Kampionatet kombëtare me synim arritjen e rezultateve cilësore.

## Realizimi i buxhetit të planifikuar:

*000/leke*

| Programi 08130 | Paga& sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| PBA 2022 | 19,974 | 23,360 | 41,446 | | 84,780 |
| Plani fillestar 2022 | 21,834 | 31,023 | 44,486 | | 97,343 |
| Plani i rishikuar 2022 | 21,216 | 22,841 | 33,667 | 31,525 | 109,249 |
| Realizimi viti 2022 | 14,960 | 20,769 | 32,621 | | 68,350 |
| % e realizimit | 70.5% | 90.9% | 96.9% | - | 62.6% |




Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin në total është 62.6 %, sipas zërave kryesorë më poshtë:

| | |
|---|---|
| Shpenzime korente | 87.9% |
| Shpenzime kapitale | 0.0% |

## Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Përsa i përket mbështetjes së financimit të zhvillimit të sportit në Bashkinë Shkodër nëpërmjet mbështetjes së projekteve sportive të shoqatave të ndryshme sportive që funksionojnë në këtë Bashki janë ndeshur vështirësi në drejtim të kapaciteteve të këtyre shoqatave për të ndjekur konkretisht si nga ana sportive ashtu dhe financiare të projekteve të tyre. Kapacitetet e tyre sapo kanë filluar të ndërtohen dhe duhet punë në drejtim të konsolidimit të tyre. Mbështetja jonë si Bashki ka qenë mjaft me vlerë, gjë që shprehet dhe në takimet tona të përbashkëta.

## Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

**Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022**

| Kodi i Programit | 8130 | Emertimi i programit: | Sport dhe Argetim | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | Krijimi i infrastrukturës mbështetëse dhe bazës materiale për zhvillimin e proceseve stërvitore për të gjitha ekipet zinxhire të klubit shumësportësh "Vllaznia". Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive dhe zhvillimin e sportit në komunitet synojmë organizimin e përvitshëm të programit "Jeto me sportin". | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performance s/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/ Produktit | |
| *Objektivi 1* | Të promovojmë dhe te nxisim pjesëmarrjen aktive të te rinjve ne aktivitete sportive dhe sociale, si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit. | 1 | Numri i pjesmarrësve në veprimtaritë rinore. | 700 | 700 | 700 | 1,400 | 200% | |
| | | | | | | | | | |
| *Objektivi 2* | Manaxhimi dhe mireadministrimi i strukturave sportive dhe krijimi infrastruktures së përshtatshme dhe cilësore për të gjithë sportet. | 2 | Numri i strukturave sportive të menaxhuara nga Bashkia Shkodër. | 3 | 3 | 3 | 3 | 100% | |
| | | 3 | Administrimi dhe Mirëmbajtje e objekteve/terreneve sportive në pronësi të Bashkisë Shkodër në 000/lekë | 17,294 | 41,528 | 42,985 | 34,698 | 81% | |
| | | 4 | Numri i punonjësve -Njësia Mirëmbajtje terrene sportive në pronësi të bashkisë | 33 | 31 | 40 | 40 | 100% | |
| | | | | | | | | | |
| *Objektivi 3* | Garantimi i pjesëmarrjes së të gjithë ekipeve të Klubit Vllaznia në Kampionatet Kombëtare me synim arritjen e rezultateve cilësore | 4 | Numri i sportistëve të përfshirë në ekipet sportive. | 304 | 454 | 454 | 500 | 110% | |
| | | 6 | Numri i disiplinave sportive të mbështetura | 14 | 14 | 14 | 14 | 100% | |
| | | 7 | Numri i ekipeve të mbështetura | 23 | 24 | 24 | 24 | 100% | |

## ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Sport dhe argëtim | Kodi i Programit | 8130 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2021) | Shpenzimet (sipas vitit 2021) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2021) | Sasia (sipas planit të vitit 2022 | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022 | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022) | Sasia Faktike (viti 2022) | Shpenzimet Faktike (viti 2022) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2022) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | Komente |
| 1 | Pjesëmarrje aktive e rinisë në aktivitetet argëtuese dhe sportive | numri i të rinjve pjesmarrës në aktivitetet e rinore gjatë vitit. | 700 | 1,029 | 1.5 | 700 | 1,708 | 2.4 | 700 | 1,708 | 2.4 | 1,400 | 1,649 | 1.2 | -0.3 | -1.3 | -1.3 | |
| 2 | Struktura sportive të mirëmbajtura dhe të mirëmenaxhuara | numri i strukturave në funksion të sportit. | 3 | 115,037 | 38,346 | 3 | 41,528 | 13,843 | 3 | 42,985 | 14,328 | 3 | 34,698 | 11,566 | -26,780 | -2,277 | -2,762 | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Mbështetje e të rinjve që merren me sportive në ekipet e disiplinave sportive të mbështetura nga Bashkia Shkodër | numri i sportisteve të perfshirë. | 304 | 26,799 | 88 | 454 | 41,544 | 92 | 454 | 33,031 | 73 | 500 | 32,003 | 64 | -24 | -28 | -9 | |
| 4 | Ngritja e një kompleksi olimpik | numër | | | | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | | | | 0 | 0 | 0 | |
| 5 | Ngritja e një salle sportive | Numri i sallave sportive të ngritura. | | | | | | | 1 | 15,370 | 15,370 | | | | 0 | 0 | -15,370 | |
| 6 | Ngritja e një fushe sportive | Numri i fushave sportive të ngritura. | | | | | | | 1 | 16,155 | 16,155 | | | | 0 | 0 | -16,155 | |

## Realizimi i produkteve për periudhën 12 mujore 2022:

Në programin Rinia e Sportet, për periudhën 12 mujore 2022, eventet sportive dhe rinore në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | | | 000/leke |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Totali | | |
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| **P08130.O1.A1 Maratona e pavarësisë Ulqin – Shkodër** | Bashkia Shkodër | realizuar | 455 | 455 | 451 |
| **P08130.O1.A2 Beach voley** | Bashkia Shkodër | realizuar | 534 | 534 | 520 |
| **P08130.O1.A3. "Memorial Vllaznia ", boks.** | Bashkia Shkodër | realizuar | 400 | 400 | 384 |
| **P08130.O1.A4. Festivali i Shahut "Çesk Jubani"** | Bashkia Shkodër | realizuar | 119 | 119 | 119 |
| **P08130.O1.A5. Shkodra Tennis Tournament** | Bashkia Shkodër | realizuar | 200 | 200 | 175 |
| **P08130.O2.A1. Administrimi dhe Mirëmbajtje e objekteve/terreneve sportive në pronësi te Bashkise Shkodër & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | realizuar | 41,528 | 42,985 | 34,698 |
| **P08130.O3.A1.Ekipi i basketbollit i të rriturve për meshkuj** | Bashkia Shkodër | realizuar | 3,133 | 3,133 | 3,133 |
| **P08130.O3.A2. Mbështetje e ekipit të basketbollit meshkuj te rinj** | Bashkia Shkodër | realizuar | 806 | 806 | 806 |
| **P08130.O3.A3. Mbështetje e ekipit të basketbollit femra te rritura** | Bashkia Shkodër | realizuar | 2,548 | 2,548 | 2,548 |
| **P08130.O3.A4. Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të reja** | Bashkia Shkodër | realizuar | 573 | 573 | 332 |
| **P08130.O3.A5. Mbështetje e ekipit të volejbollit meshkuj të rritur & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | realizuar | 4,033 | 4,033 | 3,982 |
| **P08130.O3.A6. Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të rritura & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | realizuar | 2,716 | 2,717 | 2,716 |
| **P08130.O3.A7. Mbështetje e ekipit të Volejboll meshkuj të rinj** | Bashkia Shkodër | realizuar | 724 | 724 | 724 |
| **P08130.O3.A8. Mbështetje e ekipit të Volejbollit femra të reja** | Bashkia Shkodër | realizuar | 706 | 706 | 706 |
| **P08130.O3.A9. Mbështetje e ekipit të boksit meshkuj të rritur & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | realizuar | 3,045 | 3,046 | 3,045 |
| **P08130.O3.A10. Mbështetje e ekipit të atletikës meshkuj të** | Bashkia Shkodër | realizuar | 3,402 | 3,402 | 3,402 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **rritur** | | | | | |
| **P08130.O3.A11. Mbështetje e ekipit Çiklizëm meshkuj të rritur** | Bashkia Shkodër | realizuar | 1,598 | 1,598 | 1,598 |
| **P08130.O3.A12. Mbështetje e ekipit të Gjimnastikës femra të rritura** | Bashkia Shkodër | realizuar | 654 | 654 | 421 |
| **P08130.O3.A13. Mbështetje e ekipit të Hendbollit meshkuj të rritur dhe te rinj** | Bashkia Shkodër | realizuar | 342 | 342 | - |
| **P08130.O3.A14. Mbështetje e ekipit i Mundjes meshkuj te rritur** | Bashkia Shkodër | realizuar | 647 | 647 | 647 |
| **P08130.O3.A15. Mbështetje e ekipit te Notit te rritur dhe te rritura** | Bashkia Shkodër | realizuar | 365 | 365 | 365 |
| **P08130.O3.A16. Mbështetje e ekipit te peshengritjes meshkuj te rritur** | Bashkia Shkodër | realizuar | 713 | 713 | 708 |
| **P08130.O3.A17. Mbështetje e ekipit te Ping - Pong te rritur & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | realizuar | 335 | 505 | 366 |
| **P08130.O3.A18. Mbështetje e ekipit te Shahut te rritur & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | realizuar | 645 | 646 | 645 |
| **P08130.O3.A19. Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rritur/të rritura & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | realizuar | 1,216 | 1,220 | 1,216 |
| **P08130.O3.A20 Mbeshtetje e ekipit te boksit femra.** | Bashkia Shkodër | realizuar | 865 | 865 | 857 |
| **P08130.O3.A21 Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rinj / të reja** | Bashkia Shkodër | realizuar | 612 | 612 | 610 |
| **P08130.O3.A22 . Mbështetje e ekipit të atletikës femra** | Bashkia Shkodër | realizuar | 150 | 150 | 150 |
| **P08130.O3.A23. Mbështetje e ekipit të Futbollit femra të rritura** | Bashkia Shkodër | realizuar | 1,000 | 1,000 | 1,000 |
| **P08130.O3.A24 . Mbështetje e futbollit për të rinjtë** | Bashkia Shkodër | nuk realizohet | 10,000 | - | - |
| **P08130.O3.A25 Shpërblim për rezultatet në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare për sportistët e trajnerët që përfaqësojnë ekipet e Shkodrës** | Bashkia Shkodër | realizuar | 716 | 2,026 | 2,026 |
| **P08130.O4.A1. Studim për ngritjen e një kompleksi olimpik** | Bashkia Shkodër | Trasheguar per vitin pasardhes | - | - | - |
| **P08130.O4.A2 Salle sportive** | Bashkia Shkodër | Trasheguar per vitin pasardhes | - | 15,370 | - |
| **P08130.O4.A3 Ndertim ambiente sportive** | Bashkia Shkodër | Trasheguar per vitin pasardhes | - | 16,155 | - |
| **08130 Sport dhe argetim** | | | **84,780** | **109,249** | **68,350** |
| **Te trasheguara** | | | **12,563** | **-** | **-** |

| Totali | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | 97,343 | 109,249 | 68,350 |

## Përshkrimi i aktiviteteve:

### P08130.O1.A1 Maratona e pavarësisë Ulqin – Shkodër

Maratona e Pavarësisë Ulqin-Shkodër për vitin 2022 u zhvillua me 28 nëntor, Ditën e Pavarësisë. Aktivitet tashmë i kthyer në traditë pas 2 vitesh shkëputje nga pandemia, rikthehet me edicionin e tij të dhjetë.

Në terësi morën pjesë 29 të rinj/të reja, amatorë dhe profesionistë të cilët vrapuan për 42km nga Bashkia Shkodër, deri në finish që ishte Komuna e Ulqinit.

Ky aktivitet i sherben shumë forcimit te lidhjes në mes Shkodres dhe Komunes se Ulqinit, por duhet punuar me shume per ta standartizuar sipas kritereve dhe normave te maratones si aktivitet sportiv.

### P08130.O1.A2 Beach Voley

Bashkia Shkodër, me qëllim pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete sportive në programin Sport dhe Argëtim, ka parashikuar për vitin 2022 Aktivitetin Beach Voley, volejboll i cili mori emrin Volejpoja Beach Trophy sipas programit (P012130.O1.A2). Bashkia Shkodër organizoi për të katërtin vit rradhazi këtë aktivitet në Njësinë Administrative Velipojë në datat 22- 23- 24 korrik. Këtë vit morën pjesë 52 sportistë profesionistë, amatorë dhe sportistë elitar nga klube të ndryshme të Shqipërisë si Erzeni, Vllaznia, Tirana, Partizani, Elbasani por edhe nga Kosova, ekipe nga Prishtina Voley dhe nga Suhareka, Theranda Voley. Në kategorinë e femrave u regjistruan 6 ekipe, ndërsa në kategorinë e meshkujve 10 ekipe. Aktiviteti u gjykua nga 10 gjyqtarë dhe 1 kryegjyqtar profesionist. Ditën e parë të aktivitetit u zhvilluan 10 ndeshje në dy fusha pasdite dhe kishte rreth 100 shikues, ndërsa ditën e dytë dhe të tretë u zhvilluan 35 ndeshje të tjera. Në total numërohen 45 ndeshje meshkujsh dhe femrash dhe interesi i pushuesve ishte më i lartë duke numëruar kështu rreth 1200 spektatorë. Në ditën e fundit u zhvilluan finalet dhe ndeshjet për vend të tretë dhe të katërt ku nga këto fitues dolën:

Kategoria Femra: Edna Erkoçi - Laura Ballçiti - Vendi i 1, Izabela Dodani - Xhesika Kaçi - Vendi i 2, Stela Kiri - Klodeta Zhivani - Vendi i 3.

Kategoria Meshkuj: Nikolin Qafarena - Fatjon Çekini - Vendi i 1, Elidon Marku - Zamir Vjerdha - Vendi i 2, Fatjet Haxhagiqi - Dorjan Tafa - Vendi i 3.

### P08130.O1.A3 "Memorial Vllaznia" në boks

Bashkia Shkodër, në kuadër të aktiviteteve vjetore, si cdo vit ka organizuar turneun ndërkombëtar "Memorial Vllaznia 2022" në datat 7- 9 Prill për disiplinën e boksit. Me datën 7 ishte mbërritja dhe akomodimi i pjesëmarrësve dhe në datën 12 ishte fillimi i aktivitetit. Ky aktivitet u zhvillua në nderim të boksierëve të cilët ngritën emrin e Vllaznisë në majat e boksit Shqiptar përgjatë viteve e sot nuk jetojnë më: Liman Kulla, Shyqyri Halili, Fadil Efovija, Ymer Gruda, Dervish Efovia, Ndoc Gjoni, Nazmi Halili, Kolec Ashiku, Lem Kosova, Shpresim Bregu, Kujtim Demi, Ramiz Halili e Fadil Zhega ishin figura të shquara të boksit shkodran. Shtetet si Bullgaria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi e Shqipëria ishin pjesëmarrëse në aktivitetin 3 ditor. Interesi ishte i lartë nga sportdashësit shkodranë, por kishte edhe spektatorë të huaj nga vendet pjesëmarrëse.

Boksierët garuan në 6 pesha të ndryshme 57 kg, 63.5 kg, 71 kg, 120 kg, 126 kg dhe 92+ kg, ku dhe fituesit përkatës u shpallën: Javier Diaz 57 kg (Bullgari), Edin Alkovic 63.5 kg (Mali i Zi), Rilind Murici

71 kg (Kosovë), Arjon Kajoshi 120 kg (Shqipëri), Milorad Puric 126 kg (Mali i Zi), Gelian Rajku 92+ kg (Shqipëri).
Gjithashtu u shpallën edhe boksierët më të mirë të turneut ku boksieri më teknik u shpall Javier Diaz i ekipit të Bullgarisë dhe boksieri më i mirë Gelian Rajku i ekipit të Shqipërisë. Ndërsa ekipi më i mirë i aktivitetit u shpall ekipi i Shqipërisë.

### P08130.O1.A4 Festivali i shahut "Çesk Jubani"

Bashkia Shkodër me qëllim pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete sportive ka parashikuar për vitin 2022 aktivitetin Festivali i shahut "Çesk Jubani".
Disiplina e shahut është pjesë e SportKlub Vllaznia dhe mbështetet nga Bashkia Shkodër tradicionalisht. E konsideruar si lojë e mendjes, aktivitetet në lidhje me këtë disiplinë janë edhe fillimi i aktiviteteve rinore- sportive të Bashkisë Shkodër për vitin 2022.
Për vitin 2022 u zhvillua edicioni i 4 i tij, konkretisht në datat 12- 13- 14- 15 Shkurt. Ai u organizua pranë ambienteve të qendrës "Lulebora", qendra ku zhvillon aktivitetin e saj shoqata e shahut "Vllaznia". Morën pjesë 25 shahistë meshkuj e femra, të moshave të ndryshme për të nxjerrë kampionët në dy kategori dhe kampionin e qytetit. Kampioni i qytetit u shpall Erjon Harusha.
Aktiviteti është transmetuar live gjatë gjithë kohës në të gjitha tavolinat në faqen zyrtare të Drejtorisë së Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit.

### P08130.O1.A5 Shkodra Tennis Tournament

Shkodra Tennis Tounament për vitin 2022 u zhvillua në datat 1-4 dhjetor në mjediset e Adriatic Tenis Park. Aktivitet tashmë i kthyer në traditë organizon edicioin e tij të 13-të. Në terësi morën pjesë 60 sportistë amatorë dhe profesionistë të cilët garuan me njëri tjetrin plot 84 ndeshje. Aktiviteti u zhvillua në 2 kategori: mosha -35; dhe -45; për meshkuj dhe femra.
Aktiviteti kishte rivalitet të fortë pasi pjesëmarrës ishin sportistë të niveleve të larta të cilët luajnë edhe në liga profesioniste në vendet fqinje si Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut etj.
Fitues të aktivitetit u shpallën:
Men Single -45: Fitues Andrian Bleta, finalist Aleksander Konomi.
Men Single -35: Fitues Redi Dabulla, finalist Edi Pelinku.
Women Single: Fituese Elonia Gjata, finaliste Vesa Islami.

Informacion per aktivite shtese: **Kampionati i Pavarësisë:**
Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit ka oraganizuar kampionatin e Pavarësisëmes shkollave të Bashkisë Shkodër në Javën e Pavarësisë. Kampionati u zhvillua në datat 21-22-23 Nëntor dhe u perfshine mbi 750 te rinj e te reja. Ne kete kampionat morën pjesë gjimnazet: "Scutari", "Jordan Misja", "Kolegji Turk", "Maria", "Luce Agraja", "28 Nëntori", "Atë Pjeter Meshkalla", "Shejnaze Juka", "Përparimi", "Arben Broci", "Oso Kuka".
Ky kampionat po kthehet në traditë tashmë për qytetin ku përveç angazhimit të të rinjve në fushën e sportit, shërben edhe për evidentimin e talenteve të reja. Aktiviteti u gjykua për 3 ditë nga 8 arbitra të ndryshëm konform rregulloreve të FSHV. Në këtë kampionat fituan shkollat "Oso Kuka" për djemte dhe shkolla "Atë Pjeter Meshkalla" për femrat.
Ky aktivitet konsiderohet një ndër aktivitetet më masiv rinor dhe sportiv ne Bashkinë e Shkodrës.

**P08130.O2.A1 Administrimi dhe Mirëmbajtje e objekteve/ terreneve sportive në pronësi të Bashkisë Shkodër & të trashëguara**

Janë realizuar pagesat për shërbimin e rojeve dhe shërbimet utilitare si ujë, energji elektrike për stadiumin "*Loro Boriçi*", pallatin e sportit "*Qazim Dervishi*" dhe fushën sportive "*Reshit Rusi*".

Është realizuar dhe mirëmbajtja e rikonstruksioni i sistemit e ndricimit në pallatin e sportit i cili konsistoi në ndryshimin e gjithë projektit të ndriçimit të këtij pallati, shtesën e spoteve dhe të ndriçimit led, duke sjellë respektimin standartet e kërkuara për ndriçim për zhvillimin e ndeshjeve të lojrave me dorë.

Bashkia Shkodër, në zbatim të ligjit për sportin, mbështet zhvillimin e tij nëpërmjet projekteve sportive që shoqatat sportive kanë paraqitur e janë përzgjedhur nga Bashkia për të përfaqësuar Vllazninë në kompeticionet sportive kombëtare dhe ndërkombëtare.

Janë 14 disiplina sportive që mbështeten nëpërmjet 23 ekipeve sportive dhe 500 sportistë të përfshirë në këto ekipe që kontribuojnë në zhvillimin e sportit në Bashkinë tonë.

**P08130.O3.A1 Mbështetje të Ekipi i basketbollit meshkuj të rritur**

Ekipi i Bashketbollit i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Ekipi të rritur (Senior) – Finale të Kampionatit Kombëtar, fitues i vendit të dytë.

**P08130.O3.A2 Mbështetje e ekipit të basketbollit meshkuj të rinj**

Ekipi i basketbollit të të rinjve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Ekipi të rinj – Vend i 3- të në grup.

**P08130.O3.A3 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të rritura**

Ekipi i të rriturve për femra i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Ekipi të rritura (Senior) – Vend i 5- të Kampionat Kombëtar.

**P08130.O3.A4 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të reja**

Ekipi i basketbollit të të rinjve për femra "Vllaznia" përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Ekipi të reja – Kampion Kombëtar.

**P08130.O3.A5 Mbështetje e ekipit të volejbollit meshkuj të rritur**

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Ekipi të rritur (Senior) – Vend i 12- të Kampionat Kombëtar.

**P08130.O3.A6 Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të rritura**

Ekipi i volejbollit të të rriturve për femra përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Ekipi të rritura (Senior) – Vend i 12- të Kampionat Kombëtar.

**P08130.O3.A7 Mbështetje e ekipit të volejbollit meshkuj të rinj**

Ekipi i të rinjve i volejbollit të meshkujve Vllaznia përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Ekipi të rinj – Vend i 2- të Kampionat Kombëtar, fitues i Kupës Rinia.
2. Ekipi para të rinj – Vend i 2- të Kampionat Kombëtar.

### P08130.O3.A8 Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të reja

Ekipi i të rejave i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Ekipi të reja – Finale të Kampionatit Kombëtar, fitues i Kupës Rinia.
2. Ekipi para të reja – Vend i 4- të Kampionat Kombëtar.

### P08130.O3.A9 Mbështetje e ekipit të boksit meshkuj të rritur

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 20 sportistë dhe 2 trajnerë.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Fitues të turneut "Memorial Vllaznia 2022", stërvitje.

### P08130.O3.A10 Mbështetje e ekipit të atletikës meshkuj të rritur

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 11 sportistë dhe 3 trajnerë.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Kampion të Kupës së Shqipërisë, si dhe vazhdon stërvitja intensive për të gjithë ekipet, me fokus sportistët elitarë.

### P08130.O3.A11 Mbështetje e ekipit të Çiklizëm meshkuj të rritur

Ekipi i çiklizmit të të rriturve të Vllaznisë përbëhet nga 12 sportistë dhe 1 trajner.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Ekipi të rritur (Senior)- Vend i 1- rë Servet Kastrati (Trofeu Tirana), Vend i 2- të Bruno Kola (Trofeu Tirana),
2. Ekipi të rritur (Senior)- Vend i 3- të Servet Kastrati (Trofeu "26 Marsi"), Vend i 12- të Bruno Kola (Trofeu "26 Marsi").

### P08130.O3.A12 Mbështetje e ekipit të Gjimnastikës femra të rritura

Ekipi përbëhet nga 10 sportistë dhe 1 trajner.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Stërvitje dhe pregatitje për kompeticionet e vjeshtës.

### P08130.O3.A15 Mbështetje e ekipit të Notit të rritura dhe të rritur

Ekipi përbëhet nga 7 sportistë dhe 1 trajner.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Stërvitje dhe pregatitje për kompeticionet e vjeshtës.

### P08130.O3.A17 Mbështetje e ekipit të Ping- pong të rritur

Ekipi përbëhet nga 7 sportistë dhe 1 trajner.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Stërvitje dhe pregatitje për kompeticionet sipas kalendarit sportiv.

### P08130.O3.A18 Mbështetje e ekipit të Shahut të rritur

Ekipi përbëhet nga 10 sportistë dhe 1 trajner.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Stërvitje dhe pregatitje për kompeticionet sipas kalendarit sportiv.

### P08130.O3.A19 Mbështetje e ekipit të Xhudos për moshat të rritur/ të rritura

Ekipi përbëhet nga 30 të rinj dhe të rritur dhe 3 trajnerë.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Kampion Kombëtar.
2. Pjesëmarrje në kampionatin Ballkanik për Senior 2022 i cili u zhvillua në Pazardzhik (Bullgari). Në datat 16- 17 Korrik, me një pjesëmarrje të gjerë nga shtetet ballkanike. Rreth 123 sportistë nga 9 shtete të Ballkanit (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania dhe Turqia), pjesë e ekipit shqiptar ishin dhe 3 sportistët e Vllaznisë: Roland Vasija- 60 kg (vend i 5- të), Xhovani Shkoza- 73 kg (vend i 7- të), Demian Çuni- 121 kg (vend i 7- të).

**P08130.O3.A21 Mbështetje e ekipit të Xhudos për moshat të rinj/ të reja**

Ekipi përbëhet nga 120 kadetë dhe 2 trajnerë.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Stërvitje dhe pregatitje për kompeticionet sipas kalendarit sportiv.
2. Pjesmarrje ne aktivitetin"Japanese Ambassador's Cup 2022" me keto rezultate:
   Kadet: Ronaldo Toma pasha 60 kg vend i dyte.
   Senior: Kasandra Kovaçi pesha70 kg vend i pare, Roland Vasija pesha 60 kg vend i parë, Markelian Tanushi pesha 100 kg vend i pare

**P08130.O3.A22 Mbështetje e ekipit të Atletikës femra**

Ekipi përbëhet nga 1 sportiste dhe 1 trajner.
Arritjet në këtë 12 mujor janë:

1. Stërvitje dhe pregatitje për kompeticionet sipas kalendarit sportiv.
2. Janë të ngritura ekipet zinxhir të vajzave për moshën U13, U16 dhe U20 (të reja). Kemi një kampione kombëtare për të reja dhe të rritura në garën e kërcimit së gjati: Erisa Rrasa. Në përbërje të ekipeve zinxhir kemi vajza që premtojnë për rezultate të nivelit kombëtar.

**P08130.O3.A23 : Mbështetja e ekipit Futbollit Femra te rritura**

Ndeshjet në Kampionat Kombëtar dhe në Champions League deri më tani të realizuara sipas parashikimeve: 1.Kampionat Kombëtar: Vllaznia -Apollonia 5-0 ; Tirana-Vllaznia 0-3

2. Në ndeshjet e Champions League janë arritur këto rezultate:
Vllaznia-PSG 0-4 ; Vllaznia-Chelsea 0-4 ; Real Madrid-Vllaznia 5-1.

**P08130.O3.A25 Shpërblim për rezultatet në arenën ndërkombëtare për sportistet dhe trajnerët që përfaqësojnë ekipet e Shkodrës**

Në përmbyllje të sezoneve sportive 2021-2022, shoqatat sportive (ekipet) të Vllaznisë që përfaqësojnë qytetin në kompeticione kombëtare dhe ndërkombëtare kanë arritur rezultate të larta.

- Për **Shoqatën Sportive të Atletikës "ATLETIKË VLLAZNIA"** - Franko Burraj Kampion Kombëtar, Franko Burraj Rekordmen Kombëtar, Leandro Çardaku Kampion Kombëtar, Durjon Idrizaj Kampion Kombëtar, Muhamet Çengeli Kampion Kombëtar lekë, Lulzim Çengeli Kampion Kombëtar, Erisa Rrasa Kampione Kombëtare, Bruno Rrotani Trajner Kampion Kombëtar, Bruno Rrotani Trajner Rekordmen Kombëtar, Albert Marashi Trajner Kampion Kombëtar, Dorjan Tafa Trajner Kampion Kombëtar .

- Për **Shoqatën Sportive 'Judo Vllaznia'** - Roland Vasija Kampion Kombëtar, Xhovani Shkoza Kampion Kombëtar,Validia Aliaj Kampione Kombëtare, Kasandra Kovaçi Kampione Kombëtare , Luigj Shkoza Trajner.
- Për **Shoqatën Sportive të Basketbollit Vllaznia** - Kampion Kombëtar U-18 Femra
- Për **Shoqatën e Shkodrës Vllaznia Volleyball** - Kampion Kombëtar U-20 Femra
- Për **Shoqatën e Arteve Marciale Vllaznia Taekwondo** - Kampion Kombëtar.
- Për **Shoqatën Shkodra Tennis** - Kampion Kombëtar

- Shoqata Sportive e Atletikës "***ATLETIKË VLLAZNIA***", është shpallur Kampione Kombëtare në Kampionatin e 84-t të organizuar nga Federata Shqiptare e Atletikës në datat 23-24 maj 2022 në qytetin e Elbasanit. Gjithashtu sportistët e ekipit arritën të vendosnin rekorde kombëtare individuale.



- Shoqata Sportive '***Judo Vllaznia***' mori pjesë në Kampionatin Kombëtar të organizuar nga Federata Shqiptare e Judos më Tiranë në datën 19.03.2022. Ky ekip ka arritur të shpallë 4 kampiona në kategori të ndryshme.



- Shoqata Sportive të Basketbollit "***Vllaznia***" me ekipin e femrave U-18 ka arritur të shpallet Kampion Kombëtar në play-off të realizuar në Përmet nga Federata Shqiptare e Basketbollit në datën 7 maj 2022, duke dalë Kampione mes 15 ekipeve nga i gjithë vendi.
- Shoqata e Shkodrës "***Vllaznia Volleyball***" me ekipin e femrave U-20 ka arritur të shpallet Kampion



Kombëtar në play-off të realizuar në Shkodër nga Federata Shqiptare e Volejbollit në datën 29 maj 2022 duke dalë Kampione mes 14 ekipeve nga i gjithë vendi.




- Shoqata e Arteve Marciale '***Vllaznia Taekwondo***' **,** është shpallur Kampion Kombëtar me ekipet U-16 dhe U-14 në aktivitetet e organizuara nga Federata Shqiptare e Taekwondosë dhe Kampion Ballkanik me ekipin U-16 në turneun e organizuar nga Federata Ballkanike e Taekwondosë.



**-** Shoqata “***Shkodra Tennis***” është shpallur Kampion me sportisten Gresi Bajri në turneun "Tirana Open U16" Tennis Europe Junior Tour e zhvilluar nga Federata Shqiptare e Tenisit në bashkëpunim me Federatën Euriane të Tenisit në Tiranë në datën 7 maj 2022 dhe Kampione Kombëtare në Kampionatin Individual të zhvilluar në Tiranë në data 3-5 Qershor.




**P08130.O4.A2 Salle sportive**

Aktiviteti Salle sportive nuk është realizuar gjatë 12 Mujorit 2022 për arsye se transferimi i fondeve për realizimin e tyre u mor në vendimin nr 45 datë 27.09.2022, me shprehje ligjshmërie në datën 12.10.2022. Ndërprerja e tenderimeve në datën 15 tetor nga APP, ka sjellë pamundësine e tenderimit të fondeve për realizimn e aktivitetit.

**P08130.O4.A3 Ndërtim ambiente sportive**

Ndërtim ambiente sportive nuk është realizuar gjatë 12 Mujorit 2022 për arsye se transferimi i fondeve për realizimin e tyre u mor në vendimin nr 45 date 27.09.2022, me shprehje ligjshmërie në daten 12.10.2022. Ndërprerja e tenderimeve në datën 15 tetor nga APP, ka sjellë pamundesine e tenderimit te fondeve per realizimn e aktivitetit.

## Programi 08220:Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

2- Aparatin e Bashkisë.
3- Degën Ekonomike të Kulturës.
4- Teatrin Migjeni.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i programit Shërbimet kulturore është:

- Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

- Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

- Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave dhe ambienteve për lexim me qëllimin e edukimit të përgjithshëm të qytetarëve.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2022 kanë qenë:

O1: Vlerat e trashëgimisë kulturore të ruajtura dhe të promovuara si dhe institucione menaxhuese të mirëadministruara.

O2: Institucionet kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës të fuqizuara.

O3: Jetë kulturore të gjallëruar nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve artistike dhe kulturore përgjatë gjithë vitit.

O4: Shërbime cilësore pranë Bibliotekës "*Marin Barleti*" për promovimin dhe nxitjen e leximit si instrument edukimi.

O4: Fondi i bibliotekës "*Marin Barleti*" i mirëadministruar dhe i pasuruar.

## Realizimi i buxhetit të planifikuar:

*000/leke*

| Programi 08220 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| PBA 2022 | 45,909 | 44,780 | 5,132 | 1,754 | 97,575 |
| Plani fillestar 2022 | 58,765 | 53,133 | 6,782 | 1,871 | 120,551 |
| Plani i rishikuar 2022 | 57,445 | 46,760 | 6,992 | 1,754 | 112,951 |
| Realizimi viti 2022 | 45,119 | 37,581 | 5,755 | 1,409 | 89,863 |
| % e realizimit | 78.5% | 80.4% | 82.3% | 80.3% | 79.6% |

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 79.6 %, sipas zërave kryesorë më poshtë:

| | |
|---|---|
| Shpenzime korente | 79.5% |
| Shpenzime kapitale | 80.3% |

**Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara**:

Faktori kryesor që ka ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave të planifikuara është situata e vështirë post- pandemike e cila filloi të lehtësohet dukshëm në muajt mars dhe prill 2022.
Një ndër faktorët shumë pengues në realizimin e shpenzimeve operative dhe atyre të investimeve janë procedurat e prokurimit, zgjatja shumë në kohë deri në përfundimin dhe nënshkrimin e kontratave përkatëse.
Ndërkohë Teatri Migjeni ka arritur të realizojë aktivitetet e planifikuara në këto muaj ku bie në sy pjesëmarrja e artdashësve në shfaqjen e konkursit teatror të shkollave të mesme, varietesë "*Big Brother Vip Shkodra*", në konkursin "*Pjetër Gaci*" dhe në festivalin e këngës popullore shkodrane "*Pranverë me këngë*".
Muzeumet i kanë shërbyer një numri gjithnjë e në rritje të vizitorëve, gjë që u reflektua dhe në një numër gjithnjë e më të lartë të biletave të shitura.

**Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit**

**Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022**

| **Kodi i Programit** | **8220** | **Emertimi i programit:** | **Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore** | | | | | | **Komente** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qellimi 1** | Menaxhimi dhe administrimi i institucioneve kulturoro- artistike, aseteve të trashigimisë kulturore, duke risjellur në vëmendjen e vizitorëve vlerat dhe pasuritë që disponohen, ndër më të pasurat në vendin tonë si në sektorit arkeologjik, etnografik, historik, te fotografise, muzikës, teatrit etj. Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme të territorit të Bashkisë së Shkodrës. Zbulimin dhe zhvillimin e talenteve në fushën e artit, sportit, si dhe edukimi dhe përçimi i vlerave kulturore dhe sportive do te jete nje nga politikat e programit. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve. | | | | | | | | |
| | | | ****Treguesit e performancës/Produktet:** | | | | | | |
| ***Objektivat e politikës*:** | | **Kodi i Treguesit te Performances/Produktit** | **Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit** | **Niveli faktik i vitit paraardhes** | **Niveli i planifikuar ne vitin korent** | **Niveli i rishikuar ne vitin korent** | **Niveli faktik ne fund te vitit korent** | **% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit** | |
| ***Objektivi 1*** | Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe mireadministrimi e fuqizimi i institucioneve menaxhuese | 1 | Numri i shfaqjeve kulturore; artistike për trashëgiminë kulturore, të mbështetura me fondet e bashkisë | 16 | 16 | 16 | 32 | 200% | |
| | | 2 | Numri i aktiviteteve rreth informimit dhe promovimit te trashegimise kulturore ne komunitet. - Muzeu Oso Kuka | 6 | 7 | 7 | 7 | 100% | |
| | | 3 | Numri i guidave dhe materialeve promovuese | 1 | 1 | 1 | 1 | 100% | |
| | | 4 | Numri i materialeve promovuese fletëpalosje të prodhuara. | 3500 | 4000 | 4000 | 4000 | 100% | |
| | | 5 | Numri i aktiviteteve për promovimin e vlerave të Muzeut të Dëshmisë dhe Kujtesës. | 8 | 8 | 8 | 8 | 100% | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 6 | Numri i muzeve. | 6 | 6 | 6 | 6 | 100% | |
| | | | | | | | | | |
| ***Objektivi 2*** | Ruajtja, mirëadministrimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekes Marin Barleti | 7 | Numri i fondit të librave të pasuruar | 602 | 900 | 900 | 365 | 41% | |
| | | 8 | Numri i anëtareve të rregjistruar në Bibliotekë | 4,800 | 5,000 | 5,000 | 2,500 | 50% | |
| | | 9 | Fondi per Administrimi dhe menaxhimi i Degës ekonomike të kulturës në mijë lekë | 19,730 | 22,811 | 29,392 | 22,262 | 76% | |
| | | 10 | Numrat e revistes Gegnia | 3 | 3 | 3 | 3 | 100% | |
| | | 11 | Numri i shkrimtareve të ftuar | 8 | 8 | 8 | 8 | 100% | |
| | | 12 | Numri i të rinjve pjesmarrës. | 400 | 420 | 420 | 350 | 83% | |
| | | | | | | | | | |
| ***Objektivi 3*** | Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës. Përmirësimi i mjediseve për zhvillimin e aktiviteteve artistike, rikonstruksione të ambjenteve ndihmëse në institucionet e ndryshme të kulturës | 13 | Fondi Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit “Migjeni” në mijë lekë | 29,052 | 33,999 | 39,684 | 31,729 | 80% | |
| | | 14 | Numri i shfaqjeve në bandën frymore | 10 | 17 | 17 | 19 | 112% | |
| | | 15 | Numri i aktiviteteve kulturore të Bashkisë Shkodrës | 89 | 96 | 95 | 95 | 100% | |
| | | 16 | Numri i shfaqjeve te Teatrit Migjeni | 216 | 242 | 244 | 244 | 100% | |
| | | 17 | Numri i aktiviteteve përkujtimore dhe java e festave te nentorit | 2 | 7 | 7 | 2 | 29% | |
| | | 18 | Numri i ekspoziitave të përbashkëta, ekspozitave personale, dhe numri workshopeve | 8 | 8 | 8 | 4 | 50% | |
| | | 19 | Takime publike për promovimin e artisteve | 8 | 8 | 8 | 4 | 50% | |
| | | 20 | Numri i kinemave në qytetin e Shkodrës | 1 | 1 | 1 | 1 | 100% | |

## ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore | Kodi i Programit | 8220 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kodi** | **Emërtimi i Produktit** | **Njësia matëse** | **Sasia Faktike (sipas vitit 2021)** | **Shpenzimet (sipas vitit 2021)** | **Kosto për Njësi (sipas vitit 2021)** | **Sasia (sipas planit të vitit 2022** | **Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022)** | **Kosto për Njësi (sipas planit të viti 2022)** | **Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022)** | **Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022** | **Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022)** | **Sasia Faktike (viti 2022)** | **Shpenzimet Faktike (viti 2022)** | **Kosto për Njësi Faktike (viti 2022)** | **V = IV - I** | **V = IV - II** | **V = IV - III** | **Komente** |
| 1 | Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimise kulturore. | numri i shfaqjeve kulturore; artistike për trashëgiminë kulturore | 16 | 967 | 60 | 16 | 1,759 | 109.9 | 16 | 1,794 | 112.1 | 32 | 1,314 | 41.1 | -19.4 | -68.9 | -71.1 | |
| 2 | Fondi i bibliotekës Marin Barleti i ruajtur, i mirëmbajtur, i mirëadministruar dhe i pasuruar. | numri i fondit të librave të rinj. | 602 | 697 | 1.2 | 900 | 1,100 | 1.2 | 900 | 1,100 | 1.2 | 365 | 847 | 2.3 | 1.2 | 1.1 | 1.1 | |
| 3 | Menaxhimi dhe mirëadministrimi i strukturave të | numri i strukturave | 5 | 19,730 | 3,946 | 5 | 22,811 | 4,562 | 5 | 29,392 | 5,878 | 5 | 22,262 | 4,452 | 506 | -110 | -1,426 | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | institucionit Dega Ekonomike e Kulturës | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| **4** | Pjesëmarrje aktive e qytetarëve në aktivitetet kulturore | numri pjesëmarrësve | 400 | 570 | 1 | 420 | 638 | 2 | 420 | 638 | 2 | 350 | 587 | 2 | 0 | 0 | 0 | |
| **5** | Menaxhimi dhe mirëadministrimi i strukturave të institucionit Teatrit "Migjeni" | numri i strukturave | 2 | 29,052 | 14,526 | 2 | 33,999 | 17,000 | 2 | 39,684 | 19,842 | 2 | 31,729 | 15,865 | 1,339 | -1,135 | -3,978 | |
| **6** | Aktivitete kulturore artistike përgjatë gjithë vitit në bashkinë Shkodër | numri i aktiviteteve | 265 | 26,664 | 101 | 287 | 33,368 | 116 | 377 | 36,843 | 98 | 366 | 29,624 | 81 | -20 | -35 | -17 | |
| **7** | Aktivitete në festivalin e filmit "Ekrani i Artit" | Numri i aktiviteteve | 0 | 0 | 0 | 10 | 3,500 | 350 | 10 | 3,500 | 350 | 15 | 3,500 | 233 | 233 | -117 | -117 | |
| **8** | Administrimi dhe menaxhimi Kinemasë Shkodër | Numri i kinemave të administruara | 0 | 0 | 0 | 1 | 400 | 400 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | -400 | 0 | |

## Realizimi i aktiviteteve për periudhën 12- mujore 2022:

Për vitin 2022, në programin Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe për përmbushjen e objektivave të caktuara, janë parashikuar aktivitetet si më poshtë:

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | 000/leke | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Totali | | |
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| **P08220.O1 .A1 "Java e Pavarësisë" Ekspozitë me karakter historik dhe artistik** | DEK | Realizuar | 80 | 80 | 35 |
| **P08220.O1.A2. Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve.** | DEK | Realizuar | 60 | 60 | 30 |
| **P08220.O1.A3 Mbështetje për funksionimin dhe shëbimin në vazhdimësi të muzeut historik.** | DEK | Realizuar | 1,489 | 1,489 | 1,135 |
| **P08220.O1.A4. Materiale promocionale për rrjetin muzeal.** | DEK | Realizuar | 60 | 95 | 95 |
| **P08220.O1.A5 Publikime promocionale, fletepalosje e guidë për Vendin e Deshmisë e Kujtesës** | DEK | | - | - | - |
| **P08220.O1.A6 . Cikël takimesh dhe bisedash mbi historinë dhe të kaluarën e Shqipërisë dhe Shkodrës në veçanti** | DEK | Realizuar | 70 | 70 | 20 |
| **P08220.O1.A7.Muzeu I Arteve Pamore " Lin Delija "** | Bashkia Shkodër | | - | - | - |
| **P08220.O1.A8.Muzeu Etnografik në Shkodër** | Bashkia Shkodër | | - | - | - |
| **P08220.O2.A1 Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës** | DEK | Realizuar | 1,100 | 1,100 | 847 |
| **P08220.O2.A2 Administrimi dhe menaxhimi i Degës ekonomike të kulturës & te trasheguara** | DEK | Realizuar | 22,811 | 29,392 | 22,262 |
| **P08220.O2.A3 Periodiku Gegnia** | DEK | Realizuar | 438 | 438 | 432 |
| **P08220.O2.A4 Festivali letrar i Shkodrës** | DEK | Realizuar | 110 | 110 | 65 |
| **P08220.O2.A5 Të shkruajmë për të rinj.** | DEK | Realizuar | 30 | 30 | 30 |
| **P08220.O2.A6 Aktivitete studimore rreth personaliteteve të shquara të artit e kulturës.** | DEK | Realizuar | 60 | 60 | 60 |
| **P08220.O3.A1 Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit "Migjeni" & Te trasheguara** | Teatri Migjeni | Realizuar | 33,999 | 39,684 | 31,729 |
| **P08220..O3.A2 Orkestra Frymore Honorare vjetore & Te trasheguara** | Teatri Migjeni | Realizuar | 4,532 | 5,583 | 3,852 |
| **P08220.O3.A3 Grupi orkestror i Qendrës** | Teatri Migjeni | Realizuar | 1,100 | 1,355 | 850 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kulturore.** | | | | | |
| **P08220.O3.A4 Çmimi “Pjetër Gaci” & Te trasheguara** | Teatri Migjeni | Realizuar | 1,309 | 1,309 | 912 |
| **P08220.O3.A5 “Ahengu Shkodran”** | Teatri Migjeni | Realizuar | 520 | 520 | 494 |
| **P08220.O3.A6 “Honorare " Grupi i Valleve” & Te trasheguara** | Teatri Migjeni | Realizuar | 720 | 903 | 612 |
| **P08220.O3.A7 Festivali i Këngës Qytetare “Luleborë”.** | Teatri Migjeni | Realizuar | 5,545 | 5,545 | 5,545 |
| **P08220.O3.A8 “Koncert – Premierë e Orkestrës Frymore”** | Teatri Migjeni | Realizuar | 392 | 392 | 315 |
| **P08220.O3.A9 “Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare”** | Teatri Migjeni | Nuk eshte realizuar. | 320 | - | - |
| **P08220.O3.A10 Festival burimor** | Teatri Migjeni | Realizuar | 200 | 200 | 170 |
| **P08220.O3.A11 Dita ndërkombetare e Jazz-it** | Teatri Migjeni | | - | - | - |
| **P08220.O3.A12 Dita e Luleve 6 Maj** | Teatri Migjeni | Realizuar | 500 | 820 | 660 |
| **P08220.O3.A13 Ndërmendje** | Bashkia Shkoder | Realizuar | 1,100 | 2,180 | 1,080 |
| **P08220.O3.A14 Aktivitete me rastin e 2 Prillit** | Bashkia Shkoder | Realizuar | 270 | 270 | 170 |
| **P08220.O3.A15 Festival Jazz-i.** | Bashkia Shkoder | Realizuar | 2,500 | 2,500 | 2,500 |
| **P08220.O3.A16 Koncertet e Veres** | Teatri Migjeni | Realizuar | 600 | 1,270 | 1,042 |
| **P08220.O3.A17 Karnavalet** | Bashkia Shkoder | Realizuar | 500 | 500 | 500 |
| **P08220.O3.A18 Shkodra n'fest** | Bashkia Shkoder | ne proces likuidimi | 590 | 590 | - |
| **P08220.O3.A19 Dita ndërkombëtare e Muzikës.** | Teatri Migjeni | Realizuar | 500 | 230 | 196 |
| **P08220.O3.A20 “Festa eTrashëgimisë Kulturore”** | Bashkia Shkoder | Realizuar | 800 | 800 | 800 |
| **P08220.O3.A21 Ditët e Kosovës.** | Bashkia Shkoder | | - | - | - |
| **P08220.O3.A22 Pjesë Teatrore 1** | Teatri Migjeni | Realizuar | 1,500 | 1,500 | 1,290 |
| **P08220.O3.A23 Pjesë Teatrore 2** | Teatri Migjeni | Realizuar | 2,150 | 2,150 | 1,843 |
| **P08220.O3.A24 Pjesë Teatrore 3** | Teatri Migjeni | Realizuar | 1,200 | 1,200 | 1,035 |
| **P08220.O3.A25 Variete** | Teatri Migjeni | Realizuar | 1,700 | 1,700 | 1,460 |
| **P08220.O3.A26 Shfaqje për fëmije+Teatri i kukllave** | Teatri Migjeni | Realizuar | 1,000 | 1,000 | 850 |
| **P08220.O3.A27 Pranverë me këngë . Festivali i kenges popullore shkodrane** | Teatri Migjeni | Realizuar | 1,655 | 1,655 | 1,407 |
| **P08220.O3.A28. Festival teatri me shkollat e mesme.** | Teatri Migjeni | Realizuar | 500 | 925 | 425 |
| **P08220.O3.A29 Honorare Aktoret eTeatrit teKukullave.** | Teatri Migjeni | Realizuar | 500 | 500 | 425 |
| **P08220.O3.A30 Lëvizja e Postribës** | Bashkia Shkoder | Realizuar | 30 | 30 | 30 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **P08220.O3.A31 . Ekspozita “Salloni i vjeshtës ”** | DEK | Realizuar | 490 | 514 | 495 |
| **P08220.O3.A32 Cmimi Idromeno.** | DEK | Realizuar | 420 | 444 | 427 |
| **P08220.O3.A33 . “Personazh i ftuar”- Ekspozitë personale e një personaliteti të artit pamor shqiptar të ftuar nga Galeria e Arteve e Shkodrës.** | DEK | Realizuar | 165 | 198 | 181 |
| **P08220.O3.A34 .Takimet publike -bisedat publike mbi artin dhe workshop me artistë të rinj** | DEK | Realizuar | - | - | - |
| **P08220.O3.A35 Programet të edukimit artistik në partneritet individe dhe shoqata kulturore.** | DEK | Realizuar | 60 | 60 | 57 |
| **P08220.O3.A36. Administrimi dhe menaxhimi i Kinemasë Shkodër** | Teatri Migjeni | Nuk eshte realizuar. | 400 | - | - |
| **P08220.O3.A37. Ekrani i artit : festivali i filmit ne Shkoder** | Bashkia Shkoder | Realizuar | 3,500 | 3,500 | 3,500 |
| **8220 Trashëgimia kulturore, monumentet, kopshtet zoologjike e botanike dhe bibliotekat** | | | **97,575** | **112,951** | **89,863** |
| **Te trasheguara** | | | **22,976** | **-** | **-** |
| **Totali** | | | **120,551** | **112,951** | **89,863** |

## Përshkrimi i aktiviteteve:

**P08220.O1 .A1: Java e Pavaresisë " Ekspozitë me karakter historik dhe artistik”**

Me rastin e 110 vjetorit të Pavarësisë Kombëtare, Muzeu Historik Shkodër sjelli për publikun një veprimtari me dy përmasa kushtuar Kolë Idromenos.

Së pari ekspozitën "Dritëshkronja e Kolës" duke sjellë disa fotografi të vetë autorit nga fillimshekulli XX, të papublikuara më parë, dhe së dyti, studiuesja Eleni Laperi promovoj librin e saj “Kolë Idromeno, themelues i artit realist shqiptar”. E zgjodhëm figurën e Kolë Idromenos në këtë përvjetor të Pavarësisë sepse ai me veprën e tij të shumëllojshme artistike hodhi bazat e artit pamor shqiptar si një pikëvështrim origjinal drejtuar botës shqiptare. Aktiviteti u zhvillua me datë 26 nëntor, ora 17.00.

**P08220.O1 .A2:Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve**

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, përmes disa orëve trajnimi me studentë të Fakultetit të Arteve, stafi i muzeut së bashku me perfaqesuesin e DRTK Shkodër, Petrit Bilali, në datat 10,13 dhe 18 Maj zhvilluan teknikën e pastrimit të gjetjeve arkeologjike si dhe teknikën e gdhëndjes në gur. Fuqia e Muzeut - si vend unik i eksplorimit, na mëson për të kaluarën dhe na frymzon për ide të reja. Këto dy hapa janë thelbësorë në ndërtimin e një të ardhme më të mirë. Ky impakt sillet përmes tre objektivave:

1. Fuqia e zhvillimit të qëndrueshëm.
2. Fuqia e inovacionit në dixhitalizim dhe aksesueshmëri.

3. Fuqia e formimit të komunitetit përmes edukimit.
Këto tre objektiva janë një shtyllë e fortë e së ardhmes, ku edukimi në trashegiminë kulturore mbart vlerën kryesore këtë vit për Muzeun Historik Shkodër. Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me Universitetin Luigj Gurakuqi dhe DRTK Shkodër.

**P08220.O1.A3: Mbështetje për funksionimin dhe shëbimin në vazhdimësi të muzeut historik**

Kjo fishë synon të realizojë shpenzime mirëmbajtje dhe /ose rutinë për mirëfunksionimin e muzeve.
Prodhimi dhe shtypja e biletave të muzeut është në proces shtypje.

**P08220.O1.A4: Materiale promocionale për rrjetin muzeal.**

Është në proçes specifikimesh teknike realizimi i Guidës dhe fletëpalosjes të Muzeut Historik.

**P08220.O1.A5: Publikime promocionale, fletëpalosje e guidë për Vendin e Dëshmisë e Kujtesës.**

Realizohet 1 herë në 2 vite, dhe këtë vit nuk ka qënë i planifikuar të realizohet.

**P08220.O1.A6 : Cikël takim bisedash mbi të kaluarën e Shqipërisë dhe Shkodrës në veçanti.**

Me datën 8 korrik, ora 10:30 u zhvillua në "*Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës*" një aktivitet informues rreth historisë së diktaturës komuniste në Shqipëri. Tema e prezantuar këtë ditë titullohej "*Gjyqi Special: Trokitja e Terrorit Komunist*". U moderua nga historiani i muzeut Xherardo Nikjari. Aktiviteti u ndoq nga një publik historidashës dhe u përcoll me interes të lartë prej tyre.

Me datën 14 shtator, në datën e vdekjes së poetit italian Dante Alighieri, njërës prej figurave më themeltare në kulturën italiane dhe atë europiane, në ambientet e "Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës" u organizua një aktivitet i dyfishtë. Në pjesën e parë u çel një ekspozitë fotografike me 14 portrete të figurave kulturore shkodrane, të cilat krijimtarinë e tyre artistike ia kushtuan kulturës italiane ose pas përfundimit të studimeve të tyre në Itali u kthyen në Shqipëri për të dhënë kontributin e tyre për zhvillimin e atdheut, por pas ardhjes në pushtet të diktaturës komuniste u përndoqën ashpërsisht.

Në pjesën e dytë të aktivitetit, nisur edhe nga domethënia e datës historike, "*Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës*" ftoi përkthyesin e ri të veprës kryesore të Dantes, Komedia Hyjnore, Z. Meritan Spahija. Ky i fundit promovoi përkthimin e pjesës së parë të Komedisë Hyjnore, Ferri. Moderimi i këtij aktiviteti të dytë kulturor u realizua nga shkrimtari Zija Vukaj. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin nxënësit e Gjimnazit "Jordan

Misja" dhe shkrimtarë të tjerë nga Shoqata e Shkrimtarëve të Shkodrës. Aktiviteti i dytë u ndoq nga mediat lokale dhe zgjati nga ora 11:10-12:05.

Më datën 25 nëntor u organizua një aktivitet studimor pranë "Vendi të Dëshmisë dhe Kujtesës" me të rinjtë e Qendrës Rinore Atelie, Shkodër. Gjithashtu të rinjtë nën drejtimin e përgjegjësit të muzeut, Pjerin Mirdita, zhvilluan diskutime dhe reflektime mbi të shkuarën komuniste. Vëmendja u përqëndrua mbi zhdukjen e elitave dhe mbi shtypjen e lirive themelore të njeriut gjatë diktaturës komuniste. Të rinjtë u njohën edhe me punën e përditshme të stafit në muze që është në shërbim të vizitorëve, edukimit dhe punës shkencore.

**P08220.O2.A1: Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës**

Zhvillimi dhe pasurimi i blibliotekes me libra të rinj është një nga synimet parësore të institucionit tonë. Është një nga aktivitetet më të rëndësishme të Bibliotekës i cili synon pasurimin me libra dhe shtypin e shkruar sa më bashkohorë dhe të rëndësishëm, tituj të cilët zgjedhen me kujdes nga stafi i bibliotekës, në bazë të kërkesave të lexuesve dhe botimeve të fundit.
Janë blerë 354 tituj libra të rinj (800 kopje në gjithsej). Vazhdon proçesi i katalogimit dhe përpunimi fizik i librave sipas fondeve përkatëse.

**P08220.O2.A2**: **Administrimi dhe menaxhimi i Degës Ekonomike të Kulturës.**

Janë realizuar pagesat për pagat e personelit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore si dhe shpenzime për shërbime nga të tretë. Është lidhur kontrata vjetore për shërbimin telefon dhe internet.
Janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore për 29 punonjës të DEK për periudhën 12-Mujore.
Janë kryer pagesat e shërbimeve ndaj të tretëve. Është realizur blerja e materialeve patrimi/sanitare. Shpenzime mirëmbajtje ndërtese biblioteka. Jane realizuar punime mirëmbajtje në godinën e Bibliotekës "*Marin Barleti*". Janë riparuar ambjente sanitare, të dyshemesë së drurit në pjesën e jashtme të Bibliotekëes, riparim i oborrit të brendshëm të godinës, zevendësime të perdeve të sallave, etj. Është kryer pagesa për Siguracionin Ndërtesës. Hostim, web për 4 faqet web. Shpenzime tjera operative për ndriçimin. Shpenzime mirëmbajtje për eleminimn e lagështisë te ndërtesa Galeria e Arteve. Gjithashtu janë blerë dhe Blerje paisje TIK.

**P08220.O2.A3**: **Periodiku Gegnia**
Është realizuar mbledhja e materialeve për botimin e parë të revistës. Redaksia ka përzgjedhur dhe klasifikuar artikujt. Këtë vit janë publikuar 3 numra të revistës "*Gegnia*".
Çdo numër i revistës "*Gegnia*" përmban 18 artikuj të ndarë në 8 rubrika: Albanologji, Trashëgimi Kulturore, Histori, Letërsi, Arkiv, Kronikë, Bibliografi, In Memoriam. Fokusi i tematikave është kryesisht zona e Shkodrës. Vazhdon puna për përgatitjen e numrit 18 të revistës.

**P08220.O2.A4**: **Festivali Letrar i Shkodrës**

**Festivali Letrar i Shkodrës edicioni XV, u zhvillua me datat 22, 29 tetor, dhe 4 dhe 25 nëntor** në sallat e Bibliotekës "Marin Barleti" ku ishin ftuar shkrimtarë të njohur shqiptarë dhe të huaj. Këto takime ishin konceptuar në formën e një bashkëbisedimi për veprat e autorëve, por edhe për çështje dhe sfida të letërsisë dhe të artit bashkëkohor.

***Takimi i datës 22 tetor pati si protagonistë autorët Gani Jakupi dhe Jorge González*** të famshëm me krijimtarinë e tyre letrare e artistike, sidomos në gjininë e romanit grafik.
Pasi foli mbi romanin grafik dhe perspektivat e tij në tregun e librit, autori Gani Jakupi prezantoi romanin e fundit "Kthimi në Kosovë".
Libri sjell një rrëfim ndryshe të autorit Jakupi për luftën në Kosovë, ilustruar mjeshtërisht nga Jorge Gonzalez. Ai mbart në vetvete një mesazh të fuqishëm paqeje.
Bisedën me shkrimtarin Gani Jakupi e zhvilloi gjuhëtari i njohur nga Prishtina, Gazmend Berlajolli i cili është edhe përkthyesi i librit nga gjuha frënge.

***Takimi i datës 29 tetor kishte të ftuar autorin Alfred Çapaliku***, poet, studiues dhe pedagog pranë Universitetit të Shkodrës. Gjatë bisedës u trajtuan aspekte rreth krijimtarisë së autorit dhe mendimet e tij për sfidat e letërsisë bashkëkohore sidomos në nxitjen e talenteve të reja në fushën e letersisë. Me këtë rast autori prezantoi librin e tij të fundit "Atje larg, këtu afër" për të cilin ai shprehet se shpalos një dimension të ri që ka marrë poezia e jonë sot.
Aktorët Agron Dizdari dhe Drande Xhai interpretuan me mjeshtri disa nga poezitë e librit në fjalë duke krijuar një atmosferë të veçantë në këtë veprimtari letrare.
Takimi u moderua nga Maxhid Cungu, drejtor i Bibliotekës.

***Në bisedën e datës 4 nëntor, protagonist ishte shkrimtarin dhe dramaturgun e mirënjohur nga Prishtina, Jeton Neziraj***. Biseda u fokusua rreth krijimtarisë e tij të pasur në fushën e dramaturgjisë por edhe në opinionet rreth problematikave që ka teatri shqiptar sot.
Neziraj është autor i mbi 20 pjesë teatrale.
Shkrimet dhe dramaturgjia e tij janë përkthyer në më shumë se 10 gjuhë të ndryshme.
Të pranishmit të cilët ishin kryesisht pedagogë të letërsisë, gjimnazistë dhe miq të përhershëm të Bibliotekës, drejtuan pyetje dhe ndoqën me interes përgjigjet dhe komentet e autorit për dramaturgjinë bashkëkohore. Biseda u moderua nga dr. Ermira Alija.

***I ftuar në takimin e katërt me datën 25 nëntor ishte shkrimtari Visar Zhiti*** i cili me këtë rast prezantoi edhe librin e tij të fundit "Këpuca e aktorit".
Ky roman shtrihet në tre periudha të historisë së Shqipërisë, është një sagë familjare dhe përfshin personazhe fiksionalë dhe realë. Gjatë bisedës së tij për çështjet aktuale që lidhen me letërsinë, Zhiti shprehet se shkrimtarët kanë misionin e veçantë për të dhënë artistikisht realitetin e shoqërisë shqiptare në kohë të ndryshme.
Ndërmjet tjerash ai shprehet i lumtur që prezanton librin e tij në qytetin ku është diplomuar.
Në fund të këtij takimi që shënon edhe mbylljen e Festivalit të 15-te Letrar të Shkodrës, drejtori i Bibliotekës, Maxhid Cungu, falenderoi pjesëmarrësit dhe theksoi se ky Festival

zgjeroi pjesëmarrjen e shkrimtarëve nga vende të tjera dhe pati risi përsa i përket shumëllojshmërisë së zhanreve letrare që u paraqitën gjatë zhvillimeve të tij.

**P08220.O2A5: Të shkruajmë për të rinj.**

Me datën 12 mars filloi projekti i trajnimit i cili ka për qëllim nxitjen e talenteve të reja në fushen e Letërsisë, i cili zgjati 3 muaj. Objektivat kryesore të këtij projekti kanë qënë Zhvillimi i kreativitetit dhe aftësive të të shkruarit të letërsisë artistike tek të rinjtë, në veçanti te nxënësit e shkollave të mesme të qytetit tonë si dhe Afrimi i të rinjëve në Bibliotekën "*Marin Barleti*", nxitja e interesit për letersinë dhe librin;

Pjesëmarrës në këto trajnime janë rreth 60 nxënës të shkollave të mesme të Bashkisë Shkodër, të cilët janë identifikuar parapraksht nga mësuesit e tyre për prirje të veçanta për krijimtari në fushen e letersisë. Projekti shërben edhe si një ndihmesë për mësuesit e letërsisë për të rritur frymën e interesimit dhe vëmendjes së nxënësve për lëndën e letërsisë. Lektor në këtë projekt është Prof. Alfred Çapaliku.

***Info shtesë*** :

**Prezantim i librit "*Gjakmarrja në prozën shqipe*", i studiuesit Eduard Grishaj**

Në përkujtim të 1-vjetorit të ndarjes nga jeta të Eduard Grishaj (ish punonjës pranë Muzeut Historik Shkodër) në Bibliotekën "*Marin Barleti*" u promovua libri "*Gjakmarrja në prozën shqipe*", i lënë në dorëshkrim nga autori. Ky libër sjell një studim të mirfilltë përsa i përket kanunit dhe si dhe ndikimit qe ka pasur në letërsinë Shqipe. Aktiviteti i ndoq nga 60 pjesëmarrës.

**Veprimtari me rastin e 23 prillit, Dita Botërore e Librit.**

Me rastin e 23 prillit, Dita Botërore e Librit, Biblioteka "Marin Barleti" organizoi hapjen e ekspozitës " Shtypshkrimi në Shkodër" e cila përmban ekzemplarë që ruhen në fondin e bibliotekës tone si: libra, revista, gazeta dhe materiale të tjera të shtypura në vite në shtypshkronjat e Shkodërs.

Përveç vlerave të çmuara historike, shoqërore, fetare, filozofike që mbartin këto materiale, ato janë gjithashtu një dëshmi e përkushtimit atdhetar të një plejade intelektualësh por edhe e mjeshtrave tipografe që i krijuan dhe i zhvilluan ndër vite.

Ekspozita qëndroi e hapur deri me datën 10 maj. Gjatë kësaj kohe pati rreth 320 vizitorë.

**Prezantim ilibrit "*Mollat e vjetit te ri, dromca kujtimesh*", të autorit Filip Guaraziu**

Biblioteka "Marin Barleti" në bashkëpunim me Institutin e Studimeve për krimet e pasojat e komunizmit organizoi prezantimin e librit "Mollat e vjetit te ri, dromca kujtimesh", të autorit Filip Guaraziu me datën 28 maj. Libri ka karakter autobiografik por në masën më të madhe ai përgjithëson ngjarjet, fenomenet që u zhvilluan gjatë diktaturës në Shqipëri, duke na dhënë një tablo reale të asaj që ka ndodhur.Në veprimtari folën Gjetë Voci, shkrimtar, Çelo Hoxha, Drejtor i Institutit të Sudimit të Krimeve të Komunizmit, ish të përndjekur nga diktatura dhe vetë autori Guraziu.

**Promovimi i librit "*Mahmud Pashë Bushati*", i autorit Prof. dr. Fedhon Meksi**

Në Bibliotekën "Marin Barleti" u zhvillua promovimi i librit "*Mahmud Pashë Bushati*", i autorit Prof. dr. Fedhon Meksi me datën 14 maj.Ky është libri i parë monografik që i kushtohet jetës dhe veprimtarisë së Mahmud Pashës si një nga personalitetet më të rëndësishëm në historinë e lëvizjes shqiptare për pavarsi.Përveç autorit Fedhon Meksi, në këtë veprimtari folën edhe autori i parathënjes së librit, Dr. Ardian Muhaj, z Jani Malo, botues, z. Gjovalin Çuni, studiues, bibliograf si dhe pjesëmarres të tjerë.

**Promovim i librit "*Lumi i dhimbjes time*" i shkrimtarit Berhan Kurtaj**

Me datë 27 maj në bashkëpunim me Shoqatën e Shkrimtarëve u promovua libri "Lumi i dhimbjes time" i shkrimtarit Berhan Kurtaj. Ky është vëllimi i tretë me poezi i autorit dhe u vlerësua nga referuesit: Zija Vukaj, Kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve, Xhahid Bushati, shkrimtar, etj.

**P08220.O3.A1**: **Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit "Migjeni"**

Institucioni i Teatrit "Migjeni" në strukturën e tij përbëhet prej 37 punonjesish. Janë realizuar pagesat për Pagat e personelit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore si dhe shpenzime për shërbime nga të tretë(Energji,ujë). Janë realizuar shpenzimet për Pritje – përcjellje; Printime dhe publikime; si dhe për udhëtime brenda vendit që trupa e teatrit ka ndërmarrë.

**P08220.O3.A2**: **Orkestra Frymore Honorare vjetore**

Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike unikale që ka qyteti ynë. Janë mbështetur me honorare për 12 muajt e parë të vitit ky formacion që përbëhet prej 40 muzikantëve.

**P08220.O3.A3 Grupi orkestror i Qendrës Kulturore**

Janë kryer pagesat mujore për Grupin Orkestror të qendrës "Pjetër Gaci".

**P08220.O3.A4 Çmimi "Pjetër Gaci"**

Konkursi Pjeter Gaci, Edicioni i XXI-te u zhvillua ne datat 3-5 Maj 2022. Konkursi u zhvillua njëkohësisht në tre salla të ndryshme: Teatër Migjeni, Galeria e Arteve dhe Salla Gjon Kapidani. Informacionet për këtë aktivitet iu dërguan të gjitha shkollave artistike në Shqipëri, Mal i Zi, Kosovë, Maqedoni, Itali, Slloveni, Austri, Kroaci, etj. Informacionet u dërguan me poster dhe elektronikisht dy muaj përpara datës së fundit të rregjistrimit, e cila ishte 27 Prill 2022.

Mundësia e një mbi 50 % e pjesmarreve kanë qënë aplikues nga rajoni dhe më gjerë. Të gjitha aplikimet janë bërë nëpërmjet faqes së internetit të konkursit: www.pjetergaci.al

Në këtë edicion kanë aplikuar 170 konkurentë.

Juria e këtij edicioni:

**Piano:** Lejla Pula, Jusuf Beshiri, Carmen Santoro, Celestina Masotti

**Harqe:** Paçalin Pavaci- Kryetar Jurie**,** Sihana Badivuku, Arben Llozi

**Instrumenta Frymore:** Venera Mehmetagaj-Kajtazi, Andrea Marko, Shkumbin Bajraktari

**Kitare:** Edison Miso, Srdjan Bulatovic

**Kanto:** Carmen Santoro, Adelina Paloja, Armando Likaj

**Drejtor Artistik**: Klevis Gjergji

Çmimet sipas kategorive:

Harqe: Vesa Dume (Tirane), Briselda Mirukaj (Lezhe), Lindi Pasha (Prishtine)
Ndërsa Pamela Çobaj i jepet çmimi special Ç. Zadeja, por nuk garon.
Fryma: Olta Luli (Lezhe), Irina Klakor (Tivat), Alba Basha (Peje), Ardit Ibrahimi (Prishtine)
Ndërsa Alen Kurici i jepet çmimi special Ç. Zadeja.
**Çmimi Pjeter Gaci** këtë vit është vlerësuar Ardit Ibrahimi, Prishtinë, Klarinetë.

**P08220.O3.A5: Ahengu Shkodran**

Me datën 1 tetor u mbajt në Teatrin "Migjeni" edicioni i "*Ahengut shkodran*", me pjesmarrjen e artistëve të rinj dhe të afirmuar të qytetit si dhe të ftuar special këtë vit këngëtarë dhe artistë të ansamblit popullor të Komunës së Gjakovës.

Programi artistik i "*Ahengut Shkodran*" ishte :

1. Loja e kullanave - Grupi i Qendres Kulturore të fëmijëve
2. N'at zaman t'njasaj furie - Ea Zogaj
3. Marshalla bukuris'sate - Blerta Cina
4. Dalin vajzat prej mejtepit - Grupi "Karajfilat që ka shkodra
5. Kanga e Oso Kukes - Laorjan Ejlli + grupi

6. Synin si qershija - Martina Serreqi
7. Kur natyra kenka veshun - Sevina Kurti
8. Shkoj e vij nga dera jote - Ester Qendro
9. M'a ke gishtin për unazë - GlerditTurmetaj, Megi Toma

10. Zanusha - Savjana Vjerdha
11. O moj e vogel si florin - Mukadez Çanga
12. Ani ma ven doren - Ademir Fresku
13. U thafsha si thahet fiku - gr.Karajfilat

14. Vashënia - Adelina Correj
15. Pranver e bukur - Leonard Guga
16. S'të harroj deri sa t'vdes/ O iku nata z'bardhi drita - Xhuli Pjetraj
17. O po t'a marr kangen me saze,/ Sparit herë kur jena pa.- Klinsman Llazani
    Ritual dasme

1. Mori drandofilja e bardhë - shoqëruar nga grupi i valleve
2. Broj nji pëllumb - shoqëruar nga grupi i valleve
3. O, çka kanë djemt e rinj - Ruzhdi Çeka + Grupi
4. Kush më rrin karshi- karshi - dueti i të rinjëve
5. O shkodrani jonë Bik Ndoja - Bujar Qamili
6. Lule bore - Grupi
7. S'ka ma t'bukur se pranvera - Grupi

**P08220.O3.A6: Honorare Grupi i Valleve**

Grupi i Valleve përbëhet prej 12 personash, të cilët janë mbështetur me honorare për 12 muajt e parë të vitit.

**P08220.O3.A7: Festivali i Këngës Qytetare "*Luleborë*"**

Festivali i Këngës Qytetare "*Lulebore*" u mbajt në datat 18-19 nëntor 2022 në Teatrin "Migjeni".
Drejtorë artistik të Festivalit ishin Markelian Kapidani dhe Marjan Deda të cilët punuan për realizimin artistikisht të festivalit.
Në Festival u pranuan 17 këngë të cilat u përzgjodhen nga një juri profesioniste.
Këngët u interpretuan "Live" nën shoqërimin e orkestrës drejtuar nga dirigjentët Jetmir Barbullushi dhe Ilir Zoga.
Në përfundim të natës së II Juria e përbërë nga 5 anëtarë:

1-Hajg Zaharian
2-Ritvan Karakaqi
3-Alfred Çapaliku
4-Gridi Kraja
5-Altin Goci

Shpalli fituese të çmimit të I-rë këngën "*Zemra kërkon zemrën*" të kompozuar nga Ana Bushgjokaj.
Fitues të çmimit të II-të këngën "*Asht nji shpi me lulebora*" të kompozuar nga Halit Shpuza.
Fitues të çmimit të III-të këngën "*Nuk ban za*" kompozuar nga Enis Mullaj.
Çmimin e interpretuesit më të spikatur e fitoj këngëtarja e re Megi Toma.

**P08220.O3.A8 Koncert premierë e Orkestrës Fymore**
Koncerti premierë i Orkestrës Frymore u zhvillua me datë 21.06.2022 në orën 20.00 në Sheshin para Bashkisë Shkodër me titull "*Mbrëmje muzikore e orkestrës frymore*".
Ky aktivitet u realizua nga Qendra Kulturore "*Pjeter Gaci*" dhe Bashkia Shkodër.
Në program u përzgjodhën vepra të stileve dhe periudhave të ndryshme të zhvillimit të artit muzikor, si dhe vepra shqiptare.
Në koncert përveç pjesëve orkestrale pati edhe interpretime vokale të sopranos Klodiana Brahimi dhe tenorit te ri, Denis Fikaj si dhe interpretimi solistik në bastube i instrumentistit te ri Mirson Dishaj.
Per realizimin e aktivitetit punuan, libretistja Mira Aliaj si dhe prezantoi programin moderatorja Rajmonda Marko.
Vlen të përmendet numri i lartë i spektatorëve mbi 400 spektatore duke e mbushur sheshin dhe ndjekur aktivitetin deri në fund. Koncerti u prit me entuziazëm nga publiku artdashes shkodran duke përcjellë me duartrokitje dhe ovacione pothuajse të gjitha interpretimet artistike.
Në koncert morën pjesë 43 artistë nën dirigjimin Admir Lekaj, me drejtor artistik Bardhyl Hysa.
Moderatore e aktivitetit ishte Rajmonda Marko.

**28 nëntor 2022 "Koncert Festiv" me rastin e 110 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë.**

Me pjesmarrjen e : Armando Lika, Klodiana Brahimi, Laorjan Ejlli , Kori polifonik "*Prenkë Jakova*", grupi fitues i fjales artistike nga shkolla "*Hasan Riza Pasha*". Programi i këtij koncerti ishte i pasur me pjesë nga kompozitorë shqiptar dhe të huaj. Aktiviteti u hap me Hymni Kombëtar i Flamurit Martin Gjoka (Gjergj Fishta) - "*Ata t'lumt' që dhan'jeten*" – performoi Kori Polifonik "*Prenkë Jakova*" .

**P08220.O3.A9: Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare**

Qe nga datat 16-17 .11.2022 u mbajt në Lezhë "*Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullor*" ku mori pjesë edhe një grup folklorik i përgatitur nga Qendra Kulturore "*Pjetër Gaci*". Qendra Kulturore "*Pjetër Caci*" u prezantua në takimin e rapsodëve në Lezhë, me këto artiste: Rapsodët e grupit "Treva e Dukagjinit" Fran Kodra, Ndue Shytani, Sokol Gjoni, Mirela Brushtulli.

**P08220.O3.A10: Festival Burimor**

Edhe këtë vit në Teatrin Migjeni u realizua festivali i muzikës folklorike. Ky aktivitet ka për qëllim promovimin e muzikës folklorike, duke sjellë në skenë të rinj dhe të reja të cilët performojnë në këtë zhanër muzikor. Folklori muzikor shqiptar është jashtëzakonisht i pasur, i cili shprehet në të gjitha format muzikore, nga instrumentalet deri tek ato vokalet. Kjo mënyrë e të shprehurit të muzikës ruajti traditën tonë kombëtare duke e përcjellë atë në shekuj deri në ditët tona, si një formë autentike. Është e rëndësishme që këto vlera të ruhen dhe të promovohen nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme. Festival Burimor u realizua me datë 4 dhjetor 2022.

**P08220.O3.A12 Dita e Luleve- 6 Maj**

Çdo 6 Maj, Shkodra kthehet në një oborr të madh ngjyrash dhe aromash. Këtë vit "*Dita e Luleve- 6Maj*" erdhi në bashkëpunim me "*Qendra e Informacionit AARHUS*" me sloganin "*Çilu ti moj lulja jeme*", aktivitet i cili zgjati për 3 ditë, 6 Maj deri me 8 Maj 2022. Aktiviteti u hap me panairin e luleve dhe artizanatit në sheshin para Bashkisë Shkodër, në pedonalen "Kolë Idromeno" dhe në Gjuhadol, duke vazhduar me shfaqje me performanca nga fëmijët e kopshteve gjatë ditës. Në orën 11:00 u zhvillua koncerti i "Bilbilat e vegjël këndojnë", i organziuar nga Qendra Kulturore e Femijëve " Kujtim Alija", i cili solli gjallëri dhe një festë për të gjithë fëmijët prezent.

Në pasditen e datë 6 Maj, para Bashkisë Shkodër, performoi grupi në N'Gen, i cili solli tek publiku artdashës dhe përmes tingëllimeve moderne të jazz-it dhe të Fusion-it, muzikën tonë popullore. Përmes arranxhimeve moderne, ky grup merret me trajtimin e këngëve dhe melodive tona tradicionale si harmonikisht gjithashtu dhe ritmikisht, duke u frymëzuar nga modelet bashkohore të lojës në grup, duke interpretuar dhe improvizuar. Grupi n'Gen drejtohet nga kompozitori Markelian Kapidani.

Në orët e vona u organizua Street Party nga Grupi Urban Band, i cili solli muzikën rock për publikun prezent.

Dita e dytë 7 Maj, filloi me panairin e luleve dhe artizanatit në sheshin para Bashkisë Shkodër, në pedonalen "Kolë Idromeno" dhe në Gjuhadol.

Në orën 10:00 para sheshit të Bashkisë Shkodër, performuan shkollat 9-vjeçare dhe të mesme. Në orën 12:00 nisi "Parada e luleve" me pjesëmarrjen e fëmijëve të kopshteve dhe shkollave 9 – vjeçare të Bashkisë Shkodër. Parada filloi nga Bashkia Shkodër duke vazhduar me tej tek pedonalja " Kol Idromeno" dhe në fund në Gjuhadol.

Në orën 18:00 u zhvillua koncert me këngë shkodrane, me pjesmarrjen e artisteve të rinj dhe artisteve të mirnjohur shkodran të cilët performuan për publikun këngë dedikuar lules.
Dita e fundit e aktivitetit 8 Maj 2022 nisi me panairin e luleve dhe artizanatit në sheshin para Bashkisë Shkodër, në pedonalen "Kolë Idromeno" dhe në Gjuhadol duke vazhduar me aktivitetin përmbyllës, shpërndarjen e çmimeve për kopshtet dhe shkollat pjesmarrëse në aktivitet.
Suprizë e këtij viti ishte dhe koncerti gala i zhvilluar ne Teatrin Migjeni nga artistët me famë ndërkombëtare: Inva Mula dhe Genc Tukiçi. Një koncer madhështor, i cili mbushi sallën e teatrit plot duke sjelle emocione të jashtzakonshme, që prej kohësh i kishte munguar qyetit tonë.

**P08220.O3.A13 Ndërmendje**

Me "*Ndërmendje*", koncert i organizuar nga Bashkia Shkodër dhe Shoqata kulturore "*Rrok Jakaj*", mbyllëm një vit të ngjeshur me aktivitete kulturore.
Rikthimi pas 30 vitesh në vendlindje i dirigjentes dhe pianistes Elda Laro, performanca që na dhuroi orkestra simfonike e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit, së bashku me artistët e tjerë Ana Naqe, Denis Skura, Nikola Kondakçi, Ana Bushgjokaj, Isabel Eve Poro, ishin mbyllja më e bukur e një viti.
Moderatore e " *Ndërmendje 2022*" ishte Manjola Lloja Bushati.

**P08220.O3.A14: Aktivitete me rastin e 2 Prillit**

"*2 Prilli*" është ngjarje e cila shënoi një ndër revoltat më të mëdha në vend duke i dhënë fund komunizmit në Shqipëri.
Në kuadër të ditës përkujtimore të "2 Prillit" në sheshin që mban edhe emrin e kësaj revolte, u organizua ceremonia e vendosjes së kurorave në ndërim të dëshmorëve të demkoracisë. Shoqëroi homazhet Orkestra Frymore e Bashkisë Shkodër.
Në këtë ceremoni morën pjesë, Kryetari i Bashkisë Shkodër z. Bardh Spahia, Prof.Dr. Sali Berisha, deputetë, antarë të shoqatës "*2 Prilli*", familjarë të familjeve të Dëshmorëve të Demokracisë.
Bashkia Shkodër në kuadër të "*2 Prillit*", kishte organizuar një takim me të rinjtë e qytetit.
Në hollin e Bashkisë Shkodër u vendos ekspozita me fotografi historike të asaj dite, ku të gjithë të pranishmit e vizituan sëbashku me Kryetarin e Bashkisë.
Në orën 18:00, në sallën e Këshillit Bashkiak Shkodër u shfaq dokumentari "*In Memoriam*" , realizur në përkujtim të kësaj ngjarje.

**P08220.O3.A15 Festival Jazz**

Projekt i fituar nga Shoqata Kultuore "Rrok Jakaj", realizoj "Shkodra Jazz Festival". U prezantua i integruar brenda dhe "Rrok Academy", i cili ka si synim edukimin e brezave të rinj me muzikën jazz dhe klasike, përmes leksioneve intensive të drejtuara nga profesionistë të fushës. Përveç degëve Jazz, Klasike, Fizarmonikë dhe New Technology-Multimedia, këtë vit risia në "Rrok Academy" ishte hapja e degës Junior – harqe, e drejtuar nga Brixhilda Gega (Martini).

“**RROK ACADEMY**” u zhvillua në datat 08-28 Gusht 2022 në ambjentet e Qendrës Rinore “Atelie” dhe në Galerinë e Arteve, Shkodër.

**Dega e Fizarmonikës** mbi temën “*Mbi studimin e teknikave klasike dhe ballkanike*”, janë kurse intensive të mbajtura nga Bardh Jakova.
**Dega Klasike dhe Junior** në ambjentet e Qendrës Rinore “Atelie” dhe në Galerinë e Arteve Shkodër, me temat “Mbi studimin e teknikës orkestrale dhe muzikës së dhomës” dhe “Mbi studimin e muzikës së ansamblit për harqe dhe përmirësimin e ritmit, koordinimit në grup” për Junior, kurse të drejtuara nga Brixhilda Gega (Martini), Pacalin Pavaci dhe Sokol Prekalori.
**Dega Jazz** - Leksionet me temë “*Mbi idiomën muzikore të jazz-it*” u drejtuan nga Markelian Kapidani, ndërsa ato të këndimit nga Eileina Dennis; të bass-it nga Dino Contenti, të baterisë nga Enzo Zirilli, të trompës nga Alberto Mandarini, të pianos Daniele Tione sipas kalendarit të përcaktuar nga Drejtuesi i “Rrok Academy” dhe drejtori artistik i festivalit, Florian Jakaj.

**Dega Neë Technology – Multimedia** me temë “*Formim mbi kritikën e artit dhe përvetësim i teknikave të fotografisë e video-artit*”, u drejtua nga Amarild Bushati, Fatjon Çeliku dhe Sonela Pirani. Në “Rrok Academy” morën pjesë 64 studentë dhe risia e këtij viti ishte zgjerimi i hartës gjeografike e pjesëmarrësve të cilët ishin nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Bullgaria, Italia dhe Argjentina.
**Data 13 Gusht 2022 - Koncert - Jam Session** – Rruga historike Gjuhadol – Koncert i “Rrok Academy” dega Fizarmonikë.

**Data 16 Gusht 2022 -_“SHKODRA SOUNDS”** – Koncert në Sheshin para Bashkisë Shkodër me studentët e “Rrok Academy”, dega Fizarmonikë

**Data 23 Gusht 2022-_“SHKODRA SOUNDS” –** Koncert në Sheshin para Bashkisë Shkodër me studentët e “Rrok Academy”, dega Klasike, me orkestrën e riformuar “Skanderbeg Chamber Orchestra”.

**Data 24 Gusht 2022 -** “**SHKODRA JAZZ FESTIVAL, on tour**”, “Mrizi i Zanave” – Koncert i grupit A-C Leonte.

**Data 25 Gusht 2022 -** “**SHKODRA JAZZ FESTIVAL**” në Sheshin para Bashkisë me Duo-n Tione-Mandarini dhe grupin “Oltre Swing LAB”.

**Datat 26 Gusht 2022 -** “**SHKODRA JAZZ FESTIVAL**” në Sheshin para Bashkisë me grupin “Heart Cave” dhe grupin “Tribidado”.

**Data 27 Gusht 2022 -** “**SHKODRA JAZZ FESTIVAL**” në Sheshin para Bashkisë me grupin “Alberto Mandarini Quartet” dhe Eileina Dennis.

**Data 27 Gusht 2022 - Koncert - Jam Session** – Rruga historike Gjuhadol – Koncert i "Rrok Academy" dega Jazz, me të ftuar artistët ndërkombëtarë të ftuar në "Shkodra Jazz Festival".

**Datë 28 Gusht 2022 -** "**SHKODRA SOUNDS**" koncert tek Muzeu Historik "Oso Kuka" me pjesëmarrjen e "Rrok Academy", dega Junior dhe dega Klasike.

**P08220.O3.A16 Koncertet e Verës**

Këtë vit koncertet e verës erdhën me sloganin "*Eja në Shkodër*". " *Eja në Shkodër*" ishte një ftesë jo vetëm për qytetarët e Shkodërs, por për të gjithë Shqipërinë dhe më tej.

Koncertet e verës filluan me 4 korrik 2022, me artistet shkodrane Rezarta Smaja dhe Jozefina Simoni, të cilat i dhuruan publikun një koncert me rryma të ndryshme muzikore.

14 Korrik 2022, në skenën para Bashkisë Shkodër erdhi grupi i mirnjohur "*Fisnikët*".

Sheshi para bashkisë i mbushur plot me qytetarë të cilët shoqëronin grupin "*Fisnikët*" në cdo këngë duke kënguar dhe kërcyer.

22 Korrik 2022 të ftuar ishin Bujar Qamili dhe Mateus Frroku të cilët sollën një atmosferë fantastike për publikun.

27 Korrik 2022 koncert i grupit "*3 Musketjerët*" me artistët e mirënjohur Aleksandër Gjoka, Elton Deda dhe Redon Makashi. Me një perzgjedhje të veçantë muzikore, na risollën në vëmëndje muzikën e mirë dhe këmgët e mrekullueshme shqiptare, pjesë e repertorit të secilit prej këtyre artistëve.

15 Gusht 2022 - "*Nata Shkodrane*", një natë e veçantë dedikuar Shkodrës. Me pjesmarrjen e 25 artistëve (këngëtar dhe instrumentist ), sollën për publikun ovacione interpretime të këngëve të bukura shkodrane.

20 Gusht 2022 - Grupi "*Elita 5*" i cili solli një koncert të jashtzakonshëm me hitet e tyre ma të mira. Grupi "Elita 5" ndezi atmosferën në sheshin para Bashkisë Shkodër, duke krijuar një spektakël të vërtetë.

21 Gusht 2022, i ftuar ishte Frederik Ndoci. Një mbrëmje me muzike të zhanreve të ndyshme i shoqëruar edhe me pak humor nga artisti, solli një atmosferë të bukur për publikun .

**P08220.O3.A17: Karnavalet**

Pas dy viteve mungesë për shkak të gjendjes pandemike globale, u rikthye një ndër aktivitetet më te rëndësishme tradicionale të qytetit tonë "*Karnavalet*" .

Karnavale 2022, e titulluara " *Gjall e për gazep*" u zhvillua me datë 26.02.2022.

Këtë vit karnavet iu rikthyen traditës së karvanit lëvizës, duke filluar nisjen nga Teatri Migjeni i gjithë karvanit karnavalesk. Gjatë rrugës pati ndalesa për perfomanca të vogla të grupit artistik të "*Karnavale 2022*" tek: Dugajtë e Reja, Sarreq, sheshi "Isa Boletini", sheshi para Bashkisë Shkodër duke u drejtuar nga sheshi "Nënë Tereza". Një element i veçantë, traditë e Karnavaleve të Shkodrës, ishte edhe shpërndarja e petullave për publikun pjesëmarrës

Pas mbërritjes së karvanit në sheshin "*Nënë Tereza*", u zhvillua spektakli i plotë tradicional duke përfunduar me djegien e dordolecit. Element tjetër që karakterizon

Karnavalet e Shkodrës, janë edhe butaforitë e ndryshme.Vënia në dukje e dobësive dhe të metave të shoqërisë shqiptare në aspektin social dhe politik, përmes satirës të shfaqur në formën e karikaturës, është një element shumë interesant i cili përceptohet shumë shpejt dhe shumë thjeshtë nga çdo lloj publiku.

**P08220.O3.A18 Shkodra n'fest**

E kthyer tashmë në traditë, si çdo fundvit, edhe këtë vit u realizua projekti kulturor "Shkodra n'fest", aktivitet i cili synon të kthejë qytetin në një atmosferë festive, në kuadër të festimeve të dhjetorit.
Aktivitetet nisën që në datën 8 dhjetor, me vendosjen e shtëpizave, të cilat të vendosura në rrugën 13 Dhjetori, sheshi para Bashkisë Shkodër, i dhanë ambjentit të zbukuruar, hijeshi tjetër.

**13 Dhjetor 2022** – Koncert i përbashkët të fëmijëve të kopshtit "*Borëbardha*" dhe fëmijëve të Qendrës Kulturore të Fëmijëve "*Kujtim Alija*" dhe grupit të valleve. Fëmijët janë gëzimi i çdo feste dhe ata i dhanë hijeshi Shkodrës, duke na dhuruar një mbrëmje magjike me interpretimet e tyre. Me një repertor shumë të pasur, koncerti i fëmijëve zgjati rreth dy orë, duke sfiduar edhe temperaturat e ulëta, por duke e mbushur sheshin me spektatorët shkodranë.
**18 Dhjetor 2022** – Koncert i titulluar "*Gurrë dashnije n'Shkodër*", me pjesëmarrjen e Ansamblit të Këngës Qytetare dhe me këngëtarët më të mirë të qytetit të Shkodrës, të cilët vazhdojnë të çojnë përpara traditat më të mira tonat. Koncerti pati një interes shumë të madh të spektatorëve shkodranë, deri në orët e vona.
**19 Dhjetor 2022** – Koncert i dedikuar grupit rinor të qytetit me pjesëmarrjen e artistit Eugjen Marku dhe grupit të tij muzikor, me Flor Martinin, Daniel Prendi dhe Mark Ujka. Muzika rinore, bëri që spektatori shkodran t'i shoqërojë deri në orët e vona me interes të lartë.
**21 Dhjetor 2022** - Koncert i këngëtarit Renis Gjoka & Band, të cilët performuan hitet më të mira të muzikës shqiptare dhe asaj ndërkombëtare. Muzika rock shoqëroj publikun e shumtë në numër deri në orët e vona të mbrëmjes.
**23 Dhjetor 2022** - Koncert i këngëtarit Altin Goci & Ritfolk band solli në skënën e "Shkodra n'fest" nostalgjinë e hiteve më të bukura shqiptare dhe ndërkombëtare, duke mbledhur një numër shumë të madh spektatorësh në shesh, deri në orët e vona të mbrëmjes.
**27 Dhjetor 2022** – Koncert i titulluar "*M'ban zemra rrik e tak*", me pjesëmarrjen e Ansamblit të qytetit dhe rreth 17 këngëtarëve të muzikës qytetare dhe grupit të valleve të Qendrës Kulturore "*Pjetër Gaci*". Këngët shkodrane dhe interpretimet e artistëve të qytetit janë një magji në vete që e bënë edhe më festive Shkodrën këtë fundviti. Koncerti zgjati deri në orët e vona të mbrëmjes, me një pjesëmarrje shumë të madhe të spektatorëve. Moderatore e të gjitha aktiviteteve ishte Ketlin Pjalmi.
Të gjitha koncertet u zhvilluan në një skenë të madhe të vendosur në sheshin para Bashkisë Shkodër, e cila rrinte shumë bukur me ambjentin përreth të arreduar me finesë dhe madhështi.

**P08220.O3.A19 Dita ndërkombëtare e muzikës**

Festa e Muzikës kremtohet në 120 vende të botës, duke mos përjashtuar as qytetin tonë: Shkodrën.Me këtë rast u mbajt takimi mes kompozitorëve dhe profesionistëve të muzikës, (edicioni i dytë). Ishin prezentë figura me rëndësi si: Zef Çoba – Kompozitor, Xhahid Bushati – shkrimtar, Ridvan Karakaçi - Kritik muzike, Alfred Çapaliku – Shkrimtar, Oleg Gjerga – Kompozitor, Gjon Shllaku – Kompozitor, Fatos Mataj – Violonçelist, Arben Basha - Kontrabasist

Shpëtim Saraçi – Kompozitor, Lorenc Radovani – Violinist, Alfred Kaçinari – Kompozitor, Ergys Pirani – Kompozitor, Dorjan Ulaj - Kompozitor

Fjala e hapjes u mbajt nga Dritan Mlika, përgjegjës i Qëndrës Kulturore Pjetër Gaci.

Më tej, u diskutua rreth aktiviteteve aktuale si dhe atyre të mundëshme për të ardhmen, duke analizuar problematikat dhe përmirësimet e secilës nga ato.

Çdo aktivitet duhet të ketë impakt pozitiv tek publiku, duke sjellur jo vetëm argëtim por mbi të gjitha edukimin e brezave të rinj përmes muzikës së krijuar me kritere profesionale.

E veçanta e këtij edicioni, ishte edhe prania e disa artistëve të rinj të qytetit, tregues ky me rëndësi dhe që shtyn vëmendjen tek interesi i të rinjve kundrejt aktiviteteve muzikore të qytetit.

**P08220.O3.A20 Festa e Trashëgimisë Kulturore**

Projekt i fituar nga Qenda Za "*Za Fest VI*" u organziua në datat 28,29,30 korrik 2022 në Shkodër.

**Datë 28 Korrik 2022 -** Oborri i familjes së Doktor Frederik Shiroka

Transmetimi i filmit "*The Van*" Regjisor Enerik Beqiri - Filmi me metrazh të shkurtër arrin të bëhet pjesë zyrtare e edicionit të 93-të të çmimeve prestigjioze Academy Awards në SHBA.

Logu i Za Fest, bisedë me Jeton Neziraj- Fluturimi Mbi Teatrin E Kosovës, Arben Bajraktaraj dhe Linda Rukaj perfomanca artistike "Mall"

**Datë 29 Korrik 2022 Kalaja e Rozafës;**

Koncerti filloi me Eva Klampfer, e njohur ndryshe si **Lylit**, e cila është padyshim një nga këngëtaret më të mëdha të shpirtit në Austri, duke vazhduar me **Elina Duni, Vlashent Sata** dhe **Amror Del Ray** - Afterparty me DJ Set.

**Datë 30 Korrik 2022 Kalaja e Rozafës;**

Nata përmbyllëse e Za Fest, filloi me **Cristiana Verado** kantautore dhe kitariste e muzikës Jazz, **Las Migas** është një kuartet i formuar nga Carolina Fernández (vokal), Marta Robles (kitarë), Alicia Grillo (kitarë) dhe Roser Loscos (violinë), **Jericho** është një rock grup i formuar nga disa të rinj shqiptarë nga Kosova, muzika e te cilëve është përzierje e muzikës rock, alternative, elektronike dhe muzikës tradicionale shqiptare duke përfunduar këtë edicion me Bijat – After party DJ set.

Gjatë 3 netëve të festivalit mbi 4500 persona morën pjesë.

**P08220.O3.A22 Pjesë Teatrore 1**

"*Zhurma përtej skenës*" ishte premiera e rradhës e realizuar nga trupa e Teatrit Migjeni.

Me autor Michael Frayn, erdhi e adaptur dhe me rregji nga Enke Fezollari.
"*Zhurma përtej skenës*" solli për publikun prapakenat që ndodhin gjatë një shfaqjeje teatrore, te papriturat, problemet dhe marrdhënien e aktorëve ndërmjet tyre.
Interpretuan aktorët: Rita Gjeka Kacarosi, Jozef Shiroka, Simon Shkreli, Krist Lleshi, Merita Smaja, Aleksandër Prenga, Rajmonda Marko, Fritz Selmani, Nikolin Ferketa.
Premiera u shfaq për publikun në datat 5,6,7 nëntor 2022.

**P08220.O3.A23 Pjesë Teatrore 2**

Komedia "*Gjaja*" . Autor Joe Orton dhe me regji të Altin Bashës u vu në skenë me datë 8 Qershor 2022. Kjo shfaqje mori pjesë në festivalin "KOKO Fest" e Korçë ku u vlersua me 2 çmime , çmimin "Regjia më e mirë" Altin Basha dhe çmimin"Aktorja më e mirë protagoniste" Kristi Lleshi .

**P08220.O3.A24 Pjesë Teatrore 3**

Për herë të parë në sallën e teatrit Migjeni u shfaq një musical, një risi e cila tërhoqi vëmendjen e publikut shkodran**.**
Premiera e re " Takimi i parë", frymëzuar nga Austin Ëinsberg, u vu në shkenë nga regjizorja e re shkodrane Ina Morinaj, në datat 21 dhe 22 Dhjetor 2022.
Intepretuan e aktorët e Teatrit Migjeni: Jozef Shiroka, Krist Lleshi, Rita Gjeka Kacarosi "Mjeshtër i Madh", Fritz Selmani, Savjana Vjerdha, Aleksandër Prenga, Nikolin Ferketa.

**P08220.O3.A25: Variete**

Komedia " *Big Brother Vip Shkodra*" libreti Ismet Drishti, Besnik Çonari.
Regjia Ismet Drishti. Morën pjesë 15 aktorë, duhet të theksohet se 10 nga këto ishin të rinj.
Kjo shfaqje u shfaq 9 herë dhe u ndoq nga 4,050 spektator.

**P08220.O3.A26: Shfaqje për fëmijë+Teatri i kukllave**

Teatri Migjeni prej disa vitesh ka si prioritet rikthimin e traditës së shfaqjeve për fëmijë dhe teatrin e kukullave, si mënyra më e mirë e afrimit të fëmijëve me teatrin.
Këtë vit teatri i kukullave shfaqi premierat " *Pufi dhe Gufi*" dhe "*Fyelli magjik*". Në këto premiera morën pjesë 5 aktorë. Gjate vitit 2022 keto premiera janë shfaqur 24 herë dhe e janë ndjekur nga 2,100 fëmijë

**P08220.O3.A27: Pranverë me këngë. Festivali i këngës popullore shkodrane**

Festivali " *Prandvere me kange*" u zhvillua në datat 20-21 Mars. Në këtë festival u angazhua afro 75 artist, si kompozitor, tekst shkrues, orkestrues, këngëtar, orkestrant dhe prezantues. Ky Festival pati Udhëheqës artistik, Ilir Zogën dhe regjisor: Jozef Shirokën. Në fund juria vlerësoi me çmime këngët: "*Gëzime paçi gjithmonë*" çmimi i parë. Çmimi i dytë: "*Tinguj zemrash*". Çmimi i tretë : " *Unë kam sytë e tu*". Festivali u ndoq nga 465 spektatorë.

**P08220.O3.A28: Festival teatri me shkollat e mesme**

Festivali Teatror i shkollave të mesme u zhvillua në datat: 1-7 Mars. Morën pjesë 6 shkolla. Ato u paraqitën në këtë Festival me 6 tregime të dramatizuara dhe vënë në skenë nga 6 aktorë së trupës së teatrit. U aktivizuan 48 nxënës. Në fund të Festivalit, Juria vlerësoi si shfaqja me e mirë " Tregtare flamujsh" interpretuar nga nxënësit e shkollës Jordan Misja. U vlersuan si aktorja me e mire, nxënësja e shkollës "28 Nëntori " dhe si aktorët më të mirë nxënësit e shkollës "P. Jakova" dhe "Sh. Juka". Ky festival u ndoq nga 2,200 nxënës.

**P08220.O3.A29: Honorare aktorët e teatrit të kukullave.**

Jane 5 aktorë të teatrit të kukllave të cilët kanë marrë pjesë në performancat e reja të tetrit të kukullave të cilët janë paguar me honoraret e përmuajshme.

**P08220.O3.A30: Lëvizja e Postribës**

Kryengritja e Postribës është një prej ngjarjeve më të rëndësishme dhe që shënoi një pikë të fortë kthese në historinë e Shqipërisë.

9 shtatori i 1946-es, është dita kur Postriba, Malësia dhe Shkodra u futen kryelartë në histori përmes gjakut dhe guximit të bijve të kësaj treve dhe të gjithë atyre burrave, intelektualëve të ndritur që i dhanë jetë kryengritjes së parë antikomuniste në Europë.

Bijtë heronj të Postribës, Malësisë e Shkodrës u ngritën në emër të asaj që e kemi dëshmuar në çdo kohë se e kemi të shenjtë, Lirinë!

Kryetari i Bashkisë Shkodër z. Bardh Spahia mbajti fjalën në ceremoninë përkujtimore të 76 vjetorit të kësaj ngjarje.

**P08220.O3.A31: Ekspozita "Salloni i Vjeshtës"**

*Salloni i Vjeshtës "E Kuqja" -22 nëntor 2022*

Për shkak të përmbytjeve dhe kushteve atnmosferike ekspozita u çel me datë 01 dhjetor 2022.

Salloni i Vjeshtës, prag dimri kërkon që nëpërmjet të kuqes të depërtojë në kozmogoninë krijuese të artistit bashkëkohor.

Edicioni i XVI-të i Sallonit të Vjeshtës u kurua nga Oltsen Gripshi dhe Naim Spahiu të cilët krijuan një dimension mes reales dhe sureales. Pjesë e jurisë ishin Rozafa Shpuza, Aleksandër Filipi dhe Ylli Drishti të cilët shpallën fituesit në 2 kategori çmimesh. Në një ekspozitë me mbi 60 artistë pjesëmarrës, fitues të çmimeve u zgjodhën:

Vepra më e mirë-Artan Draçini-Pa titull. Fragment nga romani "*Rrëfim për dashurinë dhe errësirën*" nga shkrimtari Amos Oz.Teknika mikse dhe realizimi në vitin 2022.

Artisti i ri më i mirë-Qazim Xhylani "*Dua të pikturoj buzëqeshjen*".Teknika vaj në pëlhurë.

Duke qënë e vetmja ekspozitë kombëtare e mbetur në Shqipëri, mori mjaft vëmendje në televizione, programe televizive, revista, rrjete sociale etj.

**P08220.O3.A32: Çmimi Idromeno**

*Edicioni i VII-të i çmimit "Idromeno"- 17.09.2022*

Ekspozita u kurua nga Yllka Gjollesha dhe pjesë e jurisë ishin Anna Shkreli, Shpetim Kërçova, Senad Xhexhovi. Pjesëmarrës ishin artistët Kristjana Cene, Marlin Dedaj, Sala

Mlloja, Bleona Hafesllari, Bib Frrokaj, Ingrid Xheraj, Anxhela Shehi, Leart Rama, Joni Miço.
Fitues i edicionit të VII-të te çmimit "*Idromeno*" u shpall Bib Frrokaj. Një natë me emocione ku përballeshin qëndrimet e artistëve të rinj me kritikën e jurisë profesionale. Ky edicion provoi edhe njëherë rëndësinë e hapësirës që krijohet jo vetëm për artistët e rinj por edhe zgjerimin e debatit shoqëror mbi tematika të ndryshme,shpesh shumë të ndjeshme dhe me tingull të fortë.

**P08220.O3.A33**: **"Personazh i ftuar"- Ekspozitë personale e një personaliteti të artit pamor shqiptar të ftuar nga Galeria e Arteve e Shkodrës.**
"Personazh i ftuar" këtë vit ishte Pashk Pervathi.
Me datë 6 maj u çel ekspozita personale e autorit Pashk Pervathi titulluar "*N'Rreze te paqta shkon tuj u shkri*" me 47 punime ne pikture në gjninë e peisazhit, portretit dhe arkitekturore historike.
Pashk Pervathi është autor i 39 ekspozitave personale në pikturë, të hapura brenda dhe jashtë Shqipërisë. Vepra të tij janë pjesë e fondit të koleksionistëve në Europë, Amerikë dhe Azi.
Është nderuar me çmime të rëndësishme brenda dhe jashtë vendit.
Ekspozita u përcoll nga një jehonë e gjerë mediatike dhe u ndoq nga shumë vizitor vendas dhe përtej. Studente, artiste, dashamirë të artit patën mundësinë që për një muaj të ndiqnin realizimet vituoze të këtoj artisti të njohur të Shqipërisë.Ekspozita qëndroi e hapur deri me datë 28 maj 2022dhe u kurua nga Fatmir Juka dhe Sidrit Lohja.

**P08220.O3.A34: Takime Publike- Biseda publike mbi artin dhe workshop me artistë të rinj.**
*Takim me fotografin Hans Peter Jost – 21 tetor 2022*
Një takim shumë i bukur dhe sqarues i ekspozitës nga vetë autori Hans Peter Jost i cili u ndoq gjërësisht nga studentë dhe pedagogë të degës së gazetarisë arteve si dhe nxënës të shkollave të mesmë. Gjatë bisedës me autorin u ngritën mjaft pyetje nga të pranishmit të cilat kishin të bënin që nga interpretimi i fotografive të shkrepura nga ai e deri tek jeta e tij në Shqipëri.

**P08220.O3.A35: Programe edukimi artistik në partneritet me individë dhe shoqata kulturore.**
Në Galerinë e Arteve Shkodër nën udhëheqjen e Znj. Indira Çoçja vjen workshopi me titull;
"*Stima e porcelanit*".
Me mbështetjen e Bashkisë Shkodër dhe pjesëmarrjen e studenteve të Departamentit të Arteve të Universitetit të Arteve "Luigj Gurakuqi" Shkodër, datë 28-30 mars 2022.
Edmund de Waal në qasjen e qeramistit ndaj "arit të bardhë" – porcelanit, shkruante duke e zëvëndësuar natyrën filologjike të studiuesit me atë të jehonës poetike, ku materiali i bardhë formesohet në funksion të një formimi shpirtëror të ngadaltë dhe të dhimbshëm.

***Info shtesë:***

**EX 'NATURA -** Ekspozitë pikture me vepra nga fondi i Galerisë së Arteve Shkodër, u mbajt nga data 4 shkurt deri me datën 30 mars 2022.

Ekspozita ka pasur interes të madh nga artdashësit Shkodran kjo dhe për faktin e nostalgjizmit të pejzazhit të ndryshuar në vite. Një reflektim mbi peisazhin e dikurshëm dhe atë të ndryshuar. Qëllimi i këtij prezantmi në radhë të parë, nuk ka të bëjë me evokimin e një kujtese, por se sa me shumë priret të ngacmojë lehtësisht përjetimin në çast aty për aty të "ndryshimit", mes asaj si ishte dhe si është.

Linja e ndërhyrjes së njeriut ndaj peisazhit natyral ose urban duket e qartë dhe domethënese, por edhe aty ku gjerat duken se nuk kanë lëvizur, pretendohet të shfaqet e hollë në këtë përzgjedhje, sidomos përmes retushit të gjestit piktorik dhe ndjeshmërisë së mbërritur tek artisti ku dhe "përgjegjësia" mbetet më e madhe (çasti i fiksuar, merr statusin e dokumetimit) lidhur kjo, me qasjen e interpretimit, përfaqësuar nga artisti dhe realitetit perfaqesuar nga natyra.

**EKSPOZITË PERSONALE :AHMET MALEVIA**

Ekspozita u mbajt nga data 15.02.2022 ora 18:00 (hapja) deri me datën 28.02.2022.

Një ekspozitë që përmbledh punën intensive të 3 viteve të fundit të autorit dhe vjen para publikut me dy cikle bazike, 12 portrete të personaliteteve shqiptar dhe ndërkombëtar si inspirim dhe "debulesë" siç e quan ai dhe cikli tjetër, piktura të ekspesionizmit abstrakt ku vërehet një intensitetit ngjyror dhe ekspresiv. Sipas autorit të dy ciklet lidhen me njera tjetrën jo vetëm nga ndjesitë e tij por dhe nga ana tektike pasi ai e kërkon sfondin dhe kromaturën tek portretet njëlloj si tek piktura e ekspresionismit abstrakt.

Portretet janë në tekniken mikse në kanavacë, sfondi akrelik ndërsa realizimi i figurës në vaj.

**AMA / ZONA**

Ishte ekspozita e hapur nga 17 piktore në kuadër të "Java e Gruas" organizuar e mbështetur nga Bashkia Shkodër me rastin e 8 Marsit. Është një traditë, e cila vazhdon e pasurohet vit pas viti, me pjesëmarrjen e zonjave.

Autoret; Jetmira Kraja, Ormira Lulani, Liliana Çefa, Nirvana Baja, Eremire Jahja, Anila Hetoja, Ikbale Kalaja, Rozafa Shpuza, Denisa Brahimi, Eris Bushati, Afeida Meta, Elgerta Brahimi, Teuta Lagja, Lindita Dedukaj, Servet Derguti, Greta Tahiraga dhe Amleda Gjumi, prezantuan vepra në pikturë, grafikë dhe kolazh.

Ekspozita "AMA/ZONA" e autoreve gra, tenton të përkufizojë hapësirën ekspozuese si nje zonë ku tenton ta shndërrojë në një gjallje të realiteteve të të qenurit femër që faktikisht, në globalizmin e zhvillimeve, mbeten të njëjta pothuajse kudo.
Ekspozita qendroi e hapur nga data 09 - 14 .03.2022

**SHQIPËRIA NJË HERË E NJË KOHË**

Instituti Yunus Emre Shkodër

Organizoi në Galerinë e Arteve Shkodër, me date 18 mars, ekspozitën e kartolinave historike "Shqipëria Një Herë e Një Kohë". Me mbështetjen e Bashkisë Shkodër, nën kujdesin e Ambasadës së Republikës së Turqisë në Tiranë, në ekspozitën e hapur, krahas

Ambasadorit të Republikës së Turqisë në Tiranë z. Murat Ahmet YÖRÜK, koleksionistit z. Mehmet DİKTAŞ. Në ekspozitën me kartolina që përmbajnë mjaft informacion mbi jetën e asokohe dhe zgjojnë kujtime të nënshtruara harresës.

**SIDI KANANI**

RRAGVIM - 04.04.2.22 ora 18 : 00 deri me 20.04.22

Në Galerinë e Arteve Shkodër u hap ekspozita personale e artistit Sidi Kanani

Ekspozita "RRAVGIM" është një pruajrje domëthënëse dhe me e avancuar me një kërkim disi më personal ose siç preferon ai ta quajë, "rravgim" ku sfondi i pikturuar tenton ta fusë publikun në një materie të një tipi tjetër, një materie ndjesore që Marcel Duschamp do ta quante "infrathin". Një koncept që flet përtej kohës materiale e ndjesore në kufinjt e një dimensioni që është gjithmonë mes nesh dhe subjekteve që pësojnë prej nesh, por që kjo marrëdhënie për tu përcaktuar mbetet ekskluzivitet vetëm i artistit që ja servir publikut me interesin e vetëm, atë të të zgjerimit të shpirtit ndjesor dhe konceptual.

**1-4 Qershor 2022**

Galeria e Arteve Shkoder u bë pjesë e festivalit të përvitshëm tashmë siç është dhe "*Ekrani I Artit*". Ne ambientet e sallave ekspozuese u projektuan rreth 15 projeksione videsosh artistike , dokumetarë dhe filma me metrazh të shkurtër. Ky pavion u kurua nga kuratori Zef Paci.

**18 Qershor 2022**

U prezantua Ekspozita personale ne pikture dhe skulpture e autorit Genti Tavanxhiu, i cili erdhi para publikut të Bashkisë Shkodër me një energji krijuese prej mesdhetari ku në veprën e tij , ndihet masa e një kulture të gjërë që hidhet sa në krahët e senseve filozofike aq dhe te formes se ideve.

Ai na ftoi në një udhëtim disi Odisean ku gjatë këtij rrugëtimi vepra e tij përshëndet e na mëson për Platonin , Homerin, Mikelanxhelon, Velazkesin, Magritin, Marubin dhe Lin Deline, stacione që bekohen nga një prezencë e fortë femërore e botëkuptimit të tij.

"ES" (pavetëdija, dosja e memories).

Kjo ekspozitë vjen për herë të parë për publikun e mbarsur me udhëtimet reale dhe alegorike, që gurgullojnë nga mbamendja dhe energjia mahnitëse e imagjinatës.

Ndërthurja multiforme e shprehisë artistike, si skulptura në gur, dru, apo pikturat në letër dhe pëlhurë, janë boshti qëndror i kësaj ekspozite.

Kësisoj, shpalosja e imazheve lehtëson te publiku leximin e qartë dhe pa ngurrim duke përkthyer një bote intime në lidhje të ngushtë me simbolikën e qytetit shkodran. Ato janë të pandashme nga njëra-tjetra, por rrëshqasin ashtu si prekja e një peneli nga vepra në vepër duke përcjell joshje tek shikimet dhe perceptimet ideoemotive të vëzhguesit të mprehtë. Ekspozita u kurua nga Fatmir Juka dhe Sidrit Lohja.

**12 Korrik 2022**

Duke ndjekur traditen e viteve në mbështetje të Departamentit të Arteve, në respekt të marrëveshjeve mes Bashkise Shkodër dhe Universitetit "Luigj Gurakuqi Shkodër":

Publiku pati mundësinë të njihej nga afër me punën krijuese të pedagogeve dhe studenteve të këtij departamenti. Kuratorë të kësaj ekspozite ishin Senad Xhexhovi dhe Nirvana Baja.

Ky aktivitet u mbështet nga Stafi i Galerisë së Arteve Shkodër.

**21 Korrik 2022**
U hap ekspozita personale në pikturë e autores Afeida Meta e titulluar " *META*"
Ekspozitë personale e autores e kësaj autoreje vjen si një kërkim i kaherhemi saj për të risjellë para publikut të Shkodrës një qasje ekspresive që meton kryesisht marrëdheniet e individit me botën rrethuese deri në paraqitjen disi filozofike e metafizike të të aktorëve të këtij impakti. Kjo autore me mjetin e saj piktorik e rigjen vazhdimisht veten në frymën ekspresive dhe postmoderniste duke tentuar të ndërtojë skenën e dramës së krizave personale shoqerore. Piktura e saj përvec se mban një gjest ekspresiv të fortë ajo tenton të identifikojë përmes notave të forta emocionale dhe deformimit anatomik formën e pashqueshme fizike të shpirtit që endet në këto detra të dallgëzuara. Kjo ekspozitë vjen edhe si një thirrje personale e autores ndaj shoqërisë kundrejt vetedijesimit te kesaj shoqerie per gjurmen krijuese dhe dinjitetin personal të artistit që shpesh e gjen veten të menjanuar nga përvoja e pazakontë përjetimit që ka grup shoqëror ndryshe nga përgjithshmja. Ekspozita kishte 38 punime në gjininë e pikturës. Ekspozita u kurua nga Fatmir Juka dhe Sdidrit Lohja.

**14 tetor 2022 - Albania in betëeen nga Hans Peter Jost-.**
Një ekspozitë fotografike që pasqyron nga ditët kaotike, të trazuara dhe të dhimbshme të viteve 1990 deri në ditët e sotme të këtij kapitalizmi te egër.
Shumë imazhe prekëse veprojnë si një kujtim i një kohe që nuk do të përsëritet kurrë.
Shumë gjëra nga koha e diktaturës ende nuk janë trajtuar dhe duket se qeveritë nuk ka asnjë interes real për ta bërë këtë. Mbi 80 fotografi që na njohin dhe rinjohin me tranzicionin e viteve '90 e deri në ditët e sotme. Hans Peter Jost ka punuar që nga viti 1981 si fotograf i pavarur, aktualisht edhe si sekretar i fotografëve të shtypit zviceran dhe gazetarëve.

**23 dhjetor 2022 - Bisedë me artistin dhe shkrimtarin Vladimir Myrtezai**
Galeria e Arteve mbylli vitin 2022 me një bisedë me artistin dhe pedagogun e njohur Vladimir Myrtezai. Një natë rrëfimi mes miqsh, studentëve dhe artdashësve me mendime e sonteza, analiza e pikëpyetje,ngacmime e të pathëna. Myrtezai u ndal edhe te libri i tij i fundit "*Vila Monticelli 22*".

**P08220.O3.A37 Ekrani i Artit: Festivali i Filmit në Shkodër**
Festivali i filmit, "Ekrani i Artit", vjen si një iniciativë e Art House që prej vitit 2017 në Shkodër.
Këtë vit ky festivali u organizua në 4 ditë nga data 1 Qershor deri me 4 Qershor 2022.

Nata e parë, datë 01.06.2022 filloi në Teatrin Migjeni. Në hapjen e festivalit ishte artisti Robert Bisha, I cili performoi në piano për publikun në sallë.
Filmat që u shfaqen ishin nga: Riccardo Giacconi, Diteggiatura, 2021, 18' dhe Alain Fleischer, J'ai retrouvé Christian B., 2020, 87'

Në ditën e dytë, datë 2.6.2022 u prezantua ekspozita ‘Kordelja e Kaltër’ e artistes së mirënjohur italiane, Maria Lai;Në Galerinë e Arteve Shkodër u shfaqen tre programe me video art dhe filma të shkurtër nga autorë shqiptar, të kuruar nga Zef Paci.
Në Muzeun Historik të Shkodrës u shfaqen dy punime në video nga Francis Alys;
Tek Vendi i Dëshmisë e Kujtesës u shfaq ekspozita ‘*In stillnes we rise’* me video e filma nga Mona Hatoum, Jean-Gabriele Periot, Janis Rafa dhe Gaia De Megni.
Tek Muzeu ‘Marubi’u prezantua një punim nga artistja amerikane Sharon Lockhart.
Në ambjentet e Art House u shfaq filmi “Sulle tracce di Maria Lai” 2019 56’

Si traditë e këtij festivali, darkat u zhvendosen në oborret e disa familjeve në Shkodër.
| 2 | Përmirësimi i infrastrukturës në institucionet e arsimit të mesem profesional | numri i konvikteve dhe shkollave të arsimit profesional të rikonstruktuara | 1 | 10,800 | 10,800 | 1 | 32,445 | 32,445 | 1 | 70,158 | 70,158 | 1 | 43,695 | 43,695 | 32,895 | 11,250 | -26,463 | |

## Për vitin 2022 janë planifikuar dhe realizuar aktivitetet e mëposhtme:

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | | | 000/leke |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Totali | | |
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| **P09240.O1.A1 Mbështetje për punonjësit e arsimit të mesëm profesional.& te trasheguar** | Arsimi | Realizuar | 19,816 | 19,955 | 18,857 |
| **P09240.O1.A2.Mbështetje për infrastrukturen dhe shërbimet mbështetëse arsimi te mesem profesional** | Arsimi | Realizuar | 486 | 486 | 400 |
| **P09240.O1.A3. Ngrohje dhe gatim me gaz të lëngshem për ngrohje per arsimin e mesem profesional dhe konviktet** | Arsimi | Realizuar | 1,500 | 1,500 | 1,500 |
| **P09240.O1.A4 Trajtimi ushqimor për konviktet dhe pagese kuotave financiare - bursa** | Bashkia shkodër | Realizuar | 14,888 | 14,330 | 12,717 |
| **P09240.O1.A5 Materiale në shërbim të konvikteve** | Arsimi | Nuk eshte Realizuar. | 160 | 160 | - |
| **P09240.O1.A6. Ngrohje dhe transport me lëndë djegëse karburante e arsimit të mesëm profesional.** | Arsimi | Realizuar | 5,554 | 5,554 | 5,554 |
| **P09240.O1.A7 Furnizim me energji elektrike, uje, shërbime postare, hostim web, internet e arsimit të mesëm profesional..& te trasheguar** | Arsimi | Realizuar | 22,734 | 29,121 | 24,037 |
| **P09240.O1.A8. Mirëmbajtje e rrethimeve objekteve arsimore e arsimit të mesëm profesional.** | Arsimi | Nuk eshte Realizuar.Prokurohet vitin 2023 | 4,000 | 4,000 | - |
| **P09240.O1.A9. Dezinfektimi, higjienizim dhe sigurimi i ndërtesave e arsimit të mesëm profesional** | Arsimi | Realizuar | 310 | 310 | 310 |
| **P09240.O1.A10. Mirëmbajtje e objekteve arsimore - Bojatisja .& te trasheguar** | Arsimi | Realizuar | 3,945 | 8,757 | 4,811 |
| **P09240.O1.A11. Rikonstruksioni i objektit të ish shkollës veterinare & te trasheguar** | Bashkia shkodër | Realizuar | 32,445 | 70,158 | 43,695 |
| **09240 Arsimi mesem profesional** | | | **105,838** | **154,331** | **111,882** |
| **Te trasheguara** | | | **17,843** | **-** | **-** |
| **Totali** | | | **123,681** | **154,331** | **111,882** |

## Përshkrimi i aktiviteteve:

**P09240.O1.A1 Mbështetje për punonjësit e arsimit të mesëm profesional.**

Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Shkolla duhet t'i mundësojë të gjithë fëmijëve që të kenë rezultate në mësime, të jenë të sigurtë, të shëndetshëm dhe aktivë në jetën komunitare. Numri i punonjësve faktik është i barabartë me 26 punonjës. Ky zë është realizuar sipas pagave të planifikuara për kujdestarë të konviktit dhe punonjës mbështetës si kuzhiniere, sanitare, roje, punonjës lavanderie.

**P09240.O1.A2 Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbime mbështetëse arsimi të mesëm**
Janë realizuar blerje materiale elektrike, hidraulike etj.

**P09240.O1.A3 Ngrohje dhe gatim me gaz të lëngshëm për ngrohje për arsimin e mesëm profesional dhe konviktet**
Është realizuar blerja dhe furnizimi i gazit për gatim.

**P09240.O1.A4 Trajtimi ushqimor për konviktet dhe pagesë kuotave financiare –bursa**
Është lidhur kontrata në muajin nëntor dhe është bërë furnizimi me ushqime i konviktit dhe me ushqimet gjendje në magazinë. Është bërë likujdimi i faturave në muajin Dhjetor. Ka funksionuar normalisht furnizimi nga furnitori dhe shpërndarja nga magazinë në kuzhinën e konviktit. Është respektuar kuota ushqimore.

**P09240.O1.A5 Materiale në shërbim të konvikteve**
Nuk është realizuar. Numri i nxënësve ka rënë. Materialet ekzistuese janë të mjaftueshme dhe në gjendje të mirë për këtë vit.

**P09240.O1.A6 Ngrohje dhe transport me lëndë djegëse karburante e arsimit të mesëm profesional.**
Është realizuar.

**P09240.O1.A7 Furnizim me energji elektrike, ujë, shërbime postare, hostim Web, internet e arsimit të mesëm profesional.**
Në sistemin arsimor të mesëm profesional të Bashkisë Shkodër ndodhen 3 shkolla të mesme profesionale dhe 1 konvikt.
Për administrimin e funksionimin e shkollave të arsimit të mesëm profesional kërkohet mbështetja dhe financimi për shpezimet për energji elektrike dhe ujë.
Ky zë zë peshë në shpenzimet e arsimit profesional sepse përfshihen shpenzimet për të gjitha shkollat e Bashkisë shkodër.
Është bërë pagesa në vazhdim për të gjitha shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit.
Ky zë është realizuar sipas faturave të furnitorit. Janë bërë likujdimet e akt marrëveshjeve me OSHE për shumat debitore dhe nuk kemi asnjë detyrim të prapambetur.

**P09240.O1.A8 Mirëmbajtje e rrethimeve objekteve arsimore e arsimit të mesëm profesional.**
Nuk është realizuar. Ky buxhet do të trashëgohet në vitin 2023.

**P09240.O1.A9 Dezinfektimi, higjienizim dhe sigurimi i ndërtesave e arsimit të mesëm profesional**

Është realizuar dezinfektimi i konviktit 2 herë gjatë vitit 2022 dhe është bërë sigurimi i konviktit për raste zjarri dhe tërmete.

**P09240.O1.A10 Mirëmbajtje e objekteve –Bojatisja**

Është realizuar. Likujdimi do të bëhet gjatë muajit shkurt të vitit 2023.

**P09240.O1.A11 Rikonstruksioni i objektit të ish-shkollës "Veterinare"**

Bashkia Shkodër ka aplikuar në thirrjen e IADSA II Nr. Ref: IADSAII/2019/01 (Marrëveshja Italo-Shqiptare e Konvertimit të Borxhit për Zhvillim) me afat aplikimi deri më 31.01.2020, me projektin "Shkodra Multi-Functional Services – Model of social inclusion and development of the community" ("Shërbimet Multi-Funksionale të Shkodrës – Model i përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit").

Me datën 08.07.2020 është lidhur Kontrata me Nr. Ref: IADSAII/2020/02 ndërmjet Komitetit të Menaxhimit të IADSA-s e përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Ambasadori Italian në Shqipëri, dhe Bashkisë Shkodër të përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë.

Projekti drejtohet nga Bashkia Shkodër në rolin e Liderit të Projektit dhe ka afat zbatimi 24 muaj që nga nënshkrimi i kontratës. Me partneritet prej 2 organizatash: Terres des Hommes dhe Rajoni Emilia-Romagna, qëllimi i përgjithshëm i projektit është të rikonstruktojë dhe të kthejë godinën e ish-shkollës "Veterinare" në një qendër multi-funksionale për komunitetin duke ofruar shërbime të tilla si qendër shëndetësore, kopsht, çerdhe, ambjente të përbashkëta për aktivitete apo zyra administrative.

Bashkia Shkodër ka nisur zbatimin e projektit sipas planit të punës dhe buxhetit përkatës të nënshkruar me IADSA. Vlera totale e projektit parashikohet të jetë 70,708,106 Lek, nga të cilat 43,258,039 Lek do të jenë kontribut i IADSA i ndarë në katër këste të barabarta. Gjatë periudhës së raportimit në fjalë, janë realizuar të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe bankare dhe janë kryer me sukses tre transferta me vlerë 21,629,020 Lek, nga të cilat është detyrë e Liderit të Projektit të bëjë shpërndarjen e fondit drejt partnerëve. Janë transferuar drejt partnerit Terres des Hommes (TDH) në total 1,588,418.00 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetëmijë e katërqind e tetëmbëdhjetë) Lek. Aktivitetet e projektit vazhdojnë sipas planit të punës, sipas të cilit deri më tani: i) ka përfunduar projektimi i rikonstruksionit të godinës; ii) ka përfunduar përkthimi i dokumentacionit të projektit (kontrata, buxheti dhe udhëzimi për implementimin e projektit) nga anglisht në shqip dhe u është shpërndarë drejtorive përkatëse; iii) është bërë publikimi në gazetën "Panorama" dhe në faqen web të Bashkisë Shkodër në datat 21.12.2020 dhe 17.03.2021 i njoftimit për hapjen e ofertave për rikonstruksionin e objektit; iv) është firmosur kontrata për rikonstruksionin e ndërtesës me Nr. 4321/14 Prot., datë 18.08.2021, me vlerë 36,788,707 (tridhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetëmijë e shtatëqind e shtatë) Lekë me TVSH dhe kontrata me mbikqyrësin e punimeve me Nr. 10899/17 Prot., datë 18.08.2021; punimet ndërtimore kanë filluar zyrtarisht me datë 01.09.2021. Janë likuiduar drejt

operatorit ekonomik “K. M. Konstruksion” 4 (katër) situacione me vlerë progresive 19,997,326 Lekë, ndërkohë vlera e garancisë së punimeve 5% është bllokuar nga fondet e Bashkisë Shkodër. Për shkak të ndërthurjes së punimeve me operatorin tjetër, është bërë shtyrja e kontratës deri me datë 27.05.2022. Kontrata është likuiduar e plotë me përfundimin dhe kolaudimin e punimeve.
iv) është kryer procedura e tenderimit për zërin e buxhetit 4.1.1.8 me objekt “Rikonstruksioni i objektit të ish shkollës veterinare” ku fokusi është pajisja me dyer dhe dritare , si dhe veshja e mureve të jashtëm me kapotë. Kontrata me vlerë 8,380,578 (tetë milion e treqind e tetëdhjetëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë) Lek është lidhur me datë 20.12.2021. Kontrata është likuiduar e plotë me përfundimin dhe kolaudimin e punimeve.
Partneri TDH në bashkëpunim me stafin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik të Bashkisë Shkodër ka përfunduar aktivitetet përkatëse nga ku janë përfituar 3 dokumente programatike: 1. Udhëzuesi për përfshirjen e komunitetit, 2. Udhëzuesi për strukturën menaxheriale dhe programatike të Qendrës Multi-Funksionale Komunitare dhe 3. Plani 5-vjeçar social i aktiviteteve të Qendrës Multi-Funksionale Komunitare. Është kryer rakordimi final i shpenzimeve me sukses.
Partneri Rajoni Emilia-Romagna në bashkëpunim me stafin e projektit, Universitetin e Bolonjës dhe Bashkinë Forli kanë zhvilluar modulet e trajnimit për edukatorët e kopshteve dhe çerdheve, ku një pjesë e trajnimit është kryer online nëpërmjet infrastrukturës së Qendrës Rinore “Atelie” dhe për 5 ditë gjatë qershorit ekspertët kanë vizituar kopshtet dhe çerdhet kryesore të qytetit dhe kanë përfunduar modulet e trajnimit.
Janë trajnuar 30 pjesëmarrëse, edukatorë të nivelit 0-6 të arsimit, në Qendrën Rinore “Atelie”.
Projekti ka përfunduar zyrtarisht me 7 Korrik 2022, por me Amendamentin Nr. 1 të Kontratës datë 14.09.2022 janë shtyrë procedurat e raportimit deri më 31.12.2022. Gjatë kësaj periudhe janë kryer të gjitha likuidimet dhe raportimet përfundimtare financiare dhe narrative.
Ndërkohë presim vlerësimin nga Komiteti Menaxhues i IADSA dhe kthimin e fondeve të pashpenzuara nga Rajoni Emilia Romagna. Mbyllja e llogarisë bankare do të bëhet në përfundim të rakordimeve me Komitetin Menaxhues dhe me partnerët në projekt.
Çdo muaj raportohet në Ministrinë e Financave mbi shpenzimet e kryera deri në momentin e mbylljes së llogarisë.

**Rikonstruksioni i objektit të ish shkollës veterinare (shtesë)**

Me qëllim përmbylljen e punimeve dhe mobilimin e plotë të godinës së ish-shkollës Veterinare dhe vënien në funksion të saj si një Qendër Multifunksionale, Bashkia Shkodër ka aplikuar në thirrjen e Skemës së Granteve “BE për Bashkitë” e cila drejtohet nga konsorciumi i udhëhequr nga “Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale së Evropës-Juglindore” – NALAS, dega Shqipëri, më 15.04.2022 me projektin *“Nxitja e përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit”.* Projekti me nr. ref: **EU4M-CFP1-A2** është përzgjedhur fitues për lidhjen e kontratës së grantit, e cila u nënshkrua më 23.06.2022.

Bashkia e Shkodrës ka marrë pjesë në ceremoninë e ndarjes së granteve të zhvilluar në Bashkinë Burrel më 23 qershor 2022 për nënshkrimin e kontratës së grantit. Zbatimi i projektit ka filluar zyrtarisht më 01.07.2022 me një kohëzgjatje prej 13 muajsh. Në datën 05.07.2022 u ngrit grupi i punës, i përbërë nga të gjithë specialistët specifikë të nevojshëm për realizimin e suksesshëm të projektit.

Projekti është miratuar me VKB nr. 48, datë 27.09.2022 "Për miratim shtesë plani ne buxhetin e Bashkisë Shkodër". Vlera totale e buxhetit të propozimit për Bashkinë Shkodër parashikohet të jetë 195,920 Euro (23,510,400 lekë), nga të cilat Projekti i financuar nga Bashkimi Europian, do të financojë shumën 176,225 Euro (21,147,000 lekë), kontribut i bashkisë me staf ekzistues do të jetë bashkëfinancimi në masën 10.05% në vlerën 19,695 euro (2,003,400 lekë), TVSH 20% për investime dhe garanci 5 % në vlerën 36,500 euro (4,380,000 lekë). Me shkresën nr. 17778/1 Prot., datë 24.10.2022 "Transferim fondi për shpenzime kapitale", është transferuar nga SASPAC fondi i parashikuar për bashkëfinancim në vlerën 2,367,795 lekë.

Gjatë kësaj periudhe raportimi, menaxheri i projektit ka kryer procedurat e hapjes së llogarisë së projektit në bankën e nivelit të dytë, ku është disbursuar kësti i parë nga donatori me vlerën 16,474,922.8 lekë.

Në datën 3 tetor, Bashkia e Shkodrës organizoi takimin e hapjes së projektit. Ky aktivitet synonte të prezantonte projektin para grupeve të interesit, komunitetit dhe më e rëndësishmja për donatorët të kenë një pasqyrë më të mirë të objektit që po ndërtohet dhe fushëveprimit të shërbimeve që do të ofrohen. Pjesëmarrja totale ishte rreth 35-40 persona duke përfshirë stafin administrativ nga bashkia, Drejtoria e çerdheve dhe kopshteve, përfaqësues nga OSHC që operojnë në zonë, komuniteti dhe media.

## FUNKSIONI 10: MBROJTJA SOCIALE

# Programi 10430: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:
1. Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.
2. Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike
3. Drejtorinë e Çerdheve dhe Kopshteve

### Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i programit të **"Kujdesi social për familjet dhe fëmijët".**

- Mbulim sa më të plotë të territorit me Shërbime Sociale duke u harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit. Gjithëpërfshirja, pjesëmarrja, krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, minoritetit etj. Partneriteti i ngushtë ligjor me shoqërinë civile, organizata jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2022 kanë qenë:
- O1. Mbulimi sa më i plotë i territorit, të Bashkisë, me shërbime sociale duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit.
- O2. Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me strategjitë dhe politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare
- O3. Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.
- O4. Gjithpërfshirja, pjesëmarrja, krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskrimini për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit.
- O5. Fuqizimi i institucioneve që ofrojnë shërbime sociale me orientim promovimin dhe zhvillimin e shërbimeve alternative.
- O6. Krijimi i qendrës komunitare rinore për nxitjen dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive në formim profesional e edukim, aktivitete artistike, kulturore dhe sociale për të rinjtë e Bashkisë Shkodër.
- O7. Krijimi i fondit te dedikuar për mbështetjen e personave me AN në bashkërendim me shoqërinë civile.
- O8. Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me strategjitë dhe politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare.

- O9. Fuqizimi i institucioneve që ofrojnë shërbime sociale me orientim promovimin dhe zhvillimin e shërbimeve alternative.

Në kuadër të mbulimit sa më të plotë të territorit me shërbime sociale duke siguruar gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen, krijimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimin për shkak të aftësive të kufizuara, gjinisë, origjinës, minoritetit etj., Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik ka planifikuar dhe zbaton një sërë aktivitetesh të shpërndara përgjatë të gjithë vitit.

**Realizimi i Buxhetit të planifikuar për programin "Kujdesi social për familjet dhe fëmijët":**

*000/leke*

| Programi 10430 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| PBA 2022 | 51,604 | 16,193 | 1,027,172 | 10,401 | 1,105,370 |
| Plani fillestar 2022 | 65,396 | 22,381 | 1,030,539 | 11,255 | 1,129,571 |
| Plani i rishikuar 2022 | 65,465 | 22,426 | 1,057,303 | 13,487 | 1,158,681 |
| Realizimi viti 2022 | 46,068 | 14,403 | 1,049,233 | 867 | 1,110,571 |
| % e realizimit | 70.4% | 64.2% | 99.2% | 6.4% | 95.8% |




Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 95.8 %, sipas zërave kryesorë më poshtë:

**Shpenzimet korrente** (paga+sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferime) **96.9%**
**Shpenzimet kapitale** **6.4%**




### Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Fondet e planifikuara janë realizuar në masën 95.8 %.

**Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit**

**Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022**

| Kodi i Programit | 10430 | Emertimi i programit: | Kujdesi social për familjet dhe fëmijët | | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | Mbulim sa më të plotë të territorit me Shërbime Sociale duke u harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit. Gjithëpërfshirja, pjesëmarrja, krijimi i Mundësive të Barabarta dhe Mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, minoritetit etj.:Partneriteti i ngushtë ligjor me shoqërinë civile, organizata jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti. | | | | | | | | | ..... |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | | ..... |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | | |
| *Objektivi1* | Mbulimi sa më i plotë i territorit, të Bashkisë, me shërbime sociale duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit. | | | | | | | | | ..... |
| | | 1 | Numri i fëmijëve të trajtuar në situatë rruge | 60 | 50 | 50 | 50 | 100% | | |
| | | 2 | Numri i familjeve në situatë rruge të mbështetura; | 160 | 20 | 20 | 20 | 100% | | |
| | | 3 | Numri i fëmijëve me masë mbrojtese të mbështetur nga NJMF | 0 | 5 | 5 | 9 | 180% | | |
| | | 4 | Numri i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të përfshirë në programet e përfshirjes sociale | 70 | 70 | 70 | 33 | 47% | | |
| | | 5 | Numri i takimeve të organizuara të Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN) | 30 | 30 | 30 | 20 | 67% | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 6 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese për promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe parandalimin e formave të keqtrajtimit ndaj të miturve. | 10 | 10 | 20 | 20 | 100% | |
| ***Objektivi 2*** | Bashkërendim i dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me Strategjitë dhe politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare | | | | | | | | |
| | | 7 | Numri i rasteve të referuara të dhunës në familje | 150 | 80 | 100 | 108 | 108% | |
| | | 8 | Numri i përfituesve nga funksionimi i sistemit të referimit. | 300 | 180 | 299 | 324 | 108% | |
| | | 9 | Numri i takimeve të organizuara të Ekipit Teknik ndërdisiplinor (ETN) | 9 | 10 | 10 | 8 | 80% | |
| | | 10 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese. | 20 | 42 | 40 | 43 | 108% | |
| | | 11 | Numri i pjesmarrësve në aktivitete. | 330 | 350 | 350 | 290 | 83% | |
| | | 12 | Numri organizatave pjesmarrese. | 25 | 25 | 25 | 10 | 40% | |
| | | 13 | Numri i studentëve që zhvillojnë praktikën mësimore në Bashki. | 15 | 12 | 25 | 25 | 100% | |
| ***Objektivi 3*** | Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në | | | | | | | | |
| | | 14 | Numri i takimeve periodike të tryezës konsultative. | 17 | 12 | 15 | 14 | 93% | |
| | | 15 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori. | 0 | 3 | 5 | 5 | 100% | |
| | | 16 | Numri i fëmijëve pjesëmarrës | 0 | 200 | 200 | 198 | 99% | |
| | | 17 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese për "1 Qershorin" | 0 | 5 | 5 | 2 | 40% | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | nevojë. | 18 | Numri i fëmijëve pjesëmarrës. | 250 | 250 | 250 | 300 | 120% | |
| | | 19 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese në kuadër të 8 Marsit. | 15 | 17 | 15 | 13 | 87% | |
| | | 20 | Numri i partneriteteve me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, | 23 | 5 | 5 | 5 | 100% | |
| | | 21 | Numri i familjeve përfituese | 0 | 200 | 200 | 190 | 95% | |
| | | 22 | Numri i fëmijëve përfitues qe jetojne ne institucionet rezidenciale | 80 | 80 | 80 | 63 | 79% | |
| | | 23 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese në kuadër të ditës ndërkombëtare të PAN. | 6 | 7 | 9 | 12 | 133% | |
| | | 24 | Numri i fëmijëve përfitues të shërbimeve ekzistuese dhe atyre alternative–Trendi vjetor ne % | 0 | 250 | 250 | 250 | 100% | |
| | | 25 | Numri i partneriteteve me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, | 0 | 7 | 7 | 7 | 100% | |
| | | 26 | Rritja e numrit të personave të shërbyer në vit / Të moshuar të trajtuar në vit në qendrat e shërbimeve sociale. | 160 | 50 | 150 | 159 | 106% | |
| | | 27 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese, | 10 | 3 | 12 | 12 | 100% | |
| | | 28 | Numri i partneriteteve me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse | 7 | 4 | 4 | 4 | 100% | |
| | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Objektivi 4*** | Gjithpërfshirja, Pjesëmarrja, krijimi i Mundësive të Barabarta dhe Mosdiskrimini i për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit | 29 | Numri i personave që do të marrin shërbime pranë Qëndrës Komunitare për Rom dhe Egjiptian | 500 | 500 | 500 | 420 | 84% | |
| | | 30 | Numri i jetimëve të mbështetur me rastin e festave të fundit të vitit; | 41 | 50 | 40 | 37 | 93% | |
| | | 31 | Numri i fëmijëve dhe familjeve që marrin shërbim në qendrën e specializuar për diagnostimin e hershem të fëmijëve me autizem. | 15 | 15 | 15 | 16 | 107% | |
| ***Objektivi 5*** | Fuqizimi i Institucioneve që ofrojnë Shërbime Sociale me orientim Promovimin dhe Zhvillimin e Shërbimeve Alternative. | | | | | | | | |
| | | 32 | Numri i Qëndrave sociale komunitare funksionale; | 13 | 13 | 13 | 13 | 100% | |
| | | 33 | Numri i përfituesve të shërbimeve nëqendrat. | 6,600 | 6,600 | 6,600 | 6,000 | | |
| | | 34 | Numri i Shërbimeve Alternative te ofruara. | 7 | 7 | 7 | 7 | 100% | |
| | | 35 | Numri i fëmijeve dhe familjeve përfituese. | 50 | 65 | 65 | 23 | 35% | |
| | | 36 | Numri i familjeve përfituese | 45 | 45 | 45 | 23 | 51% | |
| | | 37 | Numri i jetimëve përfitues | 0 | 8 | 8 | 5 | 63% | |
| ***Objektivi 6*** | Krijimi i qendrës komunitare rinore për nxitjen dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive ne formim profesional e edukim, aktivitete artistike, | | | | | | | | |
| | | 38 | Numri i të rinjve përfitues në shërbimet e Qëndrës Rinore. | 1000 | 1200 | 3000 | 3482 | 116% | |
| | | 39 | Numri i shërbimeve të ofruara në qëndër për të rinjtë. | 6 | 6 | 6 | 6 | 100% | |
| | | 40 | Numri të rinjve të përfshirë në organizimin dhe mbledhjen e historive | 0 | 15 | 20 | 22 | 110% | |
| | | 41 | Numri i pjesëmarresve në eventin final | 0 | 100 | 100 | 100 | 100% | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | kulturore dhe sociale për të rinjtë e Bashkisë Shkodër. | 42 | Përmirësimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimi i praktikave të mira ndërmjet partnerëve të huaj dhe aktorëve vendas në fushën e trashëgimisë kulturore. | 0 | 5 | 5 | 3 | 60% | |
| ***Objektivi 7*** | Krijimi i fondit të dedikuar per mbështetjen e personave me AN në bashkerëndim me Shoqërine Civile. | | | | | | | | |
| | | 43 | Numri i fëmijëve në nevojë që marrin pjesë dhe performojnë në aktivitetin artistiko-kulturor. | 0 | 30 | 30 | 25 | 83% | |
| | | 44 | Numri i fëmijëve në nevojë që marrin pjesë dhe performojnë në aktivitetin artistiko-kulturor. | 22 | 25 | 25 | 26 | 104% | |
| | | 45 | Numri i shtëpive familje funksionale dhe në shërbim të PAN. Shërbimet e ofruara për PAN-të në shtëpi-familje; | 8 | 8 | 8 | 8 | 100% | |
| | | 46 | Numri i klientëve të mbështetur me shërbime; | 79 | 77 | 80 | 80 | 100% | |
| | | 47 | Numri i rasteve të parandaluara drejt institucionalizimit të personave me AN | 3 | 8 | 3 | 0 | 0% | |
| ***Objektivi 8*** | Bashkërendim i dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me Strategjitë dhe politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe | | | | | | | | ..... |
| | | 48 | Numri i personave të asistuar me pagesë paaftësie | 3960 | 4800 | 3814 | 3808 | 100% | |
| | | 49 | Numri i personave të asistuar me pagesë invaliditeti; | 3282 | 3282 | 3244 | 3224 | 99% | |
| | | 50 | Numri i familjeve me kryefamiljarë gra/burra të asistuara me ndihmë ekonomike | 2019 | 2580 | 1865 | 1833 | 98% | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | shtetet kufitare. | | | | | | | | |
| ***Objektivi 9*** | Fuqizimi i Institucioneve që ofrojnë Shërbime Sociale me orientim Promovimin dhe Zhvillimin e Shërbimeve Alternative. | | | | | | | | ..... |
| | | 51 | Numri i çerdheve | 6 | 7 | 7 | 6 | 86% | |
| | | 52 | Numri i fëmijëve përfitues të shërbimit | 222 | 310 | 310 | 249 | 80% | |
| | | 53 | Numri i fëmijëve (vajza/djem që frekuentojnë çerdhet. | 101 | 150 | 150 | 114 | 76% | |
| | | 54 | Numri i stafit për fëmijë | 67 | 67 | 68 | 68 | 100% | |
| | | 55 | Numri i Cerdheve të reja dhe të rikonstruktuara | 0 | 1 | 1 | 0 | 0% | |

**ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"**

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Programi | Kujdesi social për familjet dhe fëmijët | Kodi i Programit | 10430 |

| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kodi** | **Emërtimi i Produktit** | **Njësia matëse** | **Sasia Faktike (sipas vitit 2021)** | **Shpenzimet (sipas vitit 2021)** | **Kosto për Njësi (sipas vitit 2021)** | **Sasia (sipas planit te vitit 2022)** | **Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022)** | **Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022)** | **Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022)** | **Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022** | **Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2022)** | **Sasia Faktike (viti 2022)** | **Shpenzimet Faktike (viti 2022)** | **Kosto për Njësi Faktike (viti 2022)** | **V = IV - I** | **V = IV - II** | **V = IV - III** | **Komente** |
| **1** | Ndërgjegjësim i komunitetit mbi fenomenin e lypjes | fushatë ndërgjegjësimi | 1 | 82 | 82 | 1 | 100 | 100 | 1 | 100 | 100 | 1 | 98 | 98 | 16 | -2 | -2 | |
| **2** | Numri i fëmijëve me masë mbrojtje të mbështetur nga NJMF | numër | 0 | 0 | 0 | 5 | 200 | 40 | 5 | 200 | 40 | 9 | 0 | 0 | 0 | -40 | -40 | |
| **3** | Numri i fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje të përfshirë në programet e kujdesit shoqëror të ofruar nga NJMF dhe punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve. | numër | 0 | 0 | 0 | 70 | 100 | 1 | 70 | 100 | 1 | 33 | 0 | 0 | 0 | -1 | -1 | |
| **4** | Fushatë ndërgjegjësimi kundër dhunës me bazë gjinorë, promovimi i familjes | fushatë ndërgjegjësimi | 3 | 370 | 123 | 3 | 350 | 117 | 3 | 4,801 | 1,600 | 3 | 280 | 0 | -123 | -117 | -1,600 | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **5** | Komunitet i ndërgjegjësuar për të drejtat e fëmijëve, rolin e gruas ne shoqëri, PAK | numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese | 3 | 244 | 81 | 4 | 400 | 100 | 4 | 400 | 100 | 4 | 208 | 52 | -29 | -48 | -48 | |
| **6** | Të moshuar që marrin shërbim pranë rrjetit të qendrave komunitare për familjen. | numër | 160 | 0 | 0 | 50 | 0 | 0 | 150 | 0 | 0 | 159 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| **7** | Familje Rome dhe Egjiptiane, që marrin shërbime pranë Qëndrës Komunitare | numri i personave | 500 | 0 | 0 | 500 | 200 | 0 | 500 | 200 | 0 | 420 | 83 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| **8** | Jetimë të mbështetur me rastin e festave të fundit të vitit | numri i jetimëve | 41 | 380 | 9 | 50 | 400 | 8 | 40 | 400 | 10 | 37 | 370 | 0 | -9 | -8 | -10 | |
| **9** | Fëmijë që marrin shërbim në qëndrën e specializuar për diagnostimin e hershëm të fëmijëve me autizem. | numri i fëmijëve | 15 | 2,295 | 153 | 15 | 0 | 0 | 15 | 0 | 0 | 16 | 0 | 0 | -153 | 0 | 0 | |
| **10** | Numri i Qendrave sociale komunitare funksionale; | numri i qendrave | 13 | 8,571 | 659 | 13 | 17,214 | 1,324 | 13 | 23,820 | 1,832 | 13 | 12,615 | 970 | 311 | -354 | -862 | |
| **11** | Promovimi dhe Zhvillimi i Shërbimeve Alternative. | fushatë ndërgjegjësimi | 1 | 82 | 82 | 1 | 100 | 100 | 1 | 100 | 100 | 1 | 97 | 0 | -82 | -100 | -100 | |
| **12** | Vënia në funksion e strehëzëz për fëmijët pa kujdes prindëror | jetimë përfitues | | | | 8 | 0 | 0 | 8 | 7,842 | 980 | 5 | 3,553 | 711 | 711 | 711 | -270 | |
| **13** | Shërbime të ofruara në qendër për të rinjtë | numri i shërbimeve | 6 | | | 6 | 0 | 0 | 6 | 0 | 0 | 6 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| **14** | Mbledhja dhe prezantimi i historive të persekutimeve fetare ne Shkodër gjatë periudhës së komunizmit në eventin | numri i të rinjve | | | | 15 | 1,512 | 101 | 20 | 1,512 | 76 | 22 | 867 | 39 | 39 | -61 | -36 | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | që do të organizohet. | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| **15** | Komunitet i ndërgjegjësuar në nivel vendor në trashëgiminë kulturore. | numër takimesh | | | | 5 | 0 | 0 | 5 | 1,374 | 275 | 3 | 872 | 291 | 291 | 291 | 16 | |
| **16** | Aktivitete gjithpërfshirëse për fëmijë në kuadër te festave të fundvitit | numër aktivitetesh | | | | 30 | 271 | 9 | 30 | 271 | 9 | 25 | 220 | 0 | 0 | -9 | -9 | |
| **17** | Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe” | numri i fëmijëve që marrin pjesë te trupa | 22 | 281 | 13 | 25 | 369 | 15 | 25 | 449 | 18 | 26 | 367 | 14 | 1 | -1 | -4 | |
| **18** | Numri i shtëpive familje funksionale dhe në shërbim të PAK. | numri i shtëpive familje | 8 | 35,278 | 4,410 | 8 | 36,651 | 4,581 | 8 | 39,627 | 4,953 | 8 | 36,367 | 4,546 | 136 | -36 | -408 | |
| **19** | Persona të asistuar me pagesë paaftësie dhe invaliditeti | numri përfituesve | 7,242 | 762,996 | 105 | 8,082 | 845,000 | 105 | 7,058 | 815,559 | 116 | 7,032 | 815,366 | 116 | 11 | 11 | 0 | |
| **20** | Familje dhe individë ne nevojë qe përfitojne nga skema e Ndihmes ekonomike | numri përfituesve | 2,019 | 180,963 | 90 | 2,580 | 145,000 | 56 | 1,865 | 191,972 | 103 | 1,833 | 191,774 | 105 | 15 | 48 | 2 | |
| **21** | Fëmijë përfitues të shërbimit te çerdheve | numri i fëmijëve | 222 | 42,501 | 191 | 310 | 47,502 | 153 | 310 | 56,164 | 181 | 249 | 46,496 | 187 | -5 | 33 | 6 | |
| **22** | Përmirësimi i infrastrukturës në institucionet e çerdheve | godinë | 0 | 0 | 0 | 1 | 10,001 | 10,001 | 1 | 10,001 | 10,001 | 1 | 541 | 0 | 0 | -10,001 | -10,001 | |

Për vitin 2022 në Programin **“Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”,** në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara, janë parashikuar këto aktivitete:

| Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi i Aktiviteteve | | | 000/leke |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Totali | | |
| | | | Plani fillestar 2022 | Plani i rishikuar 2022 | Realizimi 2022 |
| **P10430.O1.A1 Zbatimi i Planit lokal të Veprimit për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 100 | 100 | 98 |
| **P10430.O1.A2 Fuqizim dhe shtrirje e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 200 | 200 | - |
| **P10430. O1.A3. Koordinimi i punës për parandalimin, identifikimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik apo nevojë për mbrojtje ( Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve)** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 100 | 100 | - |
| **P10430.O2.A1. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 200 | 200 | 200 |
| **P10430.O2.A2. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 50 | 50 | - |
| **P10430.O2.A3. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| **P10430.O2.A4. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 100 | 100 | 80 |
| **P10430.O2.A5 TVESA@SH– Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër(TVESA@SH)** | Bashkia Shkodër | Prokurime qe janë në proçes | - | 4,451 | - |
| **P10430.O3.A1.Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës;** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| **P10430.O3.A2. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 50 | 50 | 41 |
| **P10430.O3.A3. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qershori"** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| **P10430.O3.A4.Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 150 | 150 | - |
| **P10430.O3.A5.Bashkëpunimi me** | Bashkia | Realizuar | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Fondacionin "Shpresë për botën", për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.** | Shkodër | | - | - | - |
| **P10430.O3.A6. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor.** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 200 | 200 | 167 |
| **P10430.O3. A7. Kujdesi social ndaj moshës së tretë** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| **P10430.O4.A1 Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 200 | 200 | 83 |
| **P10430.O4.A2 Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 400 | 400 | 370 |
| **P10430.O4.A3 . Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| **P10430.O5.A1. Ngritja , vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare "Për Familjen" & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 17,214 | 23,820 | 12,615 |
| **P10430.O5.A2. Shërbime alternative për fëmijët dhe familjen.** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 100 | 100 | 97 |
| **Projekti: P10430.O5.A3 Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 7,842 | 3,553 |
| **P10430.O6.A1 Qendra Rinore "Atelie"** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| **Projekti: P10430.O6.A2**<br><br>**PEOPLE– Histori personale të diskriminimit dhe persekutimit nën regjimet totalitare të shekullit XX**<br><br>**(PEOPLE - Personal stories of discrimination and persecution under the totalitarian regimes of the XX century)** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,512 | 1,512 | 867 |
| **Projekti: P10430.O6.A3**<br>**FARO - Trashëgimi të ndryshme në qytezat europiane - Krijimi i një rrëfimi të identiteteve europiane të kontestuara përmes pjesëmarrjes së qytetarëve .**<br>**(FARO - The Dissonant Heritage in European Towns - Creating a European narrative of contested identities through citizen's participation . )** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 1,374 | 872 |
| **P10430.O7. A1. "Asnjë Fëmijë Jashtë"** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 271 | 271 | 220 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **P10430.O7.A2. Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi te kufizuar" & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 369 | 449 | 367 |
| **P10430.O7.A3 Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 16,600 | 17,814 | 16,337 |
| **P10430.O7.A4. Projekti "Shpresa" për përsonat e braktisur dhe me aftësi ndryshe; & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 20,051 | 21,813 | 20,031 |
| **P010430.O8.A1. Pagese PAK dhe Invaliditeti .** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 845,000 | 815,559 | 815,366 |
| **P10430.O8.A2. Ndihma ekonomike** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 145,000 | 191,972 | 191,774 |
| **P10430.O9.A1.Administrimi dhe funksionimi i cerdheve & te trasheguara** | Drejtoria e Cerdheve dhe Kopshteve | Realizuar | 47,502 | 56,164 | 46,496 |
| **P10430.O9.A2. Rikonstruksioni i Çerdhes "Manush Alimani".** | Bashkia Shkodër | Prokurime që do të mbarten për vitin 2023 zbatimi | 10,001 | 10,001 | 541 |
| **10430 Kujdesi social per familjet dhe femijet** | | | **1,105,370** | **1,154,892** | **1,110,175** |
| **Te trasheguara** | | | **24,201** | **3,789** | **396** |
| **Totali** | | | **1,129,571** | **1,158,681** | **1,110,571** |

- **P10430.O1.A1** Zbatimi i Planit lokal të Veprimit për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.

Në kuadrin e nënshkrimit të Marrëveshjes Bashkëpunimit midis MMSR, MAS dhe MPB "Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge dhe Planit Kombëtar të Veprimit "Ndihmë për Familjet dhe Fëmijët në situatë rruge", është hartuar dhe vazhdon të zbatohet Plani lokal i veprimit, ku bashkia (NJMF), ka përgjegjësinë kryesore për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve dhe koordinimin e punës ndërmjet institucioneve përgjegjëse, brenda territorit të qytetit. Vazhdojnë të funksionojnë skuadrat e terrenit me përfaqësues të Bashkisë Shkodër, stafi i qendrave komunitare, përfaqësues të Policisë dhe organizatave partnere të shoqërisë civile të cilët janë trajnuar, kanë qenë dhe janë prezent në territor sipas një kalendari të paracaktuar. Në zbatim të ligjit 18/2017 " Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", Bashkia Shkodër po koordinon Mbledhjet e Grupit Teknik Ndërsektorial me përfaqësues nga të gjitha institucionet publike vendore dhe organizatat partnere ku janë diskutuar rastet për çdo familje të fëmijëve në situatë rruge. Gjithashtu janë hartuar plane individuale ndërhyrjeje për fëmijët në situatë rruge me qëllim mbështetjen dhe përmirësimin e situatës së këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre. Nr. i fëmijëve të identifikuar në situatë rruge si dhe të mbështetur është 40. Për secilën familje të identifikuar janë ofruar ndihma në veshmbathje, ushqime, asistencë ligjore, ndërmjetësim për punësim, ndihmë ekonomike, rregjistrim i fëmijëve në shkollë dhe kopshte, monitorim për frekuentimin dhe ecurinë e fëmijeve në shkollë sipas vlerësimeve dhe planeve individuale të ndërhyrjes. Në ditën ndërkombëtare të fëmijëve në

situatë rruge, me datë 12 prill, u zhvillua një aktivitet ndërgjegjësues, në sheshin para bashkisë, i cili kishte si qëllim rritjen e ndërgjegjesimit ndaj fenomenit të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve duke përfshirë dhe fëmijët në situatë rruge. Ky aktivitet u zhvillua në formën e një panairi ku u pasqyruan shërbimet që ofrohen pranë qendrave tona komunitare për fëmijët dhe familjet në nevojë dhe u shpërndanë materiale promocionale që përcjellin mesazhin "Mos dhuro para, dhuro kujdes". Ky mesazh sensibilizues u përcoll edhe përmes mediave lokale dhe atyre sociale. Gjithashtu me datë 8 prill, Dita ndërkombëtare e Romëve, u zhvilluan aktivitete ndërgjegjësuese në Qendrën Komunitare Multifinksionale "Për familjen", për të promovuar kulturën e traditat rome dhe njëkohësisht për të promovuar integrimin dhe perfshirjen e tyre sociale.

- **P10430.O1.A2** Fuqizim dhe shtrirje e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

Njësitë e qeverisjes vendore kanë autoritetin për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative stuktura të posaçme për mbrojtjen e fëmijëve sipas Ligjit Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës". Në Bashkinë Shkodër vazhdon të jetë funksionale njësia e mbrojtjes së fëmijëve si një njësi e posaçme brenda strukturës së drejtorisë së shërbimeve sociale dhe ka për detyrë parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje. Për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, drejtori i strukturës përgjegjëse ose punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve mbledh grupin teknik ndërsektorial, të cilët janë aktorët përgjegjës për zbatimin e masave të mbrojtjes së fëmijës si dhe për zbatimin e planit individual të mbrojtjes për ndjekjen dhe menaxhimin e rastit.
Gjatë vitit 2022 janë organizuar mbledhje të grupit teknik ndërsektorial me qëllim trajtimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje si dhe janë marrë masa emergjente dhe mbrojtëse për fëmijët në nevojë për mbrojtje, duke vendosur fëmijën pranë një strukture të përkujdesjes alternative. Në zbatim të Ligjit Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" neni 46 pika gj bashkitë janë përgjegjëse për fiancimin e Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës dhe Planit për Aftësim Prindëror. Në këtë kuadër për funksionimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, Bashkia Shkodër ka planifikuar të financojë shërbimet sociale mbështetëse, si pako ushqimore dhe higjeno- sanitare, si dhe veshmbathje për fëmijët me masë mbrojtëse dhe familjen me qëllim fuqizimin social ekonomik të familjes si qeliza bazë e shoqërisë.

- **P10430. O1.A3.** Koordinimi i punës për parandalimin, identifikimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik apo nevojë për mbrojtje (Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve)

Njësitë e qeverisjes vendore kanë autoritetin për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative stuktura të posaçme për mbrojtjen e fëmijëve sipas Ligjit Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës". Në Bashkinë Shkodër vazhdon të jetë funksionale njësia e mbrojtjes së fëmijëve si një njësi e posaçme brenda strukturës së drejtorisë së shërbimeve sociale dhe ka për detyrë parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje. Për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, drejtori i strukturës përgjegjëse ose punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve mbledh grupin teknik ndërsektorial, të cilët janë aktorët përgjegjës për zbatimin e masave të mbrojtjes së fëmijës si dhe për zbatimin e planit individual të mbrojtjes për ndjekjen dhe menaxhimin e rastit.

Gjatë vitit 2022 janë organizuar mbledhje të grupit teknik ndërsektorial me qëllim trajtimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje si dhe janë marrë masa emergjente dhe mbrojtëse për fëmijët në nevojë për mbrojtje, duke vendosur fëmijën pranë një strukture të përkujdesjes alternative. Në zbatim të Ligjit Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" neni 59 pika 4 punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së vendimit për masën përkatëse të mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, depoziton në gjykatën kompetente kërkesën për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose të masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, e cila përmban edhe kërkesën për vendosjen e fëmijës në kujdestari. Gjykata shqyrton dhe vendos, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës përkatëse nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, për vlefshmërinë e masës se mbrojtjes duke shqyrtuar edhe ankimet përkatëse të paraqitura nga palët. Kur gjykata vendos dhënien e masës së mbrojtjes, atëherë ajo vazhdon gjykimin edhe për shqyrtimin e kërkesës për vendosjen e fëmijës në kujdestari, sipas legjislacionit në fuqi. Me qëllim marrjen e vendimit të gjykatës për caktimin e kujdestarisë ligjore të të miturit në nevojë për mbrojtje, kërkohët mendimi i një eksperti psikolog i paanshëm sipas listës të vënë në dispozicion nga ana e Gjykatës që të realizojë vlerësimin lidhur me kujdestarinë ligjore të të fëmijës në nevojë për mbrojtje. Caktimi i shpenzimeve për ekspertët në gjykatë bazohet në Udhëzim nr 4 datë 12.12.2012 "Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesat e ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë proçesit gjyqësor".

- **P10430.O2.A1.** Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.

Njësitë e qeverisjes vendore, si autoritete përgjegjëse në luftën kundër dhunës në familje, kanë detyrim ligjor ngritjen dhe funksionimin e sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. (Ligji nr.9669 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar me ligjin nr.47/2018 dhe VKM nr. 334, datë 17. 02. 2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit tij", i ndryshuar me VKM Nr.327, datë 02.06.2021). Në bashkinë e Shkodrës, që në shkurt të vitit 2017, nga drejtuesit e institucioneve vendore, rajonale dhe organizatave të shoqërisë civile që veprojnë me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, është arritur firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit për riorganizimin dhe ngritjen e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e proçedimit të tij. Në kuadër të ndërgjegjësimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, Bashkia Shkodër ka realizuar një sërë aktivitetesh për ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore gjatë këtij periudhe. Janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas një kalendari të paracaktuar. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare "Për Familjen", shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë

Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj.Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Krahas këtyre aktiviteteve, fushatat e komunikimit online, me qëllim rritjen e informimit dhe sensibilizimit të komunitetit për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, janë organizuar vazhdimisht përgjatë të gjithë kësaj periudhe me anë të postimeve në mediat sociale të Bashkisë Shkodër dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Bashkia Shkodër për këtë periudhë ka trajtuar, menaxhuar dhe monitoruar 86 raste të reja të pajisura me urdhër mbrojtje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Gjithashtu ka vazhduar trajtimi i 32 rasteve nga viti 2021. Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe konsolidimi i tyre. Për të gjithë rastet janë hartuar dhe dërguar raportet përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër. Në varësi të nevojave viktimat e dhunës në familje, kanë marrë mbështetjen e duhur psikologjike dhe ligjore nga stafi i Qendrave Komunitare “Për familjen” të Bashkisë Shkodër dhe organizatat partnere që ofrojnë të tilla shërbime në Bashkinë Shkodër.

- **P10430.O2.A2.** Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj.

Në Ditën Ndërkombëtare të Familjes në gjithë botën organizohen aktivitete në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, që kanë në fokus familjen, duke e përqëndruar vëmendjen tek proceset shoqërore, ekonomike dhe demografike që prekin familjet. Gjithashtu fokusi i kësaj dite është promovimi i vlerave të familjes, nxitja e barazisë midis grave dhe burrave në familje, mbrojtja e familjes si njësi bazë e shoqërisë dhe mundësia për të ndihmuar familjet për të përmbushur përgjegjësinë e tyre për komunitetin ku bëjnë pjesë. Në territorin e Bashkisë së Shkodrës, ekziston një numër i madh familjesh në vështirësi të theksuara sociale e ekonomike. Situata në të cilën ndodhen këto familje vjen si shkak i ndikimit të një sërë faktorësh si: niveli i ulët arsimor, kulturor, ekonomik, etj. Si pasojë të faktorëve të lartpërmendur, këto familje shpesh herë kanë mungesë informacioni, nuk marrin interesim për shërbimet sociale që ofrohen në territor dhe jetojnë në kushte ekstreme varfërie. Duke qenë se Bashkia e Shkodrës që nga viti 2016, arriti ngritjen dhe vënien në funksion të qendrave komunitare të quajtura ”Për Familjen”, duke parë familjen si qeliza bazë për zhvillimin e komunitetit, sivjet në kuadër të ditës ndërkombëtare për familjen është realizuar një javë me aktivitete nën moton ”Familja asht dashni”. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

- **P10430.O2.A3.** Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë.

Në universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në degët e psikologjisë, punës sociale, fizioterapisë dhe infermierisë, çdo vit regjistrohen rreth 50 studentë në secilën degë. Në vitin e

tretë të studimeve bachelor, gjatë gjithë vitit akademik, studentët zhvillojnë lëndën e “Praktikumit”. Një lëndë e tillë është me shumë rëndësi për përfitimin e njohurive praktike në fushat përkatëse. Gjithashtu pas përfundimit të studimeve në ciklin bachelor, ka shumë rëndësi praktika e njohurive të marra gjatë viteve të studimit. Bashkia e Shkodrës ka arritur një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ku pjesë e kësaj marrëveshje ka qenë bashkëpunimi për ofrimin e një praktike sa më profesionale dhe të vlefshme për zhvillimin akademik e profesional të studentëve. 25 studentë: 18 të nivelit bachelor dhe 7 të nivelit master kanë zhvilluar praktikën profesionale pranë shërbimeve sociale dhe kanë kontribuar në aktivitetet e planifikuara pranë qendrave komunitare “Për Familjen”. Një eksperiencë e tillë ka rezultuar shumë pozitive për të dyja palët. Nëpërmjet institucionalizimit të këtij bashkëpunimi, studentët ofrojnë njohuritë e tyre në shërbim dhe në përputhje me nevojat e komunitetit, duke filluar kështu të fitojnë aftësitë bazë të profesionit tyre.

- **P10430.O2.A4.** Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.

Barazia e grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore për të gjithë dhe një vlerë thelbësore për çdo demokraci. Për t’u arritur kjo e drejtë, duhet që ajo jo vetëm të njihet me ligj, por edhe të zbatohet me efektivitet në të gjitha sferat e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Me gjithë rastet e shumta të njohjes zyrtare dhe përparimin e bërë, barazia e grave dhe burrave në jetën e përditshme ende nuk është bërë realitet. Gratë dhe burrat nuk gëzojnë të drejta të njëjta në praktikë. Ende vazhdojnë të ekzistojnë pabarazitë shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore. Këto pabarazi janë rezultat i disa nocioneve shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipave të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, mjetet e komunikimit, në botën e punës, në organizimin e shoqërisë. Janë aq të shumta fushat e jetës në të cilat mund të veprohet, përmes përdorimit të një qasjeje të re dhe realizimit të ndryshimeve strukturore. Për këtë, Bashkia e Shkodrës, pas nënshkrimit të kartës evropiane për barazi gjinore, është angazhuar në hartimin dhe miratimin e planit vendor gjinor si një mjet i rëndësishëm i zbatimit në praktikë të angazhimeve publike të ndërmarra nga Bashkia Shkodër në lidhje me parimet e barazisë, planifikimit dhe zbatimit të nevojave dhe të të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet e shoqërisë. Gjatë kësaj periudhe janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas një kalendari të paracaktuar. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

- **P10430.O2.A5** TVESA@SH– Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër(TVESA@SH)

Projekti: “Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër (TVESA@SH)”, zbatohet nga organizata Të Ndryshëm të Barabartë në rolin e Liderit të Projektit, ku Bashkia Shkodër dhe organizata KMOP (Greqi) janë partnerë. Projekti është përzgjedhur për financim në kuadër të thirrjes për propozime: EuropeAid/170610/DD/ACT/AL – “Partneritete në nivel lokal për avancimin e përfshirjes sociale në Shqipëri”, i financuar nga Bashkimi Evropian me fonde të programit IPA. Ky projekt sa i takon pjesës së Bashkisë Shkodër parashikon ndërhyrjen në infrastrukturën e qendrës komunitare “Për Familjen” Nj.A. Dajç, fshati Shirq, si dhe fuqizimin e kësaj qendre duke ofruar shërbime në ndihmë të grave dhe fëmijëve viktima të dhunës të të gjithë bashkisë.
Buxheti total i projektit është 39,651,431.8 Lekë, nga të cilat financimi i Bashkimit Evropian do të jetë në masën 90% të kostove të pranueshme në vlerën 35,686,290.3 Lekë. **Buxheti i dedikuar për Bashkinë Shkodër është në vlerën 8,739,629.5 Lekë nga të cilat 90% në vlerën 7,865,673.7 Lekë do të financohen nga donatori dhe 10% do të jetë bashkëfinancim I Bashkisë Shkodër me anë të burimeve të veta (staf ekzistues).**

Shpenzimet e TVSH-së dhe garancisë 5% të punimeve nuk njihen si kosto të pranueshme nga donatori. Fondi me vlerë 447,000 lekë i cili mbulon vlerën e TVSH-së dhe garancisë 5% të punimeve, është marrë nga teprica e fondeve nga buxheti i miratuar tek programi 9240 “Arsimi i mesëm profesional”, artikull 231, me kod projekti 1410562 me emërtim “Rikonstruksioni i objektit të ish-shkollës veterinare”, kontrata me Nr. 18397/12 Prot., datë 20.12.2021 me vlerë 10,056,694 lekë. Ky fond kalon tek programi 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, kod 231, me emërtim “Mbulim i vlerës TVSH dhe 5% garanci”.

Projekti është miratuar me VKB nr. 49, datë 27.09.2022 “Për miratim shtesë plani ne buxhetin e Bashkisë Shkodër”. Gjatë kësaj periudhe janë kryer procedurat e hapjes së llogarisë në bankën e nivelit të dytë, ku është transferuar kësti i parë me vlerë 3,867,458 lek. Me shkresën nr. 17778/1 Prot. Datë 24.10.2022 “Transferim fondi për shpenzime kapitale”, është transferuar nga SASPAC fondi i parashikuar për bashkëfinancim në vlerën 882,205 lekë.
Gjatë periudhës raportuese është zhvilluar 1 mbledhje e Komitetit Drejtues të projektit ku janë vendosur priotitetet, janë përcaktuar përmbajtjet për materialet promocionalë, janë diskutuar gjetjet nga analiza e nevojave që u është bërë stafit të bashkisë, dhe janë finalizuar disa nga figurat profesionale të punësuar në Shkodër por të kontraktuar nga organizata Të Ndryshëm Të Barabartë: 1. Punonjës Social 2. Koordinator për Fuqizimin Ekonomik.

- **P10430.O3.A1.**Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës.

Në qytetin e Shkodrës, ndodhen e funksionojnë një sërë organizatash të shoqërisë civile që ofrojnë shërbim në mbështetje të grupeve sociale në nevojë; fëmijëve, të rinjve, grave e burrave, personave me aftësi ndryshe, komunitetit rom dhe egjiptian, moshës së tretë, etj. Viti 2016 ishte

një vit i rëndësishëm i fillimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionalizimit të partneritetit me to. Gjatë këtyre viteve është konsoliduar aktiviteti i tryezave konsultative dhe zhvillimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile. Me synim koordinimin e aktiviteteve dhe shërbimeve në territorin e Bashkisë së Shkodrës, janë planifikuar dhe organizuar tryeza konsultative me shoqërinë civile. Gjatë kësaj periudhe tryezat konsultative janë organizuar për planifikimin e aktivitetetevë në kuadër të zbatimit të kartës evropiane për barazinë gjinore, 8 marsit, 8-12 prillit, 15 majit, 1 qershorit dhe në zbatim të projekteve të reja që po zbatohen në Bashkinë e Shkodrës nga organizatat partnere. Tashmë ka një proces të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të konsultimit përmes takimeve ku qëllimi i këtyre tryezave ka qenë ndërhyrja e integruar në ofrimin e shërbimeve, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe mbulimi i territorit me shërbime.

**P10430.O3.A2.** Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.

20 Nëntori "Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve" synon të promovojë mirëqenien e fëmijëve, të parandalojë çdo formë dhune apo abuzimi ndaj fëmijëve. Këto aktivitete ndërgjegjësuese kanë qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e fëmijëve. Bashkia Shkodër si çdo vit ka organizuar aktivitete ndërgjegjësuese dhe argëtuese me fëmijët e shkollave dhe qendrave Komunitare "Për familjen". Në bashkëpunim me Zyren Vendore Arsimore u realizuan aktivitetet ndergjegjesuese në ambjentet e shkollës ''Ismail Qemali'' dhe shkollës ''Skenderbeg''. Fëmijët e shkollave përmes performancave dhe punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve përcollën mesazhe mbi të drejtat e fëmijëve. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është ndërgjegjësimi i fëmijeve për të drejtat e tyre. Fëmijët janë një target grup që shumë lehtë mund të jenë pre e keqtrajtimeve dhe dhunës e për këtë është e nevojshme që të informohen në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të tyre.

- **P10430.O3.A3.** Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qershori"

Një Qershori është dita ndërkombëtare e fëmijëve. Këtë ditë fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë që të jenë të lumtur e të festojnë me familjen, me prindërit, me vëmendjen dhe përkujdesjen e nevojshme për realizimin e dëshirave tyre. Kjo ditë përveç se është një ditë festive, është një ditë sensibilizimi për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Bashkia e Shkodrës organizoi aktivitete festive dhe ndërgjegjësuese që lidhen me mirëqenien e fëmijëve, njohjen dhe respektimin e të drejtave në familje, shkollë, shoqëri dhe në të gjitha shërbimet që ofrohen për fëmijët.

- **P10430.O3.A4.** Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi.

8 Marsi njihet si "Dita e Gruas", në të gjithë botën. Në këtë ditë reflektohet mbi kurajon dhe veprimet e grave të thjeshta të cilat luajtën një rol të rëndësishëm në historinë e të drejtave të grave. Në Ditën Botërore të Gruas, në ditët e sotme, ashtu si në të shkuarën, punohet për barazinë gjinore të gruas, pavarësinë e saj, eliminimin e padrejtësive politike, për kushte më të mira pune dhe jetese. Për herë të parë 8 Marsi në Shqipëri u kremtua në vitin 1942 të shekullit të XX-të në grupe të vogla grash. Në kuadër të 8 marsit, Ditës Ndërkombëtare të gruas u realizua një fushatë ndërgjegjësuese e shtrirë përgjatë të gjithë javës nën moton “Barazi gjinore sot, për një të nesërme të qëndrueshme”. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Synimi i kësaj fushate ishte promovimi i rolit të gruas në shoqëri.

- **P10430.O3.A5.** Bashkëpunimi me Fondacionin “Shpresë për botën”, për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me organizatën “Shpresë për botën”, që ka si qëllim mbështetjen e 3 institucioneve rezidenciale: Shtëpisë së foshnjës, Shtëpisë së fëmijës shkollor dhe Qendrës së zhvillimit, është arritur që të përmirësohet cilësia e jetës së fëmijëve dhe të rinjve që jetojnë në institucionet rezidenciale, si dhe është rritur pjesëmarrja e fëmijëve në aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe sportive, me qëllim integrimin e tyre. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar një sërë aktivitetesh social kulturore me fëmijët në raste festash si dhe janë organizuar festime për ditëlindjet për fëmijët në këto institucione. Vazhdon të ofrohet mbështetje me transport për të mundësuar takimet e fëmijët me prindërit biologjikë me qëllim mbajtjen dhe fuqizimin e lidhjeve afektive mes tyre. Këto aktivitete janë organizuar gjatë gjithë vitit në të tre institucionet rezidenciale të Bashkisë Shkodër. Për disa fëmijë është mundësuar të realizohet takimi me familjet biologjike pranë banesave të tyre në Bashkinë Tiranë.

- **P10430.O3.A6.** Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor.

3 Dhjetori - Dita Botërore e Personave me Aftësi të kufizuar, synon ndërgjegjësimin e institucioneve, shoqërisë civile, donatorëve, por edhe të mbarë komunitetit për t’u bërë pjesë dhe për t’u përfshirë në proçesin e integrimit të personave me aftësi të kufizuar në jetën politike, sociale, ekonomike e kulturore. Në kuadër të ditës ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuar janë organizuar disa aktivitete. Qëllimi ynë është mposhtja e të gjitha barrierave, jo vetëm barrierat fizike të betonit, por ato kulturore dhe sociale të cilat pengojnë integrimin e personave me aftësi të kufizuara në fusha të ndryshme të jetës. Nën moton “Të hapim dyert, thyejmë barrierat”, janë organizuar disa aktivitete. Kjo ditë synon ndërgjegjësimin e

institucioneve, shoqërisë civile, donatorëve, por edhe të mbarë komunitetit për t'u bërë pjesë dhe për t'u përfshirë në proçesin e integrimit të personave me aftësi të kufizuar në jetën politike, sociale, ekonomike e kulturore

- **P10430.O3. A7.** Kujdesi social ndaj moshës së tretë

Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve është një ditë e veçantë për personat e moshës së tretë në të gjithë botën. Pleqëria është një prej rregullave të pandryshueshme të krijimit dhe një nga periudhat e rëndësishme të ciklit të jetës. Diskutimet janë përqëndruar në tema të tilla si: plakja e popullsisë dhe ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat e kësaj moshe, puna vullnetare, kujdesi social dhe gjetja e mënyrave sa më përfshirëse për personat e moshuar, në fuqinë punëtore. Një problem shqetësues në vendin tonë është ndryshimi i dinamikave brenda familjes shqiptare, ku si pasojë e ndryshimeve dhe zhvillimeve social-ekonomike, kulturore, etj, fëmijët kanë prirje për të jetuar vetëm, për të emigruar dhe për t'u shkëputur nga familja. Një ndryshim i tillë në konceptin dhe traditën e familjes shqiptare, ka bërë që të kemi një rritje të të moshuarve që jetojnë vetëm, pa përkujdesjen dhe vëmendjen e nevojshme. Nuk ka të dhëna mbi numrin e saktë të moshuarve që jetojnë në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Një pjesë e madhe e kësaj kategorie jetojnë në shtëpi, vetëm, shpesh pa përkujdesje të veçantë dhe në varfëri e në kushte shumë të papërshtatshme. Pranë qendrës komunitare "Për Familjen" Nr.4, Bashkia e Shkodrës ofron shërbime ditore, të cilat konsistojnë në: informim, këshillim për problemet shëndetësore kryesore që prekin moshën e tretë, mundësi për kohën e lirë, ofrim çaji, kafeje, shtyp i ditës, pjesëmarrje në aktivitete social-kulturore, etj. Të moshuarit marrin rregullisht këshilla mjekësore dhe bëjnë vizita periodike për matjen e presionit të gjakut dhe të glicemisë në gjak. Festojnë rregullisht ditëlindjen duke organizuar festa ose dreka në ambjentet e qendrës dhe jashtë saj. Ndërkohë gjatë vitit 2022 është arritur shtrirja e këtij shërbimi edhe në një qendër tjetër komunitare. Tashmë në Qendrën Komunitare "Për Familjen" Nr.3 janë në dispozicion 2 hapësira, të cilat ofrojnë shërbime ditore për të moshuarit e lagjes nr.3.

- **P10430.O4.A1** Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian.

Ka vazhduar edhe gjatë vitit 2022 ofrimi i shërbimeve sociale, integruese dhe mbështetëse pranë Qendrës Komunitare Multifunksionale "Për familjen" për komunitetin rom dhe egjiptian. Qendra Komunitare Multifunksionale "Për Familjen" për komunitetin rom dhe egjiptian është vënë në funksion të plotë dhe ofron shërbime specifike për komunitetin rom dhe egjiptian. Numri total i përfituesve të shërbimeve në këtë qendër është 420 përfitues, nga të cilat 390 i përkasin komunitetit rom dhe 30 i përkasin komunitetit egjiptjan. Fëmijët që përfitojnë shërbime integruese gjatë frekuentimit të qendrës Multifunksionale janë 80 fëmijë, të cilët mbështeten çdo ditë me lehtësues në komunitet, transport në shkollë/kopësht, vakte ushqimore, klasa passhkollore aktivitete dhe lojra psiko-sociale. Për çdo fëmijë përfitues të shërbimeve të qendrës është bërë i mundur organizimi dhe festimi i ditëlindjes së tij në qendër. Gjithashtu këto fëmijë

janë pjesë e aktiviteteve sociale dhe argëtuese, lojra psiko sociale që zhvillohen në qendër dhe jashtë saj.  Bashkia Shkodër në bashkëpunim edhe me organizatat partnere organizon çdo vit aktivitetin kamp veror. Gjatë vitit 2022 fëmijët dhe familjet e komunitetit rom/egjiptjan të cilat janë përfituese të Qendrës Multifunksionale kanë vizituar qytete edhe vende turistike si: pika turistike e Razmës, Lumi i Jetës në Dajç si dhe Librarinë lundruese  në Durrës. Fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptjan që mbështeten nga Qendra Komunitare Multifunksionale, që janë rregjistruar në arsimin parashkollor dhe atë të detyrueshëm për vitin shkollor 2022- 2023 janë: 141 të rregjistruar në shkollë dhe 40 fëmijë janë regjistruar në kopsht. Të gjithë fëmijët e rregjistruar në shkollë janë mbështetur në fillim të vitit shkollor me çanta dhe materiale shkollore, nga Bashkia Shkodër në bashkëpunim me organizatat partnere. Gjithashtu në Qendrën Komunitare Multifunksionale ofrohen edhe klasa prindërimi dhe fokus grupe kryesisht me prindër të fëmijëvë që frekuentojnë Qendrën. Gjatë këtyre takimeve diskutohen dhe trajtohen tema në përshtatje me problematikat e hasura më shpesh. Nr. i përfituesve të klasave të prindërimit është 50 prindër të komunitetit rom dhe egjiptjan. Familjet rome/egjiptjanë fëmijët e të cilave kanë frekuentuar rregullisht shkollën/kopshtin janë mbështetur çdo muaj me pako ushqimore dhe higjenike. Përveç këtyre familjeve në fundvit janë mbështetur edhe 24 familje R/E me pako ushqimore. Janë trajtuar 17 raste të miturish në konflikt/kontakt me ligjin gjatë vitit 2022. Kanë përfituar pagesën e urdhërit të mbrojtjes gjithsej 7 përfitues. Gjatë vitit 2022 është arritur strehimi i 24 familjeve (142 banorë ) të cilët janë të rregjistruar si banorë të Bashkisë Shkodër. Banesat janë tip 1+1 dhe 2+1

- **P10430.O4.A2**  Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit.

Në territorin e Bashkisë së Shkodrës ofrojnë shërbim rezidencial për fëmijë pa përkujdes prindëror 3 institucione të ndryshme të ndara sipas grupmoshave. Këto institucione ofrojnë shërbime për të rinjtë deri në moshën 18 vjeçare. Bashkia e Shkodrës në vitin 2017 ka aplikuar, fituar dhe zbatuar projektin për ristrukturimin e godinës së ish konviktit të shkollës pyjore, pranë MZHU, me qëllim strehimin dhe ofrimin e kushteve sa më të mira banimi për jetimët e dalë nga strukturat rezidenciale dhe që jetojnë në konviktet e shkollave të mesme të qytetit. Aktualisht janë të gatshme dhe janë vënë në funksion 24 apartamente sociale për strehimin e jetimëve dhe grave kryefamiljare. Gjithashtu, në ndihmë të kësaj shtrese është shpërndarë ashtu si vitet parardhëse shpërblimi i jetimëve të dalë nga strukturat rezidenciale dhe jo vetëm, banorë të Bashkisë Shkodër, me rastin e festave të fundvitit. Qëllimi i kësaj ndihme është lehtësimi i situatës së tyre ekonomike dhe krijimi i një atmosfere sa më të mirë festive.

- **P10430.O4.A3** Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ.

Autizmi është një sëmundje e cila karakterizohet nga çrregullime të marrëdhënieve sociale, të komunikimit dhe sjellje e lëvizje stereotipike. Autizmi po përhapet në mënyrë të shpejtë duke u

shndërruar në një sfidë për shëndetin publik në mbarë botën për shkak të kostove shoqërore dhe ekonomike. Njohuritë për autizmin në shërbimin shëndetësor e më tepër në popullatën shqiptare janë shumë të pakta dhe nuk është e qartë se rritja e rasteve është rezultat i shtimit real të rasteve apo diagnostikimit më të mirë. Në Shqipëri shifrat janë në rritje, por nuk ka të dhëna të sakta. Specialistët e shëndetësisë bëjnë thirrje për sensibilizimin e opinionit publik për diagnostikimin e hershëm, përkrahjen ndaj fëmijëve autikë dhe integrimin e tyre në shoqëri. Në Shkodër nuk ka pasur një shërbim të specializuar për trajtimin e fëmijëve me autizëm që të mundësojë mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve integruese në moshë sa më të hershme në shërbimet edukuese parashkollore dhe shkollore. Gjatë vitit 2019, Bashkia Shkodër është shpallur fituese me projektin "Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë e Shkodrës" në kuadër të thirrjes për projekte "Askush të Mos Mbetet Pas", një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Kanë përfunduar punimet për përshtatjen e ambjenteve fizike për ofrimin e shërbimeve, është siguruar mobilimi i ambjenteve, përzgjedhja e stafit dhe trajnimi i tij nga Fondacioni "Fëmijët Shqiptarë", si enti më me eksperiencë në ofrimin e një ekspertizë të tillë. Qendra Harmonia tashmë ka filluar punën dhe ofron shërbime për spektrin e autizmit. Përgjatë kësaj periudhe kanë marrë shërbim rreth 16 fëmijë të diagnostikuar me spektrin e autizmit.

- **P10430.O5.A1.** Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare "Për Familjen".

Në vitin 2016 filloi krijimi i rrjetit të shërbimit social në komunitet. Për herë të parë u ngritën qendrat komunitare "Për familjen", të cilat ofrojnë shërbime sociale si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psikosociale, etj. Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimit social në territor, janë ngritur dhe vënë në funksion në total 13 qendra komunitare "Për Familjen", të shtrira në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Gjatë kësaj periudhe, sa i përket konsolidimit të shërbimit komunitar në qendrat komunitare "Për Familjen", janë rritur shërbimet e ofruara, aktivitetet dhe përfituesit, pranë këtyre qendrave. Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin.

- **P10430.O5.A2.** Shërbime alternative për fëmijët dhe familjen.

Sigurimi i mbrojtjes shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe i të drejtave të tyre është një ndër sfidat më të rëndësishme për Bashkinë e Shkodrës, por edhe për shoqërinë civile, duke kërkuar një vëmendje më të veçantë për këtë target grup. Gjatë kësaj periudhe, në bashkëpunim me organizatën 'Nisma" për ndryshim shoqëror janë identifikuar familje në rrezik institucionalizimi dhe po punohet për fuqizimin e tyre dhe paralelisht po punohet me fuqizimin e

familjeve që kanë fëmijë në institucione rezidenciale, me synim deinstitucionalizimin e tyre. Ka vazhduar bashkëpunimi me Bethany, duke realizuar një fushatë ndërgjegjësuese me aktorë të ndryshëm publik dhe jo publik, por edhe me komunitetin për të rritur ndërgjegjësimin dhe informacionin mbi shërbimin e kujdestarisë ligjore si mundësia më e mirë për fëmijët pa kujdes prindëror. Këto aktivitete janë zhvilluar online si dhe në median lokale dhe kanë qenë pjesë e aktiviteteve të zhvilluara nga Bashkia, në kuadër të 15 majit "Ditës ndërkombëtare të Familjes".

- **P10430.O5.A3** Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror

Bashkia Shkodër ka aplikuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën Nr. 4307 Prot., datë 10.12.2021 për Fondin Social për Shërbime me Bazë Komunitare 2022 me projekt – propozimin "Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror", me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së financimit të Strehëzës për fëmijët pa kujdes prindëror, strukturë e ngritur nga Bashkia Shkodër në bashkëpunim me ACLI-IPSIA.

E përzgjedhur si bashki fituese dhe e vlefshme për financim përmes shkresës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) Nr. 1134/19 Prot., datë 04.05.2022 "Njoftim për përzgjedhjen fitues të projekt propozimit "Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror"", Strehëza filloi funksionimin e saj të plotë më 01.06.2022.
Me anë të këtij shërbimi të ri dhe alternativ synojmë të ofrojmë një mundësi për fëmijët pa kujdes prindëror, të cilët nuk mund të rriten në një mjedis familjar, duke synuar gjithashtu përfshirjen brenda proçesit të deinstitucionalizimit dhe të decentralizimit të nisur në Shqipëri, kryesisht referuar Planit Kombëtar të De-Institucionalizimit 2020-2022 të miratuar së fundmi me VKM Nr. 706, datë 09.09.2020 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitucionalizimit të Fëmijëve 2020-2022" dhe të Planit të Veprimit në zbatim të tij. Struktura përmbush standartet për shërbimet e përkujdesit shoqëror të përcaktuar në VKM Nr. 659, datë 17.10.2005 "Për standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale".
Strehëza përdor një model marrëdhëniesh, që paraqitet si alternativë e përkohshme ndaj modeleve institucionale të qendrave rezidenciale dhe në përgjithësi, ndaj institucioneve të mëdha, modele që fatkeqësisht vazhdojnë të funksionojnë në vendin tonë. Organizimi i strukturës, duke filluar prej hapësirave fizike deri te veprimtaritë ditore, janë pjesë përbërëse e ndërhyrjes edukative dhe synojnë riparimin e dështimeve të mëparshme ambientale. Gjithashtu, ky shërbim synon të ofrojë edhe strehim emergjent të sigurtë dhe rehabilitues për fëmijët në situata emergjente apo në rrezik të lartë deri në rehabilitimin e plotë të fëmijëve dhe të familjes biologjike me qëllim që të minimizohet koha e qëndrimit të të miturit në Strehëz.

Në strehëz është planifikuar që të ofrohet shërbim deri në kapacitet maksimal për 8 fëmijë të moshës 6 deri në 18 vjeç. Aktualisht pranë kësaj strukture janë sistemuar 5 fëmijë, me vendim të Komisionit Multidisiplinar të Bashkisë të datës 30.03.2022. Shërbimi ofrohet nga 8 (tetë punonjës) i përbërë nga 6 specialistë (në rolin e edukatorëve të cilët punojnë me tre turne) sipas standartit 1 edukator për 4 fëmijë, 1 kuzhinier/sanitar dhe 1 koordinator i Strehëzës, personel pjesë e strukturës së Bashkisë Shkodër.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka transferuar fondin për projektin fitues të Bashkisë Shkodër më datë 11.05.2022, përmes shkresës me Nr. 2084 Prot., "Transferim fondesh për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki për vitin 2022" dhe shkresës Nr. 69/43 Prot., datë 16.05.2022 e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Akordim i fondeve për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashki për vitin 2022". Deri në datë 31.05.2022 financimi dhe vënia në funksion e strehëzës është siguruar nga financimi i projektit "Komunitetit të së ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës".
Sipas aplikimit kohëzgjatja e projektit është 36 muaj (Janar 2022 – Dhjetor 2024), dhe transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër është planifikuar të bëhet në tre këste:

- Financimi i vitit të parë në masën 90% të totalit të kostove të ofrimit të shërbimit, ku në fakt ky financim është disbursuar në maj të vitit 2022 në shumën 7,841,995 Lekë që përkon në mënyrë përpjëstimore me 7 muaj shërbim.
- Viti i dytë i zbatimit të projektit do financohet në masën 60% të vlerës së projektit.
- Viti i tretë i zbatimit të projektit do financohet në masën 30% deri sa shërbimi do të mbulohet 100% nga Bashkia Shkodër.

Për shkak të tipologjisë së shërbimit të strehëzës dhe mirëfunksionimit të saj deri më tani është e domosdoshme që në rastin e vitit të dytë të ofrimit të shërbimit, financimi në masën 60% të vlerës së projektit të transferohet në buxhetin e Bashkisë Shkodër që në fillim të muajit janar 2023 për të siguruar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit rezidencial dhe mbulimin e të gjitha kostove operative jetësore të parashikuara me këtë fond sipas linjave të buxhetit më poshtë.

Ndaj Bashkia Shkodër i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale me shkresën Nr.18419 Prot, datë 09.12.2022 me lëndë "Vënie në dijeni dhe kërkesë për kalim fondi".

Streheza për fëmijët pa kujdes prindeëror vepron si një komunitet me dimension familjar, me karakter edukativ me qëllim edukimin fëmijëve pa familje ose me familje në vështirësi, me asistencë përkujdesjeje ditë e natë, organizimi dhe ndihma e kohës së lirë, mbështetje arsimore, formimin kulturor, shoqërimin dhe integrimin e fëmijëve nepërmjet kurseve të ndryshme.
Struktura synon të mbështesë procesin e zhvillimit të fëmijëve, nëpërmjet një organizimi të jetës që lejon marrëdhënie të qëndrueshme dhe emocionalisht të rëndësishme, dhe t'i shoqërojë dhe mbështesë drejt një procesi gradual të autonomisë.
Strehëza ndodhet në lagjen 3 Heronjtë, dhe ka kapacitet të strehojë deri në tetë fëmijë, me dy vende shtesë të rezervuara për rastet emergjente.
Aktualisht në Strehëzën për fëmijët pa kujdes prindëror jetojnë 5 fëmijë, të cilët frekuentojnë arsimin e ciklit 9 vjeçar. Të gjithë frekuentojne shkollën "Mati Logoreci". Më i vogli këtë vit shkollor ka filluar klasën e parë. Njëri nga fëmijët është më mësuese mbështetëse.

**Organizimi :** Organizimi i jetës së përditshme është i strukturuar në mënyrë që:

- Të favorizojë realizimin e një përvoje individuale vendimtare për fëmijët për zhvillimin dhe maturimin e tyre personal nëpërmjet një organizimi që lejon marrëdhënie të qëndrueshme mes njeri-tjetrit dhe edukatorëve. Çdo ditë në Shtëpinë familje është intensive: me disa angazhime, momente loje, përgatitja e vakteve, pastrimi, këshillimi dhe bashkëndarje që e bëjnë çdo ditë unike. Jeta e përditshme nuk është vetëm tërësia e veprimeve të kryera nga pjestarët që jetojnë në shtëpinë familje, por gjithashtu ne i kushtojmë rëndësi të madhe arsimit dhe edukimit. Brenda një ditë plotësohen së pari nevojat parësore, si të lahet, ushqehet dhe pushojë, nevoja që shumica prej nesh i marrin si të mirëqena, por të cilat nuk janë gjithmonë automatike. Prandaj dita është e strukturuar në mënyrë treguese si ajo e një fëmijë që jeton në një familje "normale", ku ritmet janë lineare dhe shprehitë e fituara të sjelljes së përditshme kanë një rol qetësues, dhe një ndikim të rëndësishëm në mirëqenien e secilit. Qëllimi i këtij organizimi është që në një të ardhme fëmijët të kenë arritur autonominë dhe vendosjen e marrëdhënieve më të shëndetshme me familjet biologjike.

- Të inkurajojë pjesëmarrjen e të gjithëve, secili në raport me rolin që luan, me organizimin dhe rregulloren e brendshme për menaxhimin e jetës së shtëpisë, duke shfrytëzuar në maksimum momentet e takimit me njëri tjetrin për një dialog autentik edukativ.

- Të favorizojnë arritjen e përvojave të rëndësishme që mbështesin zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve dhe ta shoqërojnë atë drejt një përvetësimi gradual të mjeteve dhe burimet që synojnë promovimin e autonomisë së tij në një të ardhme.

**Dosja personale:** për çdo fëmijë është mbajtur dhe përditësohet dosja personale, e cila përbëhet nga sa vijon**,** seksionet:

a) Administrative - për dokumentacionin e regjistrimit, vendimet e Komisionit Multidisipinar si dhe vendimet e gjykatës.

Në muajin qershor kemi marrë kujdestarinë ligjore të dy fëmijëve dhe në muajin shtator është marrë kujdestaria ligjore për një tjetër fëmijë. Jemi në pritje të marrjes së kujdestarisë ligjore edhe për dy fëmijët e tjerë.

b) Sociale dhe psikologjike - për raportet e ndryshme psiko-sociale, si: formular i informacionit të domosdoshem, raport për vlerësimin e nevojave dhe ecurisë (RVNE), plani i kujdesit, raporte psikologjike.

Në muajin Nëntor janë mundësuar seanca këshillimi/terapie për njërin nga fëmijët, të rekomanduara nga Neuropediatria. Seancat zhvillohen 2 herë në javë, dhe janë mundësuar nga dy donator italian.

c) Arsimore - për dokumentimin e punës edukative; Plani i arsimit që është bërë në bashkëpunim me shkollën, Rishikimi i planit të Arsimit, Raport mujor i arsimit nga edukatorët, dëftesat etj., relacionet nga takimet e shkollës me mësuesit përkatës.

d) Shëndetësore – Kartela shendetësore për çdo njërin nga fëmijët për dokumentimin e kontrolleve shëndetësore, vizitat rutinë, vaksinimet, fletoret shëndetësore për raportimin nga edukatorët të medikamenteve të administruara në rastet e rekomanduara nga mjekja.
Gjatë muajit nëntor i gjithë personeli është angazhuar për ri-shikimet e planeve të kujdesit dhe të arsimimit për çdo njërin nga fëmijët.

**Shëndeti:** Fëmijet nuk kanë patur problematika shëndetësore, vetëm simptoma të virozave sezonale. Disa prej tyre u jane bërë vizita tek mjeku i familjes. Dy fëmijëve më të vegjël ju janë bërë dhe vaksinat në muajin qershor.
Po ashtu fëmijëve u janë bërë dhe vizita tek disa okulistë gjerman, (të mundësuara nga Organizata Shpresë për Botën). Njëri prej tyre ka probleme me shikimin dhe i është mundësuar ndërrimi i numrit të syzeve. Në muajin Nëntor të gjithë fëmijët i janë nënshtruar vizitave mjekësore të përgjithshme nga një mjeke italiane dhe janë marrë recetat dhe ilaçet e rekomanduara.

**Aktivitetet e ndryshme:** Momentet rikrijuese të përfaqësuara nga udhëtimet dhe shëtitjet konsiderohen jashtëzakonisht të rëndësishme dhe pasuruese si nga pikëpamja e marrëdhënies ndërmjet fëmijëve me njëri tjetrin po ashtu edhe nga pikëpamja e marrëdhënies edukator- fëmijë. Gjatë këtyre muajve, janë organizuar dalje të ndryshme ku fëmijet janë argëtuar, kanë mësuar gjëra të reja dhe janë përfshirë në një realitet ndryshe nga ai i shtëpisë familje. Fëmijët janë regjistruar në aktivitetet të ndryshme për të promovuar argëtimin dhe socializimin.

*Disa nga aktivitetet jashtë shtëpisë*:
- Pjesëmarrja në aktivitetin e 1 Qershorit para Bashkise, ku fëmijët kanë paraqitur disa nga punimet e tyre, si: vizatime/pikturat të realizuara nga vetë fëmijët.
- Pjesëmarrja në kampet verore tek Oratori Don Bosko.
- Pishina së bashku me fëmijët e Oratorit Don Bosko.
- Shirokë, aktivitet dhe vizita në Azilin e të moshuarve, të motrave Stigmatine, momente bashkëndarje dhe argëtimi së bashku me të moshuarit e qendrës.
- 3 herë në muaj në parkun e lojrave për fëmijë tek Blu Sky.
- Pushime në plazhin e Velipojës së bashku me edukatorët rreth 1 javë.
- Pjesëmarrje në disa aktivitete të organizuara nga Organizata Shpresë për Botën.
- Aktivitet 2 herë në muaj nga grupi “LER”, grupi i nxënësve të shkollës “Atë Pjetër Meshkalla”.
- Animacion në mjediset e shtëpisë familje, nga grupi i animatorëve të Qendrës Don Bosko.
- Vizita nga fëmijët e Shtëpisë së fëmijës 6-15 vjeç, edukatorët.
- Vizita nga familjarët e tyre.

Në muajt shtator dhe tetor në Shtëpinë Familje janë festuar dhe ditëlindjet e katër fëmijëve, ku përveç personelit në festën e tyre janë ftuar dhe kanë marrë pjesë edhe miqtë e tyre të lagjes dhe pjestarë të Organizatës “Shpresë për Botën”. Po ashtu për njërin nga fëmijët prezentë kanë qënë

edhe prindërit. Deri më tani janë kryer proçedurat e prokurimeve për zërat: ushqime, materiale pastrimit, mjete kancelarike dhe ilaçe.

- **P10430.O6.A1** Qendra Rinore "Atelie"

Gjatë vitit 2022 pranë Qendrës Rinore "Atelie", u realizuan trajnime për "Shkrimi Web & CSS, Stilim Web & CSS", trajnim mbi "Advanced Robotic", "Game Development", "Shkrim dhe menaxhim projekti", "Si të krijojmë website" , "Kriptomonedha", "Siguria Online" si dhe kampi veror tre ditor titulluar "Tech Camp" ku të rinjtë jo vetëm u informuan, por patën mundësi edhe të zhvillojnë në praktikë njohuritë në Robotik dhe "Game Development" me JavaScript. Të gjitha këto aktivitete janë zhvilluar në sallën Bibliotech dhe janë mundësuar falë bashkëpunimit me UNICEF Albania.
Nga të rinjtë e Qendrës Rinore "Atelie" u realizua ekspozita "Kujtimet" në kuadër të javës ndërkombetare të familjes. U organizua iniciativa rinore "Kinerinore" për të rinjtë e Shkodrës e cila zhvillohet për çdo muaj. Të rinjtë e Qendrës Rinore në bashkëpunim me Departamentin e Arteve dhe Shkollën "Ndre Mjeda" organizuan ekspozitën "Metamofroza" në kuadër të "16 Ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore". U zhvilluan EduLab mbi robotikën, fizikë, letërsinë, psikologji dhe kërcim në kuadër të iniciativës rinore "Të rinjtë për të rinjtë". Në kuadër të muajit të luftës kundër trafikimit të personave, në Qendrën Rinore "Atelie" u zhvillua aktiviteti "A dëgjohen viktimat? Ne e kemi nisur. A vazhdojmë së bashku?", ku është prezantuar studimi mbi përvojat e të rinjve në drejtesinë penale për dhunën seksuale dhe trafikimin, në bashkëpunim më organizatën "Të ndryshëm, Të barabartë". U realizua ekspozita "Unë jam Krishtlindja" ku me angazhimin e të rinjve me aftësi të kufizuara të Projektit Shpresa.
Bashkia Shkodër ka realizuar takime informuese dhe ndërgjegjësues me të rinjtë e qendrës për duhanin, HIV/AIDS, kancerin e gjirit, dhe per vullnetarizmin. Në kuadër të muajit të luftës kundër trafikimit të personave, së bashku me të rinjtë e Qendrës Rinore "Atelie" u realizua sesioni informues mbi konceptin e trafikimit, mënyrat që ndjekin trafikuesit përmes manipulimit, institucionet ku mund të kërkojmë ndihmë. U realizua takimi me aktor publik dhe jopublik për ngritjen e Këshillit Rinor Vendor. U realizua projekti "PEOPLE" me temë "Histori personale të diskriminimit dhe persekutimit nën regjimet totalitare të shekullit XX" ku morën pjesë të rinjtë e Qendrës Rinore "Atelie", nxënësit e shkollës "Oso Kuka" si dhe studentët e universitetit "Luigj Gurakuqi". Në bashkëpunim me organizatën Gruaja tek Gruaja u realizuan trajnime me shërbimet psiko-sociale në shkolla. U zhvillua sesioni informues dhe ndërgjegjësues kundër trafikimit të personave; trajnimi "Qasja e grave në të drejtat pronësore të trashegimisë si një mjet për të luftuar diskriminimin me bazë gjinore"; trajnimi për sipërmarrjen; trajnimi "Qasja e grave në të drejtat pronësore të trashëgimisë-një mjet për të luftuar diskriminimin më bazë gjinore". U realizuan trajnimet me temë "Marketingu dhe menaxhimi i bizneseve turistike dhe artizanale"; Përdorimi i mjeteve dhe platformave online në kuadër të projektit "Sucessful together", ku 20 gra dhe vajza nga zona e Shkodrës dhe rrethinat janë trajnuar mbi sipërmarrjen, 10 fëmijë janë trajnuar mbi instrumentat online si dhe është ofruar mbështetje psikologjike. Këto aktivitete janë organizuar nga organizata IRSH në bashkëpunim me Qendrën Rinore "Atelie".

Në bashkëpunim me Zyrën Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO) u realizua aktiviteti Supershkollat për shkëmbimet shkollore në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor që ka për qëllim të mbështesë proceset e paqes e pajtimit, si dhe dialogun dhe të mësuarit ndërkulturor midis shkollave, nxënësve dhe komuniteteve të tyre, ku morën pjesë përfaqësues nga shkollat e Bashkisë Shkodër. U realizua aktiviteti "Le të flasim për: Mundësitë e vetëpunësimit, kurse profesionale dhe internship për rininë që ofron Caritasi Dioqezan në kuadër të projektit YourJOB në Shkodër". Qendra Rinore në bashkëpunim me Qendrën YEA vazhdon siparin e takimeve në kuadër YEA! AWARDS 2022. Përgjatë të gjithë vitit janë organizuar edhe programet afterschool. U zhvillua trajnimi tre ditor "Transformers 2", ku të rinjtë mësuan mbi rëndësinë për fuqizimin e rolit të të rinjve nëpërmjet rritjes së ndikimit dhe pjesëmarrjes së tyre në vendimarrjen lokale për politikat rinore dhe më gjerë. U realizua trajnimi i projektit "Bëhu zë, jo jehonë!", ku si qëllim ka advokimin nëpërmjet artit. Këto aktivtete u realizuan fal bashkëpunimit me Kongresin Kombëtar Rinor. Pranë Qendrës Rinore "Atelie" u zhvillua aktiviteti titulluar "Gjurmë Rinore: Çfarë mund të bëjnë të rinjtë për qeverisjen mjedisore?" Ky aktivitetet u organizua si një ëorkshop për krijimin e një "Plan Veprimi Rinor për Qeverisjen Mjedisore", i cili do të përfshijë veprimet e komunitetit dhe shoqërisë civile për qeverisjen mjedisore, mekanizmat dhe strukturat për pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse të qeverisjes mjedisore, akses në informacion, implikimet ligjore, si dhe tematika të cilat u diskutuan nga të rinjtë me drejtimin e një eksperti të fushës. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me OSCE in Albania. U realizua shfaqja me poezi nga nxënësit e shkollës Ndre Mjeda. U realizuan ëorkshope për "Menaxhimin e projekteve për të rinjtë"; trajnim mbi konceptet bazë të fotografisë; trajnimi mbi editimin e fotografive "Identifikimi dhe menaxhimi i iniciativave të udhëhequra nga të rinjtë". Të rinjtë u trajnuan nga eksperti ndërkombëtar Z. Bojan Boscovic. Gjatë trajnimit të rinjtë mësuan si të menaxhojnë një projekt ide, që i shërben komunitetit ku ato jetojnë si dhe u realizua trajnimi tiltulluar "Creating Soundscapes", ku të rinjtë filluan eksperimentimin në përpunimin e tingujve me anë të softëare të ndryshëm. Këto aktivitete u realizuan falë bashkëpunimit me organizatën RAYS. U realizuan trajnimet "Rrugëtim i të rinjve drejt mirëqenies, fuqizimit dhe qëndrueshmërisë", sesionet "Lifeskills", "Dizenjimi i karrierës personale dhe zhvillimi i mentalitetit sipërmarrës", sesione me prindër "Disiplina Pozitive", sesion me prindër "Udhëzuesi për Karrierë", event në komunitet "Dhuna me bazë gjinore", "Edukimi bashkëmoshatar" -Grupi Peer to Peer", "Abuzimi dhe shfrytëzimi i të miturve, format dhe pasojat", "E drejta e fëmijëve për pjesëmarrje në procese vendimmarrëse", "Abuzimi dhe shfrytëzimi i të miturve, format dhe pasojat të cilat u organizuan nga organizata Save the Children në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër.

U realizuan workshopet me temë: Coding & Programming Skills", "Brainstorming & Idea Finding", "Business Identity & Marketing", "Business Plan & Businesss Laws in Albania", "Presentation Techniques & Fund Raising" të cilat u organizuan nga Qendra YEA! në bashkëpunim më Bashkinë Shkodër.

- **P10430.O6.A2 - PEOPLE**– Historì personale të diskriminimit dhe persekutimit nën regjimet totalitare të shekullit XX.
  (PEOPLE - Personal stories of discrimination and persecution under the totalitarian regimes of the XX century).

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 58, datë 06.12.2021 "Për shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër" dhe marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Shkodër (partner) dhe Shoqatës ATRIUM (partner lider) me Nr. 16891 Prot., datë 05.10.2021, po zbatohet projekti PEOPLE– Histori personale të diskriminimit dhe persekutimit nën regjimet totalitare të shekullit XX, i cili financohet nga Komisioni Evropian, në kuadër të Programit "Europa për Qytetarët" - EACEA/52/2019: Përkujtimi Europian 2020.
Projekti drejtohet nga Shoqata ATRIUM - Arkitektura e Regjimeve Totalitare të Shekullit XX në Kujtesën Urbane të Europës, në rolin e Liderit të Projektit dhe zbatohet në një partneritet prej 5 palësh të përfshira (Shoqata ATRIUM, Bashkia Shkodër, Bashkia Labin, Bashkia Dimitrovgrad, Shoqata e Refugjatëve Politikë Portugezë).
Qëllimi i përgjithshëm i projektit është përfshirja e të rinjve, në rolin e grupit të punës, në mbledhjen dhe prezantimin e historive të persekutimeve fetare në Shkodër gjatë periudhës së komunizmit në eventin që do të organizohet dhe faqen web që do të krijohet, i cili do të nxisë reflektimin e kësaj historie të përbashkët midis vendeve të ndryshme dhe do të rrisë ndërgjegjësimin mbi kuptimin e diversitetit dhe mbi rëndësinë e të pasurit dije të gjithanshme.
Bashkia Shkodër, si partnere e projektit të sipërpërmendur, ka zbatuar projektin sipas planit të punës të dakordësuar me liderin e projektit dhe bazuar në buxhetin përkatës të vënë në dispozicion për këtë qëllim.
Buxheti i Projektit për Bashkinë Shkodër do të jetë 12.445 Euro (1.511.944 Lekë) për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit. Transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër do të bëhet në tre këste: 30% e buxhetit do të transferohet pas firmosjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit, këst i cili ka mbërritur me datë 14.12.2021 me vlerën 438,679.65 Lekë; 30% e buxhetit do të transferohet pas fazës kërkimore/përgatitore, këst i cili ka mbërritur me datë 05.05.2022 me vlerë 436,025.03 Lekë; dhe 40% e buxhetit do të transferohet pas raportimit final.
Gjatë periudhës së raportimit në fjalë, janë realizuar të gjithë procedurat e nevojshme administrative për vijimësinë e aktiviteteve të projektit. Këto aktivitete për 12-mujorin në fjalë përfshijnë: i) realizimin e takimeve prezantuese dhe koordinuese me të rinjtë të cilët janë përzgjedhur për të qënë pjesë e grupit të punës pranë qendrës rinore "Atelie"; ii) realizimin e takimit në Labin dhe dërgimin e përfaqësuesve nga Bashkia Shkodër në këtë takim; iii) realizimin e procedurave të prokurimit dhe kontraktimit të operatorit i cili zbatoi me përpikmëri fushatën e komunikimit dhe prodhoi produktet për rritjen e vizibilitetit të projektit, ku janë realizuar posterat, videot, faqja web, kartolinat memory, hartat turistike dhe tabelat përshkruese të objekteve të kultit të pajisura me kod QR; iv) realizimin e takimit në Dimitrovgrad dhe dërgimin e përfaqësuesve nga Bashkia Shkodër në këtë takim; v) realizimin e eventit në Shkodër ku u pritën 10 përfaqësues nga vendet partnere. Eventi u zhvillua pranë Qendrës Rinore "Atelie" dhe Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës, me pjesëmarrjen e 100 personave dhe u prezantua e gjithë

puna e të rinjve, materialet e komunikimit dhe u ofrua një tur turistik dhe historiko-kulturor për partnerët; vi) realizimin e takimit në Forli, Itali dhe dërgimin e përfaqësuesve nga Bashkia Shkodër në këtë takim; vii) realizimin e në këtë takim. Projekti është përmbyllur me rezultate të arritura dhe vizibilitet maksimal. Është takimit përmbyllës në Marinha Grande/Lisbonë, Portugali dhe dërgimin e përfaqësuesve nga Bashkia Shkodër dërguar raporti final, ndërkohë pritet të vijë edhe balanca 40% e projektit për likuidimet e fundit.

- **P10430.O6.A3 FARO –** Trashëgimi të ndryshme në Qytezat Europiane – Krijimi i një narrative europiane të identiteteve të kontestuara përmes pjesëmarrjes së qytetarëve. (**FARO** – The Dissonant Heritage in European Towns – Creating a European narrative of contested identities through citizens' participation)

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak VKB Nr. nr. 17 datë 31.03.2022 "Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër" dhe marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Dimitrovgrad (partneri lider) dhe Bashkisë Shkodër, me Nr. 3758 Prot, datë 21.02.2022., po zbatohet projekti FARO – Trashëgimi të ndryshme në Qytezat Europiane – Krijimi i një narrative europiane të identiteteve të kontestuara përmes pjesëmarrjes së qytetarëve, i cili financohet nga Komisioni Evropian, në kuadër të Programit "Europa për Qytetarët" - EACEA 36/2018: Rrjetëzimi i qytezave.

Projekti drejtohet nga Bashkia Dimitrovgrad, në rolin e Liderit të Projektit dhe zbatohet në një partneritet prej 10 palësh të përfshira (Bashkia Dimitrovgrad, Bashkia Shkodër, Shoqata ATRIUM, Bashkia Nova Gorica, Bashkia Lousada, Bashkia Stei, Bashkia Carbonia, dhe Poëiat Piotrkoëski).

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është përfshirja e të rinjve dhe qytetarëve, në rolin e grupit të punës, në organizimin e eventit 2-ditor, i cili do të nxisë reflektimin e kësaj historie të përbashkët midis vendeve të ndryshme.

Buxheti i Projektit për Bashkinë Shkodër do të jetë 14,600 Euro (1,766,000 Lekë) për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.

Transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër do të bëhet në dy këste: 60% e buxhetit do të transferohet pas firmosjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit, këst i cili ka mbërritur me datë 17.03.2022 në vlerën 1,041,564 lekë; 40% e buxhetit do të transferohet pas raportimit final.

Gjatë periudhës së raportimit në fjalë, janë realizuar të gjithë procedurat e nevojshme administrative për vijimësinë e aktiviteteve të projektit. Këto aktivitete për 12-mujorin në fjalë përfshijnë: i) realizimin e takimeve prezantuese dhe koordinuese me të rinjtë dhe palët e interesit të cilët janë përzgjedhur për të qënë pjesë e grupit të punës pranë qendrës rinore "Atelie"; ii) realizimin e takimit në Forli dhe dërgimin e përfaqësuesve nga Bashkia Shkodër në këtë takim mes partnerëve; iii) realizimin e takimit në Lousada, Portugali dhe dërgimin e përfaqësuesve nga Bashkia Shkodër në këtë takim mes partnerëve; iv) realizimin e takimit në Dimitrovgrad, Bullgari dhe dërgimin e përfaqësuesve nga Bashkia Shkodër në këtë takim mes partnerëve; v) përgatitjen e materialeve të vizibilitetit për Bashkinë Shkodër të cilat do të prezantohen nga faqja kryesore e projektit; vi) realizimin e eventit në Shkodër ku u pritën 17 përfaqësues nga vendet partnere. Eventi u zhvillua pranë Qendrës Rinore "Atelie" dhe Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës,

me pjesëmarrjen e rreth 65 personave dhe u prezantua e gjithë puna e të rinjve dhe e eksperteve ku u bë një prezantim i detajuar mbi trashëgiminë arkitektonike të komunizmit, materialet e komunikimit dhe u ofrua një tur turistik dhe historiko-kulturor për partnerët në objekte të ndryshme të qytetit; vii) realizimin e takimit në Powiat Piotrkowski, Poloni dhe dërgimin e përfaqësuesve nga Bashkia Shkodër në këtë takim mes partnerëve.

- **P10430.O7. A1.** “Asnjë Fëmijë Jashtë”

“Asnjë fëmijë jashtë” është një aktivitet social-kulturor që organizohet që nga viti 2005, me rastin e festave të fundvitit. Protagonistë të këtij aktiviteti janë fëmijët e familjeve në vështirësi social-ekonomike. Ky aktivitet përfshin të gjitha kategoritë e fëmijëve të familjeve në vështirësi të theksuara social-ekonomike, gjithashtu përfshin aktivisht PAK-të, fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian, fëmijët e ngujuar, fëmijë të institucioneve rezidenciale, fëmijë në situatë rruge duke përfshirë edhe fëmijë nga të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër. Fëmijët përgatiten dhe performojnë në fusha të ndryshme artistike si; muzikë, recitim, vegla muzikore, teatër, etj duke synuar gjithëpërfshirjen e fëmijëve në fusha të ndryshme të artit duke qenë vetë ata protagonisët. Bashkia Shkodër në bashkëpunim me organizatën The Door organizoi në ambjentet e Teatrit Migjeni aktivitetin "Asnjë fëmijë jashtë". Mesazhi i kësaj nisme është që asnjë fëmijë nuk duhet të përjashtohet, por duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë. Ishin vetë fëmijët nëpërmjet performancave të ndryshme artistike si: këngë, recitime, animacion, muzikë, etj që e përcollën kaq bukur këtë mesazh.

- **P10430.O7.A2.** Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe.

Që nga viti 2005 në qytetin e Shkodrës zhvillon veprimtarinë e saj trupa muzikore The DOOR Albania, e vetmja në rajonin e Ballkanit. “Trupa muzikore e PAN-ve” përbëhet nga një grup të rinjsh me aftësi të kufizuara, të gjithë ish nxënës të shkollës speciale “3 Dhjetori”. Kjo trupë muzikore angazhohet në aktivitete të ndryshme që realizohen në territorin e Bashkisë Shkodër, por jo vetëm. Kursi synon integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të cilët janë shumë të aftë në veglat frymore dhe përmes angazhimit përcjellin mesazhin: Mundësi integrimi për të gjithë. Trupa Muzikore përbëhet nga 25 të rinj me aftësi të kufizuar. Gjatë kësaj periudhe kjo bandë ka punuar dhe vazhduar provat dhe ka arritur të marrë pjesë dhe të performojë në aktivitete të ndryshme.

- **P10430.O7.A3** Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa.

Opera Madonnina del Grappa, është një organizatë e liçensuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAK të braktisur nga familja dhe të deinstitucionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1992 ku filloi aktivitetin e saj në mbështetje të përsonave dhe familjeve më në nevojë. Në vitin 1994 filloj ristrukturimin i plotë i ish spitalit psikiatrik të fëmijëve në Shkodër, duke sjellë përmirësimin e kushteve te jetesës dhe trajtimit të fëmijëve, por në mënyrë të veçantë ky projekt realizoi krijimin për herë të

parë në Shqipëri të Qendrës Ditore për fëmijët më aftësi të kufizuar dhe të krijimit të Shtëpisë Familje. Aktualisht në shtëpinë familje të Opera Madonnina del Grappa marrin shërbim 18 persona me aftësi të kufizuar. Qëllimi i kësaj strukture është rehabilitimi dhe përfshirja në jetën sociale e komunitare nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme me karakter edukativ e integrues duke ju ofruar përfituesve të saj shërbim rezidencial konform standarteve të miratuara nga Ministria e linjës. Mbështetja e shtëpive – familje të "Opera Madonnina del Grappa" është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi të kufizuara dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike. Me qëllim sigurimin e vazhdimësisë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve shoqata "Opera Madonnina del Grappa", i është drejtuar vazhdimisht për mbështetje Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Shkodër me kërkesën për financim të shërbimeve, në mbështetje të ligjit nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë". Në përgjigje të këtyre kërkesave Bashkia Shkodër, i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kërkesën për fonde për mbështetje të "Opera Madonnina del Grappa", për fond për paga dhe sigurime shoqërore për punonjës, si kujdestar social dhe figura profesionale në fusha të ndryshme si: drejtor, ekonomist, psikolog, punonjës social, fizioterapist, infermier dhe kuzhinier, punëtor mirëmbajtës etj. Përveç pagesës për personelin, Bashkia Shkodër mbështet "Opera Madonnina del Grappa" duke mbuluar kuotën ushqimore për personat me aftësi të kufizuar të sistemuar pranë "Opera Madonnina del Grappa", energjinë elektrike, ujë, gaz, karburant, shpenzime mjekësore etj. sipas marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Shkodër dhe "Opera Madonnina del Grappa".

- **P10430.O7.A4.** Projekti "Shpresa" për përsonat e braktisur dhe me aftësi ndryshe.

Projekti Shpresa, është një organizatë e liçensuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAK-të e braktisur nga familja dhe të deinstitucionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1995. Projekti "Shpresa" ka 7 shtëpi-familje, të shpërndara në komunitet dhe aktualisht marrin shërbim 62 persona me aftësi të kufizuara. Projekti "Shpresa", duke ofruar shërbime alternative për personat me aftësi të kufizuara, të cilët janë pa asnjë përkujdes dhe interesim familjar, dhe me problematika të ndryshme, ka nevojë për mbështetje financiare dhe vëmendje të shtetit. Mbështetja e projektit "Shpresa" është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi të kufizuar dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike. Në këto qendra përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, rehabilituese dhe shëndetësore 62 individë me aftësi të kufizuara.

- **P010430.O8.A1.** Pagesë PAK dhe Invaliditeti.

Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr.8626 datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" të ndryshuar; Ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të vërbërit" i ndryshuar, Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 "Statusi i invalidit" të ndryshuar.
Numri i personave të trajtuar me pagesë paaftësie ka qenë: në muajin Janar 3895, në Shkurt 33858, në Mars 3849, në Prill 3858, në Maj 3847, në Qershor 3863, në Korrik 3769, në Gusht

3704, në Shtator 3684, në Tetor 3724, në Nëntor 3817, në Dhjetor 3828. Kanë përfituar shpërblimin e fundvitit në masën 3 000(tre mijë) lekë, 2980 persona.

Numri i invalidëve të punës të trajtuar me shtesë kempi ka qenë: në muajin Janar 3236, në Shkurt 3242, në Mars 3240, në Prill 3230, në Maj 3223, në Qershor 3229, në Korrik 3222, në Gusht 3196, në Shtator 3205, në Tetor 3215, në Nëntor 3217, në Dhjetor 3227.

Për kryerjen e këtyre pagesave mujore fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë:
PAK : Janar-Shkurt 131 461 000 Lekë, Mars-Prill 127 354 000 Lekë, Maj-Qershor 127 290 000 Lekë, Korrik - Gusht 126 326 000 Lekë, Shtator - Tetor 126 540 000, Nëntor - Dhjetor 117 895 000.
Për shpërblimin e fundvitit 8 964 000.

Mbetet detyrimi i papaguar për muajin Dhjetor 2022 për mungesë fondi 4 352 622 lekë. Kjo diferencë është paguar me çeljen e fondeve të reja të viti kalendarik 2023.

Në zbatim të Vendimit Nr.159, datë 12.3.2022 "Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në ukrainë", kanë përfituar mbështetje financiare, në masën 3 000 (tre mijë) lekë në muaj, për një periudhë 3 (tre) mujore:

Pagesa I :
- 2810 persona të trajtuar me pagesë paaftësie me një fond total 8 430 000 lekë

Pagesa II :
- 2763 persona të trajtuar me pagesë paaftësie me një fond total 8 292 000 lekë

Pagesa III :
- 2728 persona të trajtuar me pagesë paaftësie me një fond total 8 184 000 lekë

Fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror për kryerjen e pagesave për mbështetje financiare, në masën 3 000 (tre mijë) lekë në muaj janë si më poshtë:
PAK : Prill (pagesa I) 8 547 000, Maj (pagesa II) 8 547 000, Qershor (pagesa III) 8 547 000 Lekë.

Në zbatim të Vendim nr. 899, datë 29.12.2022 për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e impaktit të krizës, kanë përfituar mbështetjen financiare:

- 3003 persona që trajtohen me PAK, me një fond total 24 024 000 lekë.

Fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror për kryerjen e pagesave janë 24 208 000 lekë.

- **P10430.O8.A2.** Ndihma ekonomike.

Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”,VKM nr 597, datë 14.09.2019 “Për përcaktimin e proçedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Përfitues të skemës së ndihmës ekonomike kanë qenë:

Në muajin Janar - 1842 familje, nga të cilat: 1634 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 208 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.
Në muajin Shkurt - 1848 familje, nga të cilat: 1635 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 213 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.
Në muajin Mars - 1888 familje, nga të cilat: 1664 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 224 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.
Në muajin Prill - 1888 familje, nga të cilat: 1655 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 233 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.
Në muajin Maj - 1886 familje, nga të cilat: 1651 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 235 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.
Në muajin Qershor - 1865 familje, nga të cilat: 1642 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 223 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.
Në muajin Korrik -1827 familje, nga të cilat: 1604 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 223 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.
Në muajin Gusht -1853 familje, nga të cilat: 1632 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 221 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.
Në muajin Shtator -1784 familje, nga të cilat: 1559 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 225 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.
Në muajin Tetor -1749 familje, nga të cilat: 1558 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 191 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.
Në muajin Nëntor -1783 familje, nga të cilat: 1588 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 195 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.
Në muajin Dhjetor -1589 familje, nga të cilat: 1589 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar. Vendimi i muajit Dhjetor për familjet që trajtohen nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6% miratohet gjatë muajit Janar 2023.

Kanë përfituar shperblimin e fundvitit 2022, 1754 familje, nga të cilat : 1564 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 190 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Duhet të theksojmë faktin se pagesa e muajit Dhjetor 2021, për familjet që trajtohen me fondin e kushtëzuar të bllok ndihmës deri në 6%, për 188 familje në vlerën 507 260 Lekë, është paguar me çeljen e fondeve të reja të viti kalendarik 2022.

Për kryerjen e këtyre pagesave fondet mujore të çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë:
Ndihma Ekonomike: Janar – Shkurt 22 464 000 Lekë, Mars-Prill 33 077 000 Lekë, Maj-Qershor 25 077 000 Lekë, Korrik - Gusht 25 720 000 Lekë, Shtator - Tetor 25 506 000 , Nëntor - Dhjetor 20 755 000.
Për shperblimin e fundvitit 5 277 000.

Mbetet detyrimi i papaguar për muajin Dhjetor 2022 për mungesë fondi 966 086 lekë. Kjo diferencë është paguar me çeljen e fondeve të reja të viti kalendarik 2023.

Në zbatim të Vendimit Nr.159, datë 12.3.2022 "Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në ukrainë", kanë përfituar mbështetje financiare, në masën 3 000 (tre mijë) lekë në muaj, për një periudhë 3 (tre) mujore:
Pagesa I :

- 1616 familje përfituese të Ndihmës Ekonomike me një fond total 4 848 000 lekë
- 213 familje përfituese nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6% me një fond total 639 000 lekë

Pagesa II :

- 1545 familje përfituese të Ndihmës Ekonomike me një fond total 4 635 000 lekë
- 209 familje përfituese nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6% me një fond total 627 000 lekë

Pagesa III :

- 1512 familje përfituese të Ndihmës Ekonomike me një fond total 4 545 000 lekë
- 203 familje përfituese nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6% me një fond total 609 000 lekë

Fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror për kryerjen e pagesave për mbështetje financiare, në masën 3 000 (tre mijë) lekë në muaj janë si më poshtë:
Ndihma Ekonomike: Prill (pagesa I) 5 568 000 Lekë, Maj (pagesa II) 5 568 000 Lekë, Qershor (pagesa III) 5 568 000 Lekë.

Në zbatim të Vendim nr. 899, datë 29.12.2022 për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e impaktit të krizës, kanë përfituar mbështetjen financiare:

- 1567 familje përfituese nga skema e ndihmës ekonomike me një fond total 14 540 000 lekë.
- 195 familje përfituese nga fondi i kushtëzuar 6% me një fond total 2 772 000 lekë.

Fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror për kryerjen e pagesave janë 17 392 000 lekë.

- **P10430.O9.A1**. Administrimi dhe funksionimi i çerdheve.

Është realizuar vlerësimi i nevojave për ndërhyrje me qëllim krijimin e kushteve sa më të favorshme për foshnjet që frekuentojnë këto çerdhe dhe gjithashtu familjet e tyre. Në Bashkinë e Shkodrës, ofrojnë shërbim për foshnjat dhe familjet e tyre 6 çerdhe. Numri i foshnjeve që frekuentojnë këto çerdhe është 249.

**1.** “**Shpenzime për paga e sigurime“**

Fondi i planifikuar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe sigurime është **37,440 mijë lekë** është realizuar për 12 mujorin 2022, muaji Dhjetor në proces.

2. “**Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera“**

Fondi i planifikuar për këtë zë është **9,541 mijë lekë** dhe realizimi i këtij artikulli paraqitet me vlerën **2,956 mijë lekë**.

Në zërin **“Materiale zyre dhe të përgjithshme“** , fondi i planifikuar është **95 mijë lekë** për blerje kancelarie është realizuar.

Në zërin **“Materiale për pastrim ngrohje dhe ndriçim“** fondi i planifikuar është **1000 mijë lekë**. Materiale për pastrim është realizuar në vlerën **599 mije lekë** dhe **300 mijë lekë**është realizuarpër blerje gazi.

Në zërin **“Furnizime me ushqime“** për 6 Çerdhe fondi i planifikuar është **5,300 mijë lekë**, është lidhur kontrata ne muajin Mars, jane likujduar faturat e ushqimeve deri në muajin Nëntor në bazë të frekuentimit të fëmijëve në Çerdhe dhe për muajin Dhjetor është në proces likujdimi. Nga periudha Janar-Mars është mbuluar me gjendjen e ushqimeve në magazinë nga kontrata e vitit 2021**.**

Në zërin **“Blerjeve të materialeve të tjera**” si batanije, carcafë, enë kuzhine etj fondi i planifikuar është **150 mijë lekë** është realizuar.

Në zërin **“Shërbime nga të tretë“** fondi i parashikuar është **1,800 mijë lekë**. Kjo vlerë përdoret për likujdimin e faturave të energjise elektrike dhe ujit ku janë likujduar faturat deri në muajin Nëntor në baze te KW të konsumuar dhe është në proces likujdimi për muajin Dhjetor. Për vlerën **46 mijë lekë** të parashikuar për internet është likujduar plotesisht.

Në zërin **“Blerje e lëndëve djegëse”** dru zjarri fondi i parashikuar prej **300 mijë lekë** është realizuar.

Shërbimi **për dezinfektimin** e ambjenteve të Çerdheve është parashikuar në vlerën prej **40 mijë lekë**. Është realizuar për vlerën **32 mijë lekë**.

Në zërin “**Shpenzime Transporti“** fondi i parashikuar përfshin vlerën prej **200 mijë lekë** në të cilën përfshihen shpenzimet që janë për blerje karburanti është realizuar.Në zërin **“Mirëmbajtje e zakonshme e magazines ushqimore”** është realizuar.

**Mirëmbajtje e aparateve dhe paisjeve teknike** në vlerën prej **40 mijë lekë** është realizuar dhe **30 mijë lekë** për mirëmbajtje të paisjeve të zyrës përdoren për t’u realizuar sipas nevojës.

Në zërin “**Shpenzime përsigurimin e ndërtesave”** fondi i planifikuar është **40 mijë lekë** dhe është realizuar.

3. **“Transferta Buxhetore për individë”** që akordohet për rastet e daljes në pension.

4. Në zërin **"Investime"** fondi i planifikuar është **400 mijë lekë** për **Blerje paisje TIK** me plan **200 mijë** dhe është parashikur gjate vitit**,** ndërsa **Blerje paisje orendi** me plan **200 mijë lekë** janë realizuar.

- **P10430.O9.A2**. Rikonstruksioni i Çerdhes "Manush Alimani".

Gjatë vitit 2020, Bashkia Shkodër ka vlerësuar dhe analizuar gjëndjen infrastrukturore të çerdheve në territorin e saj dhe ka lindur nevoja për rikonstruksionin e plotë të godinës së çerdhes "Manush Alimani" për shkak të gjëndjes së saj të amortizuar.
Në bazë të verifikimeve që janë bërë ka rezultuar që kjo çerdhe ka nevojë të theksuar për rikonstruksion të plotë, pasi godina është në gjëndje shumë të amortizuar të dyshemesë, mureve, dyerve, tavanit dhe dritareve. Për vitin 2022 është planifikuar ndërhyrja infrastukturore pranë kësaj çerdheje. Është kryer proçedura e prokurimit për projektimin e objektit "Rikonstruksioni i Çerdhes "Manush Alimani".

## Programi 10661: Strehimi social

### Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i programit të **"Strehimi social".**

- Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2022 kanë qenë:

- O1.Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë.

- O2.Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm.

### Realizimi i Buxhetit të planifikuar te programi "Strehimi social":

*000/leke*

| **Programi 10661** | **Shpenzime operative** | **Transferta** | **Investime** | **Totali** |
|---|---|---|---|---|
| PBA 2022 | 1,150 | 7,100 | | 8,250 |
| Plani fillestar 2022 | 2,216 | 8,756 | 28,027 | 38,999 |
| Plani i rishikuar 2022 | 1,917 | 12,287 | 15,388 | 29,591 |
| Realizimi viti 2022 | 985 | 8,655 | 15,385 | 25,025 |
| % e realizimit | 51.4% | 70.4% | 100.0% | 84.6% |




Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 84.6 %, sipas zërave kryesorë më poshtë:

| | |
|---|---|
| Shpenzime korente | 67.9% |
| Investime | 100.0% |




**Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara.**

Një arsye e mosrealizimit të fondeve të planifikuara është mosdepozitimi i kontratës së qirasë nga përfituesi, duke penguar lëvrimin e fondeve të parashikuar për "Subvencionimi i qirasë në treg të lirë". Arsyeja e mosrealizimit të plotë të fondit të parashikuar tek fishe P10661.O1.A1 "Administrimi i banesave sociale me qira si pjesë e fondit publik të banesave sociale me qira të bashkisë" është se banesat sociale të bashkisë janë ndërtime të reja, rikonstruksion i plotë dhe ndërhyrja për mirëmbajtje nuk ka qenë e nevojshme.

**Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit**

**Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2022**

| Kodi i Programit | 10661 | Emertimi i programit: | Strehimi social | | | | | | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qellimi 1 | Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. | | | | | | | | ..... |
| | | | | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| ***Objektivi 1*** | Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë | | | | | | | | |
| | | 1 | Numri personave të mbështetur me strehim social | 159 | 450 | 450 | 125 | 28% | |
| | | 2 | Numri i banesave sociale funksionale si pjesë e fondit të banesave sociale me qira të bashkisë | 51 | 107 | 107 | 79 | 74% | |
| | | 3 | Numri i individe/familjevë që perfitojne banesa sociale me qira | 16 | 150 | 150 | 69 | 46% | |
| ***Objektivi 2*** | Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në | | | | | | | | |
| | | 4 | Numri i aplikimeve për subvencionim qiraje | 55 | 55 | 65 | 70 | 108% | |
| | | 5 | Numri i aplikimeve për subvencionimin e interesave të kredisë | 100 | 100 | 130 | 147 | 113% | |
| | | 6 | Numri i aplikimeve për banesa sociale me qira | 78 | 78 | 50 | 36 | 72% | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | nevojë,përmes ofrimit të alternativave për njëstrehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm | 7 | Numri i aplikimeve pranë qeverisë dhe donatorëve për programet sociale të strehimit në vit, | 4 | 6 | 6 | 1 | 17% | |
| | | 8 | Numri i zonave të vlerësuara për zhvillim dhe pajisje me infrastrukturë me qëllim strehimin; | 1 | 2 | 2 | 0 | 0% | |
| | | 9 | Numri i aplikimeve për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese; | 7 | 7 | 7 | 0 | 0% | |
| | | 10 | Numri i banesave sociale me qira;<br>Numri i familjeve përfituese;<br>Numri i përfituesve. | 28 | 28 | 28 | 28 | 100% | |

**ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"**

| **Emri i Grupit** | **Bashkia Shkodër** | **Kodi i Grupit** | **141** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| **Programi** | **Strehimi Social** | **Kodi i Programit** | **10661** |

| | **në 000/lekë** | | | | **I** | | | **II** | | | **III** | | | **IV** | **Luhatjet në Koston për Njësi** | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kodi** | **Emërtimi i Produktit** | **Njësia matëse** | **Sasia Faktike (sipas vitit 2021)** | **Shpenzimet (sipas vitit 2021)** | **Kosto për Njësi (sipas vitit 2021)** | **Sasia (sipas planit te vitit 2022** | **Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022)** | **Kosto për Njësi (sipas planit** | **Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2022)** | **Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2022** | **Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar** | **Sasia Faktike (viti 2022)** | **Shpenzimet Faktike (viti 2022)** | **Kosto për Njësi Faktike (viti 2022** | **V = IV - I** | **V = IV - II** | **V = IV - III** | **Komente** |

| | | | | | | | | të vitit 2022) | | | viti 2022) | | | ) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Persona të mbështetur me strehim social në banesa sociale me qira | numri personave | 159 | 115 | 1 | 450 | 1,150 | 3 | 450 | 1,917 | 4 | 125 | 985 | 8 | 7 | 5 | 4 | |
| **2** | Persona të mbështetur me subvencionim qiraje në tregun e lire dhe perfitues të subvencionimit të interesave të kredisë për banesa me kosto të ulët | numër aplikimesh | 44 | 3,747 | 85 | 155 | 7,100 | 46 | 155 | 12,287 | 79 | 217 | 8,655 | 40 | -45 | -6 | -39 | |
| **3** | Projekte për përmiresimin e kushteve të banimit të komuniteteve të paforizuara | numër projektesh | 4 | 0 | 0 | 6 | 0 | 0 | 6 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| **4** | Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social | numri i banesave sociale | 28 | 50,574 | 1,806 | 28 | 0 | 0 | 28 | 15,388 | 550 | 28 | 15,385 | 549 | -1,257 | 549 | 0 | |

Për vitin 2022 në Programin **“Strehimi social”,** në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara, janë parashikuar këto aktivitete”:

| **Aktivitete/Projekte** | **Institucioni** | **Statusi i Aktiviteteve** | | | **000/leke** |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Totali** | | |
| | | | **Plani fillestar 2022** | **Plani i rishikuar 2022** | **Realizimi 2022** |
| **P10661.O1.A1 Administrimi i banesave sociale me qira si pjesë e fondit publik të banesave sociale me qira në pronësi të bashkisë & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,150 | 1,917 | 985 |
| **P06190 Kodi i Ministrise P10661.O2.A1 Zbatimi i programeve të strehimit social & te trasheguara** | Bashkia Shkodër | Realizuar | 7,100 | 12,287 | 8,655 |
| **P10661.O2.A2 Projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit** | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| **P6190.O2.A3. Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksion I ish Konviktit te Shkolles Veterinare) te trasheguara** | Bashkia Shkoder | Realizuar | - | 15,388 | 15,385 |
| **10661 Strehimi social** | | | **8,250** | **29,591** | **25,025** |
| **Te trasheguara** | | | **30,749** | **-** | **-** |
| **Totali** | | | **38,999** | **29,591** | **25,025** |

- **P10661.O1.A1** Administrimi i banesave sociale me qira të ngritura pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr 6.dhe ofrimi i shërbimeve integruese & zhvilluese.

Fondi publik i banesave sociale me qira në pronësi të bashkisë Shkodër përbëhet nga dy godina të dala jashtë funksionit dhe të përshtatura për strehim social si dhe ndërtim i ri me kontenier, të cilët, aktualisht janë funksionale.

Bashkia Shkodër administron tre Banesa Sociale me Qira, pjesë e fondit publik të banesave sociale me qira në pronësi të bashkisë, të cilat kanë 79 njësi banimi në total, ku përfitojnë rreth 69 familje të sistemuara pranë këtyre banesave sociale.

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimitme nr. 2691 prot, datë 07.03.2016 që Bashkia Shkodër ka lidhur me Ministrinë e Zhvillimit Urban, është realizuar rikonstruksioni i ish-konviktit të shkollës Pyjore, me qëllim përshtatjen në banesa sociale me qira për strehimin e

jetimëve që kanë dalë nga institucionet e përkujdesit shoqëror dhe aktualisht jetojnë në konviktet e qytetit, si dhe familjeve njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë dhe ndodhen në situatë të vështirë social-ekonomike.
Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 26, datë 10.05.2022 "Për disa shtesa në VKB-në nr. 49, datë 30.10.2020 "Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale me qira pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr. 6" (pranë ish-konviktit të shkollës Pyjore) janë miratuar listat e përfituesve që kanë nënshkruar kontrata qiraje 1-vjeçare.
Janë rreth 24 njësi banimi me qira ku përfitojnë rreth 22 individë/familje, mes të cilave një familje në kushtet e nevojës emergjente për strehim, miratuar me VKB nr. 60,datë 07.11.2022.
Përfituesit pranë këtyre banesave përfitojnë edhe shërbime integruese dhe zhvilluese, me qëllim fuqizimin social-ekonomik, shërbime që ofrohen nga Qendra Komunitare "Për Familjen" nr.6.
Në mbledhjen e datës 20.12.2022 të Komisionit të Strehimit janë shqyrtuar dhe vlerësuar 2 aplikime si familje të reja përfituese pranë këtyre banesave, të cilat janë paraqitur pranë Këshillit Bashkiak për miratim.

Është miratuar niveli i qirasë për tre banesat sociale me qira, pjesëe fondit publiknë pronësi të bashkisë. Niveli i qirasë për BSQ miratohet çdo vit dheështëi vlefshëm deri më 31 janar të vitit pasardhës.

- **P06190 Kodi i Ministrise  P10661.O2.A1** Zbatimi i programeve të strehimit social

Për zbatimin e programeve sociale të strehimit, në përmbushje të detyrimeve ligjore, Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe miratuar në Këshill Bashkiak një paketë vendimesh, të cilat synojnë të rregullojnë veprimtarinë e strukturës përgjegjëse dhe Komisionit të Strehimit pranë bashkisë gjatë zbatimit të programeve sociale të strehimit.

Gjatë kësaj periudhe, informacioni në lidhje me programet e strehimit në zbatim ka qenë i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë si dhe janë shfrytëzuar mediat lokale për promovimin dhe shpërndarjen e këtij informacioni sa më shumë tek qytetarët. Gjithashtu, specialisti i strehimit pranë Bashkisë ka qenë në dispozicion për ofrimin e informacionit dhe mbështetjes së nevojshme për qytetarët, çdo ditë pranë Zyrës me Një Ndalesë.

Për instrumentin financiar "Subvencionimi i interesave të kredisë", në zbatim të programit social të strehimit "Banesë me kosto të ulët"

Bashkia Shkodër kishte në dispozicion 100 kuota të miratuara që nga viti 2019, por meqënëse këto kuota nuk janë plotësuar akoma edhe pse janë miratuar tre lista përfituesish nga Bashkia

Shkodër, pas rakordimit me bankat zbatuese në lidhje me kuotat në dispozicion për vitin 2022, Bashkia do të shpallë përsëri Thirrje në këtë program.
Deri tani, ka 22 përfitues të kredituar nga bankat.

Me datë 16.01.2023, është shpallur njoftimi me listën e aplikuesve të rinjë në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe së shpejti vazhdojnë procedurat përkatëse për trajtimin, shqyrtimin dhe miratimin e listës së përfituesve, me vendim të Këshillit Bashkiak.

Gjatë vitit 2022, është zbatuar instrumenti financiar "Subvencionimi i qirasë në treg të lirë" për programin social të strehimit "Banesa sociale me qira".
Lista e aplikuesve në këtë program strehimi i është përcjellë në nëntor të 2021, ministrisë së linjës me kërkesën për parashikimin e fondeve për financim për vitin 2022, sipas nenit 35, të ligjit nr.22 "Për Strehimin Social", dhe sipas Shtojca A "Formati i aplikimit për fonde nga buxheti i shtetit, kriteret përkatëse dhe informacioni për kategoritë, numrin e aplikimeve dhe planifikimin e fondeve nga NJVV".

Në zbatim të nenit 39, të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", përfituesit kanë dorëzuar kontratën e qirasë pas miratimit të listës së përfituesve nga Komisioni i Strehimit për të përcaktuar dhe vlerën e subvencionimit të qirasë. Në mbledhjen e Komisionit të Strehimit të datës 21.01.2022 është miratuar lista përfundimtare e përfituesve dhe vlerat e subvencionimit për secilin përfitues sipas kontratës së qirasë të depozituar pranë Komisionit të Strehimit, sipas procesverbalit përfundimtar nr. 113/b/1 prot. datë 21.01.2022.

Llogaritja e vlerës së subvencionimit të qirasë bazohet në VKM nr. 362 datë 20.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", shtojca "A", dhe realizohet në varësi të të ardhurave të familjes sipas përcaktimeve ligjore dhe vlerës mesatare të qirasë në treg të lirë të miratuar me VKB nr. 26 datë 26.6.2020 "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë në treg të lire".
Vlerat konkrete të subvencionimit të qirasë për çdo përfitues përcatohet sipas kontratave të qirasë të cilat nuk kalojnë vlerat e përcaktuara sipas shtojcës "A" të VKM-së 362, datë 20.05.2019.
Për këtë instrument financiar, për vitin 2022 janë miratuar 54 përfitues që përfitojnë subvencionim të qirasë në treg të lirë. Për të mbuluar shpenzimet, bashkia ka kërkuar shtesë buxheti nga rialokimet e fondeve të papërdorura për vitin 2021.

Për vitin 2023, për këtë instrument financiar, në zbatim të programit të banesave sociale me qira, aplikimet kanë qenë të hapura deri në muajin nëntor 2022.
Lista e aplikuesve në këtë program social të strehimit i është përcjellë në nëntor të 2022, ministrisë së linjës me kërkesën për parashikimin e fondeve për financim për vitin 2023, sipas nenit 35, të ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", dhe sipas Shtojca A "Formati i aplikimit

për fonde nga buxheti i shtetit, kriteret përkatëse dhe informacioni për kategoritë, numrin e aplikimeve dhe planifikimin e fondeve nga NJVV".

Të gjithë aplikuesit e kualifikuar në fazën e parë janë njoftuar për plotësimin dhe dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe janë mbështetur nga struktura përgjegjëse për strehimin në Bashki.

Në mbledhjen e Komisionit të Strehimit të datës 20.12.2022, është miratuar lista e përfituesve të instrumentit financiar të subvencionit të qirasë në treg të lirë për vitin 2023, sipas procesverbalit përfundimtar të mbledhjes së Komisionit, me nr. 18336/1 prot, datë 20.12.2022.

Në zbatim të nenit 39, të ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", përfituesit kanë dorëzuar kontratën e qirasë brenda afateve kohore ligjore pas miratimit të listës së përfituesve nga Komisioni i Strehimit për të përcaktuar dhe vlerën e subvencionimit të qirasë.

Llogaritja e vlerës së subvencionimit të qirasë bazohet në VKM nr. 362, datë 20.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", shtojca "A", dhe realizohet në varësi të të ardhurave të familjes sipas përcaktimeve ligjore dhe vlerës mesatare të qirasë në treg të lirë të miratuar me VKB.
Vlerat konkrete të subvencionimit të qirasë për çdo përfitues, përcaktohen sipas kontratave të qirasë, të cilat nuk kalojnë vlerat e përcaktuara sipas shtojcës "A" të VKM-së 362, datë 20.05.2019.

Me VKB nr. 12, datë 31.01.2023 është miratuar lista e përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për vitin 2023, me 61 familje përfituese.

**P10661.O2.A2** Projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit.

Ka përfunduar projekti i strehimit social "Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri, godina sociale, me kontenier 1+1 dhe 2+1)", që synon përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom për 27 familje rome në Bashkinë Shkodër. Janë nënshkruar kontratat e qirasë me familjet përfituese dhe aktualisht janë sistemuar pranë këtyre godinave sociale 23 familje përfituese, me VKB nr. 29, datë 03.06.2021 "Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin rom dhe për miratimin e "Rregullores së administrimit të banesave sociale me qira të ngritura për komunitetin rom në zbatim të projektit "Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri godina, me kontenier 1+1

dhe 2+1). Gjithashtu, është miratuar me vendim të Këshill Bashkiak masa e qirasë mujore në këto banesa.
Në mbledhjen e datës 20.12.2022 të Komisionit të Strehimit janë shqyrtuar dhe vlerësuar 3 aplikime si familje të reja përfituese pranë këtyre godinave sociale, të cilat janë paraqitur pranë Këshillit Bashkiak për miratim.

- **P6190.O2.A3.** Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksion i ish Konviktit te Shkolles Veterinare)

Ka përfunduar projekti i adaptimittë ish-konviktit të shkollës Veterinare në banesa sociale. Bashkia Shkodër ka aplikuar për programin banesa sociale me qira, adaptim i objektit ekzistues, sepse objekti kishte nevojë emergjente për rikonstruksion. Nga ky projekt, janë rikonstruktuar 28 banesa sociale. Ky projekt është miratuar nga ministria e linjës me bashkëfinancim me Bashkinë Shkodër. Me VKB nr. 24, datë 10.05.2022 është miratuar lista e përfituesve me 26 familje pranë këtyre banesave sociale me qira. Aktualisht, janë sistemuar 24 familje. Dy prej familjeve përfituese nuk kanë nënshkruar kontratën e qirasë me Bashkinë Shkodër.
Në mbledhjen e datës 20.12.2022 të Komisionit të Strehimit janë shqyrtuar dhe vlerësuar 2 aplikime si familje të reja përfituese pranë këtyre godinave sociale, të cilat janë paraqitur pranë Këshillit Bashkiak për miratim.

Për të shtuar fondin e banesave sociale të Bashkisë Shkodër është riaplikuar pranë ministrisë së linjës për shtesë kati pranë banesave sociale me qira pranë ish-konviktit tëshkollës Veterinare, për 14 njësi banimi të reja, në mënyrë që të rritet numri i përfituesve për strehim të përshtatshëm.